



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në “Drejtorinë Rajonale Tatimore FIER”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“AUDITIM FINANCIAR DHE
PËRPUTHSHMËRIE”**

NË

**DREJTORINË RAJONALE
TATIMORE FIER**

Tetor 2021

Nr.	Përmbatja	FAOE
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE		
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	6-9
II. Hyrja		
1.	Objekti i auditimit.....	9-13
2.	Qëllimi i auditimit.....	9-13
3.	Identifikimi i çështjes.....	9-13
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	9-13
5.	Përgjegjësitë e audituesve.....	9-13
6.	Kriteret e vlerësimit.....	9-13
7.	Standardet e auditimit.....	9-13
8.	Metodat e auditimit.....	9-13
9.	Dokumentimi i auditimit.....	9-13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT		
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	13-14
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:	
1.	Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare për vitet 2018-2019. Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, marrëdhëniet me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta për periudhën nën auditim. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimi financiar dhe kontrollit, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar sipas komponentëve dhe kontrollit të brendshëm.....	14-32
2.	Përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me të ardhurat, duke ndaluar në fushat kryesore të të ardhurave tatimore (tatim fitimi, tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi vlerën e shtuar, etj.) dhe jo tatimore për periudhën 01.01.2018-30.09.2020 në mbështetje të kuadrit fiskal në fuqi.....	32-100
2/1	Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor.....	100-247
3.	Vlerësimi i evidentimit, saktësisë së llogaritjes së ndryshimeve në aktivet(e trupëzuara dhe qarkulluese) të institucionit, pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, zbatimi i dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmërie procedurave për nxjerrjen jashtëpërdorimit/asgjësimin aktiveve.....	63-69
4.	Saktësia dhe rregullshmëria e kryerjes së pagesave për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimeve për udhëtim e dieta, si dhe shpenzime personeli të tjera, etj.....	69-79
5.	Zbatimi i dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga planifikimi i nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave për punime mallra/shërbime nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 i ndryshuar.....	79-92
6.	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme dhe probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....	92-100
IV. GJETJET DHE RAKOMANDIMET		247-263
V. Aneks		264-295

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të Programit të Auditimit nr.844/1, datë 25.9.2020, ndryshuar, kreu misionin e auditimit në subjektin Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (*këtu e më poshtë DRT Fier*), për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.12.2020.

Mbi konstatimet e rezultuara u mbajtën akt konstatimet përkatëse me personat përgjegjës si dhe rezultatet e auditimit u trajtuan në Projektraportin e Auditimit, i cili i është përcjellë subjektit me shkresën nr.844/65, datë 04.08.2021. Nga ana e subjektit nuk është përcjellë në KLSH një kopje e Projektraportit të auditimit i shoqëruar me deklaratën e nënshkruar nga titullari i insitucionit ose personi i autorizuar prej tij, që konfirmon njohjen me Projektraportin, por janë përcjellë vetëm komente/observacione nga personat përgjegjës në lidhje me gjetjet e auditimit. Në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit, nenit 34, u realizua në ambientet e KLSH ballafaqimi date 15.09.2021 me drejtuesit e lartë të saj, grupit të auditimit dhe subjektit. Në takim u diskutuan çështje të auditimit për të cilat kishte komente dhe opinione të ndryshme, të cilat u pasqyruan në këtë Raport përfundimtar auditimi duke u shoqëruar me trajtimet përkatëse.

1.2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi i përputhshmërisë veprimtarisë Drejtorisë Kontrollit (<i>kontrolli në vend/operacional</i>) rezultoi se në kontrollet e ushtruara në subjektet tatimpagues dhe raportet e kontrollit të hartuara nga inspektorët: - nuk kanë zbatuar pikat e programit të kontrollit, pasi nuk kanë kryer rakordimin e bërjeve në FDP me ato të deklaruara në pasqyrat financiare, - nuk shoqërohen me raport teknik të inxhinierit mbi punimet e kryera/situacione punimesh, -nuk është bërë analiza e bilancit material përsa i përket artikujve që gjatë procesit transformohen në mallra ose shërbime referuar normativave të lejuara ligjore, -nuk është dokumentuar kontrolli kronologjik i shitjeve, lidhja Faturë-Libër-FDP, etj. Veprimet kanë shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 105,255 mijë lekë , konkretisht të specifikuara sipas subjekteve: -G.K, me vlerë 53,555,148 Lekë. -A....., me vlerë 406,740 Lekë. -A....., me vlerë 1,314,575 Lekë. -A.D, me vlerë 166,006 Lekë. -K.J, me vlerën 18,871 Lekë. -F.A, me vlerë 492,986 Lekë. -B.L, me vlerë 97,276 Lekë. -SH....., me vlerë 1,270,200 Lekë. -H....., me vlerën4,704,308 Lekë. -B.... me vlerë 43,230,089 Lekë.	Fq 100-164	I lartë	DRT Fier, për tatimpaguesit e cituar më sipër, për të cilët nga grupi i kontrollit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit të llogaritura të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 105,255 mijë lekë , të merren masa që për subjektet të bëjë propozimet përkatëse në DPT për ri kontroll tatimor.
2.	Nga auditimi i raport <i>kontrolleve të plota dhe tematike</i> , për vitet 2018- 2020, me përzgjedhje për subjektet e listuara në tabelën referuese u konstatua se: inspektorët e kontrollit nuk kanë zbatuar pikat e	fq	I lartë	DRT Fier, për 9 tatimpaguesit e cituar më sipër, për të cilët nga grupi i auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit në vlerën 24,419 mijë lekë , të marrë masa për tatimpaguesit

	<p>programit dhe të manualit të kontrollit dhe legjislacionin tatimor pasi nuk kanë kryer rakordimin e blerjeve në FDP me ato të deklaruara në pasqyrat financiare, nuk janë kryer analizat e shitjeve apo rritjes së çmimit, nuk kanë verifikuar diferencën tatime / dogana, konstatohen diferenca në inventar, nuk kanë analizuar saktë edhe në ato raste kur është kryer bilanci material, nuk janë kryer analizat e shpenzimeve për zërat kryesore të zhvillimit të aktivitetit referuar kartës teknologjike, nuk pasqyrojnë në raport kontrolli situacionet e punimeve. Veprimet e sipërme kanë shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 26,390,516 lekë.</p>			e identifikuar me shkelje të bëjë propozimet përkatëse në DPT për ri kontroll tatimor dhe të merren masa për kryerjen e një vlerësimi tatimor.
3.	<p>Nga auditimi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (në Vend/operacional) Fier, në kuadër të planit operacional të Korrik-Dhjetor 2020, për zbatimin e pikës “<i>për subjektet të cilat kanë transaksione me subjektet të cilat janë në hetim për skemë mashtrimi me TVSH-në</i>” ka rezultuar: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT është përcjell subjekti B.... si subjekt i cili ka patur transaksione me tatimpagues që kanë kryer transaksione në formë të një skeme mashtrimi me TVSH-në, dhe nga kjo drejtori është kërkuar të verifikohen transaksionet me këto subjekte. Nga DRT-Fier është iniciuar një vizitë fiskale mbi këtë çështje e cila nuk ka arritur të përmbushi objektivin e verifikimit. Në programin e vizitës fiskale nuk është përcaktuar periudha që do të kontrollohet si dhe afati kryerjes së saj. Kontrolli ka përfshirë vetëm një periudhë 18 mujore pa arritur të vlerësojë transaksionet e dyshimta, objekt i informacionit të përcjell. Nga verifikimet mbi të dhënat e DRT-Fier rezultoi se, subjekt B.... ka kryer blerje në 9 (nëntë) tatimpagues “fiktiv” duke përfituar fatura blerje për të cilat DRT-Fier duhet të kishte kryer saktësimin dhe më pas vlerësimin e situatës financiare e cila krijon një efekt financiar të munguar që llogaritet në vlerën rreth 43,230 mijë lekë. Rezultatet e verifikimit nuk janë përcjellë nga DRT-Fier drejt organit qendror por as nga ky i fundit nuk evidentohen hapa të ndërmarra në kuadër të monitorimit mbi veprimet e kryera nga ana e DRT-Fier çka tregon për një bashkëveprim dhe monitorim jo efektiv midis hallkave institucionale.</p>	fq	I lartë	Nga ana e DRT-Fier të merren masat e menjëhershme për rivlerësimin e situatës financiare të subjektit B...dhe arkëtimin e detyrimeve përkatëse në vlerën 43,230 mijë lekë.
4.	<p>Nga auditimi i raportit të kontrollit për subjektin tatimpagues “B...”, “E....” dhe “R....” konstatohet: -mos verifikim i burimit të huasë nga subjekti/ortaku, (“B....”) pasi Raporti nuk shprehet mbi rritjen prej 39,039 mijë lekë që ka pësuar në pasqyrat financiare/pasivi viti 2018, llogaria “Detyrimet afatshkurtra” në zërin “hua të tjera”, pasi në 2018 rezulton vlera prej 74,689 mijë lekë ndërkohë që në 2017 rezulton në vlerën 35,650 mijë lekë. Rritja e vlerës argumentohet “<i>si pasojë e shtimit të inventarit</i>”. Gjithashtu dhe nga verifikimi në sistemin C@TS, rezulton që fitimi për këtë subjekt për periudhën nga 2015-2018 është në total në vlerën 10,735 mijë lekë, nuk rezulton që ortaku i subjektit të jetë aksioner në ndonjë subjekt tjetër nga verifikimi edhe i deklaratave individuale. -mos raportim RAD (<i>Raportim i aktivitetit</i>)</p>	Fq 100-164	I lartë	<p>-Të merren masa nga DPT Fier, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pas konstatimit të bërë nga KLSH, mbi burimin e fitimit për vlerën 39,039 mijë lekë, që përfaqëson rritjen llogarisë së ortakut të subjektit tatimpagues “B....” SHPK. -Të merren masa nga DRT Fier, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pas konstatimit të bërë nga KLSH, mbi burimin e fitimit për vlerën 32,765 mijë lekë, që përfaqëson rritjen që ka pësuar huaja krahasuar me vitin 2015, për subjektin tatimpagues “E....” SHPK. - Të merren masa nga DRT Fier, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve,</p>

	<p>të dyshimtë) në organet kompetente</p> <p>-mos verifikim i rritjes së huas në vlerën 32,765 mijë lekë ("E....") në pasqyrat financiare viti 2016, e për pasojë asnjë analizë mbi tatim fitimin apo tatimin në burim, ku nga subjekti është deklaruar në llogarinë "detyrimet afatshkurtra" zërin "të tjera të pagueshme" vlera prej 97,000 mijë lekë krahasuar me vitin paraardhës 2015, që ishte 64,243 mijë lekë, por analizohet vetëm si "hua të tjera në shumën 97,000,000 lekë përfaqësojnë detyrime ndaj të tjerëve",</p> <p>-mos dhënie informacioni në Raport, nëse huatë janë transferuar përmes sistemit bankar apo deklaratave të ligjshme mbi huamarrjen,</p> <p>-mos raportim RAD (Raportim i aktivitetit të dyshimtë) në organet kompetente.</p> <p>-mos verifikim i rritjes së huas në vlerën 97,895 mijë lekë, në bilancin e shoqërisë (R...) në lidhje me huat e mëdha (Zëri "Detyrime të tjera"), që janë në vlerë më të lartë se edhe vetë kreditë bankare formale të marra në institucionet e kredisë (kreditë afatshkurtër+kreditë afatgjata), (viti 2017 vlera e huas 255,114 mijë lekë, viti 2018 është 353,009 mijë lekë),</p> <p>-nuk ka informacion nëse janë të kaluara jashtë apo nëpërmjet sistemit bankar si dhe nuk është dhënë informacion mbi kushtet që është marrë ky borxh.</p> <p>-nuk është verifikuar burimi i këtyre huave të deklaruara, me të cilën lidhet ngushtë tatim fitimi apo tatimi në burim.</p>			<p>pas konstatimit të bërë nga KLSH, mbi burimin e fitimit për vlerën 97,895 mijë lekë, që përfaqëson rritjen që ka pësuar huaja krahasuar me vitin 2017 për subjektin tatimpagues "R...." SHPK.</p>
5.	<p>Nga analizimi i të dhënave të Sektorit të Informatikës mbi mospërputhjet në deklarim të situatës financiare me të ardhurat, në pasqyrat financiare u konstatua se: 200 tatimpagues të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2018, nuk kanë kryer pagesën e Tatim Fitimit në vlerën 20,889 mijë lekë, 263 tatimpagues kanë kryer deklarimin e TF 2019 por nuk kanë kryer pagesën e tatim fitimit në vlerën 59,690 mijë lekë, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total në vlerën 80,579 mijë lekë. Detyrimi duhet të ishte arkëtuar për TFe vitit 2018 brenda datës 31.03.2019 dhe për TF e vitit 2019 brenda datës 31.03.2020.</p>	Fq 170-206	I lartë	<p>Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Fier të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit në vlerën 80,579 mijë lekë, nga subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën, duke ndjekur procedurat administrative dhe gjyqësore.</p>
6.	<p>Në DRT, në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 12.06.2015 për subjektet e përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar, nuk është dorëzuar kopje e marrëveshjes dhe kontratës, por vetëm autorizimi nga AKBN. Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat/ vlerat për përjashtim nga TVSH sipas subjekteve dhe viteve përkatëse të miratuara në autorizim dhe vlerave që rezultojnë në deklaratën e TVSH-s, kategoria "shitje të përjashtuara nga TVSH", "shitje pa TVSH" dhe "Eksporte", ku për subjektet sipas anekseve përkatëse në Raportin e auditimit janë vlerësuar detyrime në vlerën 12,848 mijë lekë dhe gjobë 100% në vlerën 12,848 mijë lekë.</p>	Fq170-206	I lartë	<p>DRT Fier të marrë masa për rivlerësimin e detyrimit të subjekteve sipas anekseve përkatëse në raportin e auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve në buxhetin e shtetit në vlerën 12,848 mijë lekë dhe gjobë 100% në vlerën 12,848 mijë lekë.</p>
7.	<p>Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (kontrolli nga zyra), u konstatua se, DRT-Fier nuk ka përmbushur detyrimin për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me diferenca në qarkullim sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në TFTH-s dhe TVSH-s, në kundërshtim me</p>	Fq 170-206	I lartë	<p>DRT Fier/ Sektori i Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në vlerën 100,987 mijë lekë, në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse</p>

	<p>përcaktimet ligjore e proceduralë të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Për bizneset e vogla pa TVSH u konstatuan 530 subjekte për vitin 2018 me qarkullim sipas kasës me vlerë 116,290 mijë lekë tepër sesa të ardhurat e deklaruar në TTHF dhe 347 subjekte për vitin 2019 me vlerë 90,761 mijë më të lartë sesa të ardhurat e deklaruar në TTHF. <i>Për sa më sipër konstatohen parregullsi në të ardhurat e deklaruar për vitin 2018-2019 për 877 subjekte në vlerën 207,051 mijë lekë.</i></p> <p>b) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-s ku u konstatuan: 40 subjekte për vitin 2018 me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 44,118,079 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 14,706 mijë lekë. <i>(7,353 mijë lekë detyrim dhe 100 % gjobë).</i></p> <p>Për vitin 2019 u konstatuan 175 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 48,649 mijë lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 16,216 mijë lekë. <i>(8,108 mijë lekë detyrim dhe 100 % gjobë).</i></p> <p>c) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-s, ku u konstatuan për vitin 2018, 36 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 95,455 mijë lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 31,818 mijë lekë. <i>(15,909 mijë lekë detyrim dhe 100% gjobë).</i></p> <p>Për vitin 2019 u konstatuan 28 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH në vlerën 114,741,121 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 38,247 mijë lekë <i>(19,124 mijë lekë dhe 100% gjobë).</i></p>			<p>sipas tabelave bashkangjitur Projekt raportit në seksionin “Aneksë”.</p>
8.	<p>Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (<i>kontrolli nga zyra</i>), u konstatua se, DRT-Fier nuk ka përmbushur detyrimin për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me deklarim të pasaktë të (TF) Tatimit mbi Fitimin dhe (TVSH) Tatimin mbi vlerën e shtuar, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e proceduriale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Konstatimi i diferencave negative të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruar në formularin vjetor të TF me totalin e shitjeve të vetë deklaruar nëpërmjet deklaratave të TVSH –së, kjo sipas situatës financiare për periudhat 2017-2019. Përkatesisht 28 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2017 në shumën 714,252, mijë lekë krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëjtin vit, 27 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2018 në shumën 1,232,651 mijë lekë krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëjtin vit, 52 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të</p>	Fq170-206	I lartë	<p>DRT Fier/Sektori i Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në vlerën totale 1,736,530 mijë lekë, në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse sipas aneksit 1-6, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p>

<p>ardhura në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2019 në shumën 1,371,739 mijë lekë.</p> <p><i>Këto diferenca sjellin një vlerë të munguar në zërin Tatim Fitimi në total prej 995,593 mijë lekë (3,318,642 mijë lekë x 15% detyrim + gjobë 100%)</i></p> <p>b) Në deklaratat vjetore të TF për vitin 2017 u konstatuan 28 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura më shumë në këtë deklaratë krahasuar me shitjet e deklaruara në situatën financiare të këtij viti, në shumën 369,729 mijë lekë, për vitin 2018 u konstatuan 58 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën 825,557 mijë lekë krahasuar me shitjet e deklaruara sipas situatës financiare vjetore, për vitin 2019 u konstatuan 58 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën 657,057 mijë lekë krahasuar me shitjet e deklaruara sipas situatës financiare vjetore.</p> <p><i>Këto diferenca sjellin një vlerë të munguar të TVSH-së në shumën totale prej 740,937 mijë lekë. (1,852,343 mijë lekë x 20% + gjobë 100%).</i></p>			
---	--	--	--

Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, (DRT Fier) konstatohen mospërputhje me kriteret e përcaktuara por jo të përhapura në lidhje me pasqyrat financiare 2018-2019 të cilat janë baza për dhënien e opinionit më poshtë.

Opinion i pa modifikuar /me theksim çështje për pasqyrat financiare.

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit financiar për pasqyrat financiare 2018-2019 nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e zbatueshme të përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsive materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre. Bazuar në rezultatet e auditimit, japim **opinion të pa modifikuar/me theksim çështje**, se pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, përveç aspekteve që adresohen në bazën për theksim të çështjes, duke përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e një opinionit të pamodifikuar/pakualifikuar.

Në opinionin tonë, përse i takon shkallës së zbatimit nga subjekti DRT Fier, të standardeve mbi raportimin financiar, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të performancës financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare për periudhën 01.01.2018-31.12.2019, kjo referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Çështje për tu theksuar janë:

-Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, në bilancin e vitit 2019, rezulton me vlerë 0 lekë, nga 21,728,526 lekë që duhej të ishte pasqyruar.

-Transferimi i aktiveve (llog. 214), nuk është shoqëruar me shkresën e Njesisë (DPT) për transferim, si dhe nuk ka autorizim për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues.

-Regjistrimet në kontabilitet për llog.214 janë kryer mbështetur vetëm mbi dokumentacion vërtetues (fletë hyrj dhe fletë dalje), pa shoqëruar me dokumentacion autorizues nga DPT, që të autorizojë kryerjen e një veprimit ekonomik e që në çdo rast duhet t’i bashkëlidhet

dokumentit vërtetues.

-Në bilancin e vitit 2019, vlera kontabël e llogarisë 215 “Mjete transporti” rezulton në shumën 10,786,081 lekë, nga 10,898,739 lekë që duhej të ishte në fakt, pra më e ulët për 112,658 lekë, si rrjedhojë e llogaritjes gabim të amortizimit për automjetin Toyota Rav 4 AA 826PK,

-Në pasqyrat financiare viti 2019, shuma 9,611,993 lekë është keq klasifikuar në llog.7200 “Grand korert”, shuma nuk përfaqëson grand por të ardhura jo tatimore. Për rrjedhojë, duhej të klasifikohej në grupin e llog.71 “Të ardhura jo tatimore”.

Opinionin mbi përputhshmërinë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Në realizimin e angazhimit të auditimit, kemi audituar përputhshmërinë e subjektit me ligjet dhe aktet normative në lidhje me realizimin e ushtrimit të kontrollit tatimor, mbledhjes së detyrimeve të papaguara, shërbimit të tatimpaguesit si dhe hetimit tatimor.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga DRT Fier, e cila konsiderohet nga ana e jonë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe kemi ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionin me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit, niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, të detajuara më pas në ISSAI-t e nivelit 4. Procedura e auditimit është bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; praktikat e mira që lidhen me pavarësinë dhe ISSAI 130 Kodin e Etikës së INTOSAI dhe Kodin e Etikës së KLSH-së, si dhe dokumentimi i auditimit ka shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionin në këtë auditim përputhshmërie.

Në gjykimin tonë, bazuar në sa më sipër dhe në evidenca të mjaftueshme të auditimit mbi çështjet e përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2020, nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e zbatueshme të përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi. Krahas parregullsive materiale sasiore, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre, duke rezultuar me një **Opinion të Kundërt**.

Baza për Opinionin e Kundërt

Nga rezultatet e këtij auditimi, të cilat kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë konstatimet si më poshtë:

-Nuk janë marrë masa për vlerësimin nga zyra për tatimpaguesit me diferenca në qarkullim sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në TTH-s dhe TVSH-s jo në përputhje me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a) parregullsi në të ardhurat e deklaruarat për vitin 2018-2019, për 877 subjekte në vlerën 207,051 mijë lekë.

b) për bizneset e vogla me Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh), për vitin 2018-2019, u konstatuan 215 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 30,922 mijë lekë.

c) për Biznesin e Madh (BM) u konstatuan për vitin 2018-2019, 64 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-së duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 70,065 mijë lekë.

-Nuk është përmbushur detyrimi për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me deklarim të pasaktë të Tatimit mbi Fitimin (TF) dhe Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a) për periudhat 2017-2019, janë konstatuar 55 subjekte me diferenca në qarkullim të të ardhurave të deklaruarat në formularin vjetor të Tatim Fitimit (TF) me totalin e shitjeve të vetë deklaruarat nëpërmjet deklaratave të TVSh –së, që kanë sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në zërin Tatim Fitimi në vlerën 995,593 mijë lekë.

b) për periudhat 2017-2019 janë konstatuar 86 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura më shumë krahasuar me shitjet e deklaruarat në situatën financiare të këtij viti, që kanë sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në zërin TVSh në vlerën 740,937 mijë lekë.

c) për periudhat 2018-2019 u konstatuan 463 tatimpagues të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2018-2019, por nuk kanë kryer pagesën e TF duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total në vlerën **80,579 mijë lekë**, detyrim i cili duhet të ishte arkëtuar për TF 2018 brenda datës 31.03.2019 dhe për TF 2019 brenda datës 31.03.2020.

d) 10 subjekte në kundërshtim me ligjin nr.94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, neni 38/9, kanë përfituar nga pagesa prej 8% e dividendit, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit të ardhura të munguara në vlerën **5,709 mijë lekë**.

-Në kontrollet e ushtruara në subjektet tatimpagues, në shumicën e rasteve nuk janë zbatuar pikat e programit të kontrollit veprime të cilat kanë shkaktuar **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 129,674 mijë lekë**.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Strukturat drejtuese të DRT Fier, përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;

-Nëse të ardhurat janë realizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore dhe aktet në zbatim të tij, etj.;

-Nëse janë zbatuar dispozitat e akteve ligjore e nënligjore në planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për procedurat tatimore në RSH;

-Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

-Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.844/1, datë 25.9.2020, ndryshuar me shkresat: nr.844/2, datë 05.10.2020, nr.844/3, datë 02.11.2020, nr.844/4, datë 16.12.2020, nr.844/5, datë 18.01.2021, nr. 844/8, datë 04.03.2021, nr.844/11, datë 19.03.2021 dhe nr.844/15, datë 01.04.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.09.2020 deri në datë 09.04.2021, në subjektin Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (*këtu e më poshtë DRT Fier*), për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.12.2020 u krye auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1.M. H. (Përgjegjës Grupi)

2.E. H. Auditues

3.T. A. Auditues

4.A. B. Auditues

5.B. Z. Auditues

të cilët përgatitën këtë Raport duke iu referuar edhe gjetjeve dhe rekomandimeve të konstatuara nga grupi i mëparshëm i auditimit (*për të cilat janë mbajtur me subjektin aktet përkatëse pjesë përbërëse e këtij Raporti*), deri në momentin e zëvendësimit të audituesve sipas Programit nr.844/5, datë 18.01.2021.

1. Objekti i auditimit:

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator duke përfshirë këtu, dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit dhe dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së tij, nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit: synon në përcaktimin nëse pasqyrat financiare të subjektit që auditohen janë paraqitur saktë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e

raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Auditimi synon arritjen e objektivave mbi dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, në përcaktimin nga ana e audituesve:

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financimit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

-dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së DRT Fier.

3. Identifikimi i çështjes.

Raporti mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të DRT Fier, për periudhën 01.01.2018-31.12.2020, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

-Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare për vitet 2018-2019. Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, marrëdhëniet me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta për periudhën nën auditim. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar sipas komponentëve dhe kontrollit të brendshëm.

-Përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me të ardhurat, duke ndaluar në fushat kryesore të të ardhurave tatimore (tatim fitimi, tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi vlerën e shtuar, etj.) dhe jo tatimore për periudhën 01.01.2018-30.09.2020 në mbështetje të kuadrit fiskal në fuqi.

-Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtorisë së Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

-Vlerësimi i evidentimit, saktësisë së llogaritjes së ndryshimeve në aktivet (e trupëzuara dhe qarkulluese) të institucionit, pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, zbatimi i dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmëria e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve.

-Saktësia dhe rregullshmëria e kryerjes së pagesave për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimeve për udhëtim e dieta, si dhe shpenzime personeli të tjera, etj.

-Zbatimi i dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga planifikimi i nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave për punime, mallra/shërbime nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 i ndryshuar.

-Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme dhe probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5.Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-^{së}) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;

-Nëse të ardhurat janë realizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore dhe aktet në zbatim të tij, etj.;

-Nëse janë zbatuar dispozitat e akteve ligjore e nënligjore në planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për procedurat tatimore në RSH;

-Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

-Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

6.Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtimeve të auditimit:

-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr.9920, datë 19.5.2008“Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; si dhe Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” etj.

-VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;

-VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar;

-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr. 4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”; Udhëzimi i APP nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike”;

-Akte të tjera ligjore/nënligjore.

7.Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 100 (Parime parimet themelore të auditimit të sektorit publik), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 400 (Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstion specifik të auditimit të përputhshmërisë;

-ISSAI 4000 "Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

-ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;

-Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.;

-Praktikat të mira të fushës.

8.Metodat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, Drejtoria Rajonale Fier (DRT) funksion në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar e cila ushtron kontroll tatimor në subjektet tatimpagues, në mënyrë që të verifikojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* – mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejttimeve në veçanti.

9.Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e DRT Fier, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohej për ushtrimin e gjyqimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar me akt konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projektraporti.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.

1.INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.

Drejtoria Rajonale Fier (DRT) është krijuar dhe funksion në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe është strukturë e Administratës Tatimore Qendrore që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve si dhe mbledhjen e borxhit tatimor, sipas Urdhrit nr. 13, datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave “Për miratimin e Rregullores së brendshme”, Objekti kryesor si detyrim ligjor është të verifikojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi. DRT përbëhet nga Drejtori funksionale, Sektor dhe Zyra. Çdo strukturë organizative brenda DRT-së mbulon një funksion të caktuar.

2.Përshkrimi i auditimit, sipas drejttimeve të auditimit:

2.1. Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare për vitet 2018 dhe 2019 (afate, formate, miratimi dhe dërgimi). Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, marrëdhëniet me Drejtorinë e Përgjithshme dhe me palët e treta për periudhën nën auditim. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

2.1.1 Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare për vitet 2018 dhe 2019 (afate, formate, miratimi dhe dërgimi). Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, marrëdhëniet me Drejtorinë e Përgjithshme dhe me palët e treta për periudhën nën auditim.

Nga auditimi u konstatua se, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pasqyrat financiare të vitit 2018.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Pasqyrat financiare të DRT-së Fier të vitit 2018, përmbajnë të gjitha formatet e pasqyrave që përcaktohen në pikën 25 dhe 26 të Udhëzimit të MFE Nr.8, datë 09.03.2018, konkretisht nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Pasqyra e performancës financiare;
- Pasqyra e flukseve monetare;
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Shënimet shpjeguese, si dhe pasqyrat statistikore;
- Pasqyrat e investimeve dhe burimit të financimit të tyre;
- Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Në zbatim të UMFE nr.8, datë 09.03.2018, DPT me shkresën Nr.852, datë 16.01.2019 ka udhëzuar DRT-të, në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe afatet e dorëzimit në degën e thesarit të rrethit përkatës brenda datës 28 shkurt dhe në DPT brenda datës 10 Mars. Nga auditimi në lidhje me respektimin e afateve të dorëzimit të pasqyrave financiare, rezulton se, pasqyrat financiare të vitit 2018, DRT Fier i ka dërguar në degën e thesarit të rrethit Fier, me shkresën nr.5048, datë 09.04.2019, 26 ditë pune me vonesë dhe në DPT me shkresën nr.4383, datë 29.03.2019, me 13 ditë pune vonesë (Për më tepër rezulton që pasqyrat financiare të vitit 2018 janë dërguar në DPT përpara se të konfirmoheshin nga Dega e Thesarit Fier), ndërkohë kopje e pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk rezulton e dërguar në zyrën e statistikës së rrethit.

Titullari i DRT Fier, që është njëkohësisht NA i institucionit nuk rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2018, por vetëm shkresat përcjellëse të tyre për Degën e Thesarit të Rrethit, si dhe për DPT. Formatet e pasqyrave financiare për vitin 2018, si dhe shënimet shpjeguese janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues dhe Drejtori i Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit.

Konstatim:

Për pasqyrat financiare të vitit 2018 nuk janë respektuar kërkesat e përcaktuara në pikën 117 të UMFE nr.8, datë 09.03.2018 ku shprehimisht citohet:

Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur, brenda muajit mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet bërë duke dërguar një kopje në Degën e Thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikës së rrethit.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2018 rezultoi:

Në pasqyrën e pozicionit financiar aktivet paraqiten në shumën 243,642,149 lekë, prej të cilave AASH në shumën 163,160,101 lekë dhe AAGJ në shumën 80,482,047 lekë.

Aktivët Afatshkurtra paraqiten në bilanc në shumën 163,160,101 lekë dhe përbëhen nga:

Në lekë

EMËRTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
-----------------	---------------------------	----------------------------

	I.Aktivët Afat shkurtra	163,160,101	164,550,118
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	59,803	59,803
520	Disponibilitete në Thesar	59,803	59,803
	2.Gjendje Inventari qarkullues	1,654,686	948,818
31	Materiale	405,964	49,578
35	Mallra	1,248,722	899,240
	3.Llogari të Arketushme (Klasa 4)	161,445,612	163,541,497
468	Debitorë të ndryshëm	80,789,991	71,261,797
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	80,655,621	92,279,700

Burimi i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Llog. 31 në shumën 405,964 lekë dhe llog.35 në shumën 1,248,722 lekë, paraqesin gjendjen e inventarit në magazinë në datë 31.12.2018 për materiale dhe mallra, shuma këto të kuadruara me ditarin e magazinës.

ANALIZA E DEBI-KREDIVE:

Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Klasa 4 e pasqyruar në aktiv të bilancit (Formati nr.1), në shumën 161,445,612 lekë, përfaqësohet nga llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 80,789,991 lekë dhe llog.4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në shumën 80,655,621 lekë.

Referuar bilancit të DRT Fier, Llog. 468 në aktiv të bilancit, në shumën 80,789,991 lekë, ka si kundër parti në pasiv të bilancit, në të njëjtën shumë, llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe llog. 4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në shumën 80,655,621 lekë ka në pasiv të bilancit: llog.4341 “Operacione me shtetin detyrime” në shumën 67,404,921 lekë; llog 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën 2,193,682 lekë; llog 42 “Detyrime ndaj personelit” në shumën 7,697,605 lekë; llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në shumën 716,629 lekë;llog.435&436 “Sigurime Shoqërore& Shëndetësore” në shumën 2,642,784 lekë.

Referuar përcaktimeve të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018,

Konstatim:

Keq klasifikim i llogarive të klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”, pa efekt në kuadrin aktiv-pasiv të pasqyrave financiare të vitit 2018, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e kap 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 ku sqarohet se:

“...Llog 468 “Debitorë të ndryshëm” ka si kundër parti në pasiv të bilancit llog. 4341 “Operacione me shtetin detyrime” dhe Llog.4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në aktiv të bilancit, ka si kundër parti në pasiv të bilancit: llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”; llog 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; llog 42 “Detyrime ndaj personelit”; llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”; llog.435 &436 “Sigurime Shoqërore & Shëndetësore”. Llog 4342, operacione me shtetin (të drejta) kreditohet për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me buxhetin e vitit ushtrimor raportues..”.

“Aktivet afatgjata materiale” paraqiten në bilanc në shumën 80,482,047 lekë dhe në analizë përfaqësojnë:

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M Ë R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	21	2.Aktive Afatgjata materiale	80,482,047	86,922,036
2	210	Toka, Troje, Terrene	0	0
3	212	Ndërtesa e Konstruksione	55,893,220	58,834,968
4	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	35,498	44,373
5	214	Instalime teknike, makineri e paisje	534,740	662,236
6	215	Mjete Transporti	13,482,601	16,296,836

7	218	Inventar ekonomik	10,535,988	11,083,624
---	-----	-------------------	------------	------------

Burimi i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të DRT Fier për vitin 2018, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve, zëri “Toka, Troje, Terrene” (llog. 210) nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (janë evidentuar për vleftën zero lekë).

DRT Fier zotëron/administron:


-Certifikatë pronësie të lëshuar nga ZRPP në datë 12.12.2017, me numër pasurie 2/146, në zonën kadastrale nr.8534 në Fier, të llojit truall me sipërfaqe totale 1,224 m², prej së cilës 550 m² ndërtesë, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

- Vërtetim hipotekor, lëshuar nga ZRPP në datë 07.07.2012, me numër pasurie 14/86, në zonën kadastrale 8571, në Lushnje, me sipërfaqe 570 m² e llojit truall + ndërtesë, prej së cilës 265 m² ndërtesë, në përgjegjësi administrimi të DPT.


VKM nr. 89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016), përcakton vlerën e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për secilin qytet.

Për vitin 2018, aktiv afatgjatë material me certifikatë pronësie rezulton sipërfaqe tokë truall në Fier 1,224 m² dhe në Lushnje, 570 m².

Referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016, vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall, në qytetin e Fierit (1,224 m²), në zonën kadastrale nr.8534, vlerësohet me 12,893 lekë/m², për rrjedhje vlera e tokës truall për sipas përcaktimeve të VKM nr.89, datë 03.02.2016 përllorarit: 1,224 m²x 12,893 lekë/m² = 15,781,032 lekë.



Referuar VKM nr. 89, datë 03.02.2016, vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall (570 m²), në qytetin e Lushnjës, në zonën kadastrale nr. 8571, vlerësohet me 9,709 lekë/m², për rrjedhje vlera e tokës truall për sipas përcaktimeve të VKM nr.89, datë 03.02.2016 përllorarit: 570 m²x 9,709 lekë/m² = 5,534,130 lekë.



Konstatim:

Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në bilancin e vitit 2018 rezulton me vlerë 0 lekë, nga 21,315,162 lekë që duhej të ishte pasqyruar, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet VKM nr.89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016), ku:

...përcakton vlerën e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për secilin qytet dhe kërkesave të kapitullit 2. Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018.

Zëri “Ndërtesa e Konstruksione” (Ilog 212) rezulton në bilanc në shumën 55,893,220 lekë, e cila në analizë përfaqëson:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera fillestare	Vlera e mbetur e aktivitetit në lekë në datë 31.12.2018
1	Garazh në Fier	1	1,500,000	920,550
2	Garazh në Lushnje	3	400,400	270,831
3	Godina (Dega e Tatimeve, Lushnje)	1	15,388,693	12,963,589
4	Investime në ndërtesë (Dega e Tatimeve, Lushnje)	1	9,798,460	6,563,159
5	Muri Rrethues Lushnje	1	250,200	169,235
6	Ndërtesa me sh kate + investimi në ndërtesë në Fier		40,722,656	29,277,379
7	Ndërtesë 2 kate me tulla në Mallakastër	1	9,364,335	5,728,476
	Totali		77,424,744	55,893,220

Burimi i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Për zërin “Ndërtesa e Konstruksione” është llogaritur amortizim në masën 5% mbi vlerën e mbetur, veçmas për secilin objekt, në përputhje me kërkesat e pikës 36 të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe në bilanc çdo objekt është paraqitur me vlerën e mbetur në datë 31.12.2018.

Zëri “Rrugë, rrjete, vepra ujore” (Ilog 213) paraqitet në bilanc me vlerë të mbetur në datë 31.12.2018, në shumën 35,498 lekë. Për këtë zë është llogaritur amortizimi në masën 20%, sa parashikohet në UMFE nr.8, datë 09.03.2018.

Zëri “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (Ilog. 214) për vlerën 534,740 lekë është i zbrërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Për çdo pajisje është llogaritur amortizim në masën 20% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e UMFE nr.8, datë 09.03.2018.

Zëri “Mjete transporti” (Ilog. 215) është për vlerën 13,482,601lekë është i zbrërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. (14 mjete transporti, 2 prej të cilëve me vlerë të mbetur 0). Për çdo mjet transporti është llogaritur amortizim në masën 20% mbi vlerën e mbetur. Nga testimet e kryera rezultoi se, për automjetin Toyota Rav 4AA 826 PK me vlerë fillestare 5,102,269 lekë, i bërë hyrje në DRT Fier në datë 15.12.2016, nuk është

Ilogaritur amortizim për vitin 2017. Në vitin 2018, amortizimi është llogaritur në masën 20% mbi vlerën fillestare, ndonëse aktivi është bërë hyrje që në vitin 2016 dhe shumës së rezultuar 1,020,453 lekë (5,102,269 lekë x 20%) i është shtuar amortizimi i vitit 2017, llogaritur sipas DRT Fier në shumën 704,113 lekë¹.

Në lekë

Nr.llog.	Emërtimi	Viti i hyrjes në përdorim në DRT	Vlera fillestare e aktivitet	Norma e amortizimit vjetor ne %	Amortizimi i akumuluar sipas bilancit në fund të vitit 2017	Amortizimi i llog. për vitin 2018	Amortizimi i akumuluar deri në fund të vitit 2018	Vlera e mbetur e aktivitet në datë 31.12.2018
Llog. nga DRT								
215	Automjet Toyota Rav 4 AA 826PK	15.12.2016	5,102,269	20%	-	1,724,567	1,724,567	3,377,702
Llog. nga KLSH								
215	Automjet Toyota Rav 4 AA 826PK	15.12.16	5,102,269	20%	704,113 (5,102,269x 13.8%)	879,631	1,583,7447	3,518,525

Burimi i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Konstatim:

Në bilancin e vitit 2018, vlera kontabël e llogarisë 215 “Mjete transporti” rezulton në shumën 13,482,601 lekë, nga 13,623,423 lekë, që duhej të ishte në fakt, pra më e ulët për 140,822 lekë, si rrjedhojë e llogaritjes gabim të amortizimit për automjetin Toyota Rav 4 AA 826PK, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e kapitullit 2. Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 ku citohet:

Vlera kontabël – përbën shumën neto të aktivitet (kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi).

Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 10,535,988 lekë është i zberthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer dhe nga auditimi nuk rezultuan diferenca.

Gjatë vitit 2018 AAGJ janë shtuar në shumën 8,682,996 lekë, nëpërmjet transferimit nga DPT, prej së cilës llog 215 është shtuar në shumën 6,207,208 lekë dhe llog 218, në shumën 2,475,788 lekë. Transferimi i aktiveve (llog. 218), nuk është shoqëruar me shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve, ndërkohë që për të gjithë transferimet e kryera (llog.215+llog.218) nuk ka autorizim për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 55 të UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, ku citohet:

“Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues”.

Përsa më sipër, regjistrimet kontabël për zërin “Mjete transporti” janë kryer mbështetur të dokumentacion autorizues dhe vërtetues në përputhje me kërkesat e UMF Nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

Konstatim:

¹ Në vitin 2017 norma e amortizimit për automjetet llogaritej në masën 13.8% referuar Udhëzimit nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”

Regjistrimet në kontabilitet për zërin “Inventar ekonomik”, të transferuar nga DPT, janë kryer mbështetur vetëm mbi dokumentacion vërtetues (fletë hyrje dhe fletë dalje), i pashoqëruar me dokumentacion autorizues, që të autorizojë kryerjen e një veprimit ekonomik e që në çdo rast duhet t’i bashkëlidhet dokumentit vërtetues, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 35 të UMF Nr.30, datë 27.12.2011 ku citohet:

Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

AAGJ rezultojnë të pasqyruara në F1. “Pozicioni Financiar” në shumën 80,482,047 lekë dhe po në këtë shumë, në F.7 “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ”, që pasqyron aktivet me vlerë të mbetur, pra pasqyrat financiare kuadrojnë me njëra tjetrën, por referuar konstatimeve të sipërcituara nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen reale të AAGJ.

Pasivet (detyrimet) paraqiten në bilanc në shumën 161,505,415 lekë, si vijon:

Në lekë

	E M Ë R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
B	PASIVET(DETYRIMET)	161,505,415	163,601,300
	I.Pasivet Afat shkurtra	161,505,415	163,601,300
	1. Llogari të Pagueshme	161,505,415	163,601,300
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,193,682	
42	Detyrime ndaj personelit	7,697,605	7,828,978
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	716,629	762,510
435	Sigurime Shoqërore	2,320,622	2,382,531
436	Sigurime Shëndetësore	322,162	330,637
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	59,803	59,803
467	Kreditorë të ndryshëm	80,789,991	80,974,701
4341	Operacione me shtetin	67,404,921	71,262,140

Burimi i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Në analizë llogaritë janë trajtuar si kundër parti kur analizuam llogaritë e aktivitetit.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur aktivet neto/fondet të institucionit që arrijnë në vlerën 82,136,734 lekë e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit të bilancit 243,642,149 lekë dhe B “*detyrimeve*”, të pasivit në vlerën 161,505,415 lekë. Totali i fondeve të veta është i njëjtë me totalin e aktiveve neto gjithsej në fund të vitit 2018, pasqyruar në pasqyrën F.4 të bilancit.

Fondet e veta në analizë përbëhen nga llogaria 101 zëri “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar në shumën 81,430,867 lekë dhe llogaria 85. Zëri “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” në shumën 705,868 lekë.

Në llogarinë 101 finalizohen në kontabilitet si burime gjithçka që ka ndodhur me kapitalizimin në fonde të aktiveve, si dhe të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet që kanë ndodhur në aktivet e njësisë.

Formati F.2 i pasqyrave financiare “Pasqyra e performancës financiare” paraqet të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara sipas natyrës ekonomike.

Të ardhurat e klasifikuara sipas natyrës ekonomike paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. Llog.	P Ë R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR	VITI I MËPARSHËM
A	TË ARDHURAT	173,217,979	173,674,004
71	III.TË ARDHURA JO TATIMORE	23,122,920	21,547,613
711	2.Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	23,122,920	21,547,613

7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	15,897,008	14,161,037
7114	Të ardhura nga biletat	7,225,912	7,386,576
72	V.GRANTE KORENTE	150,095,059	152,126,391
720	I.Grant korrent i Brendshëm	150,095,059	152,126,391
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	136,844,359	59,847,034
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	13,250,700	92,279,357

Burimi të dhënave: DSHM/DRT Fier

Të ardhurat përbëhen nga të ardhurat jo tatimore dhe nga granti korrent. Të ardhurat jo tatimore, për vitin 2018 janë realizuar në shumën 23,122,920 lekë dhe përbëhen nga të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në shumën 15,897,008 lekë dhe të ardhura nga biletat në shumën 7,225,912 lekë, që përfaqësojnë të ardhura të konstatuara por të pa arkëtuara nga Bashkitë/Prefektura/Prokuroritë/Gjykatat, për vlerën e pullave të taksës gjendje ende të pa shitura. Të ardhurat rezultojnë të kuadruara me akt rakordimet e mbajtura midis DRT Fier dhe Bashkitë/Prefektura/Prokuroritë/Gjykatat që operojnë në juridiksionin e DRT Fier.

Llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në shumën 13,250,750 lekë përfaqëson detyrimet e konstatuara për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe detyrimet për shpenzime udhëtim e dieta, detyrimet për energji elektrike/ujë/shërbim postar/tel, të muajit dhjetor 2018, likuiduar në janar të vitit 2019. Vlera e llog. 7206 është e kuadruar me vlerën e llog të klasës 4 në Formatin nr.1 të bilancit (401-436).

Në shpenzimet e ushtrimit, janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 705,868 lekë të ndara sipas zërave:

Llogaria (600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 118,944,842 lekë ose 69 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm në shumën 115,660,110 lekë dhe paga personel i përkohshëm në shumën 3,284,732 lekë.

Llogaria (601) “Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore” në shumën 19,780,877 lekë ose 11% të totalit të shpenzimeve.

Llogaria (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në shumën 11,127,943 lekë ose 6.4% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2018.

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 112,000 lekë ose 0,06% të totalit të shpenzimeve përfaqëson 82,000 lekë shpërblim për dalje në pension dhe 30,000 lekë shpërblim për rast fatkeqësie.

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në shumën - 705,868 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Shpenzimet e klasifikuara sipas natyrës ekonomike paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. Llog.	P Ë R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR	VITI I MËPARSHËM
B	SHPENZIMET	172,512,111	173,674,004
600	IPAGAT DHE PËRFITIMET E PUNONJËSVE	118,944,842	122,063,516
6001	Paga, personel i përhershëm	115,660,110	114,941,719
6002	Paga personel i përkohshëm	3,284,732	7,121,797
601	II.KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE	19,780,877	20,368,694
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	17,741,737	18,292,936
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	2,039,140	2,075,758
602	III.BLERJE MALLRA E SHËRBIME	11,127,943	9,463,399
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	217,200	179,520
6022	Shërbime nga te treta	3,639,605	3,516,802
6023	Shpenzime transporti	694,620	573,900
6024	Shpenzime udhëtimi	4,989,920	2,184,190
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	391,416	
6026	Shpenzime per qiramarrje	605,172	605,172
6029	Shpenzime te tjera operative	590,010	2,403,815

	V.TRANSFERIME KORENTE	112,000	82,000
606	3.Transferime per Buxhetet Familjare e Individë	112,000	82,000
6060	Transferata të paguara nga ISSH e ISKSH	82,000	82,000
6061	Transferata paguar nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	30,000	
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SË INVENTARIT	- 705,868	311,170
	IX.SHPENZIME TE TJERA	23,252,317	21,385,225
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUdhËS	705,868	0

Burimi i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Bilanci hartohet mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për periudhën raportuese, ndërsa akt rakordimi me degën e thesarit paraqet shpenzimet faktike të kryera gjatë vitit ushtrimor. Nisur nga ky fakt, duke krahasuar të dhënat e bilancit për llog.600 dhe llog.601 me të dhënat sipas listë pagesave të hartuara nga DRT Fier, rezulton si vijon:

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Bilanci	Listë pagesa për periudhën janar – dhjetor 2018	Diferenca
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	118,944,842	118,923,304	+21,538
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	17,741,737	17,742,199	-462
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	2,039,140	2,011,805	+27,335

Testuar nga KLSH

Nga auditimi rezulton mospërputhje midis të dhënave të pasqyruara në bilanc dhe të dhënave sipas listë pagesave, për të njëjtën periudhë ushtrimore, si vijon:

-Zëri “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në bilanc rezulton 21,538 lekë më shumë se të dhënat sipas listë pagesave për të njëjtën periudhë ushtrimore.

-Zëri “Kontribut i sigurimeve shoqërore” në bilanc rezulton 462 lekë më pak se të dhënat sipas listë pagesave për të njëjtën periudhë ushtrimore.

-Zëri “Kontribut i sigurimeve shëndetësore” në bilanc rezulton 27,335 lekë më shumë se të dhënat sipas listë pagesave për të njëjtën periudhë ushtrimore.

Nga krahasimi i të dhënave midis pasqyrave të bilancit dhe konkretisht formatit nr.2 me formatin nr.8 nga auditimi rezulton si vijon:

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Formati nr.2 i Bilancit viti 2018	Formati nr.8 i Bilancit viti 2018	Diferenca
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	118,944,842	118,934,224	+10,618

Testuar nga KLSH

Konstatim:

Mosrakordim midis pasqyrave financiare dhe pasqyrave statistikore që i shoqërojnë ato. Më konkretisht, zëri paga dhe përfitimet e punonjësve në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” rezulton 10,618 lekë më shumë se i njëjti zë në formatin nr.8 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 26 të kap.III, të UMF E Nr.8, datë 09.03.2018 “ku citohet:

Pasqyrat financiare vjetore shoqërohen nga disa pasqyra statistikore të cilat janë: Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre; Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Të dhënat për zërin “Paga e shpenzime të tjera personeli” referuar lëvizjeve të bankës së muajit Janar 2018 dhe Janar 2019, paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. i Llog.	Emërtimi	Shpenzime Banka/Janar 2019	Shpenzime Banka/Janar 2018	Diferenca
600	Paga e shpenzime të tjera personeli	7,697,605	7,838,978	141,373

Testuar nga KLSH

Në lekë

Nr. Llog.	Emërtimi	Bilanci 2018	Likuiduar Banka Janar 2019	Diferenca
42	Detyrime ndaj personelit	7,697,605	7,697,605	-

Testuar nga KLSH

Në lekë

Nr. Llog.	Emërtimi	Bilanci 2017	Likuiduar Banka Janar 2018	Diferenca
42	Detyrime ndaj personelit	7,828,978	7,838,978	10,000

Testuar nga KLSH

Nga krahasimi i të dhënave të bilancit (F.2 Shpenzimet) me akt rakordimin me degën e thesarit për fondet e vitit 2018, rezulton si vijon:

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Bilanci 2018	Akt rakordimi me D.Tesarit 31.12.2018	Diferenca
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	118,944,842	119,150,339	-205,497

Testuar nga KLSH

Sqarojmë se fondi i pagave referuar akt rakordimit me degën e thesarit, përfaqëson pagat e punonjësve për periudhën dhjetor 2017-nëntor 2018, ndërkohë që të dhënat e bilancit 2018 pasqyrojnë konstatimin e pagave bruto/borderotë e muajve janar-dhjetor 2018, pra diferenca midis të dhënave të bilancit dhe akt rakordimit me degën e thesarit duhet të jetë e barabartë me diferencën midis pagave të muajit dhjetor 2017 paguar në janar të vitit 2018 me pagat e muajit dhjetor 2018, paguar në janar të vitit 2019.

Nga testimet e kryera nga auditimi mbi konstatimin dhe pagesën e pagave të punonjësve, rezulton një mos rakordim midis të dhënave të thesarit dhe bilancit në shumën 64,124 lekë.

Së fundmi është plotësuar formati nr.5 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2018 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, UMFE nr.8, datë 09.03.2018, Urdhrit të Ministrit të Financave nr.64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar me shumat përkatëse.

Veprimet për vitin 2018 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 me përjashtim të konstatimeve të sipërcituara. Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet janë hedhur periodikisht.

Pasqyrat financiare të vitit 2019.

Pasqyrat financiare të DRT-së Fier të vitit 2019, përmbajnë të gjitha formatet e pasqyrave që përcaktohen në pikën 25 dhe 26 të UMFE nr.8, datë 09.03.2018, konkretisht nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Pasqyra e performancës financiare;
- Pasqyra e flukseve monetare;
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Shënimet shpjeguese, si dhe pasqyrat statistikore;
- Pasqyrat e investimeve dhe burimit të financimit të tyre;
- Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Në zbatim të udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, DPT me shkresën nr.1298, datë 21.01.2020, ka udhëzuar DRT-të, në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe afatet e dorëzimit në Degën e Thesarit të rrethit përkatës brenda datës 28 shkurt dhe në DPT brenda datës 10 Mars.

Nga auditimi në lidhje me respektimin e afateve të dorëzimit të pasqyrave financiare, rezulton se, pasqyrat financiare të vitit 2019, DRT Fier i ka dërguar në degën e thesarit të rrethit Fier, me shkresën nr.3927/1, datë 30.03.2020 me 20 ditë pune vonesë dhe në DPT me shkresën nr.3927, datë 30.03.2020, me 14 ditë pune vonesë, ndërkohë kopje e pasqyrave financiare të vitit 2019 nuk rezulton e dërguar në zyrën e statistikës së rrethit.

Titullari i DRT Fier, që është njëkohësisht NA i institucionit nuk rezulton të ketë nënshkruar formatet e pasqyrave financiare të vitit 2019, por vetëm faqen e parë, shënimet shpjeguese dhe shkresat përcjellëse të tyre për në Degën e Thesarit të Rrethit, si dhe në DPT. Formatet e pasqyrave financiare për vitin 2018, si dhe shënimet shpjeguese janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues dhe Drejtori i Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit.

Konstatim:

Për pasqyrat financiare të vitit 2019 nuk janë respektuar kërkesat e pikës 117 të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 ku shprehimisht citohet:

Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur, brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet bërë duke dërguar një kopje në Degën e Thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikës së rrethit.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2019 rezultoi:

Në pasqyrën e pozicionit financiar aktivet paraqiten në shumën 242,073,804 lekë, prej të cilave AASH në shumën 168,725,922 lekë dhe AAGJ në shumën 73,347,882 lekë.

Aktivt Afatshkurtra paraqiten në bilanc në shumën 168,725,922 lekë dhe përbëhen nga:

Në lekë

	E M Ë R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
	I.Aktivt Afat shkurtra	168,725,922	163,160,101
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	2,292,198	59,803
520	Disponibilitete në Thesar	2,292,198	59,803
	2.Gjendje Inventari qarkullues	1,815,631	1,654,686
31	Materiale	466,805	405,964
35	Mallra	1,348,826	1,248,722
	3.Llogari te Arkëtueshme	164,618,092	161,445,612
468	Debitorë të ndryshëm	69,791,002	80,789,991
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	94,827,090	80,655,621

Burimi të dhënave i: DSHM/DRT Fier

Llog. 31 në shumën 466,805 lekë përfaqëson mallra të konfiskuara gjendje deri në datë 31.12.2019 në shumën 425,777 lekë dhe material gjendje në magazinë në shumën 41,028 lekë dhe llog.35 në shumën 1,348,826 lekë, paraqet gjendjen e inventarit në magazinë për mallra, shuma këto të kuadruara me ditarin e magazinës. në datë 31.12.2019.

ANALIZA E DEBI-KREDIVE:

Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Klasa 4 e pasqyruar në aktiv të bilancit (Formati nr.1), në shumën 164,618,092 lekë, përfaqësohet nga llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 69,791,002 lekë dhe llog.4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në shumën 94,827,090 lekë. Llog.468 në aktiv të bilancit, në shumën 69,791,002 lekë, përputhet në të njëjtën shumë me llog.4341 “Operacione

me shtetin detyrime” në pasiv të bilancit që përfaqëson debitorët jashtë sistemit, të cilët në analizë paraqiten si vijon:

-Debitorë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në total në shumën 4,766,573 lekë, prej së cilës, principali në shumën 2,309,042 lekë, gjoba në shumën 1,903,660 lekë dhe interesi në shumën 553,871 lekë.

-Veprime ligjore në total në shumën 55,411,434 lekë, prej së cilës detyrimi në shumën 37,039,726 lekë, gjoba në shumën 9,259,931 lekë dhe interesi në shumën 9,111,777 lekë.

-DRT Fier debitorë në shumën 9,611,993 përfaqëson debitorët për pulla takse, rakorduar me subjektet (Bashki/Prokurori/Gjykatë), të tërhequra por të pa shitura dhe të pa arkëtuara.

-Bashkitë Fier dhe Roskovec debitorë për 1% TFTH të vitit 2017 në shumën 1,002 lekë.

Llog 4342, operacione me shtetin (të drejta) kreditohet për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me buxhetin e vitit ushtrimor raportues.

Llog.4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në aktiv të bilancit, në shumën 94,827,090 lekë përputhet në pasiv të bilancit me:

-llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 80,762,700 lekë, që përfaqëson kreditorët jashtë sistemit të analizuar në pasqyrat financiare si vijon:

- Akcizë në shumën 73,055,913 lekë;
- Tatim biznesi i vogël në shumën 6,151,647 lekë;
- Gjoba në shumën 820,812 lekë;
- Kasa fiskale në shumën 11,000 lekë;
- Pulla takse në shumën 676,263 lekë;
- Fatura në shumën 44,055 lekë;
- 1% TFTH në shumën 810 lekë.

-llog 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në shumën 2,955,010 lekë paraqet detyrime të konstatuara të institucionit ndaj punonjësve për “udhëtim e dieta” në shumën 2,371,940 lekë, detyrim i njohur i 2019, por i paguar në vitin 2020 dhe në shumën 583,070 lekë, detyrimet për energji elektrike/ujë/shërbim postar/tel, likuiduar me bankën e muajit janar 2020.

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolluam rregullshmërinë e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve;

-llog 42 “Detyrime ndaj personelit” në shumën 7,709,324 lekë paraqet detyrime të konstatuara të institucionit ndaj punonjësve, për pagat neto të muajit dhjetor 2019, të cilat paguhen në janar të vitit 2020. Nga auditimi i transaksioneve të kryera gjatë muajit janar 2020 rezulton se janë paguar shpenzime për paga me Urdhër shpenzimin nr.1-10 datë 10.01.2020, në shumën 7,709,324 lekë;

-llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në shumën 744,085 lekë;

-llog.435 &436“Sigurime Shoqërore & Shëndetësore” në shumën 2,655,971 lekë;

“Aktivet afatgjata materiale” paraqiten në bilanc në shumën 73,347,882 lekë, nga 80,482,047 lekë që ishin në vitin 2018. Diferenca prej 7,134,165 lekë përfaqëson amortizimin e AAGJ për vitin 2019. Në analizë AAGJ përfaqësojnë:

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMËRTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	21	2.Aktive Afatgjata materiale	73,347,882	80,482,047
2	210	Toka, Troje, Terrene	0	0

3	212	Ndërtesa e Konstruksione	53,098,559	55,893,220
4	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	28,399	35,498
5	214	Instalime teknike, makineri e paisje	508,712	534,740
6	215	Mjete Transporti	10,786,081	13,482,601
7	218	Inventar ekonomik	8,926,131	10,535,988

Burim i të dhënave: DSHM/DRT Fier

Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të DRT Fier për vitin 2019, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve, zëri “Toka, Troje, Terrene” (llog. 210) nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (janë evidentuar për vleftën zero lekë).


DRT Fier zotëron:

- Certifikatë pronësie të lëshuar nga ZRPP në datë 12.12.2017, me numër pasurie 2/146, në zonën kadastrale nr.8534 në Fier, të llojit truall me sipërfaqe totale 1,224 m², prej së cilës 550 m² ndërtesë, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Vërtetim hipotekor, lëshuar nga ZRPP në datë 07.07.2012, me numër pasurie 14/86, në zonën kadastrale 8571, në Lushnje, me sipërfaqe 570 m² e llojit truall + ndërtesë, prej së cilës 265 m² ndërtesë, në përgjegjësi administrimi të DPT.
- Certifikatë pronësie të lëshuar nga ZRPP në datë 30.07.2019, me numër pasurie 2/302, në zonën kadastrale nr.1090 në Ballsh, të llojit truall me sipërfaqe totale 294 m², prej së cilës 143 m² ndërtesë, pronar Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VKM Nr. 89, datë 03.02.2016, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016), përcakton vlerën e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për secilin qytet.

Referuar VKM-së së sipërcituar nga grupi i auditimit për llogari të bilancit të vitit 2018 u përllorarit vlera e truallit për zonën kadastrale nr.8534 në Fier (1,224 m²x 12,893 lekë/m² = 15,781,032 lekë) dhe vlera e truallit për zonën kadastrale nr.8571 në Lushnje (570 m²x 9,709 lekë/m² = 5,534,130 lekë). Për llogari të paraqitjes në bilancin e vitit 2019, përlloraritëm edhe vlerën e truallit për zonën kadastrale nr.1090 në Ballsh (294 m²x 1,406 lekë/m² =413,364 lekë).

Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në bilancin e vitit 2019 duhej të pasqyrohej në shumën 21,728,526 lekë, ndërkohë rezulton me vlerë 0 lekë.



Titulli:	Pasaktësi në pasqyrat financiare të viteve 2018-2019 në LLog.210 “Toka Troje, Terrene”.
Situata:	Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në bilancin e vitit 2019 rezulton me vlerë 0 lekë, nga 21,728,526 lekë që duhej të ishte pasqyruar, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e VKM nr.89, datë 03.02.2016, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016), që përcakton vlerën e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për secilin qytet dhe kërkesave të kapitullit 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të UMFE nr.8, datë 09.03.2018.
Kriteri:	VKM nr.89, datë 03.02.2016 dhe UMFE nr.8, datë 09.03.2018, kap. 2, Klasa 2.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësia në pasqyrat financiare, në llog.210 ‘Toka Troje, Terrene’, me pasojë llogaritjen gabim në vlerën 21,728,526 lekë.
Shkaku:	Veprime jo në përputhje VKM nr.89, datë 03.02.2016 dhe UMFE nr.8, datë

	09.03.2018, kap. 2, Klasa 2.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DRT Fier, të marrë masa për të saktësuar vlerën e “Aktiveve Afatgjata”, “Toka, Troje, Terrene” si dhe për të kontabilizuar e paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të AAM.

Zëri “Ndërtesa e Konstruksione” (Ilog 212) rezulton në bilanc në shumën 53,098,559 lekë, nga 55,893,220 lekë që paraqitej në vitin 2018. Diferenca prej 2,794,661 lekë përfaqëson amortizimin e aktiveve llogaritur vetëm për vitin 2019. Amortizimi rezulton i llogaritur në masën 5% mbi vlerën e mbetur, veçmas për secilin objekt, në përputhje me kërkesat e pikës 36 të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 dhe në bilanc çdo objekt është paraqitur me vlerën e mbetur në datë 31.12.2019.

Zëri “Rrugë, rrjete, vepra ujore” (Ilog 213) paraqitet në bilanc në shumën 28,399 lekë nga 35,498 lekë që paraqitej në fund të vitit 2018. Diferenca prej 7,099 lekë përfaqëson amortizimin e aktiveve llogaritur vetëm për vitin 2019. Për këtë zë është llogaritur amortizimi në masën 20%, sa parashikohet në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.

Zëri “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (Ilog. 214) paraqitet në bilanc në shumën 508,712 lekë nga 534,740 lekë që paraqitej në fund të vitit 2018. Për çdo pajisje është llogaritur amortizim në masën 20% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e UMFE Nr.8, datë 09.03.2018. Gjatë vitit 2019 janë bërë hyrje nga DPT, 8 kondicionerë me vlerë fillestare 281,090 lekë, amortizim të akumuluar deri në datë 31.12.2018, në shumën 172,210 lekë. Për këtë zë është llogaritur amortizimi në masën 20%, sa parashikohet në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018. Dokumentacion vërtetues për këtë transferim aktivësh janë fletë dalja e DPT dhe fletë hyrja e DRT Fier.

Titulli:	Transferimi i aktiveve (Ilog. 214), në pasqyrat financiare të viteve 2018-2019 ka rezultuar i pa shoqëruar me shkresën e Njesisë (DPT) për transferim, dhe pa autorizim për tërheqje malli nga NA dhe NZ si dhe regjistrimet në kontabilitet pa shoqëruar me dokumentacion autorizues nga DPT.
Situata:	<p>1. Transferimi i aktiveve (Ilog. 214), nuk është shoqëruar me shkresën e Njesisë (DPT) për transferim, si dhe nuk ka autorizim për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, veprim jo në përputhje me përcaktimet e pikës 55 të UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, ku citohet: “Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues”.</p> <p>2. Regjistrimet në kontabilitet për Ilog.214 janë kryer mbështetur vetëm mbi dokumentacion vërtetues (fletëhyrje e fletëdalje), pa shoqëruar me dokumentacion autorizues nga DPT, që të autorizojë kryerjen e një veprimit ekonomik e që në çdo rast duhet t’i bashkëlidhet dokumentit vërtetues, kërkesë kjo e pikës 35 të UMFnr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, ku citohet: <i>Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:</i></p> <p>Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.</p> <p>Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimit, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.</p>

Kriteri:	UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 55 dhe 35
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e shkresave shoqëruese të dokumentacionit
Shkaku:	Veprime jo në përputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 55 dhe 35.
Rëndësia:	I ulët
Rekomandimi:	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë DRT Fier, të marrë masa që në të gjitha rastet, transferimi dhe regjistrimi në kontabilitet i aktiveve, të kryhet mbështetur në dokumentacionin autorizues dhe vërtetues me qëllim menaxhimin me efektivitet të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Zëri “Mjete transporti” (llog. 215) paraqitet në bilanc në shumën 10,786,081 lekë nga 13,482,601 lekë që paraqitej në fund të vitit 2018. Për çdo pajisje është llogaritur amortizim në masën 20% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018. Llog 215 është e zbërthyer në mënyrë analitike dhe e rakorduar me inventarët e kryer. (14 mjete transporti, 2 prej të cilëve me vlerë të mbetur 0).

Nga testimet e kryera rezultoi se, për automjetin Toyota Rav 4AA 826 PK me vlerë fillestare 5,102,269 lekë, i bërë hyrje në DRT Fier në datë 15.12.2016, nuk është llogaritur amortizim për vitin 2017. Në vitin 2018, amortizimi është llogaritur në masën 20% mbi vlerën fillestare, ndonëse aktivi është bërë hyrje që në vitin 2016 dhe shumës së rezultuar 1, 020,453 lekë (5,102,269 lekë x 20%) i është shtuar amortizimi i vitit 2017, llogaritur sipas DRT Fier në shumën 704,113 lekë. Mbi këtë logjikë është vazhduar edhe për llogaritjen e amortizimit në vitin 2019.

Në lekë

Nr.llog.	Emërtimi	Viti i hyrjes në përdorim në DRT	Vlera fillestare aktivitet	Norma e amortizimit vjetor ne %	Amortizimi i akumuluar sipas bilancit në fund të vitit 2018	Amortizimi llog. për vitin 2019	Amortizimi akumuluar deri në fund të vitit 2019	Vlera mbetur e aktivitet në datë 31.12.2019
Llog. nga DRT								
215	Automjet Toyota Rav 4AA826PK	15.12.2016	5,102,269	20%	1,724,567	675,540	2,400,107	2,702,162
Llog. nga KLSH								
215	Automjet Toyota Rav AA 826PK	15.12.16	5,102,269	20%	1,583,744	703,705	2,287,449	2,814,820

Burimi: DSHM/DRT Fier

Shënim: Pasqyrimi jo i saktë i vlerës së mbetur të aktivitet në PF ka ardhur si rezultat i shtesës nga jashtë në vitin 2018 të amortizimit që i përket vitit 2017, i pa llogaritur dhe i paregjistruar në PF të vitit 2017. Korrigjimi i gabimit të mos llogaritjes së amortizimit për vitin 2017 duhej të kryhej duke rillogaritur edhe njëherë që nga momenti i hyrjes së aktivitet referuar normave të amortizimit të periudhave respektive.

Titulli:	Llogaritje e gabuar e amortizimit për automjetin Toyota Rav 4 AA 826PK. (viti 2019)
Situata:	Në bilancin e vitit 2019, vlera kontabël e llogarisë 215 “Mjete transporti” rezulton në shumën 10,786,081 lekë, nga 10,898,739 lekë që duhej të ishte në fakt, pra më e ulët për 112,658 lekë, si rrjedhojë e llogaritjes gabim të amortizimit për automjetin Toyota Rav 4 AA 826PK, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e kapitullit 2. Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018 ku citohet: <i>Vlera kontabël – përbën shumën neto të aktivitet (kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi).</i>
Kriteri:	UMFE nr.8, datë 09.03.2018 kapitulli 2. Klasa 2

Ndikimi/Efekti:	Llogaritje e gabuar e amortizimit të mjetit, me pasojë rezultati në bilanc në vlerën më të ulët 112,658 lekë.
Shkaku:	Kryerja e veprimeve jo në përputhje me kërkesat e UMFE nr.8, datë 09.03.2018 Kap.2, Klasa 2.
Rëndësia:	I ulët
Rekomandimi:	Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse në DRT Fier të marrë masat për të kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve në përputhje me normat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të aktiveve dhe paraqitjen e tyre me vlerë reale në pasqyrat financiare.

Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 8,926,131 lekë, nga 10,535,988 lekë që paraqitej në fund të vitit 2018. Gjatë vitit 2019 ka hyrë inventar ekonomik nga DPT me kosto historike në shumën 2,908,198 lekë dhe amortizim të akumuluar në shumën 3,231,054 lekë dhe është transferuar për në DPT inventar ekonomik me kosto historike në shumën 2,496,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në shumën 1,209,000 lekë.

AAGJ rezultojnë të pasqyruara në F1. “Pozicioni Financiar” në shumën 73,347,882 lekë lekë dhe po në këtë shumë, në F.7 “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ”, që pasqyron aktivet me vlerë neto, pra pasqyrat financiare kuadrojnë me njëra tjetrën, por referuar konstatimeve të sipërcituara nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen reale të AAGJ.

Pasivet (detyrimet) paraqiten në bilanc në shumën 166,910,290 lekë, si vijon:

Në lekë

	Emërtimi	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
B	PASIVET(DETYRIMET)	166,910,290	161,505,415
	L.Pasivet Afat shkurtra	166,910,290	161,505,415
	1. Llogari te Pagueshme	166,910,290	161,505,415
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	2,955,010	2,193,682
42	Detyrime ndaj personelit	7,709,324	7,697,605
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	744,085	716,629
435	Sigurime Shoqërore	2,332,301	2,320,622
436	Sigurime Shendetsore	323,670	322,162
44	Institucione te tjera publike	2,232,395	-
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	59,803	59,803
467	Kreditore te ndryshëm	80,762,700	80,789,991
4341	Operacione me shtetin(detyrime	69,791,002	67,404,921

Burimi: DSHM/DRT Fier

Në analizë llogaritë janë trajtuar si kundërparti kur analizuam llogaritë e aktivit.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur aktivet neto/fondet të institucionit që arrijnë në vlerën 75,163,514 lekë e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivit të bilancit 242,073,804 lekë dhe B “detyrimeve”, të pasivit në vlerën 166,910,290 lekë. Totali i fondeve të veta është i njëjtë me totalin e aktiveve neto gjithsej në fund të vitit 2019, pasqyruar në pasqyrën F.4 të bilancit.

Fondet e veta në analizë përbëhen nga llogaria 101 zëri “Teprica (Fondi i akumuluar) /Deficiti i akumuluar në shumën 75,002,568 lekë dhe llogaria 85, zëri “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” në shumën 160,945 lekë.

Formati F.2 i pasqyrave financiare “Pasqyra e performancës financiare” paraqet të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara sipas natyrës ekonomike.

Të ardhurat e klasifikuara sipas natyrës ekonomike paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. Llog.	P Ë R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MËPARSHËM
A	TE ARDHURAT	172,513,580	173,217,979
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	17,209,591	23,122,920
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	17,209,591	23,122,920
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	17,209,591	15,897,008
7114	Te ardhura nga biletat	-	7,225,912
72	V.GRANTE KORENTE	155,303,989	150,095,059
720	I.Grant korent i Brendshëm	155,303,989	150,095,059

7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	141,239,599	136,844,359
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	14,064,390	13,250,700

Burimi i të dhënave

Të ardhurat përbëhen nga të ardhurat jo tatimore dhe nga granti korent. Të ardhurat jo tatimore, për vitin 2019 janë realizuar në shumën 26,821,584 lekë dhe janë të ardhura të realizuara nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në shumën 17,209,591 dhe të ardhura nga biletat në shumën 9,611,993 lekë. Këto të ardhura rezultojnë të kuadruara me akt rakordimet e mbajtura midis DRT Fier dhe Bashkitë/Prefektura/Prokuroritë/Gjykatat që operojnë në juridiksionin e DRT Fier.

Llog.7200 “Grand nga Buxheti për NJQP në shumën 141,239,599 lekë konsiston në:

-158,810 lekë grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale referuar akt rakordimit me Degën e Thesarit për vitin 2019;

-9,611,993 lekë të ardhura të konstatuara por të pa arkëtuara nga Bashkitë/Prefektura/Prokuroritë/ Gjykatat, për vlerën e pullave të taksës, gjendje ende të pa shitura.

-131,468,796 lekë përfaqëson diferencën midis shpenzimeve faktike sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit për vitin 2019 dhe financimit të pritshëm të vitit paraardhës (144,719,496-13,250,700).

Titulli:	Klasifikim i gabuar i llog.7200 “Grand korrent”
Situata:	Shuma 9,611,993 lekë është keq klasifikuar në llog.7200 “Grand korent”, pasi kjo shumë nuk përfaqëson grand por të ardhura jo tatimore dhe për rrjedhojë duhej të klasifikohet në grupin e llog.71 “Të ardhura jo tatimore”. Ky veprim nuk është në përputhje me përcaktimet e kapitullit 4.2 të UMFE Nr.8, datë 09.03.2018, ku shprehimisht citohet: Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore” janë ato të ardhura të detyrueshme, por jo me natyrë tatimore për t’u mbledhur si nga pushteti qendror ashtu dhe organet vendore. Përfshihen të ardhurat nga ndërmarrjet dhe pronësia, të ardhura nga shërbimet administrative, të ardhura sekondare, e të tjera në përputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Më konkretisht, ky grup të ardhurash (grupi 71) në nivele tre shifrore përmban: 711-Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare, ku përfshihen tarifa me natyrë jo tatimore nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare (nga tarifa administrative dhe rregullatore, nga pagesa shërbimesh, nga shitja e mallrave e shërbimeve, nga biletat, qiratë, e të tjera).
Kriteri:	UMFE nr.8, datë 09.03.2018, kapitullit 4.2
Ndikimi/Efekti:	Klasifikim i gabuar i llog.7200 pa efekt financiar
Shkaku:	Mos zbatim i drejtë i UMFE nr.8, datë 09.03.2018, kapitullit 4.2
Rëndësia:	I ulët
Rekomandimi:	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DRT Fier, të marrë masat për të sistemuar në pasqyrat financiare vlerën e të ardhurave jo tatimore, klasifikuar gabimisht në pasqyrat financiare të vitit 2019 në llog. 7200 “Grand korrent”.

Llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në shumën 14,064,390 lekë përfaqëson detyrimet e konstatuara për paga, sig shoqërore e shëndetësore dhe detyrimet për shpenzime udhëtim e dieta, detyrimet për energji elektrike/ujë/shërbim postar/tel, të muajit dhjetor 2019, likuiduar në janar të vitit 2020. Vlera e llog. 7206 është e kuadruar me vlerën e llog të klasës 4 në Formatin nr.1 të bilancit (401-408+42+431+435+436).

Në shpenzimet e ushtrimit, janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën -160,945 lekë të ndara sipas zërave:

Llogaria (600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 116,652,641 lekë ose 68 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të

përhershëm në shumën 113,504,203 lekë dhe paga personel i përkohshëm në shumën 3,148,438 lekë.

Llogaria (601) “Kontribute për sig. shoqërore e shëndetësore” në shumën 19,407,114 lekë ose 11% të totalit të shpenzimeve.

Llogaria (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në shumën 7,739,831 lekë ose 4.5 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2019.

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 1,733,600 lekë ose 1% të totalit të shpenzimeve.

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në shumën -160,945 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Shpenzimet e klasifikuara sipas natyrës ekonomike paraqiten si vijon:

Viti 2019/Në lekë

Nr. Llog.	P Ë R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MËPARSHËM
B	SHPENZIMET	172,352,635	172,512,111
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	116,652,641	118,944,842
6001	Paga, personel I përhershëm	113,504,203	115,660,110
6002	Paga personel I Përkohshëm	3,148,438	3,284,732
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	19,407,114	19,780,877
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	17,431,474	17,741,737
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	1,975,640	2,039,140
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	7,739,831	11,127,943
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	0	217,200
6022	Shërbime nga te trete	3,230,782	3,639,605
6023	Shpenzime transporti	498,880	694,620
6024	Shpenzime udhëtimi	3,576,860	4,989,920
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	0	391,416
6026	Shpenzime për qiramarrje	50,431	605,172
6029	Shpenzime te tjera operative	382,878	590,010
	V.TRANSFERIME KORENTE	1,733,600	112,000
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individë	1,733,600	112,000
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	1,488,600	82,000
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	245,000	30,000
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-160,945	-705,868
	IX.SHPENZIME TE TJERA	26,980,394	23,252,317
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIU DHES (Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)	160,945	705,868

Burimi: DSHM/DRT Fier

Nga krahasimi i të dhënave midis pasqyrave të bilancit dhe konkretisht formatit nr.2 me formatin nr.8, nga auditimi rezulton përputhshmëri e të dhënave që do të thotë, vlera e zërit paga dhe përfitimet e punonjësve në formatin nr.2 është e njëjtë me vlerën e po këtij zëri në formatin nr.8.

Të dhënat për zërin “Paga e shpenzime të tjera personeli” referuar lëvizjeve të bankës së muajit Janar 2019 dhe Janar 2020, paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. Llog.	Emërtimi	Shpenzime Banka/Janar 2020	Shpenzime Banka/Janar 2019	Diferenca
600	Paga e shpenzime të tjera personeli	7,709,324	7,697,605	+11,719

Testuar nga KLSH

Në lekë

Nr. Llog.	Emërtimi	Bilanci 2019	Likuiduar Banka Janar 2020	Diferenca
42	Detyrime ndaj personelit	7,709,324	7,709,324	-

Testuar nga KLSH

Në lekë

Nr. Llog.	Emërtimi	Bilanci 2018	Likuiduar Banka Janar 2019	Diferenca
-----------	----------	--------------	----------------------------	-----------

42	Detyrime ndaj personelit	7,697,605	7,697,605	-
----	--------------------------	-----------	-----------	---

Testuar nga KLSH

Nga krahasimi i të dhënave të bilancit (F.2 Shpenzimet) me akt rakordimin me degën e thesarit për fondet e vitit 2019, rezulton si vijon:

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Bilanci	Akt rakordimi me D.Thezarit	Diferenca
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	116,652,641	116,608,181	+44,460

Testuar nga KLSH

Sqarojmë se fondi i pagave referuar akt rakordimit me degën e thesarit, përfaqëson pagat e punonjësve për periudhën dhjetor 2018-nëntor 2019, ndërkohë që të dhënat e bilancit 2019 pasqyrojnë konstatimin e pagave bruto/borderotë e muajve janar-dhjetor 2019, pra diferenca midis të dhënave të bilancit dhe akt rakordimit me degën e thesarit duhet të jetë e barabartë me diferencën midis pagave të muajit dhjetor 2018 paguar në janar të vitit 2019 me pagat e muajit dhjetor 2019, paguar në janar të vitit 2020.

Nga testimet e kryera nga auditimi mbi konstatimin dhe pagesën e pagave të punonjësve, rezulton një mos rakordim midis të dhënave të thesarit dhe bilancit në shumën 32,741 lekë.

Rezulton se është plotësuar formati nr.5 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2019 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar, UMFE nr.8, datë 09.03.2018, Urdhrit të Ministrit të Financave nr.64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumatat përkatëse, përveç rasteve të konstatuara me diferenca nga grupi i auditimit.

Veprimet për vitin 2019 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar, UMFE nr.8, datë 09.03.2018. Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet janë hedhur periodikisht.

2.1.2 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi e komunikimi, monitorimi.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi si vijon

1. Strukturat përgjegjëse të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier (DRT), nuk kanë njohuri të plota mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, Manualin e miratuar me Urdhrit të Ministrit të Financave Nr.108, datë 17.11.2016 si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale të DPT-ve dhe DRT-ve janë bazuar në "Strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën 2017-2021". Strategjia parashikon që në pesë vitet e ardhshme të vijojë përmirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj tatimpaguesit duke u mbështetur në modelin e përmbushjes vullnetare. Objektivat dhe masat për zbatimin e misionit të Administratës Tatimore Qendrore, mbështeten në bindjen se përmbushja vullnetare mundësohet vetëm atëherë kur të gjitha funksionet për shërbimin ndaj

tatimpaguesit, kontrollit tatimor dhe mbledhjes së detyrimeve të prapambetura do të trajtohen si një tërësi veprimesh të ndërvarura dhe të mbështetura në modelin e menaxhimit të riskut.

2. Nga auditimi i kryer në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet e politikave vijuese të dala në zbatim të tij, duke analizuar përmbajtjen e rregullores si dhe pozicionet e rolet e vendosura në Rregulloren e Funkcionimit të DRT, rezultonte mungon një përputhje dhe harmonizim i akteve dhe dispozitave (rregullores dhe strukturës së miratuar).

Për periudhën 01.01.2018-12.08.2020 rezulton mos rakordim midis pozicioneve të punës në strukturën e miratuar me urdhrat e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016; nr.49, datë 27.02.2019 dhe nr.171, datë 13.05.2019 dhe përgjegjësi dhe detyrave të përcaktuara në Rregulloren për Funkcionimin e Drejtorive Rajonale, miratuar me Urdhrin Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017. Ndryshimet strukturore gjatë kësaj periudhe nuk janë reflektuar me ndryshime të Rregullores. Referuar Manualit të MFK, struktura organizative është korniza me anë të cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Struktura duhet të jetë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme. Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.192, datë 12.08.2020 “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”, është miratuar Rregullorja e brendshme e funksionimit DRT-ve.

3. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) në pozicionin e Drejtorit të Funksioneve Mbështetëse, *si vijon:*

Për periudhën objekt auditimi, NA është emëruar z.O. C., me shkresën e DPT nr.8068/1, datë 23.04.2018, i cili deri në këtë datë ka qenë i komanduar në këtë pozicion, me vendimin e DP të DPT nr.604, datë 08.08.2017 dhe NZ. z.J. G. i emëruar në këtë detyrë me vendimin e DP të DPT nr.14, datë 16.10.2015, konfirmuar periudha kalimtare e implementimit të kërkesave ligjore për NZ me shkresën e Drejtorit të DRT Fier me nr.1817/1, datë 12.02.2018. Aktualisht z. J. G. kryen funksionet e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe është në vartësi direkte të NA.

Sa më sipër, janë përmbushur kërkesat e nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar.

4. Nga ana e institucionit të DRT Fier nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore “Pyetësorët e Vetëvlerësimit”, “Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2018 dhe 2019”, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “*deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i dërgohen Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave*”.

Titulli:	Problematika ne funksionimin e sistemit te MFK.
Situata:	Konstatohen problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar si: Nuk janë hartuar Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar që përcakton se nëpunësi autorizues i njësisë publike së bashku me deklaratën mbi SKB paraqet raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm. Këto veprime nuk janë në përputhje me përcaktimet e nenit 18, pika 1, të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, Manualit të MFK, kapitulli III, pika 3.5 “ <i>Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm</i> ”, që përcakton se: “ <i>Çdo vit, NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe</i>

	<p><i>cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te NPA në MF, kërkesë e nenit 18, të ligjit për MFK-në. Raporti duhet të dorëzohet deri në fund të shkurtit dhe mbulon vitin e kaluar financiar (janar-dhjetor). Ai dorëzohet së bashku me deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, e cila është gjithashtu një kërkesë e nenit 18. Informacioni i dhënë në raportin vjetor duhet të jetë në përputhje me deklaratën. Në fakt, deklarata ofron një përmbledhje të konkluzioneve të raportit vjetor.</i></p> <p><i>Përmes raportit vjetor, subjektet e raportimit raportojnë te DH/MFK për funksionimin e sistemit të MFK-së sipas komponentëve të tij” Gjithashtu në DRT Fier nuk janë përbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe <u>krijimin e Regjistrin të Risqeve</u>, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrisë të Financave, ku citohet:</i></p> <p><i>Neni 12</i></p> <p><i>“Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:..identifikimin dhe krijimin e regjistrin të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë...”</i></p> <p><i>Neni 21</i></p> <p><i>“Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsisë, <u>nëpunësit autorizues të njësisë publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsisë”.</u></i></p> <p><i>Neni 30</i></p> <p><i>“Drejtori i Funksioneve Mbështetëse harton regjistrin e riskut, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe <u>realizon përmbledhjen në një regjistër të informacionit nga drejtoritë e tjera në DRT”.</u></i></p>
Kriteri:	Ligji nr.10296/2010, i ndryshuar neni 18, pika 1 dhe Manuali MFK, kapitulli III, pika 3.5
Ndikimi/Efekti:	Mos hartimi i pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm
Shkaku:	Mos veprimi në përputhje me ligji nr.10296/2010, i ndryshuar neni 18, pika 1 dhe Manuali MFK, kapitulli III, pika 3.5
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Titullari i institucionit, të marrë masa për zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve njohjen dhe implementimin e detyrimeve.

5. Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të DRT Fier, parashikuar në pikën 8, neni 8, të ligjit nr.10296 dhe nenin 4 dhe 30 të Rregullores ”Për funksionimin e drejtorive rajonale tatimore”, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr.19, datë 22.02.2017, rezulton se kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:

-Përgatitjen e planit vjetor operacional për Drejtorinë Rajonale Tatimore, në përputhje me objektivat e përcaktuara në planin strategjik të administratës tatimore dhe menaxhimin e zbatimit të tij;

-Përgatitjen e programeve mujore të punës sipas planit operacional të DRT;

-Miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve;

-Vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre. Njësia nuk ka funksionin e auditimit të brendshëm dhe këto shërbime janë kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të DPT. Auditimi i fundit i DPT, është realizuar sipas programit nr.17358/1, prot., datë 25.08.2017, ndërsa Raporti Përfundimtar është dërguar me shkresën nr.17358/17, prot datë 31.01.2018.

❖ ***Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:***

Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Nga ana e NZ të DRT janë përgatitur kërkesat buxhetore për DRT Fier, të cilat janë përcjellë elektronikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

❖ ***Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:***

Janë hartuar rregullat bazë për organizmin kontabël dhe administrimin e pasurisë. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe veprimet janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti. Procedurat e inventarizimit janë kryer çdo vit. Nga auditimi rezulton se në institucion ka dhomë të serverave, administrimi i të dhënave kryhet nga Sektori i IT. Sistemi i teknologjisë së informacionit siguron një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (backup), gjë që mundëson ruajtjen e një kopje të informacionit.

Përsa i takon mbrojtjes së informacionit të përdoruesve dhe kontrollit periodik të pajisjeve dhe sistemeve të instaluara, institucioni zbaton udhëzimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për këtë qëllim.

6. Nga ana e DRT Fier zbatohen rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e aktiveve, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa “ç”, të ligjit nr.10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr.5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, titullari i njësisë publike ka autorizuar inventarizimin çdo vit të pasurisë shtetërore. Nga auditimi rezulton se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i asetëve, detyrim nga pika nr.26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e inventarizimit të pasurisë dhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrave të veçantë të Titullarit të Institucionit.

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm: është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, DRT ushtron veprimtarinë mbështetur në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 dhe nr.192, datë 12.08.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Drejtoritë e veçanta nuk kanë hartuar regjistër risku dhe për më tepër Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është edhe NZ, nuk ka hartuar regjistrin përmbledhës për DRT, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i kërkesave të nenit 12 të ligjit nr.10296/ 2010 ,i ndryshuar dhe nenit 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

Rezulton se nivelet menaxheriale nuk kanë zhvilluar trajnime të dedikuara mbi njohuritë për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

b. Etika personale dhe profesionale.

Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e DRT Fier, rezulton se këto norma janë përcaktuar në Kodin e Etikës për punonjësit e Administratës Tatimore Qendror, sipas përcaktimeve të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”.

c. Struktura organizative.

Për periudhën objekt auditimi institucioni ka ushtruar funksionet nëpërmjet strukturës organizative, miratuar me: Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”; Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, Urdhrin nr.171, datë 13.05.2019 si dhe Urdhrin nr.33, datë 12.02.2020. Konstatohet një numër i konsiderueshëm emërimesh dhe largimesh nga detyra përgjatë periudhës së auditimit trajtuar më poshtë në kete raport të cilët nuk japin siguri për realizimin e objektivave të institucionit.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Procedurat për emërimet dhe largimet nga puna rezultojnë të jenë kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe vendimi i marrë rast pas rasti i është përcjellë zyrtarisht Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Nga ana e DRT Fier, rezulton të jenë kryer vlerësime vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së brendshme. Procesi i vlerësimit të punës për punonjësit me status të nëpunësit civil është bërë 2 herë në vit dhe i është përcjellë zyrtarisht DPT me shkresën nr.11239/1, datë 09.07.2018 “Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2018”; me shkresën nr.615, datë 10.01.2019 “Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën 01.07.2018- 31.12.2018”; me shkresën nr.9793/1, datë 09.07.2019 “Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2019”; me shkresën nr.815, datë 21.01.2020 “Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën 01.07.2019- 31.12.2019” dhe me shkresën nr.11249, datë 22.06.2020, “Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2020”.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale DPT disponon plane të trajnimeve (sidomos për legjislacionin tatimor), dhe disponon një data-base mbi trajnimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e pikas nr. 3/1 , nën çështja “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016. Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë menaxhuese.

2.Menaxhimi i riskut (a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar në analiza etj.).

-Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e DRT Fier, nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat nuk është hartuar regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një plan veprimi për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.

Nga auditimi konstatohet se: Për vetë natyrën e këtij institucioni, koncepti i “Menaxhimit të Riskut” dhe vendosjes së kontroleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e DRT Fier.

3. Aktivitetet e kontrollit:

Nga auditimi rezulton se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve. U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve dhe për cdo vit NA ka autorizuar kryerjen e inventarizimit të pasurisë shtetërore. Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Në DRT proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e institucionit. Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë.

Regjistrimet kontabël kryen me anë të programit financiar “ALPHA”.

4. Informimi dhe Komunikimi

Drejtuesit e DRT Fier, përgjegjësit e sektorëve dhe NZ i njësisë nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar.

Titullari informohet nga drejtuesit e drejtorive, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

5. Monitorimi dhe raportimi (

Në DRT Fier është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë.

Në institucion, titullari i njësisë informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike (javore, mujore dhe tremujore), me shkrim, apo verbalisht.

2.2 Përputhshmëria me kriteret ligjore në realizimin e tyre duke ndaluar në fushat kryesore të të ardhurave tatimore (tatim fitimi, tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi vlerën e shtuar, etj.) dhe jo tatimore, për periudhën 01.01.2018 deri në 31.12.2020, në mbështetje të kuadrit fiskal në fuqi.

Për auditimin e këtij drejtimi të auditimit në zbatim të programit u shqyrtuan informacionet, dokumentacionet dhe baza ligjore si më poshtë:

-Rregullore për funksionimin e Drejtorive Rajonale miratuar me Urdhrin nr.19 datë 22.02.2017.

- Ligji Nr. 9920, Datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji Nr. 92/2014 “Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr.9975, Datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar.
- Treguesit e realizimit të planit të DRT Fier.
- Raporte elektronike të gjeneruar prej sistemit informatik C@ts.
- Analiza dhe raporte progresive për realizimin e të ardhurave nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit.
- Akt-Rakordimet e mbajtura midis DRT Fier dhe Degës së Thesarit.
- Udhëzimi MF dhe MD Nr.33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor shtetëror, prokurorisë dhe noterisë”
- Udhëzimi MF Nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”
- Ligji Nr.9632, datë 30.12.2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar me Ligjin Nr.181/2013.

Të ardhurat tatimore, evidentimi dhe regjistrimi:

Nga auditimi u evidentua që të ardhurat tatimore në bazë *deklarate*, arkëtohen në një llogari të vetme në DPT, e cila nëpërmjet strukturës përkatëse të Drejtorisë së Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave, evidenton, regjistron dhe përpilon pasqyrat financiare të të ardhurave tatimore për të gjitha DRT nëpërmjet dy sistemeve informatike *E-Tax* dhe *SIFQ*. Ndërsa DRT e konkretisht nga DRT Fier, nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhura kryen ndjekjen e realizimit të arkëtimit të ardhurave nga subjektet tatimpaguese të Qarkut Fier, nga sistemi informatik *E-Tax*, duke përgatitur raporte me qëllim monitorimin e tyre.

Më konkretisht ky proces paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Duke filluar nga 5 Janar 2015, DPT i arkëton të ardhurat nga tatimet në një llogari të vetme, pra në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ***është përqendruar arkëtimi i të ardhurave tatimore*** në rang kombëtar. Shkëmbimi i të dhënave me MFE është në mënyrë automatike si rezultat i ndërveprimit automatik të dy sistemeve informatike, *E-Tax* dhe *SIFQ*. Pagesat mbërrijnë në sistemin *E-tax* nga bankat e nivelit të dytë si pagesa të jashtme dhe nga Sistemi i Thesarit (për të gjithë subjektet që kryejnë pagesa nëpërmjet buxhetit të shtetit) si pagesa të brendshme në mënyrë elektronike. Pas procesit automatik të kontabilizimit të pagesave në sistemin *E-tax*, në llogarinë e çdo Tatimpaguesi. Raportimi i të dhënave lidhur me arkëtimet ***për llogari të DRT (ku përfshihet dhe DRT Fier)*** në Sistemin Informatik Qendror Financiar (*SIQF*) bëhet çdo ditë në mënyrë automatike. *Në fund të çdo periudhe raportuese (muajore dhe progresive)*, ***DPT*** bën *kontroll të raportimeve lidhur me arkëtimet e kontabilizuara në sistemin E-Tax në nivel të DRT.* Raportimi mujor dhe progresiv finalizohet në fund viti duke nënshkruar evidencën përfundimtare nëpërmjet përfaqësuesit të Degës së Thesarit Tiranë dhe DPT.

Drejtoria Rajonale Fier realizon:

Monitorimin e realizimit të të ardhurave tatimore e përqendruar në një llogari të qendëruar në DPT dhe ardhurave dytësore nga subjektet Tatimpagues në *DRT Fier* dhe përgatit në fund të çdo muaji dhe tremujori raporte dhe evidenca për DPT dhe Titullarin e institucionit për realizimin e treguesve të ardhurave tatimore si dhe evidencat të detyrimeve debitore që mbahen jashtë sistemit informatik C@TS.

Organizimi dhe funksionimi i këtij Sektori:

Ky sektor në zbatim të detyrave funksionale përgatit raporte sasiore dhe cilësore në lidhje me analizën e treguesve të realizuar nga DRT Fier për planin e të ardhurave. Dërgimi i informacionit të pagesave për çdo ditë dhe muaj nga Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave nga DRT në DPT bëhet për të ardhurat tatimore të realizuara nga sistemi në bazë deklaratë dhe jashtë sistemit si të ardhura detyësore jo-tatimore të kryera nga shërbimet që kryen së bashku me detyrimet përkatëse. Gjithashtu kryen dhe rakordimet me institucionet përkatëse për shërbimet që kryen si bashkitë e Qarkut Fier për 1% e TFTH, me institucionet e drejtësisë për furnizimet e kryera me pulla, realizimin e të ardhurave si dhe të detyrimeve përkatëse, në bazë të Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, neni 11/a ,b. Për këto të ardhura që realizohen, Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT Fier regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim”, me kartela analitike për çdo Bashki dhe Njësi Administrative për administrimin e tatim të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Në fund të vitit nga ky sektor përpilohet pasqyra financiare e të ardhurave të realizuara nga DRT Fier së bashku me detyrimet përkatëse duke përfshirë dhe detyrimet debitore të krijuara ndër vite (nga viti 2008 e deri më vitin 2011) që rezultojnë pa dokumente të rregullta që mbahen jashtë sistemit informatik të tatimeve.

DRT Fier realizon gjatë veprimtarisë së saj të ardhura detyësore të cilat janë:

- **Të ardhurat nga TFTH**

Duke ju referuar Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, neni 10 dhe neni 11, ku përcaktohet për shërbimin e kryer Administrata Tatimore Rajonale përfiton të ardhura në masën 1% të shumës së arkëtimit për llogari të qeverisjes vendore të të ardhurave tatimore nga TFTH për biznesin e vogël, të arkëtuara nga DRT. Kjo shumë (1% i TFTH) derdhet për llogari të DPT në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e grumbulluara si agjent tatimor DRT nga pushteti vendor.

Për vitin 2018 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TFTH mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën **prej 129,397 lekë**. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akt-rakordimeve rezulton se shuma totale e pa likuiduar e komisionit 1% të TFTH për llogari të DRT Fier, nga viti 2017 është **1,210 lekë**, shumë kjo që u përket respektivisht bashkive si më poshtë:

Bashkia Fier në shumën prej 243 lekë.

Bashkia Roskovec në shumën prej 759 lekë.

Bashkia Ballsh në shumën prej 208 lekë.

Gjendja e detyrimit më 31.12.2018 të komisionit 1% të TFTH, i pa arkëtuar nga bashkitë në total është në shumën prej **1,002 lekë**, që u përket respektivisht bashkive si më poshtë:

Bashkia Fier në shumën prej 243 lekë.

Bashkia Roskovec në shumën prej 759 lekë.

Gjithashtu, rezulton një shumë në vlerën **810 lekë** e cila është likuiduar shtese mbi detyrimin total si 1% e TFTH, derdhur në DRT Fier nga ana e Bashkisë Ballsh. *Situata paraqitet më konkretisht në tabelën si më posht*

Lloji Tax	DRT	Komuna / Bashkia ku janë transferuar shumat	Shuma e celur e Degen e Thesarit per pushtetin vendor nga 01 Janar deri 31/12/2018	Shuma e transferuar per pushtetin vendor per periudhen Dhjetor 2017	Shuma e transferuar për pushtetin vendor per periudhen 01 Janar deri 31/12/2018	Shuma e transferuar Gjithsej per pushtetin vendor per periudhen deri 31/12/2018	Shuma prej 1% qe i takon DRT deri 31/12/2018	Shuma e palikujduar 2017	Shuma totale qe duhej likujduar deri ne 31.12.2018	Shuma prej 1% qe eshte transferuar DRT deri 31/12/2018	Shuma pa likujduar 2018	Shuma a likujduar teper 2018
1		2	3	4	5	6 = 4 + 5	6=5x1%					
TFTH	Fr	Fier	6,944,098	447,257	6,944,098	7,391,355	73,914	243	74,157	73,913	243	

TFTH	Fr	Patos	337,130	-	337,130	337,130	3,371	0	3,372	3,371		
TFTH	Fr	Roskovec	967,951	-	967,951	967,951	9,680	759	10,439	9,680	759	
TFTH	Fr	Lushnje	3,009,364	180,822	3,009,364	3,190,186	31,902	0	31,902	31,902		
TFTH	Fr	Divjake	493,280	70,763	493,280	564,043	5,640	0	5,641	5,640		
TFTH	Fr	Ballsh	380,446	6,809	380,446	387,255	3,873	208	4,080	4,891		810
			12,132,269	705,651	12,132,269	12,837,920	128,380	1,210	129,590	129,397	1,002	810

Burimi i të dhënave .DRT Fier

Për vitin 2019 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TFTH mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën **prej 158,810 lekë**. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akt-rakordimeve rezulton shuma totale e pa likuiduar e komisionit 1% të TFTH për llogari të DRT Fier nga viti 2018 është **1,002 lekë**, shumë kjo që u përket respektivisht bashkive si më poshtë:

Bashkia Fier në shumën prej 243 lekë.

Bashkia Roskovec në shumën prej 759 lekë.

Kurse **gjendja e këtij detyrimi më 31.12.2019**, në masën 1% i pa arkëtuar nga bashkitë është në total në shumën **1,002 lekë**, i përket:

Bashkisë Fier në shumën prej 243 lekë.

Bashkisë Roskovec në shumën prej 759 lekë.

Gjithashtu vazhdon të rezultojë shuma në vlerën **810 lekë**, e cila është likuiduar shtese mbi detyrimin total si 1% e TFTH, derdhur në DRT Fier nga ana e Bashkisë Ballsh në vitin 2018. Nga përlllogaritjet rezulton një diferencë midis kuadrati (3) "Shuma e çelur ne Degën e Thesarit për pushtetin vendor nga 01 Janar deri 31/12/2019" dhe kuadrati (6) "Shuma e transferuar gjithsej për pushtetin vendor për periudhën deri 31/12/2019" prej **2,232,395 lekë**. Shumë kjo e cila nuk i është kaluar bashkive dhe për rrjedhojë nuk është kaluar dhe komisioni respektive për 1% e TFTH për llogari të DRT Fier.

Situata paraqitet më konkretisht në tabelën si më poshtë:

Lloji I Takse	DR T	Emri I Komune s/ Bashkis e ku jane transferuar shumat	Shuma e celur ne Degen e Thesarit per pushtetin vendor nga 01 Janar deri 31/12/2019	Shuma e transferuar per pushtetin vendor per periudhen Dhjetor 2018	Shuma e transferuar per pushtetin vendor per periudhen 01 Janar deri 31/12/2019	Shuma e transferuar Gjithsej per pushtetin vendor per periudhen deri 31/12/2019	Shuma prej 1% qe I takon DRT deri 31/12/2019	Shuma e palikuiduar 2018	Shuma totale qe duhej likuiduar deri ne 31.12.2019	Shuma prej 1% qe eshte transferuar DRT deri 31/12/2019	Shuma likuiduar r teper 2018	Shuma pa likuiduar r 2019
1	2	3	4	5	6 = 4 + 5	7 = 5x1%						
TFTH	FR	Fier	11,164,552	88,130	9,772,631	9,860,761	98,608	243	98,851	98,608		243
TFTH	FR	Patos	1,065,500	11,681	932,188	943,869	9,440		9,440	9,440		-
TFTH	FR	Roskovec	964,335		859,029	859,029	8,590	759	9,349	8,590		759
TFTH	FR	Lushnje	3,740,129	41,848	3,146,278	3,188,126	31,881		31,881	31,881		0
TFTH	FR	Divjake	913,532	41,680	749,914	791,594	7,916		7,916	7,916		0
TFTH	FR	Ballsh	265,169		237,443	237,443	2,375		2,375	2,375	810	-
			18,113,217	183,339	15,697,483	15,880,822	158,810	1,002	159,810	158,810	810	1,002

Burimi i të dhënave

Situata dhe problematika e mësipërme e mospagimit në kohë të detyrimeve në masën 1% referuar udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013, *vjen si rezultat pasi mungojnë afatet ligjore për pagimin e detyrimeve nga institucionet e pushtetit vendor në DRT*. Gjithashtu referuar udhëzimit mungojnë dhe penalitete për mos derdhjen e detyrimeve tatimore për TFTH për biznesin e vogël nga institucionet përfituese.

Për vitin 2020 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TFTH mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën **prej 164,217 lekë**. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i akt-rakordimeve rezulton shuma totale e pa likuiduar e komisionit 1% të TFTH për llogari të DRT Fier për vitin 2020 është **23,325 lekë**, shumë kjo që u përket respektivisht bashkive si më poshtë:

Bashkia Fier në shumën prej 13,280 lekë.

Bashkia Roskovec në shumën prej 1,812 lekë.

Bashkia Patos në shumën prej 1,216 lekë

Bashkia Lushnje në shumen prej 5,520 lekë

Bashkia Divjakë në shumen prej 1,219 lekë

Bashkia Ballsh në shumen prej 278 lekë

Situata dhe problematika e më poshtme e mospagimit në kohë të detyrimeve në masën 1% referuar udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013, vjen si rezultat pasi mungojnë afatet ligjore për pagimin e detyrimeve nga institucionet e pushtetit vendor në DRT. Gjithashtu referuar udhëzimit mungojnë dhe penalitete për mos derdhjen e detyrimeve tatimore për TFTH për biznesin e vogël nga institucionet përfituese.

Lloji i Takses	DRT	Emri i Komunes/ Bashkise ku janë transferuar shumat	Shuma e celur e Degene Thezarit per pushtetin vendor nga 01 Janar deri 31/12/2020	Shuma e transferuar per pushtetin vendor per periudhen Dhjetor 2019	Shuma e transferuar per pushtetin vendor per periudhen 01 Janar deri 30/09/2020	Shuma e transferuar Gjithsej per pushtetin vendor per periudhen deri 31/12/2020	Shuma prej 1% qe I takon DRT deri 31/12/2020	Shuma e palikujduar 2017	Shuma e palikujduar 2019	Shuma totale qe duhej likujduar deri ne 31.12.2020	Shuma prej 1% qe eshte transferuar DRT deri 31/12/2020	Shuma likujduar teper 2019	Shuma pa likujduar 2020
1	2	3	4	5	5	6=5x1%							
TFTH	FR	Fier	9,831,023		9,695,700	9,695,700	96,957	243	13,038	110,238	96,957		13,280
TFTH	FR	Patos	1,106,789		1,093,868	1,093,868	10,939	-	1,216	12,155	10,939		1,216
TFTH	FR	Roskovec	536,101		488,074	488,074	4,881	759	1,053	6,693	4,881		1,812
TFTH	FR	Lushnje	4,309,714		4,227,819	4,227,819	42,278	-	5,520	47,798	42,278		5,520
TFTH	FR	Divjake	647,345		570,481	570,481	5,705	-	1,219	6,924	5,705		1,219
TFTH	FR	Ballsh	392,626		345,745	345,745	3,457	-	277	3,734	3,457	-810	278
			16,823,598	0	16,421,687	16,421,687	164,217	1,002	22,323	187,542	164,217	-810	23,325

Të ardhurat nga shitja e shtypshkrimeve

Nga shitja e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj. për **vitin 2018** (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar të ardhura në shumën **prej 15,907,158 lekë** por nga rakordimi me Degën e Thezarit Fier rezulton se arkëtimet në thesar janë në vlerën **15,897,008 lekë**, pra figuron një diferencë prej **(+10,150 lekë)**. Nga sqarimet e bëra me përfaqësuesit e subjektit pretendohet se kjo diferencë vjen si pasojë se disa prej pagesave në zërin “Bileta Udhëtimi” dhe “Dëftesë Tatimore” kanë kaluar në zërin “TVSH”.

Shitjet e kryera nga DRT Fier të shtypshkrimeve për vitin 2018 paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Shitur viti 2018	Njësia e matjes	Sasi	Vlerë/lekë
Fature Tatimore	cope	22,653	8,155,080
Fature Mod.4	cope	1,297	163,422
Fature Shoqërimi	cope	3,656	1,316,160
dëftesë Tatimore	cope	3,356	422,856
Bileta	cope	2,275,100	5,849,640
Shuma		2,306,062	15,907,158

Nga shitja e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj., për **vitin 2019** (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar të ardhura në shumën **prej 17,163,336 lekë**, por nga rakordimi me Degën e Thezarit rezulton se arkëtimet në thesar janë në vlerën **17,207,391 lekë**, pra figuron një diferencë prej **(-44,055 lekë)**. Nga sqarimet verbale me përfaqësuesit e subjektit pretendohet se kjo diferencë vjen si pasojë e fund vitit ku bëhet pagesa përkatëse në thesar për shtypshkrime por ato tërhiqen fizikisht në një kohë të dytë pranë DRT Fier, duke sjell dhe këtë diferencë përkatëse. Gjithashtu është sqaruar se vlera e arkëtimeve në Degën e Thezarit Fier është realisht 17,209,591 lekë, dhe pagesa 2,220 lekë është kaluar gabim.

Shitjet e kryera nga DRT Fier të shtypshkrimeve për vitin 2019 paraqiten si më poshtë:

Në Lekë

Shitur viti 2019	Njësia e matjes	Sasi	Vlerë/lekë
Fature Tatimore	cope	19,527	7,875,840
Fature Mod.4	cope	871	111,888
Fature Shoqërimi	cope	3,272	1,313,160

Flete shoqërimi malli per te....	cope	2	720
Dëftese Tatimore	cope	2,453	380,016
Bileta	cope	2,493,650	7,481,712
Shuma		2,519,773	17,163,3366

Burimi i të dhënave

Nga shitja e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj., për **periudhën deri në 30.09.2020** (sipas fletë-daljeve të magazinës) janë realizuar të ardhura në shumën prej **9,476,100 lekë** por nga rakordimi me Degën e Thesarit rezulton se arkëtimet në thesar janë në vlerën **9,442,312 lekë**, pra figuron një diferencë prej **(+33,788 lekë)**.

Shitjet e kryera nga DRT Fier të shtypshkrimeve për periudhën deri në 30.09.2020 paraqiten si më poshtë:

			Në lekë
Shitur deri ne 30.09.2020	Njësia e matjes	Sasi	Vlerë/lekë
Fature Tatimore	cope	12,295	5,163,900
Fature Mod.4	cope	547	91,896
Fature Shoqërimi	cope	2,298	965,160
Dëftese Tatimore	cope	2,512	422,016
Bileta	cope	862,350	2,833,128
Shuma		880,002	9,476,100

Burimi i të dhënave

- **Evidenca për detyrimet për arkëtimet të taksës kombëtare së pullës.**

Ligji Nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, nenit 2/4 Agjenti i taksave dhe tarifave është personi i cili sipas kërkesave të ligjit është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin, dhe transferimin në llogari të DRTatimore për t’u transferuar në buxhetin e shtetit të ardhurat nga taksa dhe tarifa.

Nenit 3 “Llojet e taksave”, pika 5 “Taksë kombëtare janë dhe taksat e akteve të pullës”;

Nenit 5 “Agjentët e taksës” pika d për vjeljen e taksës së pullës dhe të akteve ngarkohen **Zyrat e Gjendjes Civile pranë Bashkive** të cilat për shërbimin që kryejnë përfitojnë në masën prej 5% në rrugë buxhetore”.

Nga ky sektor **mbahen evidenca për detyrimet për arkëtimet të taksës kombëtare së pullës dhe të akteve për zyrat e gjendjes civile në bashki dhe në gjykata, prokurori dhe noteri në masën 90%, 95%, të ardhura të cilat derdhen në buxhetin e shtetit si të ardhura tatimore në bazë të** Udhëzimit të MF dhe MD nr.33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror, prokurorisë dhe noterisë” pika 12, ku përcaktohet se administrata e gjykatave, prokurorisë, Ministria e Drejtësisë dhe Posta Shqiptare, në cilësinë e agjentit tatimor të mbledhjes së tarifës së pullës dhe për shërbimet e kryera nga gjykata, prokurori, administrata e gjyqësorit **përfitojnë 10% komision. Gjithashtu** dhe pika 14 ku përcaktohet se “Agjentët në përputhje me këtë udhëzim vete llogaritin shumën që përfitojnë nga komisioni, duke shumëzuar përqindjen e komisionit, të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët, me vlerën e arkëtimeve nga tarifatat për periudhën tatimore dhe mbajnë drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfitojnë, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfitojnë”.

Referuar akt-rakordimeve të mbajtur nga DRT Fier dhe Gjykatës, Prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier dhe Lushnje, Prefekturës së Qarkut Fier dhe Rrethit Lushnje dhe Bashkitë (Zyrat e Gjendjes civile), për furnizim pulle me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë (i mbajtur në sasi dhe vleftë sipas institucioneve përkatëse), gjatë vitit 2018 rezulton se:

EVIDENCA PULLA TAKSE (01.01.2018-31.12.2018)										
NIPT	SUBJEKTI	Zona	Personi i autorizuar	Çelje 01.01.2018		Sistemi	Terheqje 2018	Arketime 2018	Debitore 31.12.18	Kreditorë 31.12.18
				Debitore	Kreditorë					

						e ne celje				
K.....F	BASHKIA FIER	Bashkia Fier	F. P.	3,217,250			11,484,000	11,635,300	3,065,950	
K.....F	BASHKIA FIER	Bashkia Fier	Bashkia Fier		500					500
K.....L	BASHKIA LUSHNJE	Bashkia Lushnje	Bashkia Lushnje	224,000	30,774		9,000	155,000	80,000	30,774
K.....N	BASHKIA ROSKOVEC	Rroskovec	R.G.	548,705			-	-	548,705	
K.....C	BASHKIA DIVJAKE	Bashkia Divjake	Bashkia Divjake	437,500	62,050		1,890,000	2,093,010	234,490	62,050
K.....N	BASHKIA BALLSH	Bashkia Ballsh	M.S.	546,400			2,412,000	2,144,400	814,000	
K.....D	BASHKIA PATOS	Bashkia Patos	A.B, R.H. & E.M.	230,150	566,000		1,764,000	1,619,000	375,150	566,000
K.....H	GJYKATA E RRETHIT FIER	Gjykata FR	M.F.	1,224,000			5,580,000	5,733,000	1,071,000	
K.....R	PROKURORI A E RRETHIT FIER	Prokuroria FR	M. G.	108,000			504,000	468,000	144,000	
K.....P	PREFEKTUR A E QARKUT FIER	Prefektura FR	E. S.;E. N.	271,000			900,000	773,600	397,400	
K.....S	GJYKATA E RRETHIT LUSHNJE	Gjykata LU	M.N.	346,600			2,655,000	2,818,000	183,600	
K.....A	PROKURORI A E RRETHIT LUSHNJE	Prokuroria LU	E. Z.	173,000			360,000	303,000	230,000	
		Z.R.P.P MK	L. B.		9,500					9,500
		Greta Naco			500					500
		Kallezim penal ne Prokurori, v.1997		18,330					18,330	
		O.D			50,000					50,000
		Pulla takse speciment ne punonjjes		343					343	
		S.K		35,798					35,798	
		Sh.G		5,500					5,500	
		E. S			14,989					14,989
		A. K.			3,500					3,500
		Shume kreditore nga LU ne 31.12.2008, pa emer			500					500
Totali				7,386,576	738,313	0	27,558,000	27,742,310	7,204,266	738,313

Debitore 01.01.2018: 7,386,576 lekë

Kreditorë 01.01.2018: 738,313 lekë

Veprime sistemimi gjatë vitit 2018: Nuk janë bërë

Tërheqje pullash gjatë vitit 2018: 27,558,000 lekë

Arkëtime: 27,742,310 lekë.

Debitorë 31.12.2018: 7,204,266 lekë

Kreditorë 31.12.2018: 738,313 lekë

Nga tabela shpjeguese e mësipërme pasqyrohet se gjendja e detyrimit të pa arkëtuar për vitin 2018, pra pullë e pa përdorur gjendje në gjykatë, prokurori dhe zyra gjendjes civile, në fund të vitit 2018, është në shumën prej **7,144,295 lekë**, e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile, për t'u derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2018.

Nga krahasimi dhe verifikimi i mëtejshëm i “Evidencës Pulla Takse” me “Akt-Rakordimet” individuale me secilin institucion kanë rezultuar diferencat si më poshtë:

a. Sipas akt-rakordimit të mbajtur më datë 17.01.2019 me Gjykatën e Rrethit Lushnje është një diferencë prej 600 lekë tek çelja, e njëjta diferencë është edhe në gjendjen e pullave në fund.

b. Në akt-rakordimin e datës 25.04.2019 me Bashkinë Patos, është evidentuar diferencë në arkëtimet prej 150 lekë dhe e njëjta diferencë është evidentuar gjendja e pullave në fund 31.12.2019.

c. Në akt-rakordimin me Bashkia Divjakës gjendja 01.01.2018 është bërë në baza neto (janë kompensuar shumat debitoare me ato kreditore) kurse në evidencë këto shuma janë paraqitur të ndara dhe jo në bazë neto. Sipas Akt-Rakordimit është një vlerë debitoare 103,000 lekë e mbartur dhe e arkëtuar gabimisht në llogarinë e thesarit dhe jo tek tatimet.

Për vitin 2019 ky detyrim është në shumën prej **9,661,993 lekë** (pulla të pa përdorura në fund të vitit 2019 me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë) në zbatim të kërkesave të UMF nr.33, datë 29.12.2014 e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile për t'u derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2019.

EVIDENCA PULLA TAKSE (01.01.2019-31.12.2019)

NIPT	SUBJEKTI	Zona	Personi autorizuar	Celje 01.01.2019		Sistemi në celje	Terheqje 2019	Arketime 2019	Debitore 31.12.19	Kreditor e 31.12.19
				Debitore	Kreditor e					
K....F	B. FIER	B. Fier	F. P.	3,065,950			13,617,000	10,854,000	5,828,950	
K.....F	B. FIER	Bashkia Fier	Bashkia Fier		500					500
K.....L	B.LUSHNJE	B.Lushnje	Bashkia Lushnje	80,000	30,774		0		80,000	30,774
K....C	B. ROSKOVEC	Rroskovec	R.G	548,705			-	-	548,705	
K.....C	B. DIVJAKE	B.Divjake	Bashkia Divjake	234,490	62,050		0	-	172,440	0
K.....N	BASHKIA BALLSH	Bashkia Ballsh	M.S	814,000			1,935,000	2,169,300	579,700	
K.....D	B.PATOS	B.Patos	A.B., R.H. & E.M.	375,150	566,000		1,233,000	1,476,150	132,000	566,000
K.....H	GJYKATA E RRETHIT FIER	Gjykata FR	M. F.	1,071,000			6,525,000	6,584,000	1,012,000	
K.....R	PROKURORIA E RRETHIT FIER	Prokuroria FR	M. G.	144,000			648,000	432,000	360,000	
K.....P	PREFEKTURA E QARKUT FIER	Prefektura FR	E. S.;E N	397,400			900,000	934,773	362,627	
K.....7S	GJYKATA E RRETHIT LUSHNJE	Gjykata LU	M N	183,600			3,078,000	3,045,000	216,600	
K.....A	PROKURORIA E RRETHIT LUSHNJE	Prokuroria LU	E Z	230,000			360,000	331,000	259,000	
		Z.R.P.P MK	L B		9,500					9,500
			G N		500					500
		Kalëzim penal në Prokurori, v.1997		18,330					18,330	
		O.D			50,000					50,000
		Pulla takse speciment ne punonjes		343					343	
		Selvie Kaja		35,798					35,798	
		Shkëndie Dingozi		5,500					5,500	
		Erleta Sota			14,989					14,989
		Ardian Karroqe			3,500					3,500
		Shume kreditore nga LU ne 31.12.2008 , pa emer			500					500
Totali				7,204,266	738,313	0	28,296,000	25,826,223	9,611,993	676,263

Debitore 01.01.2019: 7,204,266 lekë

Kreditorë 01.01.2019: 738,313 lekë

Veprime sistemimi gjatë vitit 2019: Nuk janë bërë

Tërheqje pullash gjatë vitit 2019: 28,296,000 lekë

Arketime: 25,826,233 lekë.

Debitore 31.12.2019: 9,611,993 lekë

Kreditorë 31.12.2019: 676,263 lekë

Nga krahasimi dhe verifikimi i mëtejshëm i “Evidencës Pulla Takse” me “Akt-Rakordimet” individuale me secilin institucion kanë rezultuar diferencat si më poshtë:

- Sipas akt-rakordimit të mbajtur më datë 12.03.2020 me Bashkinë Patos kemi një diferencë prej arkëtimet ku sipas evidencës së DRT Fier shuma është 1,476,150 lekë kurse sipas akt-rakordimit është 1,476,000 lekë.
- Në akt-rakordimin e datës 14.01.2020 me Prefekturën e Qarkut Fier është bërë shënimi se gabimisht vlera prej 10,000 lekë nuk është vendosur tek arkëtimet e vitit 2019 por do të sistemohet në pasqyrën e vitit 2020.
1	J.....G	S.	në Sektorin e Shërbimit	45,910,645
2	J.....Q	S.	në Sektorin e Ndërtimit	27,720,522

3	J.....D	U. K.F	në Sektorin e Prodhimit	21,692,771
4	K.....R	M	në Sektorin e Tregtisë	21,288,639
5	K.....K	B	në Sektorin e Shërbimit	20,505,206
6	K.....K	L.	në Sektorin e Ndërtimit	19,802,496
7	K.....A	Q.S.	në Sektorin e Tregtisë	19,436,969
8	L.....A	S.	në Sektorin e Shërbimit	16,654,881
9	K.....Q	G.Z.	në Sektorin e Tregtisë	15,260,944
10	L.....B	D...	në Sektorin e Ndërtimit	13,418,744
			TOTAL	221,691,817



Titulli i Gjetjes	Mosrealizimi i të ardhurave sipas planit.
Situata	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <p>Për vitin 2018, të ardhurat tatimore janë programuar në masën 3,212,000 mijë lekë dhe rishikuar me ngritje në 5,896,001 mijë lekë sipas shkresës se DPT Nr.20537/1 datë 08.10.2018. Megjithatë, pavarësisht rishikimit, të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 5,072,498 mijë lekë ose me mosrealizim prej -14% ose -823,503 mijë lekë më pak se plani. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën të ardhurat u realizuan 2,869,420 mijë lekë, rezultatet janë në rritje të konsiderueshme me +2,203,078 mijë lekë ose +76%.</p> <p>Për vitin 2019, të ardhurat tatimore janë programuar në masën 4,345,000 mijë lekë dhe rishikuar me ngritje në 4,592,000 mijë lekë sipas shkresës Nr.9355/1 datë 03.06.2019. Megjithatë, pavarësisht rishikimit, të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 4,461,945 mijë lekë ose me mosrealizim prej -2.8% ose 130,055 mijë lekë më pak se plani. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën të ardhurat u realizuan 5,072,498 mijë lekë, rezultatet janë në rënie me -610,553 mijë lekë ose -12%.</p> <p>Për vitin 2020, të ardhurat tatimore janë programuar në masën 3,100,001 mijë lekë por të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 2,717,782 mijë lekë ose me mosrealizim prej -14.06% ose -382,219 mijë lekë më pak se plani. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën të ardhurat u realizuan 4,461,945 mijë lekë, rezultatet janë në rënie me -1,744,163 mijë lekë ose -39.09%.</p>
Kriteri	Shkresa nr.20537/1, datë 08.10.2018 Shkresa nr.9355/1, datë 03.06.2019
Ndikimi/Efekti	Planifikim jo real
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të analizojë faktorët që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave tatimore, sipas zërave dhe burimeve të disponueshme në territorin që ajo administron dhe t'i paraqes ato në mënyrë të dokumentuar në DPT, për marrje në konsideratë nga ana e saj, në funksion të një shpërndarje sa më të drejtë dhe reale të planit të të ardhurave.

2.3 Vlerësimi i evidentimi, saktësisë së llogaritjes së ndryshimeve në aktivet (e trupëzuara dhe qarkulluese) të institucionit, pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare në përputhje me aktet ligjore e nënligjor përkatëse, zbatimi i dispozitave ligjore për

inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmëria e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve.

Për auditimin e kësaj pike të programit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i aktiveve të DRT-së.
- Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit.
- Dokumentacioni shoqërues i inventarizimit.
- Dokumentacion shoqërues i asgjësimin.
- Urdhra për ngritjen e grupeve të punës për inventarizimin/asgjësimin.
- Relacione dhe çdo lloj evidence tjetër vënë në dispozicion.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

Inventarizimi i pasurisë për vitin 2018.

I. Drejtori Rajonal i Tatimeve, z. O.C, në bazë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ka nxjerrë me shkresën nr.19093/1 prot., datë 19.11.2018, Urdhër për “Ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të Institucionit, për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 i përbërë nga 7 anëtarë: F. A., kryetar, E. E., anëtare, Z. V., Anëtare, F. T., Anëtare, A. H., anëtar, A. T., anëtar dhe E. H., anëtar.

-Komisioni për vlerësimin e aktiveve do të jetë i njëjtë me komisionin për kryerjen e inventarizimit.

Urdhri është ngritur në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar.

Konstatohet se në Urdhër nuk është përcaktuar afat në lidhje me përfundimin e procesit të Inventarizimit.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të inventarizimit, konstatohet se:

➤ Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në UMF nr.30, datë 27.12.2011, pika 83, ku citohet se: “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material”.

Sipas Zyrës së Financës së Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse, gjendja kontabël e aktiveve të trupëzuara (me kosto historike) datë 31.12.2018, në total është 143,265,090 lekë, kurse e detajuar paraqitet si më poshtë:

Llogaria	Përshkrimi i aktivitetit	Gjendja e aktivitetit
2120000	Ndërtesa	77,424,744
2130000	Instalimi i rrjetit kompjuterik	154,074
2140000	Instalime, makineri, vegla pune	6,165,562
2150000	Automjete	36,237,348
2180000	Inventar ekonomik	23,283,362
	TOTAL	143,265,090

➤ Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal të plotë,

ku të pasqyrojë dhe krahasojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në tabelë duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në UMF nr.30, datë 27.12.2011 pika 85 Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:

a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proces verbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet;

Kjo tabelë të përmbledhur e inventarit nuk ka datë kur është përgatitur. Konstatohet se është firmosur nga të gjithë anëtarët.

Zyra e Financës në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse ka kryer veprimin kontabël duke rritur aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 8,682,996 lekë, përkatësisht:

Llogarinë 215 “automjete” në vlerë 6,207,208 lekë

Llogaria	Përshkrimi i aktivitetit	Viti i futjes në përdorim	Cmimi
2150000	Automjet Peugeot TR.....LH	13.04.2018	1,923,208
2150000	Automjet Mitsubishi Pajero TR.... R	30.04.2018	4,284,000
	TOTAL		6,207,208

Me shkresën nr.7612 prot., datë 13.04.2018, DPT i është drejtuar DRT Fier për kalimin e automjetit Peugeot me targa TR AA.....LH dhe me shkresën nr.9047 prot datë 30.04.2018 për kalimin e automjetit Mitsubishi Pajero me targa TR R.

Llogarinë 218 “inventar ekonomik” në vlerë 2,475,788 lekë

Llog.	Përshkrimi i aktivitetit	Viti i futjes në përdorim	Cmimi
2181000	Tavolina te zeza 15 cope	09.01.2018	366,495
2181000	Karrige te kuqe me rrota 20 cope	09.01.2018	1,109,100
2181000	Karrige me rrota (poltron) 1 cope	12.02.2018	22,000
2187000	Fotografi artistike 1 cope	13.02.2018	49,920
2186000	Printer Kyocera 1 cope	26.03.2018	7,590
2186000	Kompjuter Desktop 2015 1 cope	17.04.2018	78,387
2186000	Ups 1 cope	17.04.2018	4,758
2186000	Printer 1200 1 cope	17.05.2018	55,035
2186000	Printer 1300 1 cope	17.05.2018	42,954
2186000	KOMPJUTER ASER 1 cope	17.05.2018	75,984
2184000	Fotokopje Toshiba 1	05.12.2018	272,400
2186000	UPS 600 10 cope	05.12.2018	46,680
2186000	Sëich me 8 porta 1 cope	05.12.2018	4,680
2184000	Fotokopje Toshiba 1 cope	06.12.2018	272,400
2187000	Projektor Epson 1 cope	05.12.2018	48,720
2186000	Ups 600 3 cope	06.12.2018	14,004
2186000	Sëich me 8 porta 1 cope	06.12.2018	4,680
	TOTAL		2,475,788

Zyra e Financës në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,995,126 lekë përkatësisht:

Llogarinë 213 “instalim i rrjetit kompjuterik” me vlerë 143,615 lekë për 1 LAN instalacion and commission 1

Llogaria	Përshkrimi i aktivitetit	Viti i futjes në përdorim	Amortizimi i vitit 2018
2135000	Instalim rrjeti	2000	143,615
	TOTAL		143,615

Llogarinë 218 “Inventar ekonomik” me vlerë 14,666,525 lekë (sasi 121 copë total/të ndryshme)

Llogaria	Emertimi	Nxjerre jashte perdorimit Pv nr 2 dt. 18.12.2015	
		Sasi	Vlere
2180000	Aparat fotografik 1	1	31,260
2180000	Aparat telefoni 3	1	2,400
2186000	File Server 1	1	900,468
2186000	Ilpakt line printer 1	1	1,139,902
2180000	Karikues baterie aparati fotografik 1	1	2,350
2180000	Karte memorje aparati fotografik	1	1,190
2186000	Komp. Administrator Eorkstation	1	248,348
2186000	Kompjuter (njesi qendrore) 1	1	103,000
2186000	Kompjuter (njesi qendrore) 1	1	94,380
2186000	Kompjuter (njesi qendrore) 5	5	701,350
2186000	Kompjuter + Monitor 1	1	144,414
2186000	Kompjuter 1	1	248,209
2186000	Kompjuter 1	1	220,532
2186000	Kompjuter 1	1	164,163
2186000	Kompjuter 2	2	280,540
2186000	Kompjuter 3	3	491,400
2186000	Kompjuter 4	4	502,400
2186000	Kompjuter komplet 1	1	108,500
2186000	Kompjuter personal (njesi qendrore) 21	21	2,945,670
2186000	Kompjuter personal comp dc 5000 cope 5	5	579,700
2186000	Kompjuter personal HP Comp(njesi qendrore) 6	6	841,620
2186000	Kompjuter personal HP Compaq dc5000 SFF Business Desktop	4	463,760
2186000	Kompjuter server compaq ML 370 1cope	1	899,983
2186000	Kompjuter ein 98 1 cope	1	113,880
2186000	Monitor 17 HP Compaq 12	12	286,716
2186000	Monitor 17 HP Compaq 7	7	167,251
2186000	Monitor 17" 10	10	238,930
2186000	Monitor 19" 2	2	51,008
2186000	Monitor 4	4	83,408
2186000	Neteorksprint server devia	1	18,760
2186000	Printer 1	1	47,190
2186000	Printer 1	1	45,000
2186000	Printer 1	1	42,500
2186000	Printer 1	1	84,000
2186000	Printer Samsung 1	1	49,000
2186000	Printer 1300 2	2	85,908
2186000	Printer 1300 2	2	46,785
2186000	Printer hp 1320 personal Laser 4	4	138,880
2186000	Printer HP LazerJet 1200 1	1	187,922
2186000	Ram shtese 1	1	10,800
2186000	Server 1	1	358,980
2186000	Server 1 procesor IBM (Njesi qendrore) 1	1	716,654
2186000	Server 1 procesor IMB 1	1	716,654
2186000	UPS for Racks Tripp Lite APS INT 1012 Inverter/Charge	1	60,760
	T O T A L I	121	14,666,525

Llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” gjithsej me vlerë 184,986 lekë

Llogaria	Emërtimi	Viti	Vlera
2140000	Kondicioner 1 cope	2001	86,386
2140000	Kondicioner Hyndai 1 cope	2001	98,600
	TOTAL		184,986

Inventarizimi i pasurisë për vitin 2019.

I. Drejtori Rajonal i Tatimeve, z. O.C, në bazë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7 dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, ka nxjerrë me shpresë nr.92 prot., datë 07.01.2020, Urdhër për “Ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të institucionit, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019” i përbërë nga 7 anëtarë: E.GJ, Kryetar, E.E, anëtare, A.A, anëtare, A.T, anëtare, G.M, anëtar, A.K, anëtar dhe F.S, anëtar

-Komisioni për vlerësimin e aktiveve do të jetë i njëjtë me komisionin për kryerjen e inventarizimit.

Urdhri është ngritur në përputhje me UMF nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar. Konstatohet se në Urdhër nuk është përcaktuar afat në lidhje me përfundimin e procesit të Inventarizimit.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të inventarizimit, konstatohet se:

➤ Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit **nuk ka mbajtur procesverbal** me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në UMF nr.30, datë 27.12.2011 ku citohet se: *“Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material”*.

Sipas Zyrës së Financës së Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse, gjendja kontabël e aktiveve të trupëzuara (me kosto historike) datë 31.12.2019 në total është 143,958,389 lekë, mbajtur në procesverbalin e datës 10.01.2020, kurse e detajuar paraqitet si më poshtë:

Llogaria	Përshkrimi i aktivitet	Gjendja e aktivitet
2120000	Ndërtesa	77,424,744
2130000	Instalimi i rrjetit kompjuterik	154,074
2140000	Instalime, makineri, vegla pune	6,446,652
2150000	Automjete	36,237,348
2180000	Inventar ekonomik	23,695,561
	TOTAL	143,958,379

➤ Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal të plotë ku të pasqyrojë dhe krahasojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në tabelë duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në UMF nr.30, datë 27.12.2011 pika 85 *Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:*

a. *Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proces verbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit*

b. *Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë proces verbal;*
Konstatohet se procesverbali i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve për vitin 2019, nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët. Znj.A.T, në cilësinë e anëtare e Komisionit nuk ka firmosur. Ky procesverbal është firmosur dhe nga Z. O.C në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Zyra e Financës në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse, ka kryer veprimin kontabël duke rritur aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 3,189,288 lekë përkatësisht:

llogarinë 214 “instalim i rrjetit kompjuterik” në vlerë 281,090 lekë

Llogaria	Emertimi	Sasia	Çmimi	Vlera
2140170	Kondicioner	5	35,287	176,435
2140170	Kondicioner	1	35,000	35,000
2140170	Kondicioner	1	31,465	31,465
2140170	Kondicioner	1	38,190	38,190
	TOTAL			281,090

llogarinë 218 “inventar ekonomik” në vlerë 2,908,198 lekë

Llogaria	Emertimi	Sasia	Çmimi	Vlera
2186000	Kompjuter Agis Business 2 GB, monitor Agis	4	78,882	315,528
2186000	Kompjuter Desktop Lenovo Think Center	7	75,523.2	528,662

2186000	Kompjuter Desktop Lenovo Think Center	2	75,523.2	151,046
2186000	Kompjuter Desktop Lenovo Think Center	3	75,523.2	226,570
2186000	Kompjuter Desktop Lenovo Think Center	5	75,523.2	377,616
2186000	Kompjuter komplet desktop	2	78,387.99	156,776
2186000	Smart tableta	24	48,000	1,152,000
	TOTAL			2,908,198

Për sa më sipër këto rritje aktivi janë bërë me marrje në ngarkim nga DPT. Bashkëlidhur ketij REaporti shkresa midis Llogaritares së Drejtorisë së Tatimeve dhe Përgjegjëses së Financës në DRT Fier, që konfirmojnë marrjen në ngarkim të tyre, fletë dalje nga DPT dhe fletë hyrje në DRT Fier.

Zyra e Financës në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 2,496,000 lekë përkatësisht:

-llogarinë 218 “Inventar ekonomik” me vlerë 2,496,000 lekë.

Llogaria	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Vlera	Kthyer ne DPT		Gjendje në 31.12.19	
					Sasi	Vlere	Sasi	Vlerë
2186000	Tab Lenovo	72	48,000	3,456,000	52	2,496,000	20	960,000

Procedura e asgjësimit të aktiveve të Drejtorisë Rajonale Fier, për vitin 2018

Gjatë auditimit rezultoi se, strukturat drejtuese të Drejtorisë Rajonale Fier, kanë vijuar procedurat për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mallrave të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2014, mbajtur më datë 06.02.2015.

Me shkresën nr.3544 prot., datë 01.03.2018, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier është dërguar I.B Recycling, kërkesë për riciklimin e pajisjeve elektronike dhe elektrike, pasi i ka vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi, pas marrjes së përgjigjes nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me operatorët të cilët operojnë në fushën e “Trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve elektrike dhe elektronike” me shkresën nr.49/1 prot., datë 16.01.2018. Kerkese kjo në vijim edhe të VKM Nr.957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” në mënyrë që të menaxhohen sipas standardeve të BE-s dhe të trajtohen nga kompani të licencuara.

Me shkresën nr. 3911, datë 06.03.2018, Drejtori Rajonal Fier ka nxjerrë Urdhër të Brendshëm “Për evadimin e materialeve elektrike dhe elektronike. Në mbështetje të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM Nr.957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektronike dhe elektrike”, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 02.02.2018, të lidhur midis DRT Fier dhe kompanisë “I.B Recycling” është urdhëruar:

1. *Materialet e nxjerra jashtë përdorimit nga Komisioni i ngritur për këtë qëllim, të cilat ndodhen në magazinën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, sipas listës bashkëlidhur, objekt i VKM Nr.957 datë 19.12.2012.*

2. *Me përfaqësuesin e firmës “I.B Recycling” dhe punonjësit të magazinës të mbahet procesverbal për dorëzimin e këtyre materialeve.*

Për sa më sipër konstatohet se:

Llogaria 214: ka një amortizim të akumuluar në vlerën 1,229,069 lekë dhe vlerë të mbetur 0.

Llogaria 218: ka një amortizim të akumuluar në vlerën 13,747,557 lekë dhe vlerë të mbetur 18,500 lekë.

Në total për të dy llogaritë, amortizimi i akumuluar është në vlerën 14,995,125 lekë dhe vlerë të mbetur 18,500.

Procesverbali i dorëzimit të materialeve është firmosur nga magazinieri i DRT Fier z. A.H dhe përfaqësuesi i kompanisë I.B Recycling Z.F.M (administrator).

Konstatohet: Procedura e vlerësimit të aktiveve të inventarizuara i takon vitit 2015. Konkretisht me shkresën nr.19660/2 prot., datë 28.01.2015, Urdhër i Brendshëm “Për

vlerësimin e aktiveve të inventarizuara për vitin 2014” është ngritur Komisioni për vlerësimin e aktiveve për vitin 2014 më përbërje si në vijim: *F.A/Kryetar, D.H/Anëtar, A.C/Anëtar, L.L/Anëtar dhe E.F/Anëtar.*

Ky urdhër nuk ka të përcaktuar afat në lidhje me kohëzgjatjen e kësaj procedure.

Nga auditimi konstatohet se kryetar i komisionit të vlerësimit nuk ka qenë Nëpunësi Zbatues, në kundërshtim me pikën 99 të UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar ku citohet se “...Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë...”

Relacioni bashkëlidhur është pa datë dhe nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët por vetëm nga Kryetari.

Sipas këtij relacioni:

1. *Janë konstatuar materiale të amortizuara komplet*
2. *Materiale të amortizuara pjesërisht por që nuk mund të riparohen*
3. *Materiale të amortizuara pjesërisht por vlera e riparimit të tyre është më e madhe se vlera fillestare (vlera e blerjes).*

Me procesverbalin e datës 06.02.2015 janë bashkëlidhur materialet në llogarinë “Inventari ekonomik” (llogaria 218) dhe në llogarinë “Investime, makineri, vegla pune” (llogaria 214). Llogaria 214 është me amortizim të akumuluar 1,229,069 lekë dhe vlerë të mbetur 0. Llogaria 218 është me amortizim të akumuluar 13,974,559 lekë dhe vlerë të mbetur 381,208 lekë.

Ky procesverbal është firmosur nga të gjithë anëtarët dhe miratuar nga Drejtori Rajonal. Me proces verbalin e datës 06.02.2015 janë vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi të materialeve në llogarinë “Mjete transporti” (llogaria 215), me amortizim të akumuluar në vlerën 4,904,300 lekë.

Ky procesverbal është firmosur nga të gjithë anëtarët dhe miratuar nga Drejtori Rajonal.

Me shkresën nr.19660/3 prot datë 28.01.2015 është urdhëruar ngritja e komisionit për nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve të inventarizuara dhe të vlerësuara për tu nxjerrë nga përdorimi si në vijim: *N.T/Kryetar, Z.C/Anëtar, Z.SH/Anëtar, V.R/Anëtar dhe T.R/Anëtar.* Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Me shkresë nr.10473 prot., datë 13.08.2015 është shfuqizuar shkresa e mësipërme. Me shkresën nr.2325/1 prot., datë 11.08.2015 (*prot., në DRT në datë 13.08.2015*), të DPT-s është ringritur komision i ri për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve si në vijim:

1. *E.G Kryetar (Drejtorja e Teknologjisë dhe Informacionit) DPT*
2. *E.LL Anëtar (Drejtorja e Avokatit të Tatimpaguesve) DPT*
3. *J.G Anëtar (Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve) DPT*
4. *E.S Anëtar (Sektori i Financës) DRT Fier*
5. *B.M Anëtar (Drejtorja Juridike) DRT Fier.*

Me procesverbalin nr.2 datë 18.12.2015 është kërkuar vazhdimi i procedurave nga DRT Fier për ankand (aktive të riciklueshme).

Me shkresën nr.25468 prot., datë 14.12.2015, i është kërkuar DPT-s nga ana e Drejtorit Rajonal zëvendësimi i anëtarit z.B.M me znj.E.SH me detyrë inspektore në Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit në DRT Fier.

Kjo është miratuar nga ana e DPT-s me shkresën nr.41526/1 prot datë 24.12.2015 z.B.M është zëvendësuar me znj.E.SH me detyrë inspektore në Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit në DRT Fier.

Llogaria 218 në procedurën e vitit 2015: ka një amortizim të akumuluar 13,974,559 lekë dhe vlerë të mbetur 381,208 lekë.

Llogaria 218 në procedurën e vitit 2018: ka një amortizim të akumuluar në vlerën 13,747,557 lekë dhe vlerë të mbetur 18,500 lekë.

Konstatohet se në procedurën e evadimit të materialeve të vitit 2018 mungojnë në procesverbalin e dorëzimit të tyre materialet e mëposhtme:

Llogaria	Emërtimi	Sasia	Amortizimi i akumuluar	Vlera e mbetur
218	Karrige 1	1	1,660	2,091
218	Karrige Hekuri	29	49,192	72,608
218	Minibar italian	1	43,357	70,843
218	Piktura origjinale	1	3,510	9,490
218	Tavolinë	18	129,284	207,676
TOTAL		50	227,003	362,708

Burimi i të dhënave

Këto materiale janë asgjësuar me procesverbalin nr.1 datë 18.12.2015 për këtë arsye mungojnë në procedurën e vitit 2018, pasi nuk kanë qënë në kategorinë e materialeve elektrike dhe elektronike.

Konstatohet se në procesverbalin nr.1 të datës 18.12.2015 kanë firmosur të gjithë anëtarët e komisionit si dhe Znj.E.SH, në kundërshtim me Urdhrin nr.2325/1 prot., datë 11.08.2015, në të cilin nuk ka qënë anëtare Komisioni, ndërkohë që dhe emërimi i saj si anëtare është bërë në datën 24.12.2015, pra gati një javë pas kryerjes së procedurës së asgjësimit. Kjo praktikë është trajtuar nga grupet e mëparshme të auditimit.

Për sa i përket shkresë nr. 3911, datë 06.03.2018 të Drejtorit Rajonal dhe nxjerrjes së Urdhrit të Brendshëm “Për evadimin e materialeve elektrike dhe elektronike, nuk konstatohen problematika.

Për problematikat e konstatuara procedurale ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Inventarizimit të vitit 2018 dhe 2019.

Titulli i Gjetjes	Mos kryerja e drejtë e procedurave të inventarizimit.
Situata	Drejtori Rajonal i Tatimeve, ka nxjerrë Urdhrin nr.19093/1 prot., datë 19.11.2018, për “Ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të Institucionit, për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, dhe Urdhrin nr. 92 prot., datë 07.01.2020, Urdhër për “Ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të institucionit, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019”, të përbërë nga 7 anëtar. <i>Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të inventarizimit, konstatohet se:</i> - Në Urdhër nuk është përcaktuar afat në lidhje me përfundimin e procesit të Inventarizimit. - Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, për të fiksuar numrin e fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit. - Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal të plotë ku të pasqyrojë dhe krahasojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit. - Procesverbali i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve për vitin 2019, nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët. Veprimet dhe mosveprimet e komisioneve të inventarizimit bien në kundërshtim me pikën 83 dhe 85 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Kriteri	UMF nr.30, datë 26.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat
Ndikimi/Efekti	Institucioni përballlet me riskun potencial të mos menaxhimit administrimit dhe humbjeve të vlerave materiale.
Rëndësia	I lartë

Rekomandimi	Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masa që procesi i inventarizimit të bëhet sipas përcaktime ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.
--------------------	--

2.4 Për auditimin e saktësisë dhe rregullshmërisë së kryerjes së pagesave për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime për udhëtime dhe dieta, si dhe shpenzime të tjera personeli, etj).

Në auditimin e këtij drejtimi auditimi sipas programit, për periudhën 01.01.2018 – 30.09.2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dosjet e punonjësve (*akt emërimi/diploma*);Listëpagesat;Listëprezencat; Urdhër shpenzimet, Borderotë, Rakordimet me Thesarin dhe çdo informacion justifikues/vërtetues që është gjykuar i nevojshëm gjatë auditimit, vënë në dispozicion nga struktura e Financës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

Fondet buxhetore për art.600, në zërin “Paga” dhe në art.601, në zërin “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” për vitet 2018 -2019 dhe periudhën deri në 30.09.2020, janë çelur në zbatim të ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018” dhe ligjit nr.99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 17.01.2019, si dhe akteve të dala në zbatim të ligjeve të sipërcituara.

Tabela në vijim paraqet shpenzimet në art.600, në zërin “Paga” dhe në art.601, në zërin “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” për këtë periudhë.

Në lekë

DRT Fier	Plani Vjetor			Shpenzimet Faktike			Diferenca 2018-2019
	Paga	Sigurime	Totali	Paga	Sigurime	Totali	
Viti 2018	120,087,570	20,316,500	140,404,070	119,150,339	19,823,021	138,973,360	1,430,710
Viti 2019	119,000,000	20,000,000	139,000,000	116,608,181	19,399,212	136,007,393	2,992,607
Janar-Shtator 2020	139,347,000	24,000,000	163,347,000	85,813,743	14,694,602	100,508,345	62,838,655
Total	378,434,570	64,316,500	442,751,070	321,572,263	53,916,835	375,489,098	67,261,972

Në total për vitin 2018, shpenzimet për paga art 600-601, janë planifikuar në shumën 140,404,070 lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 138,973,360 lekë, me një realizim prej 98.98%, nga të cilat: 119,150,339 lekë për paga dhe 19,823,021 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Në tabelën e mësipërme situata e vitit 2018 paraqitet për shpenzimet e kryera Janar-Dhjetor 2018, që në fakt u takojnë pagave për muajt Dhjetor 2017-Nëntor 2018.

Në lidhje me pagat e muajve Janar 2018-Dhjetor 2018 (paguar në shkurt 2018-janar 2019) situata paraqitet si në vijim:

Viti 2018	Paga Bruto	Sig shoq.punëdhënës	Sig shëndet.punëdhënës
Janar		9,882,019	1,437,159
Shkurt		9,338,905	1,400,836
Mars		9,881,971	1,476,742
Prill		10,024,349	1,500,857

Maj	10,525,717	1,577,635	178,937
Qershor	10,573,239	1,571,073	178,194
Korrik	10,488,738	1,558,525	176,771
Gusht	10,117,519	1,516,173	171,971
Shtator	9,993,176	1,497,754	169,884
Tetor	9,513,700	1,419,557	161,021
Nentor	9,108,830	1,365,102	154,850
Dhjetor	9,475,141	1,420,786	161,077
Total	118,923,304	17,742,199	2,011,805
BILANC	118,944,224	17,741,737	2,039,140
DIFERENCA (bilancë-paga faktike)	21,538	-462	27,335

Në pasqyrën financiare të vitit 2018, pagat (zëri 600) paraqiten në shumën 118,944,224 lekë, sigurimet shoqërore në shumën 17,741,737 lekë dhe sigurimet shëndetësore në shumën 2,039,140 lekë (total zëri 601 në vlerën 19,780,877 lekë). Për sa më sipër konstatohen këto diferenca: llogaria 600 paraqitet 21,538 lekë më tepër në bilancë në krahasim me shpenzimet faktike ndërsa llogaria 601 paraqitet 26,873 lekë më tepër.

Në total për vitin 2019 shpenzimet për paga art 600-601 janë planifikuar në shumën 139,000,000 lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 136,007,393 lekë, me një realizim prej 97,84 % nga të cilat: 116,608,181 lekë për paga dhe 19,399,212 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Në tabelën e mësipërme situata e vitit 2019 paraqitet për shpenzimet e kryera Janar-Dhjetor 2019, që në fakt u takojnë pagave për muajt Dhjetor 2018-Nëntor 2019.

Në lidhje me pagat e muajve Janar 2019-Dhjetor 2019 (paguar në shkurt 2019-janar 2020) situata paraqitet si në vijim:

Viti 2019	Paga Bruto	Sig shoq. punëdhënës	Sig shëndet. punëdhënës
Janar	9,133,200	1,369,980	155,264
Shkurt	9,303,648	1,395,547	158,162
Mars	9,962,824	1,494,424	169,368
Prill	10,092,150	1,513,822	171,566
Maj	10,242,474	1,536,371	174,122
Qershor	10,303,105	1,538,481	174,361
Korrik	10,258,959	1,538,844	174,402
Gusht	9,613,893	1,415,081	160,376
Shtator	9,326,804	1,385,390	157,010
Tetor	9,244,762	1,386,714	157,161
Nentor	9,651,241	1,429,434	162,002
Dhjetor	9,519,602	1,427,940	161,833
Total	116,652,641	17,431,474	1,975,640
BILANCI	116,652,641	17,431,474	1,975,640
DIFERENCA (bilancë-paga faktike)	0	0	0

Në Bilancin e vitit 2019, pagat paraqiten në shumën 116,652,641 lekë, sigurimet shoqërore në shumën 17,431,474 lekë dhe sigurimet shëndetësore në shumën 1,975,640 lekë (në total zëri 601 në vlerën 19,407,114 lekë). Për sa më sipër nuk konstatohen diferenca.

Në total për vitin 2020 shpenzimet për paga art 600-601 janë planifikuar në shumën 163,347,000 lekë dhe deri në 30.09.2020 janë shpenzuar 100,508,345 lekë, me një realizim prej 61,5 %, nga të cilat: 85,813,743 lekë për paga dhe 14,694,602 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Për secilin vit buxhetor shpenzimet faktike rezultojnë të rakorduara me situacionet vjetore me Degën e Thesarit Fier.

Për vitin 2020, konstatohet se me Urdhër shpenzimin Nr.229 datë 24.09.2020, është bërë parapagim i sigurimeve shoqërore për muajin shtator në vlerën 2,500,000 lekë, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të cilat përcaktojnë se Entet Publike duhet të bëjnë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Udhëzimi nr.23 datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” i Ministrisë së Financave, pika 4 “Afatet e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore”

a) Deklarojnë dhe paguajnë çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Auditimi u krye mbështetur në legjislacionin e cituar te kriteret e vlerësimit si dhe në: Strukturat e miratuara nga KM; Listëpagesat; Diplomat; Listë prezencat; Urdhër shpenzimet; Urdhër e punës, etj.

Pagat e punonjësve të sistemit të tatimeve mbështeten në VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet emistrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet nëvarësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8.

Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblymet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, etj, grupi i auditimit auditoi në bazë risku praktikat dokumentare që shoqëronin shpenzimet e kryera.

Punonjësit në strukturë

Për vitin 2018, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier ka ushtruar funksionet në zbatim të strukturës organizative, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, me numër të përgjithshëm punonjësish 150, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.12381/12, datë 19.12.2016.

Nga 150 pozicione pune në strukturë, për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, 86 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe 64 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995“Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Struktura e punonjësve të DRT Fier për vitin 2018, paraqitet si vijon:

Nr.	Emërtimi i Drejtorive	Struktura	Statusi i punonjësve
1	Drejtore Rajonal	1	Status i nëpunësit civil
2	Sekretare	1	Me kontratë
3	D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	15	Status i nëpunësit civil
4	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë	14	Status i nëpunësit civil
5	Drejtoria Kontrollit Tatimor	43	Status i nëpunësit civil
6	Drejtoria e Analizës dhe IT	7	Status i nëpunësit civil
7	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	6	Status i nëpunësit civil
8	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	7	Me kontratë
9	Drejtoria e Hetimit Tatimor	56	Me kontratë
	Gjithsej	150	
	Nga këto :	86	Status i nëpunësit civil
		64	Me kontratë

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier

Realizimi i strukturës në datë 31.12.2018 paraqitet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Nr
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2018	150
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2018	134
3	Vende të lira pune në datë 01.01.2018	16
4	Realizimi në % i strukturës në datë 31.12.2018	89.3 %
5	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2018	150

6	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2018	127
7	Vende të lira pune në datë 31.12.2018	23
8	Realizimi në % i strukturës në datë 31.12.2018	84.6 %

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier

Për periudhën 01.01.2019-12.06.2019 numri i punonjësve të DRT Fier ka qenë 150, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016. Me Urdhrin e Kryeministrit nr.171, datë 13.05.2019, numri i punonjësve të DRT Fier është bërë 146 punonjës, përcjellë me shkresën nr.9732 prot., datë 12.06.2019. Nga 146 pozicione pune në strukturë, 83 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe 63 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar.

Struktura e Drejtorisë Rajonale Fier për vitin 2019, paraqitet si vijon:

Nr.	Emërtimi i Drejtorive	Struktura	Statusi i punonjësve
1	Drejtor Rajonal	1	Status i nëpunësit civil
2	Sekretare	1	Me kontratë
3	D/ Sherbimit për Tatim Paguesin	15	Status i nëpunësit civil
4	Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve të papaguara	14	Status i nëpunësit civil
5	Drejtoria Kontrollit Tatimor	43	Status i nëpunësit civil
6	Spektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të ardhurave	4	Status i nëpunësit civil
7	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	6	Status i nëpunësit civil
8	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	7	Me kontratë
9	Drejtoria e Hetimit Tatimor	55	Me kontratë
	Gjithsej	146	
	Nga këto :	83	Status i nëpunësit civil
		63	Me kontratë

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier

Realizimi i strukturës për vitin 2019

Nr.	Emërtimi	Nr
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2019	150
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2019	127
3	Vende të lira pune në datë 01.01.2019	23
4	Realizimi në % i strukturës në datë 01.01.2019	84.6 %
5	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2019	146
6	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2019	133
7	Vende të lira pune në datë 31.12.2019	13
8	Realizimi në % i strukturës në datë 31.12.2019	91 %

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier

Për periudhën 12.06.2019-12.02.2020 numri i punonjësve të DRT Fier ka qenë 146, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.171, datë 13.05.2019.Me Urdhrin e Kryeministrit nr.33, date 12.02.2020, numri i punonjësve të DRT Fier bëhet 122 punonjës, përcjellë me shkresën nr. 4284 prot., datë 24.04.2020. Nga 122 pozicione pune në strukturë, 91 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me ligjin nr.152/2013 i ndryshuar dhe 31 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar.

Struktura e punonjësve për vitin 2020, paraqitet si vijon:

Nr.	Emërtimi i Drejtorive	Struktura	Statusi i punonjësve
1	Drejtor Rajonal	1	Status i nëpunësit civil
2	Sekretare	1	Me kontratë
3	D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	11	Status i nëpunësit civil
4	Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara	26	Status i nëpunësit civil

5	Drejtoria Kontrollit Tatimor	43	Status i nëpunësit civil
6	Spektori i Analizës dhe Kontabilitetit të ardhurave	4	Status i nëpunësit civil
7	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	6	Status i nëpunësit civil
8	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	7	Me kontratë
9	Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren	23	Me kontratë
	Gjithsej	122	
	Nga këto :	91	Status i nëpunësit civil
		31	Me kontratë

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier

Realizimi i strukturës në datë 30.09.2020 paraqitet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Nr
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2020	146
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2020	133
3	Vende të lira pune në datë 01.01.2020	13
4	Realizimi në % i strukturës në datë 01.01.2020	91 %
5	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 30.09.2020	122
6	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 30.09.2020	114
7	Vende të lira pune në datë 30.09.2020	8
8	Realizimi në % i strukturës në datë 30.09.2020	93.4 %

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier

Nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT është hartuar regjistri themeltar i punonjësve dhe libri i personelit, ndërkohë që për vendimet e emërimit, transferimit, ndryshimit të kategorisë dhe largimit nga detyra janë të pasqyruara në format excel. Tabela e vjetërsisë në punë të punonjësve rishikohet për cdo muaj.

Nga analiza e listë pagesave të punonjësve të DRT Fier u konstatua se, janë llogaritur sipas përcaktimeve të VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit":

- Shtesa për pozicion (lidhja 1);
- Shtesa për kushte pune (lidhja 6/8).

Gjithashtu janë llogaritur saktë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

Grupi i auditimit auditoi pagesat e kryera nga DRT Fier referuar emërimeve. Nga auditimi rezultoi se në të gjitha rastet dhe për të gjitha drejtoritë, përpiloheshin listë prezencat mujore të cilat nënshkruheshin nga titullarët e drejtorive. Bashkëlidhur listë prezencës gjendeshin raportet mjekësore të cilat ishin të reflektuara edhe në listë prezencë.

Listë pagesat hartoheshin të plota me të gjithë komponentët e pagës dhe ndalesave. Listë pagesat konfirmoheshin nga NA dhe NZ i institucionit. Grupi i auditimit testoi llogaritjen e pagës në raport me nivelin e diplomës.

Për sa më sipër u konstatua si në vijim:

Marrëdhëniet e punës në DRT Fier rregullohen me Ligjin nr.152/2013 i ndryshuar dhe Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar. Në pikën 7 të nenit 140 të rregullores së funksionimit të administratës tatimore qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, përcaktohet se "Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT harton kriteret specifike që duhet të plotësojnë punonjësit e strukturave të hetimit tatimor për t'u emëruar në punë, kriteret të cilat i miraton te Drejtori i Përgjithshëm i DPT".

Grupi i auditimit, auditori mbi bazë risku, dokumentacionin e administruar në dosjet e punonjësve si dhe evidencat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse. U morën në shqyrtim 24 dosje, të Hetimit Tatimor (të vlerësuara me risk më të lartë duke qenë të rekrutuar dhe punonjës me kod pune), për verifikim të diplomës së tyre dhe pagesave të kryera në përputhje ose jo me pagën dhe kategorinë e diplomës dhe u konstatua se nga ana e strukturës së Financës janë paguar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për vitin 2018-2019.

Emër Mbiemër	Kategoria e pozicionit/pagës	Kushte pune	Kategoria e Diplomës	Pagesa e Financës sipas diplomës
A.C	Vendimi Nr.165 datë 10/12/2014 Inspektor Hetimi IV-a Diplomë Bachelor Administrim Biznesi	12,000	1-2-3	10,000
D.M	Vendimi Nr.229 datë 17.02.2017 Inspektor Zbatimi IV-a Diplomë Bachelor Administrim Biznesi	12,000	1-2-3	10,000
E.H	Vendimi Nr.427 datë 07.04.2017 Përgjegjës i Zyrës së Monitorimit dhe Koordinimit në Sektorin e Zbatimit Kategoria III-b Diplomë Bachelor Menaxhimi Turizimi	12,000	Punësuar pa kualifikimin e vendit të punës, anuluar nga DPT dhe kaluar specialist	10,000
SH.D	Vendimi Nr.5 datë 06.01.2016 Inspektor Hetimi IV-a Diplomë Bachelor Ekonomi	12,000	1-2-3	10,000
Z.C	Vendimi Nr.2009 datë 03.06.2013 Inspektore e dytë në Sektorin e Përpunimit të Deklaratave IV-a Diplomë Bachelor Ekonomi	12,000	1-2-3	10,000
A.M	Vendimi Nr.189 datë 19.03.2018 Inspektor Zbatimi kategoria IV-A Diplomë Bachelor Drejtësi	12,000	1-2-3	10,000
G.B	Vendimi Nr.190 datë 19.03.2018 Inspektor Zbatimi kategoria IV-A Diplomë Bachelor Drejtësi	12,000	1-2-3	10,000
A.K	Vendimi Nr.84 datë 16.01.2014 Inspektor i dytë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor Diplomë Bachelor Administrim Biznesi	12,000	1-2-3	10,000
E.A	Vendimi Nr.263 datë 25.04.2018 Inspektor Hetimi IV-a Diplomë Bachelor Menaxhim	12,000	1-2-3	10,000
R.C	Vendimi Nr.356 datë 15.03.2017 Inspektor Zbatimi IV-a Diplomë Master Profesional Menaxhim Biznesi	12,000	1-2-3	11,000
A.M	Vendim Nr.7625 datë 10.04.2019 Inspektor IV-a Bachelor Financë-Kontabilitet	12,000	1-2-3	10,000
XH.XH	Vendim Nr.7624 prot datë 10.04.2019 Inspektor Hetimi IV-a Diplomë Bachelor Financë	12,000	1-2-3	10,000
E.D	Vendim nr 438 prot datë 4.11.2019 Inspektor kategoria IV-b 38,000 Diplomë Bachelor në Ekonomi	10,000	1-2-3	10,000
G.B	Vendim nr 441 prot datë 4.11.2019 Inspektor kategoria IV-b 38,000 Diplomë Bachelor Menaxhim Biznesi	10,000	1-2-3	10,000
G.S	Vendim nr.161 datë 27/01/2017 Inspektor Hetimi IV-a Diplomë Master Shkencor Informatikë Ekonomike	12,000	1-2-3	14,000
A.S	Vendim Nr.248 datë 25.04.2018 Inspektor Hetimi IV-a Diplomë Master Profesional në Ekonomiks	12,000	1-2-3	11,000

GJ.K	Vendim Nr.299 datë 11.05.2018, Inspektor Zbatimi IV-a Diplomë Master Profesional Shkenca Administrative	12,000	1-2-3	11,000
M.P	Vendim Nr.664 datë 11.12.2018 Inspektor Hetimi IV-a Master Shkencor Drejtësi	12,000	1-2-3	14,000
D.S	Vendim Nr.386/1 datë 26.02.2019 Inspektor i Dytë kategoria IV-a Master Shkencor Financë Bankë	12,000	1-2-3	14,000
L.R	Vendim Nr.5140/46 datë 13.03.2019 Inspektor i Parë Kontrolli III-b Master Shkencor Ekonomi	12,000	1	14,000
E.M	Vendim Nr.5140/33 datë 13.03.2019 Inspektor i dytë IV-a Diplomë Master Shkencor në Ekonomiks	12,000	1-2-3	14,000
K.K	Vendim Nr.5140/40 datë 13.03.2019 Specialiste Kategoria IV-a Diplomë Master Shkencor në Financë	12,000	1-2-3	14,000
V.GJ	Vendim Nr.5140/34 datë 13.03.2019 Inspektor i dytë IV-a Diplomë Master Profesional Shkenca Administrative	12,000	1-2-3	11,000
A.XH	Vendim Nr.439 datë 04.11.2019 Inspektor kategoria IV-b Master Profesional Financë-Kontabilitet	10,000	1-2-3	11,000

1. Respektimi i dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta

Tabela në vijim paraqet shpenzimet në art.602.4, në zërin “Shpenzime udhëtimi” për vitet 2018 -2019.

Në lekë

DRT Fier	Plani Vjetor	Shpenzimet Faktike	Diferenca	Realizimi në %
Viti 2018	3,210,000	3,200,920	9,080	99.7 %
Viti 2019	3,000,000	2,993,920	6,080	99.8 %
Janar-Shtator 2020	4,000,000	2,582,000	1,418,000	64.5 %
Total	10,210,000	8,776,840	1,433,160	85.9 %

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT

Në total për vitin 2018 për art. 602.4 “Shpenzime udhëtimi” janë planifikuar për t’u shpenzuar 3,210,000 lekë dhe në fakt janë shpenzuar 3,200,920 lekë, pra zëri “Shpenzime udhëtimi” me një realizim prej 99,7 %. Nga 3200,920 lekë të shpenzuara, 2,992,000 lekë, ose 93 % të totalit të shpenzimeve, e zënë “Shpenzime udhëtimi”, për strukturën e Hetimit Tatimor.

Në total për vitin 2019 për art 602.4 “Shpenzime udhëtimi” janë planifikuar për t’u shpenzuar 3,000,000 lekë dhe në fakt janë shpenzuar 2,993,920 lekë, me një realizim prej 99,8 %. Nga 2,993,920 lekë të shpenzuara, 2,816,500 lekë, ose 94 % të totalit të shpenzimeve, e zënë “Shpenzime udhëtimi”, për strukturën e Hetimit Tatimor.

Në total për vitin 2020 për art 602.4 “Shpenzime udhëtimi” janë planifikuar për t’u shpenzuar 4,000,000 lekë dhe në fakt janë shpenzuar 2,993,920 lekë deri në 30.09.2020, me një realizim prej 99,8 %. Nga 2,582,000 lekë të shpenzuara, 2,570,500 lekë, ose 99 % të totalit të shpenzimeve, e zënë “Shpenzime udhëtimi”, për strukturën e Hetimit Tatimor.

Për secilin vit buxhetor shpenzimet rezultojnë të rakorduara me situacionet vjetore me Degën e Thesarit Fier.

Shpenzimet e udhëtimit për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor janë shpenzime mbi 100 km dhe referuar përcaktimeve të Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar sipas të cilit “Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës”.

Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullarë institucioni qendror, në kuptimin e këtij vendimi janë:

a) Për njësitë e qeverisjes qendrore: i) Për ministrinë dhe çdo institucion në varësi të saj, ministri ose i deleguari i tij.

Konkretisht për vitin 2018, MFEme Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, ka autorizuar:

1.Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve të miratojë kryerjen e udhëtimit brenda vendit, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës.

2.Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore të miratojnë kryerjen e udhëtimit brenda vendit për punonjësit nën varësinë e tyre për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Ky autorizim i shtrin efektet deri në datë 31.12.2018.

Nga auditimi i shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit e DHT Fier për vitin 2018, paraqitet si vijon:

Arsyeja e shpenzimeve	Vlera e paguar 2018
Shpenzime të udhëtimit për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor	2,992,000
Shpenzime udhëtimi për pjesëmarrje në trajnim të punonjësve	94,920
Shpenzime për mbledhje në DPT	10,000
Shpenzime furnizimi për DRT Fier	74,000
Shpenzime për transport të Dr Rajonal	30,000
TOTAL	3,200,920

Burimi DRT Fier

Për vitin 2019, Ministri i MFE me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019 ka autorizuar: Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve të miratojë kryerjen e udhëtimit brenda vendit, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës si dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore të miratojnë kryerjen e udhëtimit brenda vendit për punonjësit nën varësinë e tyre për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Ky autorizim i shtrin efektet deri në datë 31.12.2019.

Nga auditimi i shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit e DHT Fier për vitin 2019 paraqitet si vijon:

Arsyeja e shpenzimeve	Vlera e paguar 2019
Shpenzime të udhëtimit për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor	2,816,500
Shpenzime udhëtimi për pjesëmarrje në trajnim të punonjësve	88,420
Shpenzime për mbledhje në DPT	6,000
Shpenzime furnizimi për DRT Fier	70,000
Shpenzime për transport të Dr Rajonal	13,000
TOTAL	2,993,920

Nga vlera 2,816,500 lekë paguar për Shpenzime të udhëtimit për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, 1,789,000 lekë janë shpenzime udhëtimi të vitit 2018, por paguar në vitin 2019.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të viteve 2018-2019, rezulton se:

“Shpenzimet e udhëtimit” janë pasqyruar në pasqyrat financiare vjetore të institucionit në kapitullin “Shpenzime”, në formatin nr.2 “Pasqyra e Performancës Financiare”, në art.602.4;

1. Për vitin 2018 “Shpenzimet e udhëtimit” paraqiten në shumën 4,989,920 lekë nga 2,184,190 lekë në vitin 2017. (3,200,920 lekë shpenzime dieta për vitin 2018 dhe 1,789,000 lekë detyrim i njohur i 2018, por paguar në vitin 2019).

2. Për vitin 2019 “Shpenzimet e udhëtimit” paraqiten në shumën 3,576,860 lekë nga 4,989,920 lekë në vitin 2018. (1,204,920 lekë shpenzime dieta për vitin 2019 dhe 2,371,940 detyrim i njohur i 2019, por për të paguar në vitin 2020).

Nga auditimi i shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit e DHT Fier për vitin 2020 paraqitet si vijon:

Arsyeja e shpenzimeve	Vlera e paguar 2020
Shpenzime të udhëtimit për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor	2,570,500
Shpenzime udhëtimi për pjesëmarrje në trajnim të punonjësve	11,500
Shpenzime për mbledhje në DPT	0
Shpenzime furnizimi për DRT Fier	0
Shpenzime për transport të Dr Rajonal	0
TOTAL	2,582,000

burimi

Nga vlera 2,570,000 lekë paguar për Shpenzime të udhëtimit për punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, 2,232,500 lekë janë shpenzime udhëtimi të vitit 2019, por paguar në vitin 2020.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur u konstatua se nga ana e Financës pagesat e kryera kundrejt punonjësve për shpenzime udhëtimi dhe dieta nuk janë kryer konform kuadrit ligjor në fuqi duke qenë se jo vetëm janë paguar me vonesa të konsiderueshme (edhe deri në 1 vit me vonesë për shkak të mungesës së fondeve) por edhe nuk iu është paguar vlera që u takon sipas urdhrorit të punës dhe faturës tatimore që vërtetojnë kohën e qëndrimit në shërbim.

VKM nr. 130, datë 07.03.2018, “Për një ndryshim në Vendimin nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, të ndryshuar pika 1 citon: “Punonjësit e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit”

Për sa më sipër ky ndryshim në VKM, duke hequr togfjalëshin “në ditët zyrtare të punës”, nënkupton përballimin e shpenzimeve edhe në fundjavë kur punonjësit caktohen me shërbim. Nga ana e Financës për DRT Fier, edhe pse urdhër shërbimet kanë qenë për ditët e fundjavës (të shtunë-të diel), punonjësve u është llogaritur vetëm 1 ditë përballimi shpenzime diete dhe udhëtimi (përkatesisht llogaritja e premtë-e shtunë 1 ditë e plotë) dhe jo dita tjetër (e shtunë-e dielë), edhe pse dokumentacioni shoqëruar ka qenë i plotë (urdhër shërbimi i plotësuar, urdhër i punës i përcaktuar, fatura tatimore e hotelit etj).

Në lidhje me auditimin e dokumentacionit shoqëruar për dietat e audituara me zgjedhje u konstatuan disa mangësi si në vijim:

➤ F.RR është paguar për dieta 44 ditë faturë hoteli, e pavulosur, shoqëruar me dëftesë tatimore të pavulosur. Vlera e paguar është në shumën 132,000 lekë.

➤ B.T është paguar për dieta 44 ditë faturë hoteli, e pavulosur, shoqëruar me dëftesë tatimore të pavulosur. Vlera e paguar është në shumën 126,000 lekë.

➤ F.K është paguar për 9 netë faturë hoteli, e shoqëruar me kupon tatimor pa nr serial. Vlera e paguar është 27.000 (urdhër pune nr.6835 prot ., datë 30.03.2018).

- *K.B është paguar për 4 netë fjetje në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1280 prot datë 02.07.2018).*
- *K.B është paguar për 4 netë fjetje në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1592 prot datë 06.08.2018).*
- *L.H është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. Po kështu dhe dëftesa tatimore. (urdhër shërbimi nr.1381 prot datë 16.07.2018).*
- *GJ.K është paguar për 4 netë fjetje në hotel në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë (urdhër shërbimi nr.1626 prot datë 13.06.2018).*
- *K.G është paguar për 4 netë fjetje në hotel në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë (urdhër shërbimi nr.1593 prot datë 06.08.2018).*
- *K.G është paguar për 4 netë fjetje në hotel në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë (urdhër shërbimi nr.1872 prot datë 06.09.2018).*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1280 prot datë 14.06.2018).*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1330 prot datë 09.07.2018)*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1457 prot datë 23.07.2018)*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1516 prot datë 30.07.2018).*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1593 prot datë 06.08.2018).*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1628 prot datë 13.08.2018)*
- *G.K është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1208 prot datë 22.04.2018).*
- *F.Q është paguar për 4 ditë fjetje hoteli në vlerën 12,000 lekë, por fatura tatimore është pa vulë.*
- *I.A është paguar për 4 netë fjetje hoteli në vlerën 12,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1763 prot datë 03.09.2019).*
- *I.A është paguar për 3 netë fjetje hoteli në vlerën 9,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1919 prot datë 09.09.2019).*
- *F.A është paguar për 12 netë fjetje hoteli në vlerën 48,000 por fatura tatimore të shitjes janë pa vulë. (urdhër shërbimet nr.1059 datë 30.07.2019, nr.1137 prot datë 06.08.2019, nr.1222 prot datë 13.08.2019, nr.1274 prot datë 20.08.2019).*
- *M.P është paguar për 2 netë fjetje hoteli në vlerën 6,000 por fatura tatimore e shitjes është pa vulë. (urdhër shërbimi nr.1574 prot datë 27.09.2019).*

Pagesat e shpenzimeve për udhëtim dhe dieta janë kryer jo në përputhje me ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, Neni 7.

Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe:

- a) kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës;
- b) kur kreditori nuk është paguar, me përjashtim të rastit kur vonesa nuk ka ardhur për faj të debitorit;
- c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se:

i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme;

Konkluzion: Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera jo në përputhje me detyrimet ligjore trajtuar sipas rastit, ngarkohen me përgjegjësi J.G me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe E.GJ me detyrë, Përgjegjëse Finance.

Titulli i Gjetjes	Mos kryerja e drejtë e pagesave për shpenzime udhëtimi dhe dieta.
	Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur u konstatua se nga ana e strukturave të Financës pagesat e kryera kundrejt punonjësve për shpenzime udhëtimi dhe dieta nuk janë kryer konform kuadrit ligjor në fuqi duke qënë se jo vetëm janë paguar me vonesa të konsiderueshme (edhe deri në 1 vit me vonesë për shkak të mungesës së fondeve) por edhe nuk iu është paguar vlera që u takon sipas urdhërit të punës dhe faturës tatimore që vërtetojnë kohën e qëndrimit në shërbim. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM Nr. 130 Datë 07.03.2018 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.997 datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, të ndryshuar pika 1, Ligjin Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, Neni 7 “Afati për autoritetet publikë” dhe Nenin 463 të Kodit Civil.
Kriteri	VKM nr. 130, datë 07.03.2018 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.997 datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, të ndryshuar pika 1; Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, Neni 7 “Afati për autoritetet publikë”; Neni 463 i Kodit Civil.
Ndikimi/Efekti	Krijimi i detyrimeve të prapambetura dhe nisja e procesve gjyqësore nga punonjësit për përfitimin e detyrimeve të papaguara.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Drejtorja e Funksioneve Mbështetëse në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier të marrë masa për respektimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për shpenzime udhëtimi dhe dieta, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura ose nisjen e procesve gjyqësore nga ana e punonjësve me objekt përfitimin e tyre.

2.5 Për zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga planifikimi i nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave për punime/mallra/shërbime nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.5.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me regjistrin e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, në drejtim të afateve të hartimit të regjistrit të prokurimeve me vlerë të vogël bazuar në nevojat për mallra/punë dhe shërbime dhe raportimit të realizimit të tyre, konstatohet që:

Vitin 2018

Me shkresë nr.594 prot, datë 15.01.2018, të Autoritetit Kontraktor (DRT Fier), “Dërgohet regjistri i parashikimeve të prokurimit publik viti 2018”, në DPT, është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korente për 16 raste, në vlerën 5,208,333 lekë (pa TVSH), me burim financiar buxhetin e shtetit, të cilat evidentohen në tabelën nr. 1, pasqyruar në Seksionin “Aneksë” bashkangjitur këtij Raporti.

Në regjistër janë përcaktuar objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.419, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të APP-së. Me shkresën nr. 11066 prot., datë 21.06.2018, “Kërkesë për shtesë fondi”, drejtuar DPT, DRT Fier, ka kërkuar rialokim fondi në artikullin 602, me një shtesë prej 3,000,000 lekë për shlyerje dietash. DPT i është drejtuar MFE me shkresën nr. 22051 prot., datë 31.10.2018, “Kërkesë për transferim fonde në shpenzime korente”, kërkesë e cila është miratuar me shkresën nr. 19431/1 prot., datë 15.11.2018 “Miratim Transferim Fondi” në shumën 3,000,000 lekë. Në total shpenzimet e parashikuara për vitin 2018 rezultojnë në vlerën 8,208,334 lekë (fondi limit).

DRT Fier për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2018 ka nxjerrë Urdhër të Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018 “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël dhe komisionit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave”, të përbërë nga: z. E.L, kryetar; z. F.A dhe z. G.LL, anëtarë. Komision ka luajtur rolin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave si dhe marrjes në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

AK ka dorëzuar në organet qendrore informacionin e hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara prej tij, në **tejkalim** të afateve të përcaktuara në pikën 3, Kreu II të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”. Konkretisht: 4-mujori I, regjistri i realizimit të prokurimeve dorëzuar me shkresën nr. 8899 prot., datë 17.05.2018, me 7 ditë vonesë; 4-mujori II, regjistri i realizimit të prokurimeve dorëzuar me shkresën nr. 15087 prot., datë 11.09.2018, me 1 ditë vonesë; 4-mujori III (e cila pasqyron dhe totalin e realizimeve për vitin 2018 të evidentuara në tabelën nr.2), dorëzuar me shkresën nr. 930 prot., datë 15.01.2019, me 5 ditë vonesë.

Të dhënat e regjistrit të realizimit të prokurimeve evidentohen në tabelën nr. 2, pasqyruar në Seksionin “Anekse” bashkangjitur këtij Raporti.

Viti 2019

Me shkresë nr. 919 prot, datë 15.01.2019, të Autoritetit Kontraktor (DRT. Fier), “Dërgohet regjistri i parashikimeve të prokurimit publik viti 2019”, drejtuar DPT, është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korente për 13 raste në vlerën 6,433,334 lekë (pa TVSH), me burim financiar buxhetin e shtetit, të cilat evidentohen në tabelën nr.3, pasqyruar në Seksionin “Anekse” bashkangjitur këtij Projektraporti.

Në regjistër janë të përcaktuara objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr.419, datë 29.12.2014 “, i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të APP-së.

Referuar miratimit të ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, nga AK, rezulton të jetë hartuar **me vonesë**, regjistri i parashikimeve publike për vitin 2019, veprim jo në përputhje me nenin 4, pika 1, të VKM nr.914, datë 19.12.2014, i ndryshuar, si dhe Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP.

AK ka hartuar dhe dorëzuar në organet qendrore informacionin e hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara prej tij, në tejkalim të afateve të përcaktuara në pikën 3, Kreu II të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP, Konkretisht: 4-mujori I regjistri i realizimit dorëzuar me shkresën nr. 7805 prot., datë 13.05.2019, 3ditë me vonesë; 4-mujori II dorëzuar me

shkresën nr. 13656 prot., datë 04.09.2019, në afat; 4-mujori III (që pasqyron totalin e realizimeve për periudhën objekt auditimi, evidentuar në tabelën nr. 4 si më poshtë), dorëzuar me shkresën nr. 590 prot., datë 16.01.2020, me 6 ditë vonesë. Veprimet dhe mosveprimet e sipërme janë përgjegjësi O.C me detyrë, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe J.G me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Referuar miratimit të ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, nga AK, rezulton të jetë hartuar me vonesë, regjistri i parashikimeve publike për vitin 2019, veprim jo në përputhje me nenin 4, pika 1, të VKM nr.914, datë 19.12.2014, i ndryshuar, si dhe Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP.

AK ka hartuar dhe dorëzuar në organet qendrore informacionin e hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara prej tij, në tejkalim të afateve të përcaktuara në pikën 3, Kreu II të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP, Konkretisht:4-mujori I regjistri i realizimit dorëzuar me shkresën nr. 7805 prot., datë 13.05.2019, 3ditë me vonesë;4-mujori II dorëzuar me shkresën nr. 13656 prot., datë 04.09.2019, në afat; 4-mujori III (që pasqyron totalin e realizimeve për periudhën objekt auditimi, evidentuar në tabelën nr. 4 si më poshtë), dorëzuar me shkresën nr. 590 prot., datë 16.01.2020, me 6 ditë vonesë. Veprimet dhe mosveprimet e sipërme janë përgjegjësi O.C me detyrë, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe J.G me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse në cilësinë e nëpunësit zbatues.

DRT Fier për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2019 ka nxjerrë Urdhër Brendshëm nr. 502 prot., datë 09.01.2019 “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël dhe komisionit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave”, të përbërë nga: z. E.L në cilësinë kryetar; z. F.A dhe zj. ZH.A anëtar. Ky komision ka luajtur rolin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave si dhe marrjes në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Të dhënat e regjistrimit të realizimit të prokurimeve v.2019 evidentohen në tabelën nr.4, pasqyruar në Seksionin “Aneksë” bashkangjitur këtij Raporti.

Periudha 01.01 – 30.09.2020

Me shkresë nr. 395 prot, datë 13.01.2020, të Autoritetit Kontraktor, “Dërgohet regjistri i parashikimeve të prokurimit publik viti 2020”, drejtuar DPT, është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korente për 16 procedura në vlerën 9,300,001 lekë (pa TVSH), me burim financiar buxhetin e shtetit, të cilat evidentohen në tabelën nr.5, pasqyruar në Seksionin “Aneksë” bashkangjitur këtij Raporti.

Referuar miratimit të ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, nga AK, regjistri i parashikimeve publike për vitin 2020, është hartuar me vonesë, jo në përputhje me nenin 4, pika 1, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, i ndryshuar, si dhe Kreun I, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, të APP.

AK ka hartuar dhe dorëzuar në organet qendrore informacionin e hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara prej tij, në tejkalim të afateve të pikës 3, Kreu II, Udhëzimi nr. 1, datë 05.01.2018, të APP. Konkretisht:4-mujori I, regjistri dorëzuar me shkresën nr. 4657 prot., datë 12.05.2020, me 2 ditë vonesë; 4-mujori II (që pasqyron dhe totalin e realizimeve për periudhën objekt auditimi, evidentuar në tabelën nr. 6 si më poshtë), dorëzuar sipas përcaktimeve me shkresën nr. 9132/2 prot., datë 08.09.2020. Veprimet dhe mosveprimet e sipërme janë përgjegjësi e O.C me detyrë, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe J.G me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Në regjistër janë të përcaktuara objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar dhe VKM nr.419, datë 29.12.2014 i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të APP-së.

DRT Fier për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2020 ka nxjerrë Urdhër Brendshëm nr. 3982 prot., datë 03.04.2020 “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël dhe komisionit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave”, të përbërë nga: z. E.L, kryetar; zj. E.GJ dhe zj. ZH.A, anëtarë. Komision ka luajtur rolin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave si dhe marrjes në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se autoriteti kontraktor ka vepruar në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në LAPP.

Të dhënat e regjistrimit të realizimit të prokurimeve viti 2020 evidentohen në tabelën nr.6, pasqyruar në Seksionin “Anekse” bashkangjitur këtij Projektraporti.

Konkluzion:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, nga autoriteti kontraktor nuk është përgatitur dhe dorëzuar në afat (10 ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin), regjistri vjetor i parashikimeve për procedurat e prokurimit publik për vitin 2019, 2020.

2.5.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga komisioni i prokurimeve, konstatohet:

Viti 2018

1- Procedura e prokurimit “Shpenzime për printim dhe publikim”.

Urdhër prokurimi nr. 01, datë 19.03.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 97, datë 25.04.2018 në vlerën 98,640 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	- Fitues: L shpk - Vlera fituese 82,200 lekë pa TVSH - Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 120 datë 27.03.2018 me vlerë 82,200 lekë pa TVSH, (98,640 lekë me TVSH)..
Fondi limit 83,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: L SHPK	- Diferenca nga fondi limit 800 lekë
Datë e hapjes së tenderit 20.03.2018.	Marrin pjesë 3 OE S' kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018, i ndryshuar. *Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 3 operatorë ekonomikë, ku nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pika 5 dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar pika 9, pasi në ftesën për ofertë sipas

verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP nuk janë ftuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit 5 operatorë ekonomikë por janë administruar ofertat e 3 OE. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 3 operatorë ekonomik prej të cilëve, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “L” SHPK me ofertën ekonomike 82,200 lekë, për të cilën më datë 20.03.2018 është mbajtur “*Proces verbal me vlerë nën 100,000 lekë*”, sipas Formulari Nr. 5, (i cili në fakt, referuar Udhëzimit nr. 3, datë 8.01.2018 të APP, ka të bëjë me *njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit*). Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezultoi se ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK pasi ka në objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetë deklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kritereve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Për sa më sipër, fatura tatimore nr. 120, datë 27.03.2018 e emetuar nga subjekti “L” Sh.p.k, në vlerën 82,200 lekë pa TVSh (98,640 lekë me TVSh), është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 97, datë 25.04.2018 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “*Raporti përmbledhës*” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

2- Procedura e prokurimit “Siguracion i automjeteve”.

Urdhër prokurimi nr. 02, datë 06.04.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 120, datë 22.05.2018 në vlerën 199,500 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	- Fitues: OE “M” sha - Vlera fituese 199,500 lekë pa TVSH - Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr 33 datë 12.04.2018 me vlerë 199,500 lekë për 9 (nëntë) automjete.
Fondi limit 200,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “M” sha	- Diferenca nga fondi limit 500 lekë
Datë e hapjes së tenderit 12.04.2018	Marrin pjesë: 1 OE S’ kualifikuar: 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk kanë vepruar sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar si dhe pikës 9, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, pasi në ftesën për ofertë sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP nuk janë ftuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit 5 operatorë ekonomikë por janë ftuar vetëm 2 OE. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit, referuar Procesverbalit nr. 5672/1 prot., datë 12.04.2018, OE fitues është shpallur “M” sha me vlerë 199,500 lekë pa tvsh. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezultoi se ka objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Për sa më sipër, 9 faturat tatimore (polica sigurimi), datë 12.04.2018 me vlerë totale 199,500 lekë (për 9 automjete), të emetuara nga subjekti “M” sha, sipas faturës tatimore nr. 33, datë 12.04.2018, në vlerën totale 199,500 lekë pa tvsh (dhe tvsh), janë likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 120, datë 22.05.2018 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. **Në përfundim** nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

3- Procedura e prokurimit “Pjesë këmbimi, goma, bateri”.

Urdhër prokurimi nr. 03, datë 11.04.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 244, datë 12.10.2018 në vlerën 495,120 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	- Fitues sipas Proces – Verbal nr. 5671/1 prot., datë 12.04.2018: OE “S” - Vlera fituese 389,800 lekë pa TVSH; - Kontrata është lidhur me OE “A” (klasifikuar i nënti në PV); - Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 129 datë 22.05.2018 me vlerë 412,600 lekë pa TVSH, (495,120 lekë me TVSH).
Fondi limit 415,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël	Fitues: OE “A” Sh. p. k	- Diferenca nga fondi limit 2,400 lekë
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Marrin pjesë: 11 OE	Titullar i AK – O.C
Datë e hapjes së tenderit 12.04.2018	S’kualifikuar: 0 OE	

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar. *Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur dosjes së prokurimit ndodhet “Ftesë për ofertë” sipas Formulari nr. 3, me fond limit 415,000 lekë, ku përcaktohet data e zhvillimit të prokurimit është përcaktuar më 12.04.2018. Sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP, janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 11 operatorë ekonomikë. Si hartimi i ftesës për ofertë, ashtu edhe pjesmarrja në prokurim është në përputhje me kriteret ligjore të APP.

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 11 operatorë ekonomik prej të cilëve nuk është skualifikuar asnjë, si rrjedhojë, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “S” me vlerë limit 389,800 lekë (pa TVSH), kjo e pasqyruar në Proces – Verbalin nr. 5671/1 prot., datë 12.04.2018. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezultoi se ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK pasi ka në objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit.

- Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Referuar kontratës pa nr. datë 07.05.2018, lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit “A” SHPK si dhe faturës tatimore me nr. 129, datë 22.05.2018, lëshuar nga subjekti, në vlerën 412,600 lekë pa TVSH, (495,120 lekë me TVSH), likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 244, datë 12.10.2018 në vlerën totale të faturës, kontrata është lidhur me OE “A” SHPK i klasifikuar i 9 (nënti), pa u dokumentuar me procesverbal, në shkelje të nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

4- Procedura e prokurimit “Blerje materiale pastrimi dhe ndriçimi”.

Urdhër prokurimi nr. 04, datë 16.05.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 145, datë 14.06.2018 në vlerën 139,200 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	- Fitues sipas Proces – Verbal nr. 7972/1 prot., datë 23.05.2018: OE “E” - Vlera fituese 83,142 lekë pa TVSH; - Furnizimet janë kryer nga OE “A” Sh.p.k, (klasifikuar i katërti në PV); - Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 26 datë 05.06.2018 me vlerë 116,000 lekë pa TVSH, (139,200 lekë me TVSH).
Fondi limit 166,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “A.” Sh.p.k	- Diferenca nga fondi limit 50,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 22.05.2018	Marrin pjesë 38 OE S’kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur dosjes së prokurimit ndodhet “Ftesë për ofertë” sipas Formulari nr. 3, me fond limit 166,000 lekë, ku përcaktohet data e zhvillimit të prokurimit është përcaktuar më 22.05.2018. Sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP, janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 38 operatorë ekonomikë. Si hartimi i ftesës për ofertë, ashtu edhe pjesmarrja në prokurim është në përputhje me kriteret ligjore të APP.

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrë pjesë 38 operatorë ekonomik prej të cilëve nuk është skualifikuar asnjë, si rrjedhojë, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “E” me vlerë limit 83,142 lekë (pa TVSH), kjo e pasqyruar në Proces – Verbalin nr. 7972/1/1 prot., datë 23.05.2018. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014, i ndryshuar. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruar nga nëpunësit që marrin pjesë në procesin e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 56, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014, i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Në procedurën e prokurimit, referuar Procesverbalit nr. 7972/1 prot., datë 23.05.2018, OE fitues është shpallur “E” me vlerë limit 83,142 lekë (pa TVSH), ndërsa referuar faturës tatimore me nr. 26 datë 05.06.2018, lëshuar nga subjekti “A” SHPK në vlerën 116,000 lekë pa TVSH, (139,200 lekë me TVSH), likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 145, datë 14.06.2018, në vlerën totale të faturës, kontrata është lidhur me OE “A” SHPK i klasifikuar i 4 (katërti), pa u dokumentuar nga një procesverbal, në shkelje të nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

5- Procedura e prokurimit “Riparim rrjeti elektrik”.

Urdhër prokurimi nr. 05, datë 21.05.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 146, datë 14.06.2018 në vlerën 159,600 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	- Fitues sipas Proces – Verbal nr. 9174/1 prot., datë 09.05.2018: OE “R”; - Vlera fituese 108,000 lekë pa TVSH; - Punimet janë kryer nga OE “A” Sh.p.k, (klasifikuar i treti në PV); - Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 45 datë 13.06.2018 me vlerë 133,000 lekë pa TVSH, (159,600 lekë me TVSH).
Fondi limit 166,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “A” Sh. p. k	- Diferenca nga fondi limit 33,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 29.05.2018	Marrin pjesë 13 OE S’kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël kanë vepruar sipas përcaktimeve të pikës 3, shkronja “b”, të Udhëzimit nr. 11, datë 30.05.2018, të APP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 të ndryshuar, pasi në “Ftesë për ofertë”, sipas Formularit nr. 3, kanë përcaktuar fondin limit 166,000 lekë pa tvsh, me objekt “Shpenzime riparim rrjeti elektrik”, ku kanë përcaktuar edhe datën e zhvillimit të tenderit më 29.05.2018.

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 13 operatorë ekonomik prej të cilëve, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “R” me vlerë limit 108,000 lekë (pa TVSH), kjo e pasqyruar në Proces – Verbalin nr. 9174/1 prot., datë 29.05.2018. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruar nga nëpunësit që marrin pjesë në procesin e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 56, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Në procedurën e prokurimit, referuar Proces – Verbalit nr. 9174/1 prot., datë 09.05.2018, OE fitues është shpallur “R” me vlerë limit 108,000 lekë (pa TVSH), ndërsa referuar faturës tatimore me nr. 45 datë 13.06.2018, lëshuar nga subjekti “A” SHPK në vlerën 133,000 lekë pa TVSH, (159,600 lekë me TVSH), likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 146, datë 14.06.2018, në vlerën totale të faturës, kontrata është lidhur me OE “A” SHPK i klasifikuar i 3 (treti), pa u dokumentuar nga një procesverbal, në shkelje të nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

6- Procedura e prokurimit “**Riparim pajisje zyre**”, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi nr. 06, datë 04.06.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 219, datë 21.09.2018 në vlerën 132,000 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	-Fitues sipas Proces – Verbal nr. 9488/1 prot., datë 07.06.2018: OE “T”; -Vlera fituese 97,000 lekë pa TVSH; -Punimet janë kryer nga OE “E” (klasifikuar i dyti në PV); -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 26 datë 11.06.2018 me vlerë 110,000 lekë pa TVSH, (132,000 lekë me TVSH).
Fondi limit 160,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “E”	-Diferenca nga fondi limit 50,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 07.06.2018	Marrin pjesë 13 OE S’ kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018, i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk kanë vepruar sipas përcaktimeve të pikës 3, shkronja “b”, të Udhëzimit nr. 11, datë 30.05.2018, të APP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, pasi në “Ftesë për ofertë”, sipas Formularit nr. 3, kanë përcaktuar fondin limit 160,000 lekë pa tvsh, me objekt “Riparim pajisje zyre”. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 13 operatorë ekonomik prej të cilëve, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “T” me vlerë limit 97,000 lekë (pa TVSH), kjo e pasqyruar në Procesverbalin nr. 9488/1 prot., datë 07.06.2018. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Në procedurën e prokurimit, referuar Procesverbalit nr. 9488/1 prot., datë 07.06.2018, OE fitues është shpallur “T” me vlerë limit 97,000 lekë (pa TVSH), ndërsa referuar faturës tatimore me nr. 26 datë 11.06.2018, lëshuar nga subjekti “E”, në vlerën 110,000 lekë pa TVSH, (132,000 lekë me TVSH), likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 219, datë 21.09.2018, në vlerën totale të faturës, kontrata është lidhur me OE “E”, i klasifikuar i 2 (dyti), pa u

dokumentuar nga një procesverbal, në shkelje të nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

7- Procedura e prokurimit “*Blerje dokumentacioni*”.

Urdhër prokurimi nr. 07, datë 10.10.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 314, datë 28.12.2018 në vlerën 78,000 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	-Fitues: OE “A” -Vlera fituese 65,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 2339 datë 27.12.2018 me vlerë 78,000 lekë me TVSH.
Fondi limit 66,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “A”	-Diferenca nga fondi limit 1000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 24.12.2018.	Marrin pjesë 3 OE S’kualifikuar 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 3 operatorë ekonomik, ku nga antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 e ndryshuar neni 40, pika 5 dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar pika 9, pasi në ftesën për ofertë sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP nuk janë ftuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit 5 operatorë ekonomikë por janë administruar ofertat e 3 OE. Veprimet e *mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 3 operatorë ekonomik prej të cilëve, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “A”, me ofertën ekonomike 65,000 lekë, (pa TVSH), për të cilën më datë 24.12.2018 është mbajtur “*Procesverbal me vlerë nën 100,000 lekë*”, sipas Formulari Nr. 5, (i cili në fakt, referuar Udhëzimit nr. 3, datë 8.01.2018 “*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*”, të APP, ka të bëjë me *njoftimin e anullimit të procedurës së prokurimit*). Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruar nga nëpunësit që marrin pjesë në procesin e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 56, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014, i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Për sa më sipër, fatura tatimore nr. 2339, datë 27.12.2018 e emetuar nga subjekti “A”, në vlerën 65,000 lekë pa tvsh (78,000 lekë me tvsh), është likuiduar me urdhër shpenzimit nr.

314, datë 28.12.2018 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014, i ndryshuar.

8- Procedura e prokurimit “Shpenzime mirëmbajtje për objektet ndërtimore”.

Urdhër prokurimi nr. 08, datë 20.12.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 315, datë 28.12.2018 në vlerën 99,816 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A G.LL (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 1333 prot., datë 24.01.2018)	-Fitues: OE “B” shpk -Vlera fituese 83,180 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr 96 datë 27.12.2018 me vlerë 99,816 lekë me tvsh.
Fondi limit 83,333 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “B” shpk	-Diferenca nga fondi limit 153 lekë
Datë e hapjes së tenderit 24.12.2018	Marrin pjesë: 1 OE S’kualifikuar: 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është administruar oferta nga 1 operator ekonomik, ku nga antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 40, pika 5 dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar pika 9, pasi në ftesën për ofertë sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP nuk janë ftuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit 5 operatorë ekonomikë por është administruar oferta e 1 OE. Veprimet e *mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se ka marrje pjesë 1 operatorë ekonomik për të cilin, komisioni i prokurimit më datë 24.12.2018 ka mbajtur “Proces verbal me vlerë nën 100,000 lekë”, sipas Formulari Nr. 5, (i cili në fakt, referuar Udhëzimit nr. 3, datë 8.01.2018 të APP, ka të bëjë me *njoftimin e anullimit të procedurës së prokurimit*), ka vendosur ta përcaktojë fitues OE “B” SHPK me ofertën ekonomike 83,180 lekë pa TVSH. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezultoi se ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK pasi ka në objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruar nga nëpunësit që marrin pjesë në procesin e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 56, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Për sa më sipër, fatura tatimore nr. 96, datë 27.12.2018 e emetuar nga subjekti “B” SHPK në vlerën 83,180 lekë pa tvsh (99,816 lekë me tvsh), është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 315, datë 28.12.2018 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e

buxhetit. Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Viti 2019.

1- Procedura e prokurimit “Siguracion i automjeteve”

Urdhër prokurimi nr. 01, datë 08.04.2018 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 152, datë 26.06.2019 në vlerën 199,000 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L F.A Z.H.A (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 502 prot., datë 19.01.2019)	-Fitues sipas Proces – Verbal nr. 4614/1 prot., datë 12.04.2019: OE “S” sha -Vlera fituese 199,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: 11 fatura tatimore datë 12.04.2019 me vlerë totale 199,000 lekë për 11 (njëbëdhjetë) automjete.
Fondi limit 200,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “S sha	-Diferenca nga fondi limit 1000 lekë
Datë e hapjes së tenderit 12.04.2018	Marrin pjesë: 1 OE S’kualifikuar: 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018, i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk kanë vepruar sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar si dhe pikës 9, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, pasi në ftesën për ofertë sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP nuk janë ftuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit 5 operatorë ekonomikë por është ftuar vetëm 1 OE. Veprimet e *mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit, referuar Procesverbalit nr. 4614/1 prot., datë 12.04.2019, OE fitues është shpallur “S” SHA me vlerë 199,000 lekë pa tvsh. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezultoi se ka objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Për sa më sipër, 11 faturat tatimore (polica sigurimi), datë 12.04.2019 me vlerë totale 199,000 lekë për 11 (trembëdhjetë) automjete, të emetuara nga subjekti “S” sha, në vlerën totale 199,000 lekë pa tvsh janë likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 152, datë 26.06.2019 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. *Në përfundim* nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “Raporti përmbledhës” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

2- Procedura e prokurimit “Pjesë këmbimi, goma, bateri”.

Urdhër prokurimi nr. 02, datë 17.09.2019 (miratuar nga dega e	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël	-Fitues sipas Proces – Verbal nr. 17000 prot., datë 29.10.2019: OE “H”;
---	---	---

thesarit Fier me USH nr. 304, datë 13.12.2019 në vlerën 299,880 lekë me TVSH)	E.L F.A Z.H.A (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 502 prot., datë 19.01.2019)	-Vlera fituese 228,800 lekë pa TVSH; -Kontrata është lidhur me OE “A” Sh. p. k (klasifikuar i katërti në PV); -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 648 datë 15.11.2019 me vlerë 249,900 lekë pa TVSH, (299,880 lekë me TVSH) me situacionin e punimeve.
Fondi limit 250,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “A” Sh. a	-Diferenca nga fondi limit 100 lekë
Datë e hapjes së tenderit 29.10.2019	Marrin pjesë: 8 OE S`kualifikuar: 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018, i ndryshuar, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se bashkëlidhur dosjes së prokurimit nuk ndodhet “Ftesë për ofertë” sipas Formulari nr. 3, ku të përcaktohet data e zhvillimit të prokurimit, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar. Sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP, janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 8 operatorë ekonomikë. *Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 8 operatorë ekonomik prej të cilëve nuk është skualifikuar asnjë, si rrjedhojë, komisioni i prokurimit ka renditur në vend të parë vlerën më të vogël të paraqitur nga OE “I” me vlerë limit 228,800 lekë (pa TVSH), kjo e pasqyruar në Procesverbalin nr. 17000 prot., datë 29.10.2019.

Zbatimi i kontratës.

Në procedurën e prokurimit, referuar Proces – Verbalit nr. 17000 prot., datë 29.10.2019, OE fitues është shpallur “I” me vlerë limit 228,800 lekë (pa TVSH), ndërsa referuar faturës tatimore me nr. 648 datë 15.11.2019, lëshuar nga subjekti “A” SHPK në vlerën 249,900 lekë pa TVSH, (299,880 lekë me TVSH), likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 304, datë 13.12.2019, në vlerën totale të faturës, kontrata është lidhur me OE “A” SHPK i klasifikuar i 4 (katërti), pa u dokumentuar nga një procesverbal, në shkelje të nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “*Raporti përmbledhës*” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Referuar “Situacion Punimesh”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit “A” SHPK, si dhe faturës tatimore me nr. 648, datë 15.11.2019, lëshuar nga subjekti, në vlerën 249,900 lekë pa TVSH, (299,880 lekë me TVSH), likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 304, datë 13.12.2019 në vlerën totale të faturës, kontrata është lidhur me OE “A” SHPK i klasifikuar i 4 (katërti), pa u dokumentuar nga një procesverbal, në shkelje të nenit 40, pika 5, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Në përfundim nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “*Raporti përmbledhës*” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Periudha 01.01-30.09.2020.

1- Procedura e prokurimit “*Siguracion i automjeteve*”

Urdhër prokurimi nr. 01, datë 06.04.2020 (miratuar nga dega e thesarit Fier me USH nr. 199, datë 11.08.2020 në vlerën 253,166 lekë me TVSH)	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël E.L E.GJ Z.H.A (sipas Urdhër i Brendshëm nr. 3982 prot., datë 03.04.2020)	-Fitues: OE “S” sha -Vlera fituese 253,166 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: 13 fatura tatimore (polica sigurimi), datë 21.04.2020 me vlerë totale 253,166 lekë për 13 (trembëdhjetë) automjete.
Fondi limit 270,000 lekë (pa TVSH)		
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: OE “S” sha	-Diferenca nga fondi limit 16,834 lekë
Datë e hapjes së tenderit 17.04.2020	Marrin pjesë: 1 OE S’ kualifikuar: 0 OE	Titullar i AK – O.C

Argumentimi i fondit limit.

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën limit të publikuar në sistemin e APP, veprim ky, në shkelje të nenit 59, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pika 5, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018, i ndryshuar. *Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e prokurimit me vlerë të vogël.*

Ftesa për ofertë.

Nga auditimi u konstatua se antarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël nuk kanë vepruar sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të ndryshuar si dhe pikës 9, të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 8.01.2018 i ndryshuar, pasi në ftesën për ofertë sipas verifikimeve të ushtruara në dosjen e prokurimit dhe sistemin elektronik të APP nuk janë ftuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit 5 operatorë ekonomikë por është ftuar vetëm 1 OE. Veprimet e *mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.*

Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit, referuar Proces – Verbalit nr. 3603/2 prot., datë 17.04.2020, OE fitues është shpallur “S” SHA me vlerë 253,166 lekë pa tvsh. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezultoi se ka objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij objektin e prokurimit. Bashkëlidhur dosjes së procedurës së prokurimit, mungon vetëdeklarimi me shkrim nga ana e ofertuesit në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas parashikimeve të nenit 45, veprim ky, në shkelje të nenit 15, të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Zbatimi i kontratës.

Në zbatim të kontratës, 13 faturat tatimore (polica sigurimi), datë 21.04.2020 me vlerë totale 253,166 lekë për 13 (trembëdhjetë) automjete të emetuara nga subjekti “S” në vlerën totale 253,166 lekë pa tvsh janë likuiduar me urdhër shpenzimin nr.199, datë 11.08.2020 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. *Në përfundim* nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është përgatitur “*Raporti përmbledhës*” lidhur me procedurën e prokurimit, veprim ky, në shkelje të nenit 68, të VKM nr.914, datë 19.12.2014 i ndryshuar.

Konkluzion:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar në përputhje me VKM nr.914, datë 19.12.2014, i ndryshuar:
-neni 59, pika 1 dhe pika 2 shkronjat: “a”; “b” dhe “c”, pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është bërë investigim i tregut/nuk është bërë argumentimi dhe dokumentimi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës;

- neni 56, pasi në disa praktika prokurimi nga pjesëmarrësit në procedurë nuk janë nënshkruar deklaratat për konfliktin e interesit;
- neni 40, pika 5, pasi është përzgjedhur ofertues i renditur pas fituesit, veprime të cilat nuk janë dokumentuar nga komisioni përmes procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim;
- neni 68, pasi nga komisioni, në përfundim të afateve të ankimit nuk është përgatitur raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave që e dërgon për miratim të titullari i AK,
- neni 40, pika 5, pasi nga anëtarët e komisionit nuk janë ftuar të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë.

2.6 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për auditim rezultoi:

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar auditim në DRT. Fier, në bazë të Programit të Auditimit nr. 1110/1 prot., datë 16.12.2015, ndryshuar me nr.1110/5 prot., datë 16.12.2015, në përfundim të të cilit ka lënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes, të përmbledhura si më poshtë:

a. 6 Masa Organizative:

Janë rekomanduar 6 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 6 masa, nga të cilat 4 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 1 masë realizuar në vazhdimësi;

b. 8 Masa Shpërblim Dëmi.

Janë rekomanduar 8 masa për shpërblim dëmi me vlerë 107,380,472 lekë, nga të cilat: janë pranuar 8 masa, ku 4 masa janë realizuar plotësisht në vlerën totale 15,086,206 lekë; 2 masa në vlerën totale 9,330,000 lekë janë zbatuar pjesërisht në vlerën 8,060,000 lekë; 1 masë në vlerën 2,900,000 lekë nuk është zbatuar; si dhe 1 masë në vlerën 80,064,266 lekë është zbatuar pjesërisht në vlerën 14,731,758 lekë, (pa zbatuar në vlerën 65,332,508 lekë);

c. 20 Masa Disiplinore.

Janë rekomanduar gjithsej 20 masa disiplinore, nga ku rezulton se nga eprori direkt janë nisur në Komisionin Disiplinor sipas shkresave respektive për fillimin e ecursë disiplinore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi ecurinë disiplinore të nëpunësve, rezulton se Komisioni Disiplinor për 17 nëpunës ka marrë vendimin për ndërprerjen e ecursë disiplinore, dhe vetëm për 3 nëpunës ka marrë masë disiplinore.

I. Nga verifikimi rezulton se KLSH, ka dërguar në DRT Fier, Raportin Përfundimtar të Auditimit me Rekomandimet, me anë të shkresës përcjellëse nr.1110/23 prot, datë 03.05.2016, “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”. Nga DRT. Fier, me shkresën nr. 24424/126 prot., datë 11.07.2016, “Dërgohet plani i masave për raportin përfundimtar të KLSH”, drejtuar KLSH është nisur plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve, **jashtë afatit ligjor, prej 20 ditësh të vendosur nga KLSH,** veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, ku përcaktohet se: “Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastiit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”

II. Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit, nga DRT Fier, për zbatim e rekomandimeve të KLSH, nuk është kthyer përgjigje me shkresë zyrtare brenda 6-muajve nga

data e njoftimit të raportit të auditimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”

III. Realizimi i rekomandimeve.

Nga verifikimi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve rezulton se KLSH me anë të Programit të Auditimit nr. 1114 prot., datë 04.11.2016, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”, ka ushtruar auditim mbi zbatimin e tyre. Lidhur me konstatimet për masën e zbatimit të rekomandimeve, KLSH ka përcjellë në subjektin DRT. Fier me shkresën nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, “Mbi Auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, ku ri kërkohet përsheptimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Nga Grupi i Auditimit për mos të krijuar mbivendosje, u verifikuan të gjitha procedurat të cilat nga verifikimi i mëparshëm kanë rezultuar të pazbatuara.

Konkretisht:

A. Në lidhje me rekomandimet, “MASA ORGANIZATIVE”:

Rekomandimi 1. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit në DRT Fier të kryhen procedurat e njoftimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në mënyrë që të realizohet publikimi i subjekteve të kaluara në pasiv në faqen WEB të DPT-së. **Afati: në vazhdimësi.**

Nga auditimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se: Për të gjithë subjektet të evidentuar në material është realizuar publikimi në statusin “Pasiv”, por me vonesë, ndërsa për subjekte të tjerë mbetet për tu parë në vazhdimësi. **Statusi: Realizuar por mbetet në vazhdimësi.**

Rekomandimi 2. “Sektori i Kontrollit Operacional në Drejtorinë e Kontrollit të realizojë një skedë ku të evidentohet realizimi i të gjitha pikave të programit të kontrollit. Për këto subjekte, parregullsitë e të cilave u konstatuan nga grupi i auditimit të kryhet rikontrolli tatimor, referuar nenit 85 pika “c” të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”. **Afati: deri 30.09.2016**”

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se:

Në shkresën nr. 24424/125 prot., datë 18.05.2016, “Plani i masave në zbatim të raportit përfundimtar të KLSH”, kjo detyrë (rekomandim) për zbatim i caktohet **Drejtorisë së Kontrollit** (Sektorit Operacional).

Nga DRT. Fier, referuar rekomandimit të sipërcituar, me shkresën nr. 19496 prot., datë 21.11.2016, “Kërkesë për shtesë program kontrolli” për subjektin “R” Shpk me NIPT J..., si dhe shkresën nr. 19893 prot., datë 02.12.2016, “Kërkesë për shtesë program kontrolli”, për subjektet “S” me NIPT K... dhe “M” me NIPT L..., drejtuar DPT, kërkohet shtesë program kontrolli në zbatim të rekomandimeve të KLSH.

Nga DPT është miratuar ri kontrolli vetëm për subjektin “R” Shpk me NIPT J..., për të cilin nga Drejtoria e Kontrollit nëpërmjet Program Kontrollit nr. 1513/2 prot., datë 05.04.2018 është ushtruar kontroll rezultatet e të cilit janë pasqyruar në Raport Kontrollin nr. 1513/4 prot., datë 29.05.2018, duke e penalizuar subjektin me 50,000 lekë për problemet e konstatuara.

Nga DPT me shkresën nr. 40376/1 prot., datë 16.12.2016, “Mbi kërkesën për ri kontroll në zbatim të rekomandimeve të KLSH^{së}”, për subjektet “M” me NIPT L... dhe “S” me NIPT

K....., drejtuar DRT Fier, referuar nenit 85, pika 1, shkronja “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, kërkohet nga DRT Fier, citojmë: “...kryerja e ri kontrollit tatimor miratohet në se inspektori gjatë kontrollit tatimor nuk ka vepruar në përputhje me procedurat dhe, për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore apo janë marrë masa disiplinore..”. Pas kësaj shkresë nga DRT Fier nuk është vijuar me korrespondencën shkresore për realizimin e këtij rekomandimi. Statusi: Realizuar pjesërisht.

Rekomandimi 3. “Në çdo raport kontrolli të bëhet një analizë më e hollësishme e shpenzimeve të subjektit duke i ndarë shpenzimet me faturë dhe shpenzimet e pa deklaruar në FDP që të jetë e mundur rakordimi midis blerjeve të deklaruar në FDP dhe shpenzimeve në bilanc. **Afati: në Vazhdimësi**”

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 4. “Të pasqyrohet në raportin e kontrollit të subjektit analiza e detajuar e TVSH-së së importeve duke pasqyruar veçmas TVSH-në për faturën e origjinës dhe referencën në doganë, për të mundësuar një kontroll sa më real të situatës financiare të subjekteve objekt kontrolli. **Afati: në vazhdimësi**”

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 5. DRT Fier, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të kërkojë përmirësim të rregullores së brendshme të funksionimit dhe të evidentojë qartë një format tip dhe të miratuar të regjistrit të borxhit. **Afati: në vazhdimësi**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 6. Drejtoria e Borxhit të evidentojë këto raste dhe të zbatojë masat e pazbatuara të evidentuara në tabelën 5.4 dhe 5.47. **Afati: në vazhdimësi**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

B. “MASA SHPËRBLIM DËMI”:

Rekomandimi 1. Për 31 raste (subjekte), të mos vendosjes së penalteteve në shumën **80,064,266 lekë**, sipas aneksit nr. 4.3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. **Afati: Deri 30.09.2016**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se:

Në shkresën nr. 24424/125 prot., datë 18.05.2016, “Plani i masave në zbatim të raportit përfundimtar të KLSH”, kjo detyrë (rekomandim) për zbatim i caktohet **Drejtorisë së Kontrollit (Sektorit Operacional)**. Referuar Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit

të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë për 6 (gjashtë), subjekte, në vlerën 13,560,171 lekë, është zbatuar plotësisht**, konkretisht: “B”; “T”; “J”; “R”; “R”; si dhe “A”.

Nga kjo drejtori në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve për subjektet e pasqyruara në material janë hartuar “Program vizite fiskale”, sipas së cilës është ushtruar kontroll në subjekt, për verifikimin e rekomandimeve, (gjithsej 5 subjekte), pas së cilave nga inspektorët e kontrollit është hartuar “Raport Kontrolli”, me detyrime sipas tabelës “Masa shpërblim dëmi” bashkangjitur në Seksioni V “Aneke”.

Për subjektet e tjerë, në total 20 subjekte, për vlerën e rekomanduar 55,129,746 lekë, nga DRT Fier, nuk është zbatuar rekomandimi, sipas tabelës “Masa shpërblim dëmi”, bashkangjitur në Seksioni V “Aneke”

NR	SUBJEKTI	NIPTI	DET. SIPAS REKOM./L
1	H	K.....	1,898,933
2	F	K.....	438,980
3	Z. SH	J.....	397,554
4	A. M.	K.....	19,288,499
5		K.....	824,600
6	B. S	L.....	92,355
7	B	J.....	202,390
8	K	K.....	908,185
9	R	K.....	202,500
10	E. S	L.....	11,618,946
11	M. GJ	K.....	221,000
12	I. XH.	K.....	4,576,543
13	D	K.....	648,094
14	K	K.....	668,370
15	B	J.....	1,379,799
16	R	K.....	3,234,183
17	I	J.....	2,785,800
18	A. T	K.....	425,669
19	F	K.....	2,092,371
20	R.F	K.....	3,224,975
			55,129,746

Nga mosveprimi sipas rekomandimeve, efekti financiar është në vlerën 55,129,746 lekë.
Statusi: Realizuar pjesërisht.

Rekomandimi 2. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier zbatim të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenin 115 pika 1, Ligjin Nr .9920 date 19.05.2008 “ Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, të merren masa të menjëhershme për shlyerjen e detyrimeve tatimore diferencën në shumën prej **1,909,552 lekë** të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, “Mardhëniet me Thesarin”. **Afati: Deri 30.09.2016.**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 3. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në zbatim të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, për mos deklarimin e punonjësve sipas nenit 119 germa”a”, të merren masa të menjëhershme për evadimin e shkresës protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier me nr. 1822 prot, datë 12.02.2015 , në Drejtorinë e Vlerësimit të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit për verifikim dhe vlerësim tatimor si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në shumën **8,000,000 lekë** trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, “Marrëdhëniet me ISSH dhe ISHP”. **Afati: Deri 30.09.2016**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se:

Në shkresën nr. 24424/125 prot., datë 18.05.2016, "Plani i masave në zbatim të raportit përfundimtar të KLSH", kjo detyrë (rekomandim) për zbatim i caktohet **Drejtorisë së Vlerësimit**.

Referuar Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme", **rezulton se ka mbetur pa u realizuar rasti për tatimpaguesin "I.P" me NIPT L....për kontabilizim në vlerën 1,000,000 lekë.**

Nga verifikimi i materialit të Raportit të Auditimit (faqe 155) rezulton se Inspektoriati Shtetëror i Punës, Dega Rajonale Vlorë, nëpërmjet shkresës nr. 50/1 prot., datë 06.02.2015, (nr. 1822 prot., datë 12.02.2015 të DRT. Fier), ka informuar DRT. Fier se nga inspektimet e kryera për muajin Janar 2015, konkretisht më datë 22.01.2015, në subjektin **"I.P" me NIPT L...., ka konstatuar 2 punonjës të padeklaruar**, z. L.F me ID H.... dhe z. G.R me ID I...., të cilët janë gjetur në punë. DRT. Fier nëpërmjet shkresës nr. 1822/1 prot., datë 18.02.2015, "Kthim përgjigje" citon se:

"...1. z. L.F me ID H.... figuron i regjistruar në subjektin "I.P" me NIPT L.... më datë 09.02.2015.

2. z. G.R me ID I...., figuron i regjistruar në subjektin "I.P" me NIPT L.... më datë 04.02.2015".

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Nisur nga sa më sipër, referuar materialit të auditimit si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, rezulton se punonjësit e gjetur në punë në subjekt momentin e inspektimit (datë 22.01.2015), ka qenë të pa deklaruar dhe se deklarimi i tyre është bërë pas datës 04.02.2015, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 119, të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, ku citohet se: "...çdo punëmarrës duhet të deklarohet një ditë kalendarike përpara fillimit të punës...". **Nga mosveprimi sipas rekomandimeve, efekti financiar është në vlerën 1,000,000 lekë. Statusi: Realizuar pjesërisht.**

Rekomandimi 4. Për 20 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 8 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh në shumën **8,008,890 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" sipas tabelave nr. 3.3.1 dhe 3.3.2, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. **Afati: Deri 30.09.2016.**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme", **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 5. Për 12 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 71 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh në shumën **2,020,000 lekë**, sipas tabelave nr. 3.3.3 dhe 3.3.4, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH". **Afati: Deri 30.09.2016** **Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion,** Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, "Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme", **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 6. Për 174 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh në shumën **3,147,764 lekë**, sipas aneksit nr. 3.3.5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. **Afati: Deri 30.09.2016**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion, Aktverifikim nr.1, datë 02.12.2016, si dhe shkresës nr. 1114/52 prot., datë 20.01.2017, të Kryetarit të KLSH, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, **rezulton se kjo masë është zbatuar plotësisht.**

Rekomandimi 7. Për 20 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 19 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për shumën **2,900,000 lekë**, sipas Tabelës nr. 4.1 dhe 4.2, për mos aplikim të penaliteteve në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar Neni 122.1.b , neni 122 pika 2 germa (i). **Afati: Deri 30.09.2016**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se: Në shkresën nr. 24424/125 prot., datë 18.05.2016, “Plani i masave në zbatim të raportit përfundimtar të KLSH”, kjo detyrë (rekomandim) për zbatim i caktohet **Drejtorisë së Vlerësimit** si dhe **Drejtorisë së Kontrollit (Sektori i Verifikimit në Terren).** Si nga Drejtoria e Kontrollit (Sektori i Verifikimit në Terren), po ashtu edhe nga Drejtoria e Vlerësimit nuk është vepruar për realizimin e rekomandimit. **Statusi: Pa realizuar**

Rekomandimi 8. Për 63 subjekte me 133 raste të mos vendosjes së penaliteteve në vlerën **1,330,000 lekë**, sipas anekseve nr. 3.2.1 dhe 3.2.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 126 “Mosdhënia e informacionit”. **Afati: Deri 30.09.2016**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se: Në shkresën nr. 24424/125 prot., datë 18.05.2016, “Plani i masave në zbatim të raportit përfundimtar të KLSH”, kjo detyrë (rekomandim) për zbatim i caktohet **Drejtorisë së Vlerësimit.** Nga kjo drejtori janë marrë masa për realizimin e këtij rekomandimi sipas inspektorëve përkatës duke nxjerrë akt vlerësimit përkatës duke i pasqyruar në sistemin e tatimpaguesve. Konstatohet se në përmbushje të rekomandimit të sipërcituar, **zj. E.S me detyrë inspektore e vlerësimit në Drejtorinë e Vlerësimit nuk ka dalë me akt vlerësimi për 15 subjekte të pasqyruara në aneksin nr. 3.2.1, në vlerën 270,000 lekë.** Për 48 subjekte është aplikuar penalitet në vlerën totale 1,060,000 lekë referuar neni 126, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. **Statusi: Realizuar pjesërisht.**

C. Në lidhje me rekomandimet “MASA DISIPLINORE”:

Referuar neni 58, shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, nga KLSH, për 20 nëpunës civil, është rekomanduar masë disiplinore **“pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”.**

Nga verifikimi dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se: Nga eprori direkt, Drejtori i DRT. Fier, për masat disiplinore të rekomanduara, referuar neni 59, pika 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, janë përcjellë për në Komisionin Disiplinor të gjitha masat disiplinore të rekomanduara në masën e rekomanduar (neni 58, shkronja “c”), konkretisht:

1. **Znj. O.A**, në cilësinë, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, me shkresën nr. 24424/142 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40778/3 prot., datë 13.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**
2. **Znj. Z.SH**, në cilësinë, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, me shkresën nr. 24424/143 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40779/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**
3. **Znj. E.M**, në cilësinë, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, me shkresën nr. 24424/139 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40775/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**
4. **Z. G.J.S**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, me shkresën nr. 24424/140 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40776/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**
5. **Z. J.H**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, me shkresën nr. 24424/141 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40777/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**
6. **Z. A.B**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, me shkresën nr. 24424/138 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, ku, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 8356 prot., datë 10.04.2017, është marrë vendimi për pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e pagës për një periudhë 3-mujore. Statusi: **Realizuar**
7. **Z. A.H**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/130 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40766/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**
8. **Z. A.K**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/131 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, ku, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 8357 prot., datë 10.04.2017, është marrë vendimi për pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e pagës për një periudhë 3-mujore. Statusi: **Realizuar**

9. **Z. E.F**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/132 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40768/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

10. **Z. O.D**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/135 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40771/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

11. **Z. E.L**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/134 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40770/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

12. **Znj. A.Z** në cilësinë, ish-Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/133 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40769/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

13. **Z T.R** në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/136 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 8358 prot., datë 10.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

14. **Z. E.K**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Borxhit, me shkresën nr. 24424/144 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40780/2 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

15. **Z. N.T**, në cilësinë, Inspektor në Drejtorinë e Borxhit, me shkresën nr. 24424/148 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 60784/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

16. **Znj. F.K**, në cilësinë, Inspektore në Drejtorinë e Borxhit, me shkresën nr. 24424/146 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40782/2 prot., datë 24.01.2018, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

17. **Znj. M.GJ**, në cilësinë, Inspektore në Drejtorinë e Borxhit, me shkresën nr. 24424/147 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40783/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

18. **Znj. E.SH**, në cilësinë, ish-Inspektore në Drejtorinë e Borxhit, me shkresën nr. 24424/137 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40773/2 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

19. **Znj. F.H**, në cilësinë, Inspektore në Drejtorinë e Borxhit, me shkresën nr. 24424/145 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 8359 prot., datë 10.04.2017, është marrë vendimi sipas nenit 58, shkronja “b”, për mbajtja e 1/3 së pagës për një periudhë 4-mujore. Statusi: **Realizuar, por jo në masën e duhur**

20. **Z. B.S**, në cilësinë, Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 24424/129 prot., datë 02.12.2016, është përcjellë rekomandimi referuar nenit 58, shkronja “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por, nga komisioni disiplinor, me shkresën nr. 40379/3 prot., datë 12.04.2017, është marrë vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore. Statusi: **Pa realizuar**

Si konkluzion, nga 20 (njëzetë) masa disiplinore të rekomanduara, nga eprori direkt, janë përcjellë në komisionin disiplinor 20 masa disiplinore në masën e rekomanduar, por nga komisioni disiplinor rezultojnë të marra 2 masa disiplinore konform rekomandimeve të lëna, 1 jo në masën e rekomanduar dhe për 17 nuk është dhënë masë disiplinore (është ndërprerë ecuria disiplinore), pra me status të **pa realizuar**.

II.2.2.1/1 Mbi përputhshmërinë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (kontrolli në vend/operacional).

Drejtoria e Kontrollit Tatimor, bazuar në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar neni 80, ushtron kontroll tatimor në subjektet tatimpagues, në mënyrë që të verifikojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi.

Drejtoria funksion si pjesë përbërëse e strukturës së DRT Fier, në zbatim të Urdhrit Nr. 126, datë 02.8.2012 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore” i ndryshuar për periudhën Gusht 2016-Shkurt 2020 si dhe Urdhrit Nr. 33, datë 12.8.2020 për vitin 2020 e vijim.

Titulli gjetjes:	Delegimi i punonjësve nga një drejtori në tjetrën.
Situata:	Për vitin 2019, konstatohet se është kryer “delegim” i punonjësve nga ish Drejtori Rajonal, O.C, përmes lëshimit të Urdhrit të Brendshëm. Delegimi i punonjësit është bërë nga njëra drejtori në tjetrën. Konkretisht me Urdhrit Nr.19733 prot. datë 26.12.2019 është deleguar punonjës (Z.SH) me detyrë inspektor i dytë në Sektorin e Menaxhimit të Analizës së Detyrimeve të Papaguara, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara të kryejë

	detyrat e inspektorit të Sektorit të Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. <i>Delegimi i kompetencave punonjësve nga një drejtori në tjetrën nga ana e ish Drejtorit Rajonal është bërë jo në përputhje me Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 28-29, pasi të drejtën e delegimit e ka organi qendror (DPT). DRT Fier është organ në varësi të DPT në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 13-14. Inspektorët e kontrollit si nëpunës civil trajtohen referuar legjislacionit “Për nëpunësin civil”. Në këtë kuptim lëvizja e tyre kryhet sipas procedurave të parashikuara nga ky legjislacion. Gjithashtu bazuar në “Rregulloren e funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 19, datë 22.2.2017, neni 4, pika 15, Drejtori Rajonal “propozon stafin e drejtorive rajonale tatimore për lëvizje paralele, ngritje në detyrë etj., në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore”. Në këtë këndvështrim, delegimi i kompetencave i kryer me Urdhrin e Brendshëm Nr.19733 prot. datë 26.12.2019 nuk është në përputhje me aktet ligjore të sipërcituara dhe është përgjegjësi e ish Drejtorit Rajonal, O.C.</i>
Kriteri:	Ligji Nr. 44/2015, neni 28-29, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 13-14. Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Rregullore e funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore” neni 4, pika 15.
Ndikimi/Efekti:	Delegimi i kompetencave me Urdhrin Nr.19733 prot. datë 26.12.2019, në kundërshtim me detyrimet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të sipërcituara, me pasojë pavlefshmërinë e aktit administrativ (Urdhrit).
Shkaku:	Veprime jo në përputhje me ligjin.
Rëndësia:	I ulët
Rekomandimi:	Për z. O.C, në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal Fier, të përcillet kopje e Raportit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vlerësimin e përgjegjësive në lidhje me procedurën e ndjekur për delegimet e punonjësve (Z.SH) të kryera në kundërshtim me legjislacionin e nëpunësit civil pasi adresimi institucional i tij është në këtë drejtori. DPT, është përgjegjës për menaxhimin e strukturës së administratës tatimore për plotësimin në kohë të vendeve të lira me qëllim shmangien e anomalive në delegimin e punonjësve.

Në zbatim të detyrimit ligjor, përcaktuar në nenin 80 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Drejtoria e Kontrollit Tatimor kryen kontrole në dy drejtime: nga zyra dhe në vend/ terren (operacional).

Kontrollet fillojnë në zbatim të planit mujor të hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), miratuar e dërguar për zbatim Drejtorisë/ve Rajonale Tatimore. Planet u dërgohen për zbatim DRT-ve brenda afati të përcaktuar në Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2² si dhe Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar neni 135, pika 3³.

Bazuar në Manual, Kapitulli VIII, pika 8, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit hap çështjen/kontrollin bazuar në kriteret e përcaktuara, ku përparësia e çështjes i referohet rakordimit mes afatit të planifikuar nga DPT dhe përparësisë së çështjes sipas sistemit C@TS (*Core Administration Tax System*).

² “Plani përfundimtar i subjekteve për kontroll për çdo DRT, hartohet nga Drejtoria e Manaxhimit të Riskut në DPT, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe u dërgohet drejtorive rajonale tatimore brenda datës 25 të muajit për muajin pasardhës”.

³ “Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualet teknike, manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manualet tjera”.

Konstatohet se nga Drejtoria e Kontrollit nuk është hartuar plan mujor pune i detajuar me numër çështje/kontrolli, objektiv kontrolli, afate kontrolli dhe përcaktimin e inspektorit/ve përkatës, duke vepruar jo në përputhje me Manualin, Kapitulli VIII, pika 8, paragrafi 3⁴, “Rregulloren e funksionimit të DRT” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 19, datë 22.2.2017, neni 4,pika 8⁵.

Nga auditimi me zgjedhje i **raporteve të kontrollit** për vitet 2018-2020, u konstatuan problematika/gjetje të përbashkëta trajtuar në vijim, referenca ligjore e të cilave është përmbledhur tek “Konkluzioni”:

Titulli gjetjes:	Parregullsi në hartimin e Njoftimit për kontroll dhe Programit, mungesë dokumentacioni shoqërues të Raportit, vonesë në hedhjen e dokumenteve në C@TS.
Situata:	<p>Subjekti“S”SHPK;NIPT-L....., <u>Objekt aktiviteti</u>: “Transport inertesh. Agjent për sigurimin e automjeteve për llogari të S...”.</p> <p><u>Periudha tatimore për kontroll</u> “TVSH për periudhën 05/2013-04/2018, Tatim fitimin për 2013-2017, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për 05/2013-04/2018 e të tjera”.</p> <p>Në lidhje me dokumentacionin zyrtar (fizik) të praktikës:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Njoftimi i Kontrollit Tatimor Nr.12554/1, datë 27.8.2018, nuk përmban datën e fillimit/mbarimit të kontrollit. -Programi i Kontrollit nuk gjendet bashkangjitur praktikës zyrtare, -Raporti i Kontrollit nuk përmban bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit” që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81/f të brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca 1) me UMF Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1.3, paragrafi 6. -Vetëdeklarimi për konflikt interesi ka datë të korrigjuar. -Intervista me subjektin, nuk është bashkangjitur praktikës zyrtare. <p>Në lidhje me dokumentacionin e hedhur në sistemin C@TS konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -procesverbalet nr.1 dhe nr.2 datë 3.9.2018 janë hedhur me vonesë datë 13.11.2018 në sistemin C@TS. -Akt-Kontrolli datë 26.10.2018 hedhur me vonesë në sistemin C@TS, datë 13.11.2018. -Vlerësimi i detyrimit për tatimpaguesin në përfundim të kontrollit në vlerën 342,990 lekë është pranuar dhe nga subjekti. Vlera e detyrimit tatimor përputhet me vlerën e pasqyruar në Raport Kontrolli/Projekt, Raport Përfundimtar Kontrolli dhe vlerën e detyrimit tatimor të hedhur në sistemin C@TS. <p><i>Veprimet e sipërme nuk janë në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, kompetencë e inspektorit të kontrollit A.H, hartimi i Njoftimit për kontroll dhe programit kompetencë e P/Sektorit të Kontrollit E.XH, ish Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K, ish Drejtorit Rajonal O.C bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “f” si dhe Manualit, Kapitulli II, pika 2.1.2 germa “r” dhe Kapitulli VIII, pika 8, paragrafi 4,5.</i></p>

⁴ “Hapja e një çështje (për kontroll), nga Drejtori i Kontrollit në DRT bëhet duke i vendosur çështjes një prej pesë përparësive: i menjëhershëm (brenda ditës), i lartë.(brenda 10 ditëve kalendarike), i mesëm (brenda 20 ditësh kalendarike, i ulët (brenda një muaji kalendari), dhe i përgjithshëm (pa afat). Përcaktimi i përparësisë së çështjes duhet të bëhet duke u bazuar gjithashtu në afatin e planifikuar nga DPT për çdo kontroll,.....”.

⁵ “Përgatit programet mujore të punës, sipas planit operacional të DRT”.

Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kap. II, pika 2.1.2 germa “i”, pika 2.1.3, paragrafi 6. dhe Kap. VIII, pika 8, paragrafi 4,5.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i Manualit dhe Ligjit “Për procedurat Tatimore”, me pasojë parregullsi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, mbajtjes së dokumentacionit shoqërues, vonesa në hedhjen e dokumenteve në C@TS.
Rekomandimi:	<p>1. Të merren masa nga DRT Fier që në hartimin e Njoftimit Kontrollit Tatimor/Programit të përcaktohet periudha e fillimit/mbarimit të kontrollit.</p> <p>2. Të mërren masa nga DRT Fier, që miratimi i Raporteve të kontrollit nga personat kompetentë sipas hierarkisë së përcaktuar në legjislacionin tatimor të bëhet pasi të kenë përmbushur detyrimet ligjore mbi formën e paraqitjes së raportit të kontrollit dhe dokumentacionit bashkangjitur.</p>

Titulli gjetjes:	Parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, vonesa në përgatitjen e P/Raportit.
Situata:	<p>Subjekti “A.A” SHPK;NIPT-K.....; <u>Objekt aktiviteti tregtar</u> “Përpunim dhe prodhime të ndryshme të mermerit.....Përpunime dhe prodhime të ndryshme të drurit, mobilieri....”. <u>Objekti kontrollit</u> “Kontrolli në lidhje me zbatimin e Ligjit Nr.92/2014 datë 24.7.2014.....Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim të gjendjes kreditore të krijuar për periudhën Mars 2018 -Maj 2019, në shumën 15,669,006 lekë”. Periudha tatimore për kontroll: “TVSH për periudhën Mars 2018 -Maj 2019”.</p> <p>-Njoftimi i Kontrollit Tatimor Nr.10737/1, datë 19.7.2019/Programi Nr.10737/2, datë 19.7.2019, nuk përmban datën e fillimit/mbarimit të kontrollit tatimor, por vetëm kohëzgjatjen (76 orë/9.5ditë).</p> <p>-Njoftimi i Kontrollit Tatimor dhe Programi i Kontrollit kanë dalë dhe janë protokolluar në të njëjtën datë.</p>

	<p>-Raport Kontrolli/Projekti datë 21.8.2019 është përgatitur në tejkalim të afatit 5 ditor.</p> <p><i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit G.V, bazuar në UMF Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar,pika 75.1/2.5.2, Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2, 2.5, 2.1 dhe Kapitulli VIII, pika 8, paragrafi 9,P/Sektorit të Kontrollit E.XH dhe Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit B.S dhe ish Drejtorit Rajonal O.C bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa “i”.</i></p>
Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “f”, UMF Nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, pika 75.1/ 2.5.2, Manuali, Kap. II, pika 2.1, germa “i”, Kap. VII, pika 7.8 I.Kap. VIII, pika 8, paragrafi 4,5, 9.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i Manualit dhe Ligjit “Për procedurat Tatimore”, me pasojë parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, vonesa në përgatitjen e P/Raportit.
Shkaku:	Mos veprimi në përputhje me Manualin dhe LigjinNr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	I Ulët
Rekomandimi:	1. Të merren masa nga DRT Fier që në hartimin e Njoftimit Kontrollit Tatimor/Programit të përcaktohet periodha e fillimit/mbarimit të kontrollit.

Titulli gjetjes:	Parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, mungesë programi, mos verifikim i burimit të huas nga subjekti/ortaku., mos raportim RAD në organet kompetente.
Situata:	<p>Subjekti “B” SHPK;NIPT-L.....;<u>Objekt aktiviteti tregtar “Kultim i drithërave (përveç orizit), bimëve bishtajore.....”;</u><u>Objekti kontrollit “Kontrolli i saktësisë së vetëdeklarimeve dhe llogaritjes së detyrimeve në zbatim të kërkesave të ligjit. Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim të gjendjes kreditore të krijuar për periudhën Shtator 2019-Prill 2020 në shumën 6,494,040 lekë.....”.</u></p> <p><u>Periudha tatimore për kontroll: “TVSH për periudhën Shtator 2019-Prill 2020 dhe për saktësim Qershor-Gusht 2019”.</u></p> <p>-Njoftimi i Kontrollit Tatimor Nr.6061/1,datë 23.6.2020/Programi Nr. 6061/2, datë 23.6.2020 nuk përmban datën e fillimit/mbarimit të kontrollit tatimor, por vetëm kohëzgjatjen (48 orë/6 ditë).</p> <p>-Programi nuk është nënshkruar nga P/Sektorit, por përmban vetëm miratimin nga Drejtori i Drejtorisë.</p> <p>-Njoftimi i Kontrollit Tatimor dhe Programi i Kontrollit kanë dalë dhe janë protokolluar në të njëjtën datë.</p> <p>-Raport Kontrolli/Projekti datë 06.07.2020/Raport Kontrolli datë 21.07.2020, në pikën 2, si objekt kontrolli ka “<u>rimbursimin e gjendjes kreditore të krijuar për periudhën Shtator 2019-Prill 2020 në shumën 6,494,040 lekë, kontrolli i periudhës Qershor-Gusht me qëllim saktësimin e TVSH si dhe subjekti do i nënshtrohet kontrollit, pasi është miratuar si subjekt kontrolli nga DPT për tatimin mbi fitimin për periudhën 2014-2018, sigurimet shoqërore për periudhën Mars 2014/Dhjetor 2018, si dhe programet e kontrollit do të bashkohen së bashku dhe konkluzionet do përmbledhen në këtë Raport”.</u></p>

	<p>Referuar këtyre të dhënave nuk rezulton që, bashkangjitur P/Raportit dhe Raportit, të jenë 2 programet e cituara por vetëm programi Nr. 6061/2, datë 23.6.2020.</p> <p>-Raporti Përfundimtar i kontrollit për pasqyrat financiare, në lidhje me pasivin viti 2018, në llogarinë “Detyrimet afatshkurtra” në zërin “hua të tjera”, nuk analizon këtë zë, pasi në pasqyrat financiare rezulton vlera prej 74,689,338 lekë (në rritje 39,039,338), ndërkohë që në vitin paraardhës 2017 ky zë rezulton në vlerën 35,650,000 lekë. Në Raport, inspektori shprehet vetëm <u>”shuma prej 74,689,338 lekë përfaqëson llogarinë e ortakut e cila është rritur për këtë periudhë për 39,039,338 lekë që vjen si pasojë e shtimit të inventarit”</u>. Rritja e vlerës në 39,039,338 lekë nuk justifikohet nga subjekti/ortaku. Nga verifikimi që u krye në sistemin C@TS, rezulton që fitimi për këtë subjekt për periudhën nga 2015-2018 është në total në vlerën 10,734,919 lekë. Gjithashtu u verifikua nëse ortaku i subjektit të sipërcituar, ishte aksioner në ndonjë subjekt tjetër gjë e cila nuk rezulton. Nga verifikimi edhe i deklaratave individuale, nuk rezultoi të kishte të tilla. Për pasojë, nuk justifikohet burimi i rritjes së vlerës 39,039,338 lekë si hua. Për diferencën 39,039,338 lekë, nga inspektori duhet të ishte bërë raportim në organet kompetente RAD (<i>Raportim i aktivitetit të dyshimtë</i>). Ky veprim nuk është në përputhje me Ligjin Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar neni 18.1 si dhe me UMF Nr.16, datë 16.2.2009, neni 2, pika 3 dhe neni 5.</p> <p><i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit A.G, bazuar në UMF Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 75.1/2.5.2, Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2, 2.5, 2.1, Kapitulli VII, pika 7.8/III, Kapitulli VIII, pika 8, paragrafi 9, P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit B.S, ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa “i”, Kapitulli VIII, pika 8.</i></p>
Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “f”, Ligjin Nr.9917, datë 19.5.2008 i ndryshuar neni 18.1 si dhe me UMF Nr.16, datë 16.2.2009, neni 2, pika 3 dhe neni 5, Manuali, Kap. II, pika 2.1, germa “i”, 2.2, Kap.VIII, pika 8, paragrafi 8.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i Manualit dhe Ligjit “Për procedurat Tatimore”, me pasojë parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, mos verifikim i burimit të huas në vlerën 39,039,338 lekë që përfaqëson rritjen e llogarisë së ortakut si pasojë e shtimit të inventarit, mos raportim RAD në organet kompetente.
Shkaku:	Mos veprimi në përputhje me Manualin dhe Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	<p>1.Të merren masa nga DRT Fier që në hartimin e Njoftimit Kontrollit Tatimor/Programit të përcaktohet periudha e fillimit/mbarimit të kontrollit.</p> <p>2.Të merren masa nga DRT Fier, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, mbi burimin e fitimit të ortakut për subjektin tatimpagues “B” SHPK, për vlerën 39,039,338 lekë, që përfaqëson rritjen llogarisë së ortakut.</p>

Titulli gjetjes:	Parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, vonesa në përgatitjen e P/Raportit, mungesë dokumentacioni.
Situata:	<p>Subjekti “M.C”SHPK;NIPT-L.....;Objekt aktiviteti tregtar “Aktivitete të kujdesit ditor të fëmijëve”; <u>Objekti kontrollit</u> “<i>Kontrolli mbi zbatimin e ligjit</i>”Për procedurat tatimore etj....”<u>Periudha tatimore për kontroll:</u> “<i>TVSH për periudhën Shkurt 2017-Qershor 2018,Tatim fitimi për periudhën 2016-2017, Sigurimet Shoqërore Shëndetësore Shkurt 2017-Qershor 2018</i>”.</p> <p>-Njoftimi Kontrollit Tatimor Nr.16959/1, datë10.01.2019/Programi Nr.16959/2, datë 10.01.2019, nuk përmban datën e fillimit/mbarimit të kontrollit, por vetëm kohëzgjatjen (184 orë/23 ditë).</p> <p>-Raport/Projekt dhe Raport kontrolli nuk përmbajnë bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit” i cili i vihet në dispozicion, sipas formatit të miratuar (shtojca1) me UMF Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1.3, paragrafi 6</p> <p><i>Veprimet e sipërme nuk janë në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2 dhe janë kompetencë e inspektorit të kontrollit G.LL bazuar në Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2, P/Sektorit të Kontrollit E.XH, ish Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “f” si dhe Manualit, Kapitulli II, pika 2.1.dhe Kapitulli VIII, pika 8, paragrafi 5.</i></p>
Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “P”, UMF Nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, Manuali, Kap. II, pika 2.1, 3,2.2,Kap. VIII, pika 8, paragrafi 5.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatim i Manualit dhe Ligjit “ <i>Për procedurat Tatimore</i> ”, me pasojë parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, vonesa në përgatitjen e P/Raportit, mungesa në dokumentacion bashkëngjitur Raportit.
Shkaku:	Mos veprimi në përputhje me Manualin dhe LigjinNr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	I Ulët
Rekomandimi:	1.Të merren masa nga DRT Fier që në hartimin e Njoftimit Kontrollit Tatimor/Programit të përcaktohet periudha e fillimit/mbarimit të kontrollit.

Titulli gjetjes:	Parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit dhe miratimin e programit.
Situata:	<p>Subjekti “A.D”P.F.;NIPT-L.....;Objekt aktiviteti tregtar “<i>Tregëti me shumicë e fruta perimeve</i>”;<u>Objekti kontrollit:</u> “<i>Kontrolli i vetëdeklarimeve dhe llogaritjes së pagesës së detyrimeve tatimore në zbatim të kërkesave të ligjit. Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim të gjendjes kreditore të krijuar për periudhën Prill-Gusht 2020 në shumën 8,361,090 lekë</i>”.</p> <p>-Njoftimi i Kontrollit Tatimor Nr.13417/1,datë 23.12.202/Programi Nr.13417/2, datë 23.12.2020, nuk përmban datën e fillimit/mbarimit të kontrollit tatimor, por vetëm kohëzgjatjen (48 orë/6 ditë).</p> <p>-Programi i Kontrollit nuk është nënshkruar nga P/Sektorit por vetëm është miratuar nga Drejtori i Drejtorisë.</p>

	<i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit B.S dhe ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa”i”, Kapitulli VIII, pika 8.</i>
Kriteri:	Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar), neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kap. VIII, pika 8.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i Manualit dhe Ligjit “Për procedurat Tatimore”, me pasojë parregullësi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit dhe miratimin e programit..
Shkaku:	Mos veprimi në përputhje me Manualin dhe Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar.
Rëndësia:	I Ulët
Rekomandimi:	1.Të merren masa nga DRT Fier që në hartimin e Njoftimit Kontrollit të përcaktohet periudha e fillimit/mbarimit të kontrollit.

Konkluzion:

Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor **për kontrollin në vend (operacional)** për vitet 2018-2020 mbi Raportet e Kontrollit Tatimor, në mënyrë të përsëritur konstatohet:

-Mungesa e një plani mujor pune hartuar në performacën e inspektorëve dhe ngarkesën e punës, miratuar nga Drejtori i Drejtorisë, me qëllim transparencën në ndarjen e detyrave bazuar në kriteret e lartpërmëndura.

-Parregullësi dhe mospërputhje në hartimin e Njoftimit të Kontrollit Tatimor, i cili në të gjitha rastet nuk përmban datën e fillimit/mbarimit të kontrollit, veprim jo në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 1.1⁸, pika 2, germa “f”⁹ dhe Manualin Kapitulli II, pika 2.1.2 dhe germa”i” me pasojë, moszbatimin e afateve në kryerjen e kontrolleve.

-Njoftimi i Kontrollit Tatimor në të gjitha rastet e audituara miratohet në të njëjtën datë/ose afërsisht me datën e Programit të kontrollit si dhe nuk përcaktohet data e fillimit të kontrollit tatimor, veprim jo në përputhje me Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 1.1 dhe 2, germa “f”, Manualin Kapitulli II, pika 2.1.2. dhe germa “i”.

-Raportet e kontrollit nuk përmbajnë bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit” në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 3, sipas formatit të miratuar (shtojca1) me UMF Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, jo në përputhje me Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6¹⁰.

-Në disa raste, të kontrolleve për rimbursim, përgatitja e P/Raportit dhe Raportit Përfundimtar të kontrollit bëhet në tejkalim të afatit 5 ditor, veprim jo në përputhje me UMF Nr.24, datë

⁸ “Njoftimi i kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit tatimor të shkruar në njoftim...”.

⁹ “Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:... datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor”.

¹⁰ “Modeli i Njoftimit për Kontroll Tatimor është sipas formularit “Njoftim Kontrolli Tatimor” Formulari-pyetësor që i vihet në dispozicion së bashku me njoftimin për kontroll, brenda 30 ditëve, është sipas formatit të miratuar me Udhezimin e Ministrit të Financave.”.

02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, pika 75.1, pika 2.5.2¹¹ dhe Manualin Kapitulli II, pika 2.1.2¹².

-Në disa raste, në kontrollet e planifikuara, përgatitja e Raport Kontrolli/Projekti dhe Raportit Përfundimtar bëhet në tejkalim të afatit 7 ditor, jo në përputhje me Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar neni 83-84/1 dhe Manualin, Kapitulli II, pika 2.3 dhe 2.5.

-Në disa raste, të dhënat mbi afatet për kryerje kontrolli të parashikuar në Programin e Kontrollit me ato të trajtuara në Raportit Përfundimtar të Kontrollit nuk kanë përputhje, duke sjellë besueshmëri të ulët në raportimin e fakteve.

-Raportet e Kontrollit në shumicën e rasteve nuk kanë bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e kontrollit, si psh: intervista me tatimpaguesin, apo aktet nuk hidhen të gjitha në sistemin C@TS, veprim jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, , pika 2.2¹³, pika 2.8/b¹⁴, Kapitulli VII, pika 7.1¹⁵. Kapitulli II, pika 2.8/b dhe Kapitulli VII, pika 7.1.

Për sa sipër trajtuar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion mbi Projektraportin e Auditimit, me shkresë nr.9253/100, datë 24.08.2021 nga ish Drejtori Rajonal O.C dhe me shkresën nr. 9253/106, datë 01.09.2021 nga E.XH, P/Sektorit Kontrollit të cilat pasi u shqyrtuan nga grupi i auditimit **nuk merren** në konsideratë, me arsyetimin se argumentat e paraqitur janë të njëjta me ato të paraqitur ndaj aktkonstatimeve trajtuar në Projektraport.

Titulli gjetjes:	Diferenca në inventar dhe në bilancin material.
Situata:	<p>Subjekti “S.F”Shpk , me NIPT L.....</p> <p>Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim në DPT me shkresën nr. 23 datë 05.03.2019, ka kërkuar rimbursim të tvsh-së kreditore në DPT, ardhur në DRT, nga DPT me shkresën nr 5017 datë 15.03.2019, për shumën 15.456.935 Lekë, kërkesë e përcjellë në DRT Fier nga DPT me shkresën nr 3931 date 19.03.2018.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektorja e kontrollit A.K, bazuar në njoftimin e kontrollit nr. 3931/1 datë 25.03.2019 si edhe programit të kontrollit me numër protokollit, 3931/2 datë 25.03.2019, për TVSH-në për periudhën 2018.08 – 2018.12.</p> <p><u>Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:</u></p> <p>-Nuk është mbajtur procesverbal i intervistës me tatimpaguesin të parashikuar sipas pikës së programit të kontrollit.</p> <p>-Nuk është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzimi i procesverbalit tek përgjegjësi i kontrollit sipas pikës së programit të kontrollit.</p> <p>-Nuk është mbajtur procesverbal mbi numrat serial të faturave të fundit të blerjeve dhe shitjeve që kanë marr pjesë në inventar.</p> <p>-Në Raport Kontrollin nuk është trajtuar dhe analizuar lidhja e akt-marrëveshjeve me fermerët, vlefshmëria e tyre, njoftimi i DRT-së për akt-marrëveshjet e lidhura si dhe është trajtuar në mënyrë sipërfaqësore edhe mënyra e përgatitjes së faturave tatimore nga blerësi me shënimin përkatës sipas Udhëzimit nr.19 datë 03.11.2014.</p>

¹¹ “Me qëllim respektimin e afateve të rimbursimit të TVSH-së, në rastet kur tatimpaguesi i nënshtrohet kontrollit tatimor, afati për përfundimin e Raportit të Kontrollit nga inspektori/inspektorët është, jo më shumë se 5 ditë kalendarike pas përfundimit të tij”.

¹² “Në rastin kur tatimpaguesi, i cili ka kërkuar rimbursim, i nënshtrohet kontrollit, sipas analizës së riskut, me qëllim respektimin e afatit të rimbursimit, sipas këtij neni, afatet e përcaktuara nga nenet 83 dhe 84 nuk do të zbatohen dhe çdo afat do të jetë 5 ditë kalendarike”.

¹³ “Inspektori i kontrolli tatimor është i detyruar të pasqyrojë në programin informatik të tatimeve C@TS çdo hap të ndërmarrë gjatë çdo forme të kontrollit që nga dalja e Udhërit për kontroll të nënshkruar, vulosur e protokolluar nga Drejtori i Drejtorisë Tatimore Rajonale (Programi i Kontrollit)”.

¹⁴ “...Këto evidentime të kryera nga inspektori/grupi i kontrollit të mbajtuara shënim apo të siguruara nëpërmjet dokumentacionit mbështetës pasqyrohen nga ana e inspektorit të kontrollit në sistemin informatik të tatimeve C@TS”.

¹⁵ “Në fillim, kontrollori interviston një përfaqësues të shoqërisë. Intervista fillestare është shumë e rëndësishme dhe është e nevojshme..... formularë të cilat duhet të jenë në fund, pjesë përbërse e praktikës së kontrollit Tatimore të firmosura nga inspektori dhe përfaqësuesi i shoqërisë së kontrolluar...”

-Në Programin e Kontrollit përcaktohet se periudha për kontroll është 2018.09 – 2018.12, në raport janë analizuar blerjet për periudhën Gusht–Dhjetor 2018, e cila është në tejkallim të afateve të përcaktuara në programin e kontrolli me 1 (një) muaj.

-Nuk është bërë argumentimi dhe ndarja/specifikimi se nga ka ardhur teprica kreditore e TVSH-së.

-Nga kontrolli i *bilancit material të mallrave* dhe *bilancit material të ambalazhit të hartuara* nga inspektori, për bazë u morën blerje dhe shitjet e periudhës *Gusht-Dhjetor 2018*, inventari i mallrave të lëna nga kontrolli i mëparshëm i cili ka qenë zero dhe gjendja më 31.12.2018.

Sipas llogaritjeve të inspektorit në bilancin material të ambalazhit rezultoi se gjendja e mbetur është paraqitur si më poshtë:

1. **Arka Plastike (30,890 copë x 52.85 lek/copa) = 1,632,537 lek**
2. **Kuti Kartoni *** (16,778 copë x 54.69 lek/copa) = 917,598 lek**
3. **Arka Druri (1,500 copë x 60 lek/copa) = 90,000 lek**
4. **Paleta (1,723 copë x 407.25 lek/copa) = 701,692 lek**

Total 3,341,827 lek

*** Është bërë gabim në këtë artikull, sepse ka futur bashkë si kuti kartoni + arka kartoni të cilat janë artikuj të ndryshëm të cilat diferencojnë edhe nga çmimi për njësi, në llogaritjet tona është marr çmimi më i ulët i “kutive të kartonit” që është 54.69 lek/copa.

Nga kontrolli i *bilancit material të ambalazhit* rezultoi se gjendja në fund të periudhës për ambalazhet është në vlerën **3,341,827 lek**, kurse nga kontrolli i *bilancit kontabël të periudhës tatimore viti 2018* rezultoi se ky zë “*Lënde të para dhe materiale të konsumueshme*” është në shumën **6,409,677 lekë**. Nga ku rezulton një diferencë midis gjendjes faktike sipas *bilancit material të ambalazhit* që është kryer nga inspektori dhe asaj kontabël sipas *bilancit kontabël* në shumën **3,934,001 lekë**, duke u vendosur në situatën e “*shitjes pa faturë*”

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: “*Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, janë të detyruar të mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për të gjitha ngjarjet dhe veprimet që përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona të tjerë, për të gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, dhe me aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tij*”.

-Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 71, pika b) ku përcaktohet se: “*Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara*” dhe c) *tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;*

-Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, Neni 124, pika 1), ku përcaktohet qartë: “*Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*”.

Për vitin 2018 për shumën **3,341,827 lekë** llogarisim Tvsh-së dhe T.F, në zbatim të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 124, pika 1, duhet të aplikohet penaltitet në masën 100% të detyrimit të Tvsh-së dhe T.F si më poshtë:

	TVSH (3,341,827 lekë x 20%) = 668,365 lekë Gjobë (100% TVSH-së) = 668,365 lekë Tatim Fitimi (3,341,827 lekë x 15%) = 501,274 lekë Gjobë (100% T.F) = 501,274 lekë Totali = 2,339,278 lekë <i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit A.K , P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa "f", Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa "i", Kapitulli VIII, pika 8.</i>
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124, Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar pika 57.1 dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, Kap. 2
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferenat e përmenduar sjellin efekte financiare.
Shkaku:	Mos zbatimimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008 dhe Manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.

Subjekti "P.A" Sha me NIPT K.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit V.P, bazuar në Njoftim Kontrollin nr.14393/2, datë 12.11.2019, konfirmuar nga tatimpaguesi në datë 13.12.2019 dhe Programit të Kontrollit nr.14393/3, datë 12.11.2019, për TVSH-në për periudhën 01.12.2014 deri me 31.07.2019 , për Tatim Fitimin 2014-2018 dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore për 2014.12-2019.07 dhe problematika të tjera të dala gjatë kontrollit.

Kontrolli ka filluar në datë 13.12.2019 dhe Raporti i Kontrollit (Projekt) dhe ka perfunduar ne 15.01.2020, pra brenda afatit të përcaktuar.

-Konstatohet se në kundërshtim me Manualin e kontrollit inspektori nuk ka ngarkuar në sistemin c@TS procesverbalet e mbajtur në subjekt në momentin e fillimit të kontrollit (procesverbali i fuqisë puntore , i inventarit fizik i mbajtjes së kontabilitetit si dhe procesverbali i blloqeve tatimor në përdorim nga subjekti)

-Mungon analiza e zërave të bilancit në mënyrë të detajuar dhe e shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Subjekti "A.L" Shpk me NIPT L.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 22.02.2005 dhe ushtron aktivitet "Tregtim i imputeve bujqësore Import-Eksport". Me adresë kryesore "Fier Lushnje SAVER Lagjja Saver, godine 1 kateshe, pasuria Nr.63/15, zona kadastrale me Nr.3268, nje kilometer nga Pushimi i Shoferit,ne krahun e djathte te rruges Pushimi i Shoferit-Kemishtaj. I regjistruar në DRT Fier më datë 30.04.2014, me Administratori të shoqërisë F.D, kurse N.N është Aksionari i shoqërisë me 100% të kapitalit.

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit E.K, bazuar në Njoftim Kontrollin nr.10041/3, datë 20.08.2019, konfirmuar nga tatimpaguesi N.N në datë 20.08.2019 dhe Programit të Kontrollit Nr.10041/4, datë 20.08.2019, për TVSH-në për periudhën 2016.05-2018.11 dhe problematika të tjera të dala gjatë kontrollit.

Parashikuar për kontroll 104 orë (13 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit të subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 09.09.2019. Në zbatim të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në 16.09.2019.

Kontrolli ka filluar në datë 20.08.2019 dhe Raporti i Kontrollit (Projekt) mban datën 19.09.2019. Raporti i Kontrollit është dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse Nr.10041/5 datë 19.09.2019.

Raporti Përfundimtar i kontrollit mban datën 09.10.2019 dhe është evaduar me Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr.10041/6, datë 09.10.2019, brenda afateve që përcakton ligji.

Korrespondenca me DPT:

- ❖ Me shkresën Nr.11029/2., datë 18.06.2019 ka ardhur shkresa për kontroll në vend të subjektit “A.L” Shpk, si pasojë e shkresës Nr.7 prot., datë 27.05.2019, ku subjekti bën kërkesës për rimbursimin të TVSH-së në shumën 5,163,131 lekë.
- ❖ Me shkresën Nr.1004/1 Prot., datë 09.07.2019 është dërguar shkresë nga DRT Fier për “Konfirmimin e periudhës së kontrollit”, që të jetë pa ndërprerje 2016.05-2018.11.
- ❖ Me shkresën Nr.11029/4., datë 29.07.2019 nga DPT ka ardhur konfirmimi i kërkesës në lidhje me propozimin e bërë në shkresën e mëparshme nga DRT Fier për periudhën e kontrollit, duke shtuar afatin e kontrollit me plus 48 orë. (Ishte 54 orë punë + 48 orë = 104 orë pune në lidhje me këtë program kontrolli në total).

Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se:

- Është trajtuar në raportin e kontrollit realizimi i intervistës me administratorin e shoqërisë F.D për natyrën e aktivitetit në tërësi dhe problemet që ka dhe marrëdhënia me DRT Fier. Por zhvillimi i kësaj intervistë nuk është dokumentuar me procesverbalë që të jetë pjesë e dosjes së kontrollit.
- Është mbajtur procesverbal i fuqisë punëtore ku është bërë verifikimi i fuqisë punëtore
- Është bërë analiza e kostos dhe janë verifikuar marzhet e cmimeve të shitjes për artikujt që janë analizuar në bilacin material.
- Është mbajtur procesverbal i gjëndjes fizike të materiale në momentin e kontrollit, nga ku ka rezultuar se ka gjëndje inventar mallra për rishitje.
- Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.
- Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.
- Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qënë subjekt për kontroll.

Titulli gjetjes:	Diferenca në bilacin material sipas raport kontrollit per subjektin “F...B” Shpk me NIPT L.....
Situata:	Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 28.05.2019 dhe ushtron aktivitet “Import - eksport dhe tregtim fruta - perime”, me adresë kryesore “Lagjja 18 Karbunare e Poshtme, Rruga Isha fabrika e letrës (Zonë Industriale), Pasuria me nr.614/4 në zonën kadastrale 2087, Karbunarë, Lushnje. Ka 5 adresa sekondare, mjete transporti. Administratori i shoqërisë është Besnik Calamëni i cili zotëron 100% të kapitalit. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.H, bazuar në

Njoftim Kontrollin Nr.6105/1, datë 24.04.2018, konfirmuar nga tatimpaguesi B.C në datë 26.04.2018 dhe Programit të Kontrollit Nr.6105/2, datë 24.04.2018, për TVSH-në për periudhën 2015.06-2017.12 për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për periudhën 2015.06-2017.12 dhe problematika të tjera të dala gjatë kontrollit.

Parashikuar për kontroll 120 orë (15 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit të subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 20.05.2018, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në 27.05.2018.

Kontrolli ka filluar në datë 26.04.2018 dhe Raporti i Kontrollit (Projekt) mban datën 25.05.2018, pra brenda afatit të përcaktuar. Raporti i Kontrollit është dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse Nr.6105/5, datë 25.05.2018.

Raporti Përfundimtar i kontrollit mban datën 11.06.2018 dhe është evaduar me Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr.6105/6, datë 11.06.2018, brenda afateve që përcakton ligji.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

-Në Raport Kontrollin nuk është bërë analizë e thelluar e lidhjes së akt-marrëveshjeve me fermerët dhe njoftimi i DRT-së për akt-marrëveshjet e lidhura si dhe mënyra e përgatitjes së faturave tatimore nga blerësi me shënimin përkatës sipas Udhëzimit Nr.19 datë 03.11.2014 por në anekse të raportit është vendosur lista e fermerëve më të cilët janë lidhur akt-marrëveshje dhe afatet e vlefshmërisë përkatëse të tyre.

-Nuk është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzimi i procesverbalit

-Është mbajtur procesverbal i faturave të fundit të blerjes dhe të shitjes në momentin e kontrollit.

-Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll dhe janë evidentuar edhe faturat e blerjeve.

-Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll dhe janë evidentuar faturat e shitjes.

-Është realizuar analiza e kostos.

Nga kontrolli i *bilancit material të mallrave* të hartuara nga inspektori, ku për bazë u morën blerje dhe shitjet e periudhës *Janar-Dhjetor 2016*, inventari i mallrave të lëna nga kontrolli i mëparshëm i cili ka qenë zero dhe gjendja më 31.12.2016.

Sipas llogaritjeve të inspektorit në bilancin material të mallrave rezultoi se gjendja e mbetur është paraqitur si më poshtë:

- ***Banane (2,769 kg x 1,713 lekë/kg) = 4,743,297 lekë***

Nga kontrolli i bilancit material të mallrave rezultojë se gjendja në fund të periudhës për artikullin "*Banane*" është në vlerën *4,743,297 lek*, kurse nga kontrolli i bilancit kontabël të periudhës tatimore viti 2016 rezultoi se ky zë "*Mallra për rishitje*" është në shumën *0 lekë*. Nga ku rezulton një diferencë midis gjendjes faktike sipas bilancit material të mallrave që është kryer nga inspektori dhe asaj kontabël sipas bilancit kontabël në shumën *4,743,297 lekë*, jemi në situatën e "*blerjes pa faturë*".

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: "*Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, janë të detyruar të mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për të gjitha ngjarjet dhe veprimet që përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona të tjerë, për të gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tij*".

-Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 71, pika b) ku përcaktohet

	<p>se: “Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara”.</p> <p>-Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 121 “Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore” pika 1) shkronja b) ku përcaktohet qartë se: “1. Për tatimpaguesin që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aplikohen masat dhe dënimet si më poshtë:</p> <p>b) Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore, sipas nenit 53, të këtij ligji. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimi të mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të nenit 124, të këtij ligji”.</p> <p>-Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008i ndryshuar, Neni 124 ku përcaktohet qartë se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.</p> <p>Llogaritjet e penaliteteve shtesë paraqiten si më poshtë: TVSH (4,743,129 lekë x 20%) = 948,625 lekë Gjobë (100% TVSH-së) = 948,625 lekë Detyrim TF (4,743,129 x 15%) = 711,469 Lekë Gjobë TF (100%) = 711,469 Lekë Totali = 3, 320,188 lekë</p> <p>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit A.H, P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa “i”, Kapitulli VIII, pika 8.</p>
Kriteri:	Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar pika 57.1, Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 121.
Ndikimi:	Nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare.
Shkaku:	Mos zbatimi i Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar pika 57.1, Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 121.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i pikave të Programit të kontrollit, shitje nën kosto, diferenca në kasë.
Situata:	<p>“R” Shpk me NIPT K....</p> <p>Bazuar në analizën e këtij subjekti rezultoi se: Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 22.02.2005 dhe ushtron aktivitet “Ndërtim i ndërtesave rezidente dhe jorezidente”, me adresë kryesore “Lagjja Kastrioti, Fier, shoqëria ka adresa 6 sekondare që janë ende hapur. I regjistruar në QKB me Administratori i shoqërisë J.M, i cili ka 100% të kapitalit të shoqërisë.</p> <p>Shoqëria “R” shpk me shkresën nr. ska datë 20.09.2019 ka kërkuar rimbursim të tvsh-së kreditore në DPT , ardhur në DRT , nga DPT me shkresën nr 17712/1 datë 09.10.2019,</p>

<p>protokolluar me tonën nr 16112 datë 14.10.2019.</p> <p>Tvsh kreditore është krijuar për periudhën tetor 2017- korrik 2019 në shumën 53.660.208 lekë. Për këtë ka dalë lajmërim dhe programi I kontrollit nr 14392/2 datë 11.11.2019</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektorët e kontrollit V.P dhe D.S, bazuar në Njoftim Kontrollin Nr.14393/2, datë 11.11.2019, konfirmuar nga tatimpaguesi J.M në datë 02.12.2019 dhe Programit të Kontrollit Nr.14392/3, datë 11.11.2019, për TVSH-në për periudhën 2017.04-2019.07, për Tatim Fitimin për periudhën 2017-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për periudhën 2017.04-2019.07 dhe problematika të tjera të dala gjatë kontrollit.</p> <p>Parashikuar për kontroll 135 orë (16 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit të subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 26.12.2019. Në zbatim të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në 02.01.2020.</p> <p>Kontrolli ka filluar në datë 02.12.2019 dhe Raporti i Kontrollit (Projekt) mban datën 24.01.2020 . Raporti i Kontrollit është dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse Nr.14392/4 datë 24.01.2020.</p> <p>Raporti Përfundimtar i kontrollit mban datën 30.01.2020 dhe është evaduar me Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr.4548/5, datë 22.10.2019, brenda afateve që përcakton ligji.</p> <p>Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk është mbajtur procesverbal mbi inventarin e arkës. • Nuk është bërë ndarja dhe analiza e rentabilitetit të aktiviteteve të veçanta që ushtron kjo shoqëri. Ku nga objekti i aktivitetit të deklaruar në QKB rezulton se shoqëria ushtron shumë aktivitete të cilat janë të ndryshme për nga natyra dhe kërkojnë një trajtim dhe analizë të ndarë dhe të detajuar për aktivitetet e ndryshme. <p>Sipas QKB-së rezulton se fusha dhe objekti i aktivitetit është si më poshtë:</p> <p style="padding-left: 40px;"><i>Germime dheu me punime eventuale muratore e beton arme-prishje dhe punime ne toke te germuar, prodhim material ndertimi, elemente betoni, ndertime civile dhe ekonomike, industriale, turistike, ndertim banesa me skelet mbi 8 kate, ndertime rrugore, autostrade. Import eksport, tregti me shumice e pakice te artikujve ushqimore, fruta perime, industriale, paisje hidrosanitare, konfeksione, tregti me pakice te karburanteve e vajrave lubrifikate, tregti e prerje xhamash.Sherbime hotelerie, bar, restorante. Dhenien e ambiente me qira per treg ambulant. Sherbime hotelerie, bar, restorante, pishine.</i></p> <p>-Nuk është tërheqja e kuponit të kasës, nxjerrja e kuponit të kasës në momentin e kontrollit dhe krahasimi me deklaratimet e kryera.</p> <p>-Sipas Programit të Kontrollit është e përcaktuar se afati është 2017.04-2019.07, por është filluar kontrolli dhe analiza që nga periudha 2017.01 për Tvsh dhe kontributet e sigurimeve. Gjë kjo e cila është bërë në tejkalim të periudhës të përcaktuara në programin e kontrollit.</p> <p>-Nuk është bërë detajimi i aktiveve që zotëron shoqëria dhe ku të përcaktohet edhe orgjina e krijimit të tyre.</p> <p>-Nuk është verifikuar me dokumente justifikuese nëqoftëse pagat janë paguar me bankë.</p> <p>-Nuk është realizuar një analizë e detajuar në përlllogaritjen e zërit të shpenzimeve të amortizimit, duke marrë në analizë AAGJ të shoqërisë, për të cilat të jepte informacion mbi datën e hyrjes në shoqëri, vlerësimin fillestarë në hyrje, normat e amortizimit, amortizimin e akumuluar etj., por janë mjaftuar vetëm me pretendimin se janë brenda normativave të nenit 22 të Ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.</p>

-Nuk është kryer analiza e llogarisë “Ortakë” dhe nuk është analizuar fluksi i parave (Cash-Floë).

-Është dhënë informacion sipërfaqësor dhe mbi llogarinë “Klientë” duke mos dhënë informacion mbi listën e tyre në fillim dhe fund të periudhës, edhe pse sipas të dhënave të bilancit kontabël të vitit 2017 ky zë është në shumën 1,989,306,114 lekë ose 74% e totalit të aktiveve të shoqërisë dhe sipas të dhënave të bilancit kontabël të vitit 2018 kjo llogari është në vlerën 2,005,669,101 lekë ose 68% e totalit të aktivitetit të shoqërisë.

-Gjithashtu është dhënë informacion sipërfaqësor mbi llogarinë “Furnitorë” duke mos dhënë informacion mbi listën e tyre në fillim dhe fund të periudhës, edhe pse sipas të dhënave të bilancit kontabël të vitit 2017 ky zë është në shumën 869,331,057 lekë ose 35% e totalit të detyrimeve të shoqërisë (DASH + DAGJ) dhe sipas të dhënave të bilancit të vitit 2018 kjo llogari është në vlerën 858,108,225 lekë ose 30% e totalit të aktivitetit të shoqërisë.

-Procesverbalet e mbajtura nga inspektori nuk janë pasqyruar në sistemin C@TS , kjo në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proces-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

-Inspektori shprehet : *Subjekti ka kërkuar rimbursimin e tvsh për ndërtimin e Hotelit “M.P “ në Gjilek, Dhërmi, Vlorë. Hoteli është në pronësi të subjektit R. Subjekti ka filluar aktivitetin e hotelierisë dhe bar-restorant në këtë objekt në vitin 2017 . Për ndërtimin e këtij hoteli subjekti disponon lejen e ndërtimit nga pushteti nr 1762 datë 12.11.2014 miratuar nga Kryetari i Bashkisë Himarë me nr vendimi 20 datë 02.09.2013.Hoteli në Durrës i cili është në proces ndërtimi, Hoteli në Radhimë i cili është në proces ndërtimi , Hoteli në Vlore i cili është në proces ndërtimi dhe Hoteli në Tiranë i cili është në proces arredimi. Por nuk shpjegon nëse janë verifikuar afatet e lejes së ndërtimit të “ Hotelit “M.P “ në Gjilek, Dhërmi, Vlorë “ , nuk shprehet për ndërtimet në “ Radhimë , Vlorë “ dhe “ Hotel në Durrës “*

Nga analiza e bilancit të shoqërisë për vitet 2017 dhe 2018, është konstatuar se në lidhje me **huatë e mëdha (Zëri “Detyrime të tjera” në Bilancin Kontabël)**, të cilat janë në vlerë më të lartë se edhe vet kreditë bankare formale të marra në institucionet e kredisë (*kredi afatshkurtër + kredi afatgjatë*), nuk ka informacion nëq janë të kaluara jashtë apo nëpërmjet sistemit bankar si dhe nuk është dhënë informacion mbi kushtet që është marrë ky borxh.

Në bilancin kontabël të shoqërisë ky zë rezulton në shumat përkatëse sipas viteve, paraqitur në formë tabele si më poshtë:

<i>HUA (Detyrime të tjera)</i>	
<i>2017</i>	<i>2018</i>
<i>255,114,001 Lek</i>	<i>353,009,302 Lek</i>

Nga inspektorët e kontrollit dhe drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier **nuk është verifikuar burimi i këtyre huave të deklaruar, me të cilën lidhet ngushtë tatim fitimi apo tatimi në burim**, veprime këto:

* Jo në përputhje dhe shkelje të kërkesave të nenit 18.1 të Ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, ku citohet se: “Organet tatimore identifikojnë subjektet e tyre, sipas procedurave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji (ndryshuar me 4/1) dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë

pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave ...”;

* Jo në përputhje dhe shkelje të kërkesave të nenit 5.1/2 të Udhëzimit nr.16, datë 16.2. 2009 të Ministrisë së Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave” për “Raportimi i aktivitetit të dyshimtë” ku citojmë: “Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit” dhe “Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për aktivitetin e dyshimtë (sipas shtojcave në anekset II dhe III për formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi)”.

* Jo në përputhje dhe shkelje të kërkesave të pikës 1 dhe 2 të Urdhrit nr.3546 prot, datë 21.02.2013 i Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve ku citojmë:

“Inspektorët e vlerësimit kur gjatë kontrollit të pasqyrave financiare të vitit 2012 e në vijim, konstatojnë dyshime për aktivitete të pa ligjshme të pastrimit të parave apo financim të terrorizmit plotësojnë në mënyrë konfidenciale bazuar në nenin 5 të udhëzimit nr. 16 formularin e rasteve për aktivitet të dyshimtë dhe përcjellin atë së bashku me informacionin shoqërues hetimit tatimor në rolin e njësisë qendrore vlerësuese” dhe “Ngarkohet drejtoria e përpunimit dhe kontabilitetit të të ardhurave në DPT që këtë urdhër t’u a përcjellë drejtorive të vlerësimit të të ardhurave dhe kontabilitetit në DRT”.

Nga analiza e Bilancit të lëvizjes së materialeve për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 konstatohet për materialin Polisterol se cmimi i shitjes është më i ulët se cmimi I blerjes analitikiisht paraqitet sipas tabelës:

EMERTI MI I ARTIKU LLI	NJESI A	GJENDJA NE FILLIM		BLERJET		DALJET		GJENDJA NE FUND	
		SASI	cmimet	SASI	cmimet	SASI	cmimet	SASI	cmimet
Polisterol	m3	130	12,013	393	12,013	393	6,518	130	12,013

Materiali polisterol është shitur me çmimin 6,518 Lekë ndërkohë që cmimi i blerjes është 12,013 Lekë. Për diferencën (12,013 - 6,518) = 5,495 lekë * 393 M3 = 714,350 Lekë në zbatim të nenit 124 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, subjektit i linden detyrimet si vijonë:

Detyrim TVSH	714,350 x 20%	= 142,870 Lekë
Gjobë TVSH (100%)		= 142,870 Lekë
Detyrimi		= 285,740 Lekë
Detyrim TF	714,350 x 15%	= 107,152 Lekë
Gjobë TF (100%)		= 107,152 Lekë
Detyrimi		= 214,305 Lekë
Tot.		500,045 Lekë

Nga krahsimi i raportit të vitit 2018 të paisjeve fiskale rezultojnë diferenca të cilat vijnë si pasojë e mos verifikimit nga ana e inspektorit të kontrollit të cilat janë në vlerën si më poshtë:

Nr	Paisja fiskale	VI Tatueshme
1	AE05012930	518,432
2	AE05016373	1,183,075
3	AE05016542	2,858,646
4	DE50000133	16,203
5	DE50000133	5,840
6	DE50000134	5,612,137
7	DE50000135	1,718,679
8	DE50000136	674,136
		12,587,148

Shitje deklaruar nga subjekti:

Nr	Emërtimi	Adresa	Nipti	Shitje tatueshme

Njoftim Kontrollin Nr.14137/1, datë 06.09.2018, konfirmuar nga tatimpaguesi Ardian Kuka në datë 10.09.2018 dhe Programit të Kontrollit Nr.14137/2, datë 06.09.2018, për TVSH-në për periudhën 2017.12-2018.07 dhe problematika të tjera të dala gjatë kontrollit.

Parashikuar për kontroll 46 orë (6 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit të subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 18.09.2018. Në zbatim të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në 25.09.2018.

Kontrolli ka filluar në datë 10.09.2018 dhe Raporti i Kontrollit (Projekt) mban datën 24.09.2018, pra brenda afatit të përcaktuar. Raporti i Kontrollit është dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse Nr.14137/3 datë 24.09.2018.

Sipas Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23, pika 2 dhe 3, ku përcaktohet se “Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesve, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën zyrtare e deklaruar nga vet ai”. Në pikën 3 të ligjit theksohet: “Akete e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohet të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik apo pranimit të dokumentit nga shërbimi postar”, nga momenti i dërgimit me postë të raportit të kontrollit ai konsiderohet i marrë nga tatimpaguesi në datën 04.10.2018.

Sipas Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 83.4, ku përcaktohet se “Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi”, tatimpaguesi ushtron të drejtën e kundërshtimit deri në datë 19.10.2018, subjekti ka paraqitur shkresën nr.36., datë 26.09.2018 ku shprehet se është dakord me rezultatet e projekt raportit të kontrollit tatimor.

Sipas Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 84, pika 1: “Raporti Përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor”.

Raporti Përfundimtar i kontrollit mban datën 27.09.2018 dhe është evaduar me Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr.14137/6, datë 27.09.2018, brenda afateve që përcakton ligji.

Nga auditimi i raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se:

-Është realizuar intervista me tatimpaguesin mbi natyrën e aktivitetit në tërësi dhe marrëdhënien që ka me DRT Fier, gjithashtu është mbajtur procesverbal sipas pikës së program të kontrollit.

-Është kryer inventarizimi i arkës dhe është dorëzuar procesverbalit tek përgjegjësi i kontrollit.

-Është bërë verifikimi i fuqisë punëtore sipas funksioneve që ata kryejnë në shoqëri dhe është mbajtur procesverbal, por në procesverbal është evidentuar vetëm ekonomisti i shoqërisë.

-Është mbajtur procesverbal për evidentimin e faturës së fundit të blerjes dhe të shitjes deri në momentin e kontrollit.

-Është bërë inventarizimi i blloqeve tatimore.

-Është bërë analiza e kostos dhe e çmimit të blerjes.

-Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll, gjithashtu janë evidentuar faturat përkatëse të blerjeve.

-Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll, gjithashtu janë evidentuar faturat përkatëse të shitjeve.

Gjithashtu për muajin Dhjetor 2017 rezulton një diferencë midis deklaramentit të eksporteve

sipas tatimeve dhe doganave, më konkretisht:
 -Eksportet sipas deklarimit në tatime janë në shumën 15,812,177 lekë.
 -Eksportet sipas deklarimit në dogana janë në shumën 15,216,421 lekë.
 Rezulton një diferencë në shumën prej 595,756 lekë kjo diferencë vjen për artikullin “Presh” pasi nisur dhe nga analiza e bilancit material shitja e deklaruar rezulton sipas tabelës

Artikulli	Njesia	Shitje sipas inspektorit	shitje sipas doganes	Diferenca	Dif ne vlere
Presh	KG	179,840	155,760	24,080	595,756

Për diferencën inspektori shprehet se ekziston sepse deklarata doganore nr.24649, datë 31.12.2017 është prranuar dhe deklaruar në doganë në datën 01.01.2018. Por nga verifikimi në sistem i deklarave doganore të subjektit nuk rezulton që ky pohim i inspektorit të jetë i vërtet (e verifikuar kjo nga deklaratat doganore të subjektit për vitet 2017 dhe 2018). Pra në përfundim rezulton se diferenca në shumën 595,756 lekë është eksport pa faturë (shitje pa faturë) per artikulli

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin

e transaksioneve” ku përcaktohet qartë se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Në këtë situatë duhet të ishte llogaritur penaliteti sipas nenit të sipër cituar:

- **Eksport = 595,756 lekë (Vlerë e tatueshme)**
- **Tatim Fitim (595,756 lekë x 15%) = 89,363 lekë.**
- **Gjobë (89,363 lekë x 100%) = 89,363 lekë**
- **Total 178,726 lekë**

Nga verifikimi i blerje nga furnitorë vendas me 20% për periudhën e kontrollit Dhjetor 2017 janë deklaruar Kutit Kartonit në vlerën 1,868,935 lekë / = 32,660 copë , nisur nga gjendja e inventarit në celje dhe në fund të periudhës rezulton se sasia e konsumuar referuar sasisë së shitur është 15,336 copë , diferenca (32,660 copë blerje – 15,336 copë të konsumuara) = 17,323 copë * 57,2 lekë = 990,918 lekë është diferenca si shitje e padeklaruar e cila duhet të ishte rivlersuar nga ana e inspektorit , bazuar ne Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimine transaksioneve”, pika 1), ku përcaktohet qartë që: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Si rezultat subjektit i lindin detyrimet si më poshtë :

TVSH (990,918 lekë x 20%) = 198,184 lekë

Gjobë (100% TVSH-së) = 198,184 lekë

Tatim Fitimi (990,918 lekë x 15%) = 148,638 lekë

Gjobë (100% T.F) = 148,638 lekë

Totali = 693,643 lekë

Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit A.Q, P/Sektorit të Kontrollit E.XH dhe Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa “i”, Kapitulli VIII, pika 8.

Kriteri: Manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2, Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat

	Tatimore në Republikën e Shqipërisë”
Ndikimi:	Nuk janë hedhur procesverbalet në afat, ka diferencë ne inventar.
Shkaku:	Mos zbatim i manualit të Kontrollit Tatimor, Kap.2, Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
Rëndësia:	E ulët.
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.

Titulli gjetjes:	Program kontrolli pa zbatuar në tërësi, diferenca në shitje të përjashtuara dhe në shitje me shkallë 20% të pa konstatuara nga inspektori kontrollit, për subjektin “B.S” Shpk me NIPT K....
Situata:	<p>Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:</p> <p>Subjekti është regjistruar në organet tatimore sipas QKB-së më datë 16.09.2007 dhe ushtron aktivitet <i>“Prodhim, tregtim te fidaneve, perimeve, luleve, farave , Pesticideve, Fungicideve etj”</i>. Me adresë kryesore <i>Divjakë, Fier</i>. Administratori i shoqërisë është J.G.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit G.LL, bazuar në Njoftim Kontrollin Nr.18387/1, datë 13.11.2018, konfirmuar nga tatimpaguesi në datë 13.11.2018 dhe Programit të Kontrollit Nr.18387/2, datë 13.11.2018, për TVSH-në për periudhën 2016.06-2018.09 dhe problematika të tjera të dala gjatë kontrollit.</p> <p>Parashikuar për kontroll 160 orë (20 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit të subjekti i inspektorit të kontrollit është deri në datë 14.12.2018. Në zbatim të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 <i>“Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i>, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendrike, pra deri në datën 21.12.2018.</p> <p>Kontrolli ka filluar në datë 13.11.2018 dhe Raporti i Kontrollit (Projekt) mban datën 20.12.2018 pra brenda afatit të përcaktuar. Raporti i Kontrollit është dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse Nr.18387/3, datë 20.12.2018.</p> <p>Sipas Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 <i>“Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i>, i ndryshuar, neni 23, pika 2 dhe 3, ku përcaktohet se <i>“Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesve, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën zyrtare e deklaruar nga vet ai”</i>. Në pikën 3 të ligjit theksohet: <i>“Akete e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni dhe cdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore , konsiderohet të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendrike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik apo pranimit të dokumentit nga shërbimi postar”</i>, nga momenti i dërgimit me postë të raportit të kontrollit ai konsiderohet i marrë nga tatimpaguesi në datën 30.12.2018.</p> <p>Sipas Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 <i>“Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i>, i ndryshuar , pika 83.4, ku përcaktohet se <i>“Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendrike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi”</i>, tatimpaguesi ushtron të drejtën e kundërshtimit deri në datë 14.01.2019, subjekti ka paraqitur <i>observacion me nr.18387/4 datë 21.12.2018</i>.</p> <p>Sipas Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 <i>“Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i>, i ndryshuar, neni 84, pika 1: <i>“Raporti Përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet na urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendrike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor”</i>.</p> <p>Raporti Përfundimtar i kontrollit mban datën 27.12.2018 dhe është evaduar me Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr.18387/5, datë 27.12.2018, brenda afateve që përcakton ligji.</p> <p>Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është realizuar intervista me tatimpaguesin mbi natyrën e aktivitetit në tërësi dhe marrëdhënien që ka me DRT Fier, gjithashtu është mbajtur procesverbal sipas pikës së program të kontrollit. • Është kryer inventarizimi i arkës dhe dorëzuar procesverbalit tek përgjegjësi i kontrollit. • Është mbajtur procesverbali nr.3 ku janë shënuar faturat e fundit të blerjes dhe të shitjes. • Është realizuar inventari fizik i mallrave sipas procesverbalit nr.1. • Nuk është bërë verifikimi nëse numri i të punësuarve të paraqitur në listëpagesën e e tatimpaguesit

	<p>lidhur me detyrat funksionale që ato kryejnë në shoqëri përputhen me funksionin real sipas përcaktimeve në pikat e Programit të Kontrollit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është mbajtur procesverbali nr.4 i vlerave monetare. • Për TVSH-në e blerjeve është bërë kontrolli i blerjeve në tërësi sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll dhe janë evidentuar edhe faturat e blerjeve. • Për TVSH-në e shitjeve është bërë kontrolli i shitjeve në tërësi sipas muajve që kanë qenë subjekt për kontroll dhe janë evidentuar faturat e shitjes. • Është realizuar analizë e detajuar e kostos. • Është realizuar analiza e origjinës së tepicës kreditore të Tvsh-së për rimbursim. <p>Nga pasqyra e blerjeve analitike për periudhën për periudhën qershor 2016- Dhjetor 2016 konstatohet :</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><i>Fatura</i></th> <th></th> <th><i>Njesia</i></th> <th><i>Sasia</i></th> <th><i>Cmimi</i></th> <th><i>vl.pa Tvsh</i></th> <th><i>Date</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>Nr Serie</i></td> <td>Emertimi</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>43214499</td> <td>GAZOIL</td> <td>LITRA</td> <td>13,495</td> <td>121.6</td> <td>1,641,891</td> <td>14.12.2016</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga verifikimi i librave të blerjes për këtë periudhë nga subjektet të cilët kanë si veprimatri tregëtinë e karburanteve , rezulton vlera për artikullin Gazoil si më poshtë :</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Numri i faturës</th> <th>Numri serial i faturës</th> <th>Data e faturës</th> <th>Emri tregtar i shitësit /personit</th> <th>NIPT-i</th> <th>Vlera e tat</th> <th>TVSH</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>49</td> <td>43214499</td> <td>14.12.2016</td> <td>K</td> <td>K...2u</td> <td>1,641,891</td> <td>328,378</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konstatohet se subjekti në datën 14 dhjetor ka blerë gazoil në sasinë 13,495 litra të cilën pretendon se e ka depozituar ne subjekt nderkohe e nuk rezultone te kete te deklaruar depozite per sasi te till, si rezultat ky transaksion nuk qendron dhe per kete sasi te blere subjektit nuk do ti njejhet kreditimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlera e fatures 1,641,891 lekë nuk do ti njihet si shpenzim. - Si rezultat subjektit i linden detyrimet si më poshtë : <table border="1"> <tbody> <tr> <td><i>TVSH (1,641,891 lekë x 20%)</i></td> <td>= 328,378 lekë</td> </tr> <tr> <td><i>Gjobë (0.06 / 365 dite)</i></td> <td>= 71,915 lekë</td> </tr> <tr> <td><i>Tatim Fitimi (1,641,891 lekë x 15%)</i></td> <td>= 246,284 lekë</td> </tr> <tr> <td><i>Gjobë (0.06 / 365 dite)</i></td> <td>= 53,937 lekë</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>= 700,513 lekë</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit G.LL, P/Sektorit të Kontrollit E.XH dhe Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C,bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa "f", Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa "i", Kapitulli VIII, pika 8.</i></p>	<i>Fatura</i>		<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi</i>	<i>vl.pa Tvsh</i>	<i>Date</i>	<i>Nr Serie</i>	Emertimi						43214499	GAZOIL	LITRA	13,495	121.6	1,641,891	14.12.2016	Numri i faturës	Numri serial i faturës	Data e faturës	Emri tregtar i shitësit /personit	NIPT-i	Vlera e tat	TVSH	49	43214499	14.12.2016	K	K...2u	1,641,891	328,378	<i>TVSH (1,641,891 lekë x 20%)</i>	= 328,378 lekë	<i>Gjobë (0.06 / 365 dite)</i>	= 71,915 lekë	<i>Tatim Fitimi (1,641,891 lekë x 15%)</i>	= 246,284 lekë	<i>Gjobë (0.06 / 365 dite)</i>	= 53,937 lekë	Totali	= 700,513 lekë
<i>Fatura</i>		<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi</i>	<i>vl.pa Tvsh</i>	<i>Date</i>																																								
<i>Nr Serie</i>	Emertimi																																													
43214499	GAZOIL	LITRA	13,495	121.6	1,641,891	14.12.2016																																								
Numri i faturës	Numri serial i faturës	Data e faturës	Emri tregtar i shitësit /personit	NIPT-i	Vlera e tat	TVSH																																								
49	43214499	14.12.2016	K	K...2u	1,641,891	328,378																																								
<i>TVSH (1,641,891 lekë x 20%)</i>	= 328,378 lekë																																													
<i>Gjobë (0.06 / 365 dite)</i>	= 71,915 lekë																																													
<i>Tatim Fitimi (1,641,891 lekë x 15%)</i>	= 246,284 lekë																																													
<i>Gjobë (0.06 / 365 dite)</i>	= 53,937 lekë																																													
Totali	= 700,513 lekë																																													
Kriteri:	Manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2, Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.																																													
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferenat e përmenduar sjellin efekte financiare.																																													
Shkaku:	Mos zbatim i manualit të Kontrollit Tatimor, Kap.2, Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.																																													
Rëndësia:	E Lartë.																																													
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.																																													

"M.P.C" shpk me NIPT L.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 07.05.2010 dhe ushtron aktivitet "Import-Eksport,tregtim me shumic dhe pakic i barnave dhe artikujve farmaceutik etj.", me adresë: Lagjia Skënder Llibohova,Rr.Halim Haxhiu. Administratori i shoqërisë është z. V.K.

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit Z. L.C, bazuar në Njoftimet e Kontrollit nr. 14390/2, datë 07.10.2019, konfirmuar nga subjekti në datë 14.10.2019 dhe Programit të Kontrollit nr. 14390//2, datë 07.10.2019, për TVSH-në për periudhën 01.08.2014 -30.07.2019, për Tatim Fitimin për periudhën 2014-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 01.08.2014 -30.07.2019.

Njoftimi për kontroll tatimor është bërë në datë 14.10.2019 dhe referuar nenit 23 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kontrolli ka filluar në datë 18.10.2019, **brenda afateve ligjore.**

Sipas Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 84, pika 1: “Raporti Përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor”. Subjekti nuk ka paraqitur kundërshtime.

Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se raporti i kontrollit nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e programit dhe më konkretisht:

-Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 18.10.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 21.01.2020, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

-Në analizën e bilancit material për çdo vit, nuk është paraqitur lista e çmimeve të blerjes dhe shitjes të aplikuar nga shoqëria;

-Në vitin 2017 nuk kemi një analizë të plotë të klientëve dhe furnitorëve të pasqyruar në bilanc dhe raport duke qënë se cdo vit kanë ardhur në rritje ;

Emërtimi	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Klientë për mallra produkte dhe shërbime	0	3,750,600	13,743,250	34,362,880	44,903,856
Të pagueshme ndaj furnitorëve	808,332	30,899,218	55,398,866	68,638,997	89,062,509

Burimi: Raporti i Kontrollit

- Në raportin e kontrollit nuk është bërë e detajuar ndarja e shpenzimeve, për cdo periudhë. Sipas bilanceve të deklaruara nga subjekti:
- Në vitin 2018 në zërin e shpenzimeve kemi ne Shumen 1,113,431 lekë shpenzime të tjera të pa detajuara nga subjekti dhe inspektori.

Titulli gjetjes:	Moszbatim i pikave të Programit dhe manualit të kontrollit , shitje nën kosto.
Situata:	<p>“F.K” shpk me NIPT L.....</p> <p>Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 06.05.2011 dhe ushtron aktivitet “Investitor ne fushen e ndertimit dhe tregtimit te banesave. Sipermarres ne ndertim dhe tregti materiale ndertimi.Transport malli per te trete.Kultivim kultura bujqesore ne Sera dhe toke are dhe tregtim te produkteve bujqesore.Ndertim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje periodike të infrastrukturës rrugore, ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, mbrojtje lumore, sisteme hidraulike, diga e bonifikime. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmemin e energjisë elektrike të TU, TM e TL. Punime të inxhinierisë mjedisore, sinjalistikës rrugore dhe topo-gjeodezike. Punime te sistemeve mekanike, hidraulike, elektrike, HVAC, CCTV, sigurise e mbrojtjes nga zjarri”, me adresë: LUSHNJE Lagjja 18 Tetori, godine 2 kateshe, kati pare mbrapa Agro Blend.</p> <p>Administratori i shoqërisë është z. B.C.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.Q, bazuar në Njoftimet e Kontrollit nr.4548/1, datë 09.05.2019, konfirmuar nga subjekti në datë 14.05.2019 dhe Programit të Kontrollit nr.4548/2, datë 14.05.2019, për TVSH-në për periudhën 03.2014-</p>

02.2019 për Tatim Fitimin për periudhën 2014-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 03.2014-02.2019.

Parashikuar për kontroll 360 orë (45 ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike.

Sipas Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 84, pika 1: “Raporti Përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor”. Subjekti nuk ka paraqitur kundërshtime.

Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se raporti i kontrollit nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e programit dhe më konkretisht:

- Në pasqyrat dhe bilancet materiale të hartuara nga inspektori për të gjithë periudhën objekt kontrolli nuk jepen cmimet e blerjes dhe shitjes. Mungesa e informacionit lidhur me cmimet e blerjes dhe shitjes e bën të pamundur llogaritjen e të ardhurave nga shitja dhe shpenzimeve për mallra.
- Nuk është bërë analiza e bilancit material për sa i përket artikujve që gjatë procesit transformohen në mallra ose shërbime referuar normativave të lejuara ligjore
- Për periudhën 2014-2019, inspektori ka pasqyruar të ardhurat, të cilat i specifikon në:

-të ardhura nga kryerja e punimeve në ndërtim, por këto të ardhura nuk shoqërohen me raport teknik të inxhinierit mbi punimet e kryera/situacione punimesh bashkëlidhur faturën tatimore;

-Të ardhura nga shitja e materialeve të ndërtimit, e pa shoqëruar me analizë të koston së produktit; Nuk jepet informacion për sasi të shitura dhe cmimet e shitjes.

-Nga analiza e situatës financiare për periudhën Mars – Dhjetor 2014 rezultojnë se :

Gjendje ne 01.01.2014	Blerje Mars- Dhjetor 2014	Shitje Mars- Dhjetor 2014	Gjendje në fund	Materialet e konsumuara
(inventar në celje 14,355,613 + 790,437 blerje deri në datën 28.02.2014 - 1,508,280 shitjet =16,066,517 lekë				
	2,738,013	8,987,253	9,875,100	9,817,277

Konstatohet se shitja e realizuar nga subjekti për këtë periudhë është kryer pa vlerë të shtuar , veprim për të cilin inspektori duhet të bënte rivlersim në të ardhura , Bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,

Neni 71/2 Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh / transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

- a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformatojnë parimet e ligjit tatimor;
- b)veprimet/transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;
- c) veprimet/transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;
- ç) forma e veprimit/transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;
- d) evidentohen elemente të veprimeve/ transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/ transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

2. Kur një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje

me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore. (Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

- Neni 72 Baza e mënyrave alternative të vlerësimit

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në: a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi; b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta; c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjerë; ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave; d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

2. Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur. 3. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Si rezultat duke marrë si bazë referimi vlerën e shtuar për 3 vitet e ardhëshme 2015 , 2016 , 2017 rezulton :

	2015	2016	2017
Vlera e shtuar	221%	135%	121%

$\frac{1}{3} = 160 \% \text{ vlerë të shtuar } 8,929,430 * 160 \% = 14,287,088 \text{ leke} - 8,987,253 \text{ lekë} = -5,299,835 \text{ lekë}$ e cila do të trajtohet si shitje e padekluar .

- **Si rezultat subjektit i lindin detyrimet si më poshtë :**

TVSH (5,299,835 lekë x 20%) = 1,059,967 lekë

Gjobë (100% TVSH-së) = 1,059,967 lekë

Tatim Fitimi (5,299,835 lekë x 15%) = 794,975 lekë

Gjobë (100% T.F) = 794,975 lekë

Totali = 3,709,885 lekë

- Nga kontrolli i gjëndjes së inventarit rezulton se vlera e inventarit më 31.12.2015 nuk është 11,848,877 lekë por 12,269,385 lekë, pra është deklaruar 420,508 lekë më pak. Kjo sepse gjendja e hekurit mbetje është deklaruar me kosto më të vogël se ajo e magazinuar. Nga ana inspektorit është vendosur që kjo diferencë të trajtohet te kontrolli i KMSH-së dhe rezulton se:

Edhe pas korigjimit të gjëndjes së inventarit në fund të periudhës 31.12.2015, rezultati i KMSH-ës nuk ka ndryshuar, është i njëjti me KMSH e deklaruar nga subjekti në pasqyrat financiare, në vlerën 30,268,478 lekë. Në raport kur është llogaritur KMSH sipas të dhënave del që blerjet e mallrave gjatë vitit në raport janë të ndryshme nga ato që ka deklaruar subjekti në llogaritjen e KMSH, por kjo diferencë nuk është sqaruar nga ana inspektorit në raport, paraqitja e e saktë e KMSH për vitin 2015 sipas blerjeve për mallrat të llogaritura nga subjekti në tabelat si më poshtë vijon;

KMSH 2015

KMSH e deklaruar nga Subjekti (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund
30,268,478	7,446,353	34,671,002	11,848,877
KMSH e deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim e korigjuar	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund e korigjuar
30,268,478	7,446,353	35,091,510	12,269,385
KMSH që duhej deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund

	29,847,970	7,446,353	34,671,002	12,269,385																								
<p><i>Diferenca e KMSH-së së deklaruar nga subjekti me KMSH- që duhej deklaruar ka diferencën 420,508 lekë (30,268,478-29,847,970) . Diferenca 420,508 lekë janë shpenzime të deklaruar tepër në KMSH, të pa justifikuar me dokumenta dhe duhen zbritur.</i></p> <p><i>Nga kjo shoqërisë i lindin detyrimet si vijon:</i></p> <p>Detyrim t.fitim (420,508x15%) = 63,076 lekë</p> <p>Gjoha 21.9% = 13,814 lekë</p> <p>Total = 76,890 lekë</p> <p>Gjoha për deklarim të pasaktë vendoset në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 115 dhe Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar</p> <p>-Nga kontrolli i gjëndjes së inventarit rezulton se vlera e inventarit më 31.12.2016 nuk është 11,248,285 lekë por 12,348,567 lekë, pra është deklaruar 1,100,282 lekë më pak. Kjo sepse gjendja e hekurit mbetje është deklaruar me kosto më të vogël se ajo e magazinuar. Nga ana inspektorit është vendosur që kjo diferencë të trajtohet te kontrolli i KMSH-së dhe rezulton se:</p> <p>Pas korrigjimit të gjëndjes së inventarit në fund të periudhës 31.12.2016, rezultati I KMSH-ës duket se nuk është llogaritur sic duhet. Në raport kur është llogaritur KMSH sipas të dhënave del që blerjet e mallrave gjatë vitit në raport janë të ndryshme nga ato që ka deklaruar subjekti në llogaritjen e KMSH, por por kjo diferencë nuk është sqaruar nga ana inspektorit në raport, paraqitja e e saktë e KMSH për vitin 2016 sipas blerjeve për mallrat të llogaritura nga subjekti në tabelat si më poshtë vijon;</p> <p>KMSH 2016</p> <table border="1"> <tr> <td>KMSH e deklaruar nga Subjekti (Gj.fund+blerje-gj.fund)</td> <td>gjendja në fillim</td> <td>blerjet gjatë vitit</td> <td>gjendja në fund</td> </tr> <tr> <td>59,668,167</td> <td>11,848,877</td> <td>59,067,575</td> <td>11,248,285</td> </tr> <tr> <td>KMSH e deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)</td> <td>gjendja në fillim e korigjuar</td> <td>blerjet gjatë vitit</td> <td>gjendja në fund e korigjuar</td> </tr> <tr> <td>59,221,460</td> <td>12,269,385</td> <td>59,300,642</td> <td>12,348,567</td> </tr> <tr> <td>KMSH qe duhej deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)</td> <td>gjendja në fillim</td> <td>blerjet gjatë vitit</td> <td>gjendja në fund</td> </tr> <tr> <td>58,988,393</td> <td>12,269,385</td> <td>59,067,575</td> <td>12,348,567</td> </tr> </table> <p><i>Diferenca e KMSH-së së deklaruar nga subjekti me KMSH- që duhej deklaruar ka diferencën 679,774 lekë (59,668,167-5,898,393) . Diferenca 679,774 lekë janë shpenzime të deklaruar tepër në KMSH, të pa justifikuar me dokumenta e duhen zbritur.</i></p> <p><i>Nga kjo shoqërisë i lindin detyrimet si vijon:</i></p> <p>Detyrim t.fitim (679,774x15%) = 101,966 lekë</p> <p>Gjohë 21.9% = 22,331 lekë</p> <p>Total = 124,297 lekë</p> <p>Nga ana inspektorit në raport janë llogaritur detyrime</p> <p>Detyrim t.fitim (446,795x15%) = 67,019 lekë</p> <p>Gjoha 21.9% = 14,677 lekë</p> <p>Total = 81,696 lekë</p> <p>Diferenca nga detyrimet që duhet të ishin llogaritur 42,601 lekë</p> <p><i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit A.Q, P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit B.S dhe ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa “i”, Kapitulli VIII, pika 8.</i></p>					KMSH e deklaruar nga Subjekti (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund	59,668,167	11,848,877	59,067,575	11,248,285	KMSH e deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim e korigjuar	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund e korigjuar	59,221,460	12,269,385	59,300,642	12,348,567	KMSH qe duhej deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund	58,988,393	12,269,385	59,067,575	12,348,567
KMSH e deklaruar nga Subjekti (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund																									
59,668,167	11,848,877	59,067,575	11,248,285																									
KMSH e deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim e korigjuar	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund e korigjuar																									
59,221,460	12,269,385	59,300,642	12,348,567																									
KMSH qe duhej deklaruar nga Inspektori (Gj.fund+blerje-gj.fund)	gjendja në fillim	blerjet gjatë vitit	gjendja në fund																									
58,988,393	12,269,385	59,067,575	12,348,567																									
Kriteri:	Pikat e Programit dhe manualit të kontrollit , Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.																											
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare.																											
Shkaku:	Moszbatim i pikave të Programit dhe manualit të kontrollit , Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.																											
Rëndësia:	E lartë																											
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF konform legjislacionit në fuqi, që për subjektin të bëjë																											

Subjekti “F” sh.p.k, me NIPT L.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 16/06/2010 dhe ushtron aktivitet “Import-Eksport mallra të ndryshëm, industriale si materiale ndertimi e të tjera të këtij lloji. Tregeti me shumice dhe pakice të artikujve industriale dhe ushqimor. Punime të ndryshme ndertimi. Prodhim i materialeve të ndryshme të ndertimit. Magazinim, pëpunim dhe tregtimin e produkteve bujqesore e blegtorale Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme: Ndertim, projektim, rikonstruksion ndertime civile, ekonomike, industriale dhe turistike. Prodhim e tregtim të materialeve të ndertimit, inerte, rere, mermer etj. Tregtim makinerie e pjesë kembimit për llojet e ndryshme të makinerive. Tregtim të artikujve të ndryshëm me pakice e shumice, industriale dhe ushqimore, bujqesore, blegtorale, lengjeve të frutave, pijeve alkolike, ujit -si dhe import- eksportin e tyre, etj”.

Administratori i shoqërisë është z Beni Rrasa. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit z. Andi Gropa, bazuar në Njoftimet e Kontrollit nr. 20838/1 datë 28.05.2019, konfirmuar nga subjekti në datë 28.05.2019 miratuar në zbatim të tij, për TVSH-në për periudhën 04/2017 deri më 10/2018, për Tatim Fitimin për periudhën 2017, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 04/2017 -10/2018.

Njoftimi për kontroll tatimor është bërë në datë 27.04.2019 dhe referuar nenit 23 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Kontrolli ka filluar në datë 29.05.2019, brenda afateve ligjore.

Nga analiza e raportit të kontrollit konstatohet si vijon:

-Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 29.05.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 24.06.2019, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proces-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.9253/112, datë 02.09.2021 “Për Projekt Raportin e Auditimit” ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Procesverbalet janë mbajtur në datën e fillimit të kontrollit pavarësisht se nuk janë ngarkuar në sistemin C@ts.
2. Analiza e klientëve është kryer për 40 % të totalit , për shkak të numrit shumë të madh të tyre.
3. Lidhur me diferencat Tatime- Dogana kemi të bëjmë me rivlersim doganor në mars 2021 dhe për këtë arsye nuk kishin si të konstatoheshin, pasi kontrolli nga ana jonë është evaduar afërsisht dy vjet më parë (bashkëlidhur do të gjeni edhe procesverbalin e vlerësimit doganor). Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

Observacioni merret në konsideratë pasi janë paraqitur fakte dhe argumente shtesë nga ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit dhe trajtuar në Projektraport.

<p>Situata:</p>	<p>Subjekti “S” sh.p.k me NIPT K.... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 09/02/2001 dhe ushtron aktivitet “Import-eksport, tregëti me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimore, blegtorale, bujqësore, fruta perime si dhe te mallrave industriale”, me adresë: Fier Lagjja "16 Prilli", Rruga "Todi Shallapi", pallati nr.7, mbrapa QTU. Administratori i shoqërisë është z. SH.S . Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit z.A.K, bazuar në Njoftimet e Kontrollit nr. 7049 datë 27.04.2018, konfirmuar nga subjekti në datë 02.05.2018 dhe Programit të Kontrollit nr. 7049/1, për TVSH-në për periudhën 2014/10 deri më 2017/03, për Tatim Fitimin për periudhën 2014-2016, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 10.2014-03.2017. Njoftimi për kontroll tatimor është bërë në datë 27.04.2018 dhe referuar nenit 23 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar,. Kontrolli ka filluar në datë 02.05.2018, brenda afateve ligjore. Parashikuar për kontroll 136 orë (17ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë <u>24.05.2018</u> dhe në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 , i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike. Sipas Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 84, pika 1: “Raporti Përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor”. Subjekti nuk ka paraqitur kundërshtime. Nga analiza e raportit të kontrollit është konstatuar se raporti i kontrollit nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e programit dhe më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> Referuar analizës së shpenzimeve për vitin 2016 kryer nga inspektori në raport me objektin e veprimtarisë së subjektit, rezulton se nuk kemi nje ndarje të detajuar për shpenzimet “trajtime të përgjithshme” në vlerën 620,414 lekë, të cilat klasifikohen shpenzime të pazbritshme , jo në përputhje meaktivitetin e shoqërisë. $\begin{array}{l} \text{Detyrim TF} \quad 620,414 \times 15\% \quad = 93,062 \text{ lekë} \\ \text{Gjobë TF (0,06\%/ditë)21.9\%} \quad = 20,381 \text{ lekë} \\ \hline \text{Detyrimi} \quad = 113,443 \text{ lekë} \end{array}$ Në bilanc llogaritë “Klientë” dhe “Furnitorë” kanë ardhur në rritje nga viti 2014 në vitin 2015. Kemi një rënie te Klientëve dhe furnitorëve ne vitin 2016 krahasuar me vitin 2015. Inspektori nuk ka kryer analizë të vjetërsisë së klientëve dhe furnitorëve, për të konkluduar në lidhje me përlllogaritjen e provizioneve për detyrimet dhe të drejtat e mbartura. <table border="1" data-bbox="384 1518 1444 1601"> <thead> <tr> <th>Emërtimi</th> <th>Viti 2014</th> <th>Viti 2015</th> <th>Viti 2016</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Klientë për mallra produkte dhe shërbime</td> <td>11,523,786</td> <td>11,940,200</td> <td>264,840</td> </tr> <tr> <td>Të pagueshme ndaj furnitorëve</td> <td>3,834,973</td> <td>13,216,537</td> <td>2,208,000</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Burimi: Raporti i Kontrollit</i> Inspektori nuk ka kryer analizë të vjetërsisë së klientëve, për të konkluduar në lidhje me përlllogaritjen e provizioneve për detyrimet dhe të drejtat e mbartura.</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga krahasimi i mallrave të blera pasqyruar në raport me pasqyrën e importeve të shoqërisë “S....” shpk (vlera e doganës), për vitin 2016 rezulton si vijon: -Deklarime të subjektit për blerje nga importi, në shumën vlerë të tatueshme 70,914,640 lekë me tvsh 14,182,928 lekë -Deklarata doganore në shumën 71,590,656 lekë, me tvsh 14,318,131 lekë. -Diferenca midis deklaratës doganore dhe deklarimit të subjektit në vlerë të tatueshme në shumën 676,016 lekë. <p>Në zbatim të nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit</p>	Emërtimi	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Klientë për mallra produkte dhe shërbime	11,523,786	11,940,200	264,840	Të pagueshme ndaj furnitorëve	3,834,973	13,216,537	2,208,000
Emërtimi	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016										
Klientë për mallra produkte dhe shërbime	11,523,786	11,940,200	264,840										
Të pagueshme ndaj furnitorëve	3,834,973	13,216,537	2,208,000										

	<p>të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.</p> <p>Përsa më sipër detyrimet e subjektit për këtë diferencë paraqiten si vijon:</p> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td><i>Detyrim TVSH</i></td> <td><i>676,016 x 20%</i></td> <td><i>= 135,203 lekë</i></td> </tr> <tr> <td><i>Gjobë TVSH (100% e detyrimit)</i></td> <td></td> <td><i>= 135,203 lekë</i></td> </tr> <tr> <td><i>Detyrim TF</i></td> <td><i>676,016 x 15%</i></td> <td><i>= 101,402 lekë</i></td> </tr> <tr> <td><i>Gjobë TF (100% e detyrimit)</i></td> <td></td> <td><i>= 101,402 lekë</i></td> </tr> <tr> <td><i>Detyrimi Total</i></td> <td></td> <td><i>= 586,653 lekë</i></td> </tr> </table> <p><i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit A.K , P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa "f", Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa "i", Kapitulli VIII, pika 8.</i></p>	<i>Detyrim TVSH</i>	<i>676,016 x 20%</i>	<i>= 135,203 lekë</i>	<i>Gjobë TVSH (100% e detyrimit)</i>		<i>= 135,203 lekë</i>	<i>Detyrim TF</i>	<i>676,016 x 15%</i>	<i>= 101,402 lekë</i>	<i>Gjobë TF (100% e detyrimit)</i>		<i>= 101,402 lekë</i>	<i>Detyrimi Total</i>		<i>= 586,653 lekë</i>
<i>Detyrim TVSH</i>	<i>676,016 x 20%</i>	<i>= 135,203 lekë</i>														
<i>Gjobë TVSH (100% e detyrimit)</i>		<i>= 135,203 lekë</i>														
<i>Detyrim TF</i>	<i>676,016 x 15%</i>	<i>= 101,402 lekë</i>														
<i>Gjobë TF (100% e detyrimit)</i>		<i>= 101,402 lekë</i>														
<i>Detyrimi Total</i>		<i>= 586,653 lekë</i>														
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.															
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmenduar sjellin efekte financiare.															
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.															
Rëndësia:	E Lartë.															
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.															

Subjekti "L..." sh.p.k, me Nipt L....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti është regjistruar në organet tatimore në datë **10.11.2014**. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është "Linje per perpunimin, transformimin dhe prodhimin e kepuceve, sandaleve te te gjitha llojeve si dhe suprinave te te gjitha llojeve, Eksport-Import te lendeve te paraqe lidhen me perpunimin dhe prodhimin e kepuceve, sandaleve te te gjitha llojeve si dhe suprina te te gjitha llojeve. Veprimtari private ne fushen e tregtise me shumice e pakice, import-eksport te te mallrave te ndryshme industrial, lendeve dhe materialeve te ndertimit, materialeve te materialeve te inerte, pjeseve te kembimit te mjeteve, makinerive e paisjeve, hidrosanitare, elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, mjete kancelarie, punime druri, mobilje, dyer, dritare, duralumini, material plastike, punime e skelete hekuri, servis automjetesh, agjenci shitblerje e qeraje te pasurive te tundeshme dhe te patundeshme. Veprimtari private ne fushene transportit detar dhe tokesor te mallrave e pasagjereve brenda vendit, nderqytetsore, rrethqytetsore dhe jashte vendit per vet shoqerine dhe per persona te trete, agjensi turistik.". Adresa e Aktivitetit Fier Lagjja 1 Maj. ish-NRTHAN, NR-596. Përfaqësuesi ligjor i subjektit është Z. F.M.

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit: z. **G.V**, bazuar në njoftimet e kontrollit nr. **17189/1**, datë **25/11/2019**, konfirmuar nga subjekti në datë 25.11.2019 si dhe Programit kontrolli nr. **17189/2**, datë **25/11/2019** , për TVSH-në për periudhën 11.2014-10.2019, për Tatim Fitimin për periudhën 2014-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2014/11-2019/10

Sipas Ligjit Nr.9920. date 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 23, pika 3 përcakton "*Aktet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të postës rekomande. Data e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar*". Njoftimi për kontroll është bërë në datën 22.11.2019 dhe kontrolli ka filluar në datë 25.11.2019, brenda afateve ligjore.

Sipas Ligjit Nr.9920. date 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike.

Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se është zbtuar programi dhe është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit.

Në raport konstatohet se:

Për periudhat tatimore të kotnrolluara disa shpenzime të subjektit janë klasifikuar si shpenzime të panjohura për subjektin dhe janë llogaritur detyrimet për Tvsh-në + Gjjobat dhe detyrimet për TF+ gjjobë. Në total janë pëllogaritur detyrime për subjektin në shumën 690, 467 lekë dhe gjjoba në shumën 151,213 lekë .

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.9253/103, datë 30.08.2021 “Për Projekt Raportin e Auditimit ” ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1.Për periudhën tatimore për vitin 2018 të cilin ju keni bërë rivlersim subjekti cdo shpenzim e ka të shoqëruar me dokumentacionin sipas ligjit,

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Sqarimi juaj si dhe dokumentacioni shoqërues bashkëlidhur **merren** në konsideratë dhe justifikojnë diferencat e konstatuara në Projektraport.

Titulli gjetjes:	Diferenca tatime / dogana dhe Programi dhe Manualit të Kontrollit.								
Situata:	<p>Subjekti “D.F” sh.p.k, me Nipt L..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti është regjistruar në organet tatimore në datë 02.09.2013. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është “Tregti me shumice dhe pakice i frutave dhe perimeve si dhe import-eksporti i tyre.Tregti te artikujve te ndryshem ushqimore,dhe paisje elektrike. Transport mallrash per vete dhe te trete.Import dhe tregti fidane fruta perime dhe kultivim e prodhim fruta perime”. Adresa e Aktivitetit Rruga Nacionale Fier - Lushnje,Lagjja 18 Tetori,godine nje kateshe me numer pasurie 607/229 dhe zone kadastrale 2087. Përfaqësuesi ligjor i subjektit është Z. B.A. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit : z. S.Z , bazuar në njoftimet e kontrollit nr.9988/1 dhe 9328 date 06.06.2018, konfirmuar nga subjekti në datë 11.06.2018 si dhe Programit kontrolli nr. 9988/2 date 06.06.2018 , për TVSH-në tvsh per sigurimet shoqerore dhe shendetsore si edhe tatimi mbi te ardhurat personale , per periudhen 2017.10 – 2018.03. Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se nuk është zbtuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit. Në raport konstatohet se: -Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 11.16.2018 , ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 26.07.2018, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”. -Nuk është bërë verifikimi analitikë i artikujve të shitur deklaruar nga subjekti krahasuar me deklaratat analitike të eksportit. -Nga verifikimi i deklaratës analitike të eksportit për periudhën Tetor-Dhjetor 2017 për 3 artikujt e pasqyruar në tabelën më poshtë rezultojnë diferenca në sasinë e deklaruar nga subjekti / sasinë nga deklarata e eksportit në vlerën :</p>								
	1	EMERTIMI	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA	Sasi sipas doganes	Diferenca subjekt - dogane	Diferenca në vlerë
	1	KUNGULL	Kg	157,285	86	13,587,803	110,474	(46,811)	(4,044,496)

	2	LULE LAKER	Kg	7,311	66	481,347	632	(6,679)	(439,478)
	3	TRANGULL	Kg	784,201	61	47,967,462	752,254	(31,947)	(1,955,138)
				Totali					(6,439,113)
<p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, <i>Neni 124</i>. Në këtë situatë duhet të ishte llogaritur penalteti sipas nenit të sipër cituar: Eksport = 6,439,113 lekë (Vlerë e tatueshme) Tatim Fitim (6,439,113 lekë x 15%) = 973,967 lekë. Gjobë (89,363 lekë x 100%) = 973,967 lekë</p> <hr/> <p>Total 1,947,934 lekë</p> <p><i>Veprimet e sipërme janë kompetencë e inspektorit të kontrollit S.Z, P/Sektorit të Kontrollit E.XH, Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit A.K dhe ish Drejtorit Rajonal O.C, bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 2, germa “f”, Manuali, Kapitulli II, pika 2.2 dhe 2.1 germa “i”, Kapitulli VIII, pika 8.</i></p>									
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.								
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare.								
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.								
Rëndësia:	E Lartë.								
Rekomandimi:	DRT Fier, për tatimpaguesin e cituar më sipër, për të cilët nga grupi i auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit në vlerën 1,947 mijë lekë , të marrë masa për kryerjen e një vlerësimi tatimor në zbatim të nenit 68/5/b, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.								

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.9253/117, datë 03.09.2021 “Për Projekt Raportin e Auditimit ” ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. *Diferenca raport kontrolli/ doganë nuk qëndron pasi dogana disa artikuj nuk i paraqet me emër por me emërtimin perime të freskëta ,bashkëlidhur gjenden edhe faturat e shitjes se subjektit.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:Komenti dhe shpjegimet e paraqitura në observacion nuk qëndrojnë pasi nga krahasimi i sasisë së deklaruar per eksport ne raport kontrolli krahsuar me sasinë sipas doganes rezulton një diferencë prej 4,134 kg, si konkluzion materialet e paraqitura **nuk qëndrojnë** dhe nuk e justifikojmë diferencën e konstatuar.

Shënim: Në lidhje me Projektraportin kanë ardhur observacionet me nr. 9253/125 datë 07.09.2021, nr. 9253/122 datë 07.09.2021, 9253/128 datë 07.09.2021, 9253/123 datë 07.09.2021, 9253/103 datë 07.09.2021, si dhe nr. 9253/126 datë 07.09.2021, të cilat pasi u shqyrtuan nga grupi i auditimit **nuk u morën në konsideratë**, me arsyetimin se janë të njëjtat argumente si ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit të mbajtur dhe nuk ka argumente apo dokumente shtesë. Në asnjë nga observacionet e paraqitura, nuk përmbajnë argumenta për të shmangur subjektin nga propozimi për rikontroll.

Titulli gjetjes:	Diferenca në inventar dhe në bilancin material, vonesë në hedhjen e dokumenteve në C@TS, mos zbatim të plotë të pikave të program kontrollit.
Situata:	Subjekti “G.K”, me NIPT L....: Kontrollin e ka ushtruar inspektori M.U, bazuar në njoftimin e kontrollit nr.16960 datë 04.03.2019, marrë dijeni edhe subjekti më datë 08.04.2019. Programi i kontrollit për këtë subjekt

mban nr.16960/1 datë 11.03.2019, i cili përfshinë TVSH-në për periudhën 2013.09-2018.08, TF për periudhën 2013-2017 dhe kontributet shoqërore e shëndetësore për periudhën 2013.09-2018.08. Ky subjekt sipas planifikimit të DPT, duhej të kontrollohen në Tetor 2018, ndërkohë që njoftimi për kontroll ka dalë në Mars 2019, pra 4 muaj me vonesë.

Gjithashtu, sipas njoftimit të kontrollit me datë 04.03.2019, ky kontroll duhej të fillonte jo më vonë se 10 ditë, ndërkohë që kontrolli ka filluar në datën 08.04.2019, pra 23 ditë me vonesë.

Për këtë kontroll janë parashikuar 440 orë pune (55 ditë), ku afati i qëndrimit të inspektorit në subjekt duhej të ishte deri në datën 24.06.2019, pas kësaj inspektori duhej të pregatiste projekt raportin brenda 7 ditëve, pra deri në datën 01.07.2019, ndërkohë që projekti është dërguar në subjekt më datë 17.07.2019, me anë të shkresës nr.16960/3, pra 17 ditë me vonesë.

Raporti përfundimtar është dërguar më datë 30.07.2019 nëpërmjet shkresës me nr.16960/5, brenda afateve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 08.04.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 26.07.2019, pra afërsisht 10 javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: "...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (procesverbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës".

Nuk është bërë një analizë e thelluar e veprimtarisë së subjektit dhe nuk është bërë ndarja e aktiviteteve.

Bilanci material nuk është shoqëruar me raportin teknik të inxhinierit dhe situacione punimesh të kryera.

Nuk është analizuar nga ana e inspektorit bilanci i vitit 2013 dhe Tatim Fitimit për vitin 2013, sipas programit të kontrollit. Gjithashtu për vitin 2013 nuk janë analizuar as blerjet e as shitjet.

Nga analizimi i situatës financiare si dhe të librave të subjektit rezultojnë se ka diferenca në inventar. Nga ana jonë u verifikuan librat e blerjeve nga data 15.12.2014 -31.12.2014 dhe rezultojnë sa më poshtë:

Nr	Data	NIPT-i	Vlera tatueshme	TVSH	Vlera për investime	TVSH e inv.
1	15.12.2014	K....	1,898,417	379,683	0	0
2	16.12.2014	K.....	1,901,583	380,317	0	0
3	16.12.2014	K.....	1,901,583	380,317	0	0
4	20.12.2014	K....	0	0	2,137,000	427,400
5	22.12.2014	K....	676,200	135,240	0	0
6	22.12.2014	L.....	4,219,904	843,981	0	0
7	23.12.2014	K....	1,680,000	336,000	0	0
8	25.12.2014	L....	1,526,690	305,338	0	0
9	27.12.2014	K....	2,070,012	414,002	0	0
10	27.12.2014	K....	1,841,250	368,250	0	0
		Tot	17,715,639	3,543,128	2,137,000	427,400

Shitjet janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	NIPT-i	Vlera e tatu	TVSH
1	J....		
2	J....	9,803,200	1,960,640
3	L....	332,000	66,400
4	L....	364,584	72,917
5	K....	1,500,000	300,000
	Total	11,999,784	2,399,957

Sa më sipër, bazuar në deklaratën e inventarit të subjektit me zero gjëndje malli në 31.12.2014, rezultojnë se:

Blerje	17,715,639
Shitje	11,999,784
Diferenca në inventar	5,715,855 Lekë

Në zbatim të Nenit 124, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, për vitin 2014, subjektit i lindin detyrime si vijon:

TVSH	1,143,171
Gjohë 100%	1,143,171

Tatim Fitimi	857,378
Gjobë 100%	857,378
Total Detyrim	4,001,099 Lekë

Të njëjtat verifikime janë kryer edhe për vitet 2015-2017, ku rezulton se:

Viti 2015:

Blerje 26.12 - 31.12	8,103,841
Shitje	2,749,420
Gjëndje 31.12.2015	238,586
Diferenca ne inventar	5,115,835 Lekë

Tvsh	1,023,167
Gjobe 100%	1,023,167
Tf	767,375
Gjobe 100%	767,375
Total Detyrim	3,581,084 Lekë

Viti 2016:

Blerje 13.12 - 31.12	30,603,330
Shitje	19,664,354
Gjëndje 31.12.2015	1,348,384
Diferenca ne inventar	9,590,592

Tvsh	1,918,118
Gjobe 100%	1,918,118
Tf	1,438,588
Gjobe 100%	1,438,588
Total Detyrim	6,713,413 Lekë

Viti 2017:

Blerje 29.12 – 31.12	3,282,001	Tvsh	656,400
Shitje	0	Gjobe 100%	656,400
Gjëndje 31.12.2015	0	Tf	492,300
Diferenca ne inventar	3,282,001 Lekë	Gjobe 100%	492,300
		Total Detyrim	2,297,400 Lekë

Në përfundim, duke analizuar blerjet/shitjet në fund të periudhë dhe duke marrë parasysh gjëndjen e inventarit në fund të periudhës, subjektit i linden detyrime(nga diferencat e dala më sipër) për periudhën 2014-2017 në shumën 16.592.400 Lekë:

Nr.	Viti	Detyrimi sipas konstatimit
1	2014	4,001,099
2	2015	3,581,084
3	2016	6,713,413
4	2017	2,297,400
5	Total	16,592,996 Lekë

Inspektori ka analizuar blerjet e subjektit për vitin 2014 të cilat janë në shumën 140.357.454 Lekë dhe TVSH në blerje në shumën 28.071.490 Lekë, sipas zërave në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Njësia	Vl e tat.	Tvsh	Vlera totale
1	Cimento	Lekë	17.174.705	3.434.941	20.609.646
2	Pllaka	Lekë	2.282.891	456.578	2.739.469

3	Beton	Lekë	2.817.294	563.459	3.380.753
4	Hekur	Lekë	21.477.035	4.295.407	25.772.442
5	Profile alumini	Lekë	2.512.060	502.412	3.014.472
6	Pllakë veshje MDF, pllake veshje	Lekë	19.747.356	3.949.471	23.696.827
7	Bitum I lëngët	Lekë	3.195.023	639.005	3.834.028
8	Panele	Lekë	710.290	142.058	852.348
9	Paisje kondicionimi	Lekë	805.747	161.149	966.896
10	Mobilje, paisje zyre	Lekë	62.400	12.480	74.880
11	Paisje hidraulike, elektrike, punë, materiale etj	Lekë	69.482.653	13.896.531	83.379.184
12	Auditim ligjor	Lekë	90.000	18.000	108.000

Për vitin 2014 inspektori ka bërë edhe zbrëthimin e bilancit material ku shprehet se çfarë mallra ka blerë dhe ka situacionuar:

Nr	Emertimi	Njesia	GJ. Fill.	Hyrje	Dalje	GJ.Fund	Inv. Kont	Diferenca
1	Cimento	Ton	0	2148	2148	0	0	0
2	Beton	M3	0	480	480	0	0	0
3	Hekur	Kg	0	316015	316015	0	0	0
4	Pllaka	M2	0	3490	3490	0	0	0
5	Profile alumini	Koli	0	5262	5262	0	0	0
6	Bitum i lëngët	Ton	0	55.5	55.5	0	0	0
7	Paisje hidraulike, elektrike, punë etj	Lekë	0	36.812.658	36.812.658	0	0	0

Nga kjo pasqyrë vërehet se pllaka veshje MDF për shumën 19.747.356 nuk është marrë parasysh, nga ana tjetër për blerjet materiale hidraulike, elektrike, punë, etj shprehet se ka blerë 36.812.658 Lekë dhe jo 69.482.653, për të cilën na lind një diferencë prej: 32.669.995 Lekë + 19.747.365 Lekë MDF= **52.417.360 Lekë**. Për këtë subjektit do ti rriten të ardhurat në 52.417.360 Lekë dhe bazuar në Nenin 124, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, rezulton sa më poshtë:

Detyrim TVSH $52.417.360 \times 20\% = 10.483.472$ Lekë
 Gjorbë TVSH (100% e detyrimit) 10.483.472 Lekë
Detyrimi 20.966.944 Lekë

Detyrim TF $52.417.360 \times 15\% = 7.862.604$ Lekë
 Gjorbë TF (100% e detyrimit) 7.862.604 Lekë
Detyrimi 15.725.208 Lekë + 20.966.944 Lekë

Tot. 36,962,152 Lekë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi M.U në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF dhe E.XH në cilësinë e P/Sektorit të kontrollit.

Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap. 2.
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Manualit dhe Ligjit "Për procedurat Tatimore", ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumën 53,555,148 Lekë.
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.

Shënim: Nga ballafaqimi i organizuar në datë 15.09.2021 në KLSH, rezultoj se për miratimin e këtij raport kontrolli, nuk ka patur Drejtor Kontrolli të emëruar për periudhën e konstatuar, gjë e vërtetuar nga ana e subjektit me dokumenta të paraqitura në ballafaqim.

Titulli gjetjes:	Diferenca në shumën e rimbursuar si dhe vonesë në hedhjen e dokumenteve në C@TS.
Situata:	Subjekti "A....", me NIPT L..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton: Referuar shkresës nr. 8685/2 prot., datë 02.06.2020 të DPT, (nr. 5536 prot., datë

	<p>05.06.2020 të DRT Fier), me lëndë: “Dërgohet shkresë për veprim”, i kërkohej DRT Fier kontroll për periudhën 2020/01-2020/04 për efekt të kërkesës së subjektit për rimbursim TVSH-je në vlerën 3,843,578 Lekë, kontrollin e ka ushtruar inspektori V.C bazuar në programin nr.prot 5536/2 dt 17.06.2020 si dhe të konfirmuar nga tatimpaguesi nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura më datë 17.06.2020.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i perkasin datës 28.10.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 04.11.2019, pra afërsisht 1 javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.Subjekti ka bërë blerje për këtë periudhë nga furnitorë vendas të cilët janë analizuar nga ana e inspektorit në vlerën 7.158.337 Lekë dhe TVSH 1.431.673 Lekë. Inspektori liston furnitorët në vlerë Leku por jo me emërtesë produkti. Blerje nga fermerë ka në shumën 40.009.645 Lekë dhe TVSH në vlerën 2.400.581 Lekë, në tabelë inspektori nuk ka përcaktuar nr. e marrëveshjes midis shoqërisë dhe fermerit.</p> <p>Në dy raste, janë kryer auto faturime para datës së protokollit të akt marrëveshjes në DRT Fier dhe më konkretisht:</p> <table border="1" data-bbox="391 840 1428 1041"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>NIPT</th> <th>Vlera e tatueshme për blerje nga fermeri</th> <th>TVSH</th> <th>Data e lidhjes së akt marrëveshjes</th> <th>Data e dorëzimit të akt marrëveshjes në DRT Fier</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>L....7N</td> <td>294,336</td> <td>17,660</td> <td>28.04.2020</td> <td>04.05.2020</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>L...4O</td> <td>158,784</td> <td>9,527</td> <td>28.04.2020</td> <td>04.05.2020</td> </tr> <tr> <td colspan="2">TOTALI</td> <td>453,120</td> <td>27,187</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Blerjet e periudhës 2020/01-2020/04, rivlerësohen në zbritje në shumën 453,120 Lekë.</p> <p>Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, për subjektin lindin detyrime si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="558 1176 1101 1288"> <tbody> <tr> <td>TVSH</td> <td>27,187 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Gjobë (20%)</td> <td>5,437 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Total detyrimi</td> <td>32,624 Lekë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Sipas bilancit material të subjektit rezulton gjëndje prej 1.870.573 Lekë dhe TVSH 374.116 Lekë të cilën inspektori e konsideron si eksport total për këtë periudhë, ndërkohë që duhet ta lërë gjëndje kreditore në periudhat e mëvonëshme.</p> <p>Si përfundim nga shuma e kërkuar për rimbursim (3.843.578 Lekë), sipas analizës së inspektorit është zbritur shuma 95.406 Lekë dhe ka rimbursuar shumën 3.748.172 Lekë.</p> <p>Nga kjo do të zbresim $32.624 + 374.116 = 406.740$ Lekë, pra në total subjekti duhej të rimbursohej për shumën $3.748.172 - 406.740 = 3,341,432$ Lekë.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi V.C, në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF, E.XH, në cilësinë e P/Sektorit të kontrollit, në DRTF.dhe B.S, në cilësinë e Dr/Drejtorisë së Kontrollit, në DRTF.</p>	Nr	NIPT	Vlera e tatueshme për blerje nga fermeri	TVSH	Data e lidhjes së akt marrëveshjes	Data e dorëzimit të akt marrëveshjes në DRT Fier	1	L....7N	294,336	17,660	28.04.2020	04.05.2020	2	L...4O	158,784	9,527	28.04.2020	04.05.2020	TOTALI		453,120	27,187			TVSH	27,187 Lekë	Gjobë (20%)	5,437 Lekë	Total detyrimi	32,624 Lekë
Nr	NIPT	Vlera e tatueshme për blerje nga fermeri	TVSH	Data e lidhjes së akt marrëveshjes	Data e dorëzimit të akt marrëveshjes në DRT Fier																										
1	L....7N	294,336	17,660	28.04.2020	04.05.2020																										
2	L...4O	158,784	9,527	28.04.2020	04.05.2020																										
TOTALI		453,120	27,187																												
TVSH	27,187 Lekë																														
Gjobë (20%)	5,437 Lekë																														
Total detyrimi	32,624 Lekë																														
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115, UMF nr.19 datë 03.11.2014 Neni 8 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.																														
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumë n 406.740 Lekë .																														
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, UMF nr.19 datë 03.11.2014 dhe manuali i Kontrollit Tatimor.																														
Rëndësia:	E lartë.																														
Rekomandimi:	DRT Fier të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit																														

tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të konstatuara nga ana jonë.

Titulli gjetjes:	Diferenca në lidhjen Faturë-Libër-FDP, shitje malli nën kosto, vonesë në hedhjen e dokumenteve në C@TS, mos zbatim të plotë të pikave të program kontrollit.																																																																																																																																																																																
Situata:	<p>Subjekti “A...”, me NIPT L..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit në DRTF J.H, bazuar në njoftimet e kontrollit nr.14383, datë 17.09.2019 dhe nr.14383/1, datë 03.12.2019, konfirmuar nga subjekti në datë 06.12.2019 dhe programit të kontrollit nr.14383/2, datë 03.12.2019, për TVSH-në për periudhën 2017.10-2019.07, për Tatim Fitimin për periudhën 2017-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2017.10-2019.07. Kontrolli ka filluar në datë 06.12.2019, ndërkohë që nga DPT, sipas F4, ishte planifikuar për në Shtator 2019, pra afërsisht 3 muaj me vonesë. Raporti përfundimtar i kontrollit është evaduar me shkresën nr.14383/4, datë 20.02.2020 sëbashku me Njoftim Vlerësimin Tatimor 14383/5, datë 20.02.2020 me vonesë prej 4 dite kalendarike. Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 06.12.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 13.12.2019, pra afërsisht 1 javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (procesverbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”. Nga inspektori nuk është bërë një analizë e thelluar e veprimtarisë së subjektit dhe nuk është bërë ndarja e aktiviteteve, pasi nga objekti i aktivitetit si dhe nga analizimi i inventarit, rezulton se subjekti nuk kryen tregti vetëm me produkte ushqimore siç është cilësuar në raportin e kontrollit, por ka dhe materiale ndërtimi. Gjithashtu në analizën e klienteve që është bërë ndodhet edhe subjekti “Mb17 Ndërtim” me NIPT L..... me aktivitet në fushën e ndërtimit.</p> <p style="text-align: center;"><i>Per periudhen: 01/01/2018 deri: 31/12/2018</i></p> <table border="1" data-bbox="657 1375 1433 1800"> <thead> <tr> <th>Kartela</th> <th>Emertimi</th> <th>Njesia</th> <th>Hyrje</th> <th>Dalje</th> <th>Gjendje</th> <th>Cmimi Mes</th> <th>Vlefte</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>01</td><td>banane</td><td>kuti</td><td>125,130.00</td><td>115,674.00</td><td>9,456.00</td><td>1,456.45</td><td>13,772,185.24</td></tr> <tr><td>04</td><td>hudher</td><td>kg</td><td>49,640.00</td><td>41,989.00</td><td>7,651.00</td><td>131.98</td><td>1,009,777.87</td></tr> <tr><td>08</td><td>Limon</td><td>kg</td><td>29,432.60</td><td>29,027.89</td><td>404.71</td><td>33.35</td><td>13,496.33</td></tr> <tr><td>10</td><td>Molle</td><td>kg</td><td>9,510.20</td><td>9,136.19</td><td>374.01</td><td>16.49</td><td>6,169.09</td></tr> <tr><td>11</td><td>Dardhe</td><td>kg</td><td>7,763.60</td><td>7,210.25</td><td>553.35</td><td>50.00</td><td>27,668.08</td></tr> <tr><td>12</td><td>Avokado</td><td>kg</td><td>6,244.20</td><td>5,615.10</td><td>629.10</td><td>216.58</td><td>136,249.76</td></tr> <tr><td>13</td><td>Patate e embel</td><td>kg</td><td>1,239.00</td><td>1,039.35</td><td>199.65</td><td>125.00</td><td>24,955.55</td></tr> <tr><td>14</td><td>Ananas</td><td>kg</td><td>19,010.00</td><td>18,595.01</td><td>414.99</td><td>82.91</td><td>34,408.20</td></tr> <tr><td>15</td><td>Xhinxher</td><td>kg</td><td>3,012.50</td><td>2,827.00</td><td>185.50</td><td>152.15</td><td>28,224.34</td></tr> <tr><td>17</td><td>Rrush</td><td>kg</td><td>934.80</td><td>934.70</td><td>0.10</td><td>307.30</td><td>30.73</td></tr> <tr><td>18</td><td>Domate</td><td>kg</td><td>4,623.80</td><td>3,484.80</td><td>1,139.00</td><td>81.56</td><td>92,896.89</td></tr> <tr><td>22</td><td>Portokalle</td><td>kg</td><td>3,324.00</td><td>2,689.00</td><td>635.00</td><td>25.00</td><td>15,875.00</td></tr> <tr><td>29</td><td>PANEL SANDWIC</td><td>m2</td><td>8,062.42</td><td>7,492.58</td><td>569.84</td><td>1,167.07</td><td>665,045.71</td></tr> <tr><td>30</td><td>PANEL SANDWIC</td><td>m2</td><td>1,186.80</td><td>1,186.60</td><td>0.20</td><td>2,297.35</td><td>459.47</td></tr> <tr><td>31</td><td>POLIKARBONAT</td><td>m2</td><td>50.00</td><td>36.00</td><td>14.00</td><td>1,366.67</td><td>19,133.33</td></tr> <tr><td>32</td><td>KULMORE</td><td>COPE</td><td>100.00</td><td>92.00</td><td>8.00</td><td>454.76</td><td>3,638.10</td></tr> <tr><td>33</td><td>KENDE PVC</td><td>ML</td><td>150.00</td><td>100.00</td><td>50.00</td><td>205.83</td><td>10,291.66</td></tr> <tr><td>34</td><td>PROFILE LLAMAR</td><td>ML</td><td>300.00</td><td>253.00</td><td>47.00</td><td>254.17</td><td>11,945.83</td></tr> <tr><td>36</td><td>MANDARINE</td><td>KG</td><td>52,800.00</td><td>49,286.00</td><td>3,514.00</td><td>112.14</td><td>394,048.89</td></tr> <tr><td>37</td><td>VIDA</td><td>COPE</td><td>10,980.00</td><td>0.00</td><td>10,980.00</td><td>8.74</td><td>95,958.71</td></tr> <tr><td>38</td><td>ARRE KOKOSI</td><td>KG</td><td>270.00</td><td>119.40</td><td>150.60</td><td>138.38</td><td>20,840.39</td></tr> </tbody> </table> <p>Për këtë subjekt është bërë kontrolli kronologjik i blerjeve dhe lidhja faturë-libër-FDP për vitin 2018. Nuk është bërë kontrolli kronologjik i blerjeve të importit faturë-libër-FDP për vitin 2018. Në raportin e kontrollit është shënuar totali importve për vitin 2018 bazuar në FDP 262,601,960 Lekë. Ndërkohë në librat e blerjes të deklaruara nga subjekti totali importeve për vitin 2018 është 240,892,753 Lekë. Kemi një diferencë prej 21,709,207 Lekë në libër blerje për import me</p>	Kartela	Emertimi	Njesia	Hyrje	Dalje	Gjendje	Cmimi Mes	Vlefte	01	banane	kuti	125,130.00	115,674.00	9,456.00	1,456.45	13,772,185.24	04	hudher	kg	49,640.00	41,989.00	7,651.00	131.98	1,009,777.87	08	Limon	kg	29,432.60	29,027.89	404.71	33.35	13,496.33	10	Molle	kg	9,510.20	9,136.19	374.01	16.49	6,169.09	11	Dardhe	kg	7,763.60	7,210.25	553.35	50.00	27,668.08	12	Avokado	kg	6,244.20	5,615.10	629.10	216.58	136,249.76	13	Patate e embel	kg	1,239.00	1,039.35	199.65	125.00	24,955.55	14	Ananas	kg	19,010.00	18,595.01	414.99	82.91	34,408.20	15	Xhinxher	kg	3,012.50	2,827.00	185.50	152.15	28,224.34	17	Rrush	kg	934.80	934.70	0.10	307.30	30.73	18	Domate	kg	4,623.80	3,484.80	1,139.00	81.56	92,896.89	22	Portokalle	kg	3,324.00	2,689.00	635.00	25.00	15,875.00	29	PANEL SANDWIC	m2	8,062.42	7,492.58	569.84	1,167.07	665,045.71	30	PANEL SANDWIC	m2	1,186.80	1,186.60	0.20	2,297.35	459.47	31	POLIKARBONAT	m2	50.00	36.00	14.00	1,366.67	19,133.33	32	KULMORE	COPE	100.00	92.00	8.00	454.76	3,638.10	33	KENDE PVC	ML	150.00	100.00	50.00	205.83	10,291.66	34	PROFILE LLAMAR	ML	300.00	253.00	47.00	254.17	11,945.83	36	MANDARINE	KG	52,800.00	49,286.00	3,514.00	112.14	394,048.89	37	VIDA	COPE	10,980.00	0.00	10,980.00	8.74	95,958.71	38	ARRE KOKOSI	KG	270.00	119.40	150.60	138.38	20,840.39
Kartela	Emertimi	Njesia	Hyrje	Dalje	Gjendje	Cmimi Mes	Vlefte																																																																																																																																																																										
01	banane	kuti	125,130.00	115,674.00	9,456.00	1,456.45	13,772,185.24																																																																																																																																																																										
04	hudher	kg	49,640.00	41,989.00	7,651.00	131.98	1,009,777.87																																																																																																																																																																										
08	Limon	kg	29,432.60	29,027.89	404.71	33.35	13,496.33																																																																																																																																																																										
10	Molle	kg	9,510.20	9,136.19	374.01	16.49	6,169.09																																																																																																																																																																										
11	Dardhe	kg	7,763.60	7,210.25	553.35	50.00	27,668.08																																																																																																																																																																										
12	Avokado	kg	6,244.20	5,615.10	629.10	216.58	136,249.76																																																																																																																																																																										
13	Patate e embel	kg	1,239.00	1,039.35	199.65	125.00	24,955.55																																																																																																																																																																										
14	Ananas	kg	19,010.00	18,595.01	414.99	82.91	34,408.20																																																																																																																																																																										
15	Xhinxher	kg	3,012.50	2,827.00	185.50	152.15	28,224.34																																																																																																																																																																										
17	Rrush	kg	934.80	934.70	0.10	307.30	30.73																																																																																																																																																																										
18	Domate	kg	4,623.80	3,484.80	1,139.00	81.56	92,896.89																																																																																																																																																																										
22	Portokalle	kg	3,324.00	2,689.00	635.00	25.00	15,875.00																																																																																																																																																																										
29	PANEL SANDWIC	m2	8,062.42	7,492.58	569.84	1,167.07	665,045.71																																																																																																																																																																										
30	PANEL SANDWIC	m2	1,186.80	1,186.60	0.20	2,297.35	459.47																																																																																																																																																																										
31	POLIKARBONAT	m2	50.00	36.00	14.00	1,366.67	19,133.33																																																																																																																																																																										
32	KULMORE	COPE	100.00	92.00	8.00	454.76	3,638.10																																																																																																																																																																										
33	KENDE PVC	ML	150.00	100.00	50.00	205.83	10,291.66																																																																																																																																																																										
34	PROFILE LLAMAR	ML	300.00	253.00	47.00	254.17	11,945.83																																																																																																																																																																										
36	MANDARINE	KG	52,800.00	49,286.00	3,514.00	112.14	394,048.89																																																																																																																																																																										
37	VIDA	COPE	10,980.00	0.00	10,980.00	8.74	95,958.71																																																																																																																																																																										
38	ARRE KOKOSI	KG	270.00	119.40	150.60	138.38	20,840.39																																																																																																																																																																										

FDP.

Deklarime të subjektit për blerje nga importi, në shumën 262,601,960 Lekë dhe deklarata doganore në shumën 263,116,346 Lekë. Diferenca midis deklaratës doganore dhe deklarimit të subjektit në shumën 514,386 Lekë. Nga kjo, diferenca prej 387,600 Lekë është llogaritur nga inspektori në raportin e kontrollit, mbetet për tu llogaritur diferenca 126,786 Lekë. Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektin lindin detyrimet si vijojnë:

Detyrim TVSH	126,786 x 20% =	25,357 Lekë
Gjobë TVSH (0.06%/ditë)		5,553 Lekë
Detyrimi		30,910 Lekë

Detyrim TF	126,786 x 15% =	19,017 Lekë
Gjobë TF (0.06%/ditë)		4,164 Lekë
Detyrimi		23,181 Lekë + 30,910 Lekë

Tot. 54,091 Lekë

Për periudhën 01.2019-07.2019 totali i blerjeve nga furnitorë vendas sipas FDP dhe librave të blerjes është 16,554,589 Lekë dhe TVSH e zbritshëm në shumën 3,310,918 Lekë, ndërsa në raportin e kontrollit është mbledhur totali gabimisht në vlerën 13,633,879 Lekë dhe TVSH të zbritshëm për shumën 2,726,776 Lekë.

Për periudhën Maj 2019 për blerjet nga importi është nxjerr diferenca e TVSH në vlerën 113,445 Lekë nga inspektori por nuk janë llogaritur detyrimet.

Detyrim TVSH	567,225 x 20% =	113,445 Lekë
Gjobë TVSH (0.06%/ditë)		24,845 Lekë
Detyrimi		138,290 Lekë

Detyrim TF	567,225 x 15% =	85,084 Lekë
Gjobë TF (0.06%/ditë)		18,634 Lekë
Detyrimi		103,718 Lekë + 138,290 Lekë

Tot. 242,008 Lekë

Për periudhën 01.2019-07.2019 totali i blerjeve nga furnitorë vendas sipas FDP dhe librave të blerjes është 16,554,589 Lekë dhe TVSH e zbritëshme në shumën 3,310,918 Lekë, ndërsa në raportin e kontrollit është shënuar 13,633,879 Lekë dhe TVSH të zbritëshme për shumën 2,726,776 Lekë.

Për periudhën Mars 2019 blerjet nga importi janë në vlerën e tatueshme 41,913,935 Lekë me TVSH 8,382,787 Lekë, të deklaruara në libër blerje dhe FDP nga subjekti, ndërsa në raportin e kontrollit janë vendosur në vlerën e tatueshme 41,861,955 Lekë me tvsh 8,372,391 Lekë. Diferenca në TVSH është 10,396 Lekë, nuk është përmendur nga inspektori në raport.

Nga analiza e bilancit të lëvizjes së materialeve për periudhën 01.01.2019 deri më 31.07.2019 konstatohet se për artikullin hudhër çmimi i shitjes është nën kosto, analitikisht paraqitet sipas tabelës:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasi	01.01.19 çmim	hyrje Sasi	çmim bler	dalje Sasi	çmim shitje	Gjk. 31.07.19 Sasi	çmim	Kon tr. 31.0 7.19	dif Sas i
1	Banane	kuti	9456	1456.45	91922	1610	95528	1794	5850	1493	5850	0
2	Hudhër	kg	51	131.98	77000	155	53101	159	31550	165	31550	0
3	Patate e	kg	199.65	125	180	154	324	177	55.65	144	55.65	0

	embël									5																												
	<p>Kosto 165 Lekë, çmimi i shitjes 159 Lekë nga sa konstatohet subjektit do ti rivlersohet çmimi i shitjes me % e vlerës së shtuar referuar mesatares së artikujve të analizuar nga vetë inspektori, e cila rezulton në vlerën 113 %. Për diferencën (165 * 13 %) = 21,4 Lekë. Kështu, produkti hudhër është shitur me çmimin 159 Lekë: 53101 x 159 = 8,443,059 Lekë, ndërkohë që duhej shitur me çmimin 53101x186.4 = 9,898,026 Lekë. Për këtë na lind diferenca prej 1,454,967 Lekë dhe në zbatim të nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, subjektit i lindin detyrimet si vijonë:</p> <table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 50%;">Detyrim TVSH</td> <td style="width: 30%;">1,454,967x 20% =</td> <td style="width: 20%;"></td> </tr> <tr> <td>290,993 Lekë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Gjobë TVSH (100%)</td> <td></td> <td style="text-align: right;">290,993 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Detyrimi</td> <td></td> <td style="text-align: right;">581,986 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Detyrim TF</td> <td>1,454,967x 15% =</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Gjobë TF (100%)</td> <td></td> <td style="text-align: right;">218,245 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Detyrimi</td> <td></td> <td style="text-align: right;">436,490 Lekë</td> </tr> <tr> <td>+</td> <td></td> <td style="text-align: right;">581,986 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Tot. 1,018,476 Lekë</td> <td></td> <td></td> </tr> </table> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi J.H, në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF, E.XH në cilësinë e P/Sektorit të kontrollit, në DRTF. dhe B.S, në cilësinë e Dr/Drejtorisë së Kontrollit, në DRTF.</p>											Detyrim TVSH	1,454,967x 20% =		290,993 Lekë			Gjobë TVSH (100%)		290,993 Lekë	Detyrimi		581,986 Lekë	Detyrim TF	1,454,967x 15% =		Gjobë TF (100%)		218,245 Lekë	Detyrimi		436,490 Lekë	+		581,986 Lekë	Tot. 1,018,476 Lekë		
Detyrim TVSH	1,454,967x 20% =																																					
290,993 Lekë																																						
Gjobë TVSH (100%)		290,993 Lekë																																				
Detyrimi		581,986 Lekë																																				
Detyrim TF	1,454,967x 15% =																																					
Gjobë TF (100%)		218,245 Lekë																																				
Detyrimi		436,490 Lekë																																				
+		581,986 Lekë																																				
Tot. 1,018,476 Lekë																																						
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.																																					
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumë n 1.314.575 Lekë .																																					
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.																																					
Rëndësia:	E lartë.																																					
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.																																					

Titulli gjetjes:	Diferenca në lidhjen Faturë-Liber-FDP, vonesë në hedhjen e dokumenteve në C@TS, mos zbatim të plotë të pikave të program kontrollit, diferenca në bilancin material.
Situata:	<p>Subjekti “A.D”, me NIPT L.....</p> <p>Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:</p> <p>Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim në datë 11.04.2019, për shumën 1,959,733 Lekë, kërkesë e përcjellë në DRT Fier nga DPT me shkresën nr.7766/1, datë 03.05.2009. DRT ka planifikuar kryerjen e kontrollit në muajin qershor 2019.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit E.F bazuar në njoftimin e kontrollit nr.7051/1, datë 21.05.2019 dhe nr.14383/1, konfirmuar nga tatimpaguesi dhe programit të kontrollit nr.7051/2, datë 21.05.2019, për TVSH-në për periudhën 2018.04-2019.03. Parashikuar për kontroll 40 orë(5 ditë) nga data e fillimit të kontrollit (27.05.2019), nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt të inspektorit të kontrollit është deri datë 31.05.2019. Sipas Ligjit Nr.9920. datë 19.05.2008 “Per Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datën 07.06.2019. Kontrolli ka filluar në datë 27.05.2019, dhe Projekt Raporti Kontrollit mban datën 27.06.2019, hartuar me 20 ditë vonesë. Raporti kontrollit është</p>

	<p>dërguar te tatimpaguesi me shkresën përcjellëse nr.7051/3, datë 27.06.2019 brenda afateve.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 27.05.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 20.06.2018, pra afërsisht 5 javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.</p> <p>Në raport nuk është evidentuar, gjendja kreditore e mbartur nga periudha Mars 2018 (periudhë para periudhës objekt kontrolli), kërkesë kjo e Nenit 77 të Ligjit nr.92/2014, datë 27.04.2014, i ndryshuar ku citohet:“Personi i tatuëshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas kërkesave të pikave 2 dhe 3 të nenit 76 të këtij ligji”. Gjithashtu nuk është argumentuar dhe nuk është evidentuar sa është TVSH-ja kreditore si rrjedhojë e gjendjes së mallrave, sa është TVSH-ja kreditore si rrjedhojë e shërbimeve e mallrave të konsumuara.</p> <p>Nga analiza e bilancit material të hartuar nga inspektori dhe kryqëzimi i të dhënave të tij me inventarin e datës 31.12.2018 të paraqitur nga inspektori pas kërkesës së bërë dhe bilancit të vitit 2018 rezultoi si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="367 728 1388 918"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Nr.</th> <th rowspan="2">Emërtimi</th> <th colspan="2">Bilanci</th> <th rowspan="2">Bilanci i vitit 2018</th> <th rowspan="2">Diferenë</th> </tr> <tr> <th>Material 31.12.2018</th> <th>Inventari datë 31.12.2018</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>Mallra</td> <td>1,496,630</td> <td>1,259,477</td> <td>1,259,477</td> <td>237,153</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për sa më sipër për subjektin lindin detyrime në zbatim të nenit 124 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabarte me 100% të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonësave që llogariten dhe paguhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore. Kështu:</p> <table border="1" data-bbox="446 1108 1388 1366"> <tbody> <tr> <td>Detyrim TVSH</td> <td>237,153 x 20% =</td> <td>47,430 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Gjobë TVSH (100% e detyrimit)</td> <td></td> <td>47,430 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Detyrim TF</td> <td>237,153 x 15% =</td> <td>35,573 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Gjobë TF (100% e detyrimit)</td> <td></td> <td>35,573 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Detyrimi</td> <td></td> <td>166,006 Lekë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nuk është bërë kontrolli kronologjik i blerjeve dhe lidhja faturë-libër-FDP për vitin 2018. Në raportin e kontrollit sipas librave për periudhën Maj 2018, blerje të përjashtuara është shënuar në vlerën 6400 Lekë, ndërsa sipas FDP të deklaruara nga subjekti dhe korrigjimi i bërë në sistem nga inspektori, totali i blerjeve të përjashtuara për këtë periudhë Maj 2018 janë në vlerën 0 Lekë. Kemi një diferencë prej 6400 Lekë libër blerje me FDP. Këto diferenca nuk janë trajtuar nga inspektori në raportin e kontrollit.</p>	Nr.	Emërtimi	Bilanci		Bilanci i vitit 2018	Diferenë	Material 31.12.2018	Inventari datë 31.12.2018		Mallra	1,496,630	1,259,477	1,259,477	237,153	Detyrim TVSH	237,153 x 20% =	47,430 Lekë	Gjobë TVSH (100% e detyrimit)		47,430 Lekë	Detyrim TF	237,153 x 15% =	35,573 Lekë	Gjobë TF (100% e detyrimit)		35,573 Lekë	Detyrimi		166,006 Lekë
Nr.	Emërtimi			Bilanci				Bilanci i vitit 2018	Diferenë																					
		Material 31.12.2018	Inventari datë 31.12.2018																											
	Mallra	1,496,630	1,259,477	1,259,477	237,153																									
Detyrim TVSH	237,153 x 20% =	47,430 Lekë																												
Gjobë TVSH (100% e detyrimit)		47,430 Lekë																												
Detyrim TF	237,153 x 15% =	35,573 Lekë																												
Gjobë TF (100% e detyrimit)		35,573 Lekë																												
Detyrimi		166,006 Lekë																												
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124, Ligji nr.92/2014, datë 27.04.2014, i ndryshuar Neni 44,77 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.																													
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumën 1.450.442 Lekë.																													
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124, Ligji nr.92/2014, datë 27.04.2014, i ndryshuar Neni 44/77 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.																													
Rëndësia:	E lartë.																													
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF konform legjislacionit në fuqi, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.																													

Për sa është trajtuar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.9253/102, datë 25.08.2021 “Për Projektraportin” ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1... në lidhje me vlerësimin e parë, ju sqarojmë se diferenca është 237,153 Lekë dhe jo në shumën 432.534 Lekë, ku detyrimi për këtë diferencë(237,153 Lekë) përlllogaritet në shumën 166,006 Lekë.

2. ... mos analiza e kostos së mallrave të importit sqarohet se: në tabelën e kontrollit janë pasqyruar vetëm të dhënat e deklaratave doganore si fatura e hyrjes si dhe pagesa që bënë subjekti në doganë për TVSH për efekt të marrjes parasysht të kreditimit të TVSH në import. Këto mallra nuk janë objekt shitje, por qëllimi i tyre është rritja dhe barshtimi i tyre për prodhim qumështi pasi janë me vlera racore. Gjithashtu, këto importe janë shqyrtuar për efekt rakordimi të TVSh-së së paguar pasi janë pjesë e rimburimit të tyre, bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe dokumentacion shtesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Argumentat dhe dokumentacionet shtesë të paraqitura nga ana juaj për këtë pikë merren në konsideratë.

2. Argumentat dhe dokumentacionet shtesë të paraqitura nga ana juaj për këtë pikë merren pjesërisht në konsideratë. Në këtë material nuk janë trajtuar të gjitha pikat sipas manualit të kontrollit. Në lidhje me observacionet që janë marrë në konsideratë, është bërë reflektimi në raport.

Titulli gjetjes:	Program kontrolli i ndërtuar në kundërshtim me F4 të DPT.													
Situata:	<p>Subjekti “G...”, me NIPT L..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim në datë 09.05.2018 (nr.8639 prot., datë 11.05.2018 të DRT Fier), për shumën 6,895,556 Lekë, për periudhën 2017/09-2018/03, kërkesë e përcjellë në DRT Fier nga DPT me shkresën nr.8731/1, datë 09.05.2018. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit G.LL, bazuar në njoftimin e kontrollit nr.8639/1, prot., datë 17.05.2018 dhe konfirmuar nga tatimpaguesi nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura më datë 18.05.2018, dhe Programit të Kontrollit nr.8639/2, dtaë 17.05.2018. Programi i kontrollit ka tejkaluar kërkesën e DPT në lidhje me periudhën objekt kontrolli dhe llojin e kontrollit të ushtruar, si vijon:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th></th> <th style="text-align: center;">DPT</th> <th style="text-align: center;">DRTF</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Periudha</td> <td style="text-align: center;">2017/09-2018/03</td> <td style="text-align: center;">2015/10-2018/03</td> </tr> <tr> <td>Lloji kontrollit</td> <td style="text-align: center;">TVSH</td> <td style="text-align: center;">TVSH,TF 2015-2017, Sig.Shoq</td> </tr> <tr> <td>Orët e parashikuara</td> <td style="text-align: center;">24</td> <td style="text-align: center;">120</td> </tr> </tbody> </table> <p>Raporti përfundimtar i kontrollit është evaduar me Njoftim Vlerësimin Tatimor 8639/5, datë 25.06.2018 brenda afateve ligjore. Me shkresën nr.8639/4, datë 25.06.2018 është njoftuar DPT për shumën që do të rimbursohet.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 18.05.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 11.06.2018, pra afërsisht 3 javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.</p> <p>Nga ana e inspektorit janë rivlerësuar në ulje blerjet për periudhën 2018/03 duke ulur gjëndjen kreditore në shumën 224,748 Lekë, për blerje materialesh që nuk janë në përputhje me aktivitetin që kryen subjekti.</p>			DPT	DRTF	Periudha	2017/09-2018/03	2015/10-2018/03	Lloji kontrollit	TVSH	TVSH,TF 2015-2017, Sig.Shoq	Orët e parashikuara	24	120
	DPT	DRTF												
Periudha	2017/09-2018/03	2015/10-2018/03												
Lloji kontrollit	TVSH	TVSH,TF 2015-2017, Sig.Shoq												
Orët e parashikuara	24	120												

	Sipas librave të deklaruara nga subjekti dhe FDP, blerjet nuk janë paraqitur në rubrikën totali blerjeve për investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%, por në rubrikën totali i blerjeve nga furnitorë vendas me shkallë 20%. Në raport thuhet se të gjitha shpenzimet për vitin 2018 janë për investim. Gjithashtu edhe FDP-të e ndryshuara nga inspektori, me rregullimet përkatëse ku është bërë sistemimi i situatës pas rivlerësimit në ulje të TVSH, blerjet nuk janë shënuar në investime. Situata paraqitet si më poshtë:				
		Sipas raport kontrollit	Sipas Librave të Blerjes	Sipas FDP nga Subjekti	Sipas FDP nga Inspektori
	Totali blerjeve për investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%	15,800,782			
	Totali i blerjeve të përjashtuara		100	100	1,348,589
	Totali i blerjeve nga furnitorë vendas me shkallë 20%		16,300,782	16,300,782	15,177,041
	Totali importeve të investimit me TVSH 20%	765,040	765,040	765,040	765,040
totali i blerjeve me TVSH	16,565,822	17,065,822	17,065,822	15,942,081	
Sipas FDP-ve të deklaruara nga inspektori, totali i blerjeve të përjashtuara është 1,348,589 Lekë. Totali i blerjeve nga furnitorë vendas me shkallë 20% është 15,177,041 Lekë me TVSH 3,035,408 Lekë dhe totali i importeve të investimit është 7,695,040 Lekë me TVSH 153,008 Lekë. Inspektori ka bërë kontroll edhe për periudhën 2015/10 dhe 2016/10 dhe 2017/10. Nga periudha Tetor 2015-Nëntor 2016, subjekti nuk ka deklaruar asnjë libër blerje dhe shitje, vetëm FDP e TVSH -së.					
Kriteri:	Manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.				
Ndikimi:	Mos zbatimi i Manualit dhe Ligjit “Për procedurat Tatimore”, me pasojë parregullsi në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, nuk ka efekte financiare.				
Shkaku:	Mos zbatim i manualit të Kontrollit Tatimor, Kap.2.				
Rëndësia:	E mesme.				
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRT Fier që në hartimin e Njoftimit Kontrollit Tatimor/Programit të përcaktohet periudha e kontrollit e cila të përputhet me F4 ardhur nga DPT.				

Subjekti “I.F” Sh.a, me NIPT J....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti “I.F” sh.a me Nipt J.... është regjistruar në organet tatimore në datë 30.10.1997. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është “Ndërtimi i fabrikës së foragjereve, prodhimi dhe tregtimi (shitje me shumicë dhe pakicë) i foragjereve plotësuese, koncentrate, vitamina etj. Tregtimi i lëndëve të para (miell peshku, miell mishi, a inoksin, drithëra, krunde, pite pambuku dhe produkte të tjera të kësaj natyre).Tregtim i pajisjeve dhe instalimi i mullinjve cilindrik, fabrikave të foragjereve, thertoreve, sillos drithërash dhe produkteve të tjera të këtij lloji. Krijimi i linjave të foragjereve dhe tregtimi i kafshëve dhe vezëve (pularive, rritjes së derrave dhe të gjedhit)”. Adresa e Aktivitetit: Fier, fshati Portez, rruga Fier-Berat, banesa në KM 2.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 09.10.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 14.11.2019, pra më shumë se 1 muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit V.R, bazuar në njoftimet e kontrollit nr.14385/1, date 08.10.2019, konfirmuar nga subjekti në datë 09.10.2019 si dhe programit të kontrollit nr.14385/2, datë 08.10.2019, për TVSH-në për periudhën 2017.07-2019.07, për Tatim Fitimin për periudhën 2017-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2017.07-2019.07. Njoftimi për kontroll është bërë në datën 08.10.2019 dhe kontroll duhej të fillonte në datë 18.10.2019. në fakt kontrolli ka filluar në datë 09.10.2019, brënda afateve ligjore. Parashikuar për kontroll 230

orë (29 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qendrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri datë 18.11.2019. Sipas Ligjit Nr.9920. datë 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datën 25.11.2019. Projekt Raporti kontrollit është dërguar te tatimpaguesi me shkresën përcjellese nr.14385/3, datë 20.11.2019 brenda afateve ligjore. Raporti përfundimtar i kontrollit duhej të përgatitej brenda datës 29.12.2019. Në fakt Raporti përfundimtar i kontrollit është evaduar me shkresën nr.14385/4, datë 24.12.2019 sëbashku me Njoftim Vlerësimin Tatimor nr.14385/5, datë 24.12.2019, brenda afateve ligjore.

Titulli gjetjes:	Nuk është zbatuar programi, nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit si dhe vonesa në hedhjen e dokumenteve në C@TS.						
Situata:	<p>Subjekti “N.U”, me NIPT K.... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit O.D, bazuar në njoftimet e kontrollit nr.16964/1, datë 21.01.2019, konfirmuar nga subjekti në datë 21.01.2019 si dhe Programit kontrolli nr.16964/2, datë 21.01.2019, për TVSH-në për periudhën 2016.09-2018.08, për Tatim Fitimin për periudhën 2016-2017, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2016.09-2018.08. Ky subjekt, sipas planifikimit të ardhur nga DPT, duhej të kontrollohej në muajin Tetor 2018, në fakt njoftimi për kontroll është bërë në datë 21.01.2019, pra afro 3 muaj më vonë se plani i vendosur nga DPT. Parashikuar për kontroll 208 orë(26 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qendrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri datë 25.02.2019. Sipas Ligjit Nr.9920. date 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datën 03.04.2018. Projekt Raporti kontrollit është dërguar te tatimpaguesi me shkresën përcjellese nr.16964/3, datë 04.03.2019 brenda afateve ligjore Raporti përfundimtar i kontrollit është evaduar me shkresën nr.16964/4, datë 02.04.2019 sëbashku me Njoftim Vlerësimin Tatimor nr.16964/5, datë 02.04.2019 me vonesë prej 5 ditë kalendarike. Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i perkasin muajit Janar 2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në Mars 2019, pra 2 muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”. Nga Shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se nuk janë ndërtuar bilance material për periudhat 2016.09-2016.12 dhe 2018.01-2018.08. Argumentimi i dhënë nga inspektori se: “Bërja e bilancit material për vitin 2018 është e pamundur, pasi inventari fizik është i datës 11.11.2018”, nuk qëndron. Nuk ka argumentim të tepricës kreditore. Nuk ka analizë për klientët dhe furnitorët. Nuk është bërë kontrolli kronologjik i shitjeve dhe lidhja faturë-libër-FDP. Nuk ka analizë për TVSH, kërkesë kjo e programit. Nuk ka analizë kostoje për vitin 2016. Nga krahasimi i të ardhurave të deklaruara në bilanc me të ardhurat të deklaruara në sistemin tatimor C@TS për vitin 2017, rezulton një diferencë në shumën 216,000 Lekë, deklaruar më pak të ardhura për në bilanc, si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Bilanci 2017</th> <th>STI 2017</th> <th>Diferenca</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>270,118,365</td> <td>270,334,365</td> <td>(216,000)</td> </tr> </tbody> </table> <p>Kjo diferencë nuk është trajtuar nga inspektori në raportin e kontrollit. Por është sqaruar nga subjekti në shkresën datë 03.07.2018 në DRT Fier, ku thuhet se kjo diferencë konsiston në parapagime për blerje mallrash me faturat nr.44,974,322, datë 07.01.2017 me vlerë totale 126,180 Lekë dhe fatura nr.4,946,968 me vlerë totale me TVSH në shumën 133,020 Lekë. Këto të ardhura nuk janë quajtur si të ardhura në vitin ushtimor 2017.</p>	Bilanci 2017	STI 2017	Diferenca	270,118,365	270,334,365	(216,000)
Bilanci 2017	STI 2017	Diferenca					
270,118,365	270,334,365	(216,000)					
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, manuali i Kontrollit Tatimor.						
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, nuk ka efekte financiare.						

Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E lartë .
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF konform legjislacionit në fuqi, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.

Titulli gjetjes:	Procesverbalet nuk janë hedhur në sistemin tatimor C@TS sipas Manualit të Kontrollit.
Situata:	<p>Subjekti “O”, me NIPT L....</p> <p>Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim në DPT me shkresën nr.7 prot., datë 28.01.2019, për shumën 22,477,144 Lekë , kërkesë e përcjellë në DRT Fier nga DPT me shkresën nr.2143/2, datë 07.02.2019, prot., në DRT Fier me nr.2242, datë 11.02.2019.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 15.02.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 05.03.2019, pra afërsisht 3 javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (procesverbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit B.H, bazuar në njoftimin e kontrollit nr.2242/1, datë 15.02.2019, konfirmuar nga tatimpaguesi në datë 15.02.2019 dhe programit të kontrollit nr.2242/2, datë 15.02.2019, për TVSH-në për periudhën 2017.05-2018.12. Parashikuar për kontroll 84 orë (11 ditë) nga data e fillimit të kontrollit (15.02.2019), pra afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 01.03.2019. Në zbatim të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datë 08.03.2019. Kontrolli ka filluar në datë 15.02.2019 dhe projekt raporti i kontrollit mban datën 28.02.2019, dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse nr.2242/3, datë 06.03.2019, hartuar brenda afateve ligjore. Raporti përfundimtar i kontrollit mban datën 13.03.2019 dhe është evaduar me njoftim vlerësimin tatimor nr.2242/5, datë 13.03.2019, brenda afateve që përcakton ligji. Me shkresë n nr.2242/6, datë 18.03.2019 është njoftuar DPT për shumën që do të rimbursohet.</p> <p>Janë verifikuar likuidimet kundrejt fermerëve, nga ku rezulton diferencë e pa likuiduar në shumën 2,128,676 Lekë, por inspektori nuk i ka detajuar se cilët fermerë nuk janë likuiduar.</p>
Kriteri:	Manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë hedhur procesverbalet në afat, nuk ka efekte financiare.
Shkaku:	Mos zbatim i manualit të Kontrollit Tatimor, Kap.2.
Rëndësia:	E ulët.
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRT Fier që hedhja në sistemin tatimor C@TS, e dokumentave dhe procesverbaleve nga ana e inspektorëve, të bëhet brenda afateve të përcaktuara.

Subjekti “A”, me NIPT L.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Referuar shkresës nr.1732/2 prot., datë 09.02.2018 të DPT, (nr.2692prot., datë 15.02.2018 të DRT. Fier), “Dërgohet shkresë për veprim”, i kërkohet DRT Fier kontroll për periudhën 2016/05-2017/12, për efekt të kërkesës së subjektit për rimbursim TVSH-je në vlerën 3,151,308 Lekë. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.G, bazuar në njoftim kontrollin nr.2692/1 prot., datë 19.03.2018, si dhe programit të kontrollit nr.2692/2 prot., datë 19.03.2018, të konfirmuar nga tatimpaguesi nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura më datë 20.03.2018.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 20.03.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 24.04.2018, pra afërsisht një muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS

gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

Kontrolli ka filluar në datë 20.03.2018,, ku janë parashikuar për kontroll 88 orë (11 ditë) nga data e fillimit të kontrollit, nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 03.04.2018. Projekt raporti i kontrollit i përket datës 10.04.2018 dhe është dërguar te tatimpaguesi me shkresën nr.2692/3 prot., datë 18.04.2018, 8 ditë vonesë, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e Nenit neni 83, pika 1, të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në 10.04.2018. Raporti përfundimtar i kontrollit është përcjellë me shkresën nr.2692/4 prot, datë 08.05.2018 dhe është evaduar me njoftim vlerësimin tatimor me nr.2692/5 prot, datë 08.05.2018, brenda afateve, veprim ky, në përputhje me kërkesat e nenit 84, pika 1, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Titulli gjetjes:	Procesverbale të pa hedhur në sistemin tatimor C@TS si dhe konstatuar shpenzime të panjohura.
Situata:	<p>Subjekti “K.J”, me NIPT K..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti është regjistruar në organet tatimore në datë 27.03.2003. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është “Tregtim me shumicë e pakicë e artikujve të ndryshëm ushqimor e industrial, market e supermarket dhe transport me mjet, pije alkolike dhe cigare”. Adresa e Aktivitetit: Fier - Divjakë lagjja nr.2, rruga “20 Janari”, godinë 2 katëshe me nr.pasurie 492/60, zonë kadastrale me Nr.1492, në katine e parë. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.D, bazuar në njoftimin e kontrollit nr.136408/1, datë 15.10.2018, konfirmuar nga tatimpaguesi në datën 16.10.2018 dhe programit të kontrollit nr.13640/2, datë 15.10.2018, për TVSH-në për periudhën 2016.03-2018.06, për Tatim Fitimin për periudhën 2016-2017, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2016.03-2018.06. Ky subjekt, sipas planifikimit të ardhur nga DPT (Formulari 4), duhej të kontrollohej në muajin Gusht 2018, në fakt njoftimi për kontroll është bërë në datë 15.10.2018, pra 45 ditë më vonë se plani i vendosur nga DPT, parashikuar për kontroll 244 orë(31 ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri datë 27.11.2018. Sipas Ligjit Nr.9920. date 19.05.2008 i ndryshuar, Neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datën 05.12.2018. Kontrolli ka filluar në datë 16.10.2018, dhe projekt raporti kontrollit është dërguar te tatimpaguesi me shkresën përcjellese nr.13640/3, datë 10.01.2019, pra me 35 ditë kalendarike me vonesë. Raporti përfundimtar i kontrollit është evaduar me shkresën nr.13640/4, datë 04.02.2019, dhe njoftim vlerësimin tatimor nr.13640/5, datë 04.02.2019 brenda afateve ligjore. Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i perkasin datës 18.10.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 11.12.2018, pra afërsisht dy muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proesverbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”. Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se nuk është zbatuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit. Gjatë rishqyrtimit të raportit të kontrollit nr.13640/4 u konstatua se në periudhën 2017 janë listuar shpenzimet e subjektit dhe janë shënuar bileta udhëtimi në vlerën 81,328</p>

	Lekë, të cilat janë shpenzim i panjohur për subjektin. Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar për subjektin linden detyrime si vijon: Detyrim TF 81,328 x 15% = 12,199 Lekë Gjobë TF (0.06%/365) 2,672 Lekë Detyrimi 14,871 Lekë
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumë n 14.871 Lekë .
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	DRT Fier të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të konstatuara nga ana jonë .

Titulli gjetjes:	Diferenca në bilanc, procesverbalet pa hedhur në sistemin tatimor C@TS.
Situata:	<p>Subjekti “F.A ”, me NIPT L..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezultoi se: Subjekti është regjistruar në organet tatimore në datë 21.04.2016. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është “Grumbullimi, eksporti i frutave-perimeve”. Adresa e aktivitetit: “Fshati “Kafaraj”, Fier. Referuar shkresës nr.1415/1 prot., datë 01.02.2019 të DPT, (nr.1952 prot., datë 04.02.2019 të DRT Fier), “Dergohet shkresë për veprim“, i kërkohet DRT Fier kontroll për periudhën 2018/09-2018/12 për efekt të kërkesës së subjektit për rimbursim TVSH-je në vlerën 8,674,393 Lekë. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit M.U, bazuar në njoftimin e kontrollit nr.1942/1, datë 19.02.2019 si dhe Programit të Kontrollit nr.1942/2, datë 19.02.2019, të konfirmuar nga tatimpaguesi nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura të mbajtura më datë 20.02.2019. Raporti përfundimtar i kontrollit është evaduar me njoftim vlerësimin tatimor 1942/6, datë 13.03.2019 brenda afateve ligjore. Me shkresën nr.1942/5, datë 13.03.2019 është njoftuar DPT për shumën që do të rimbursohet.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 20.02.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 05.03.2019, pra afërsisht dy javë me vonë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (procesverbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.</p> <p>Në një rast, është kryer blerje në shumën 237,068 Lekë, përpara datës së prot. të aktmarrëveshjes në DRT Fier dhe për këtë inspektori ka përlllogaritur detyrim për TVSH në shumën 39,511 Lekë. Në dy raste janë kryer blerje nga fermerë të cilët rezultojnë të çregjistruar që në datë 18.07.2018 dhe në zbatim të Udhëzimit nr.19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësor për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, nga ana e inspektorit janë llogaritur detyrime në vlerën e TVSH në shumën 130,730 Lekë për periudhën 2018/10 dhe 60,170 Lekë për periudhën 2018/11.</p> <p>Në analizën e bilancit material në fund të periudhës Dhjetor 2018 të paraqitur në raport thuhet se gjendja e mallrave në fund është zero, gjithashtu dhe gjendja e ambalazhit është zero. Ndërsa sipas bilancit datë 31.12.2018 në pasqyrën e Aktiveve kemi mallra në gjendje 704,264 Lekë. Për këtë bazuar në Nenin 124, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, rezultoi sa më poshtë:</p> <p style="text-align: right;">Detyrim TVSH 704,264 x 20% = 140,853 Lekë Gjobë TVSH (100% e detyrimit) 140,853 Lekë Detyrimi 281,706 Lekë</p>

	Detyrim TF Gjobë TF (100% e detyrimit) Detyrimi	704,264 x 15% =	105,640 Lekë 105,640 Lekë 211,280 Lekë + 281,706 Lekë
			Tot. 492,986 Lekë
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.		
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumë n 492.986 Lekë .		
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 124 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.		
Rëndësia:	E Lartë.		
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.		

Subjekti “N.A ”, me NIPT L.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti është i regjistruar në organet tatimore në datë 04.11.2014. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është “Eksport fruta-perime”. Adresa e aktivitetit: rruga Lushnje - Fier pranë rotondës së Savrës, zonë kadastrale nr.2087 me pasuri Nr 829/11 9001.

Subjekti ka bërë kërkesë për rimbursim në DPT me shkrsën nr.21 prot., në datën 04.12.2018, për shumën 61,124,141 Lekë, kërkesë e përcjellë në DRT Fier nga DPT me shkresën nr.24406/2, datë 18.12.2018, prot., në DRT Fier me nr.21518, datë 21.12.2018. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit A.H, bazuar në njoftimin e kontrollit nr.21518/1, datë 07.01.2019, konfirmuar nga tatimpaguesi në datën 11.01.2019 dhe programit të kontrollit nr.21518/2, datë 07.01.2019, për TVSH-në për periudhën 2018.04-2018.10. Parashikuar për kontroll 72 orë(9ditë) nga data e fillimit të kontrollit (11.01.2019), nisur nga sa më sipër afati i qendrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri datë 23.01.2019. Sipas Ligjit Nr.9920. date 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e projekt raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datën 30.01.2019. Kontrolli ka filluar në datë 11.01.2019, dhe projekt raporti kontrollit mban datën 20.01.2019, është dërguar te tatimpaguesi me shkresën përcjellese nr.21518/3, datë 29.01.2019 brenda afateve ligjore. Raporti përfundimtar i kontrollit mban datën 30.01.2019 dhe është evaduar me njoftim vlerësimin tatimor nr.21518/6, datë 31.01.2019 brenda afateve ligjore. Me shkresën nr.21518/7, datë 05.02.2019 është njoftuar DPT për shumën që do të rimbursohet.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori nuk janë pasqyruar në sistemin tatimor C@TS, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

Në raport nga ana e inspektorit janë analizuar blerjet nga fermerët, nga ku janë evidentuar dhe përlogaritur detyrime për blerjet përpara datës së prot., të akt marrëveshjes në DRT, janë verifikuar likuidimet kundrejt fermerëve, si dhe është analizuar teprica kreditore. Nga të dhënat e sistemit doganor rezulton se për periudhën 2018.04-2018.10, subjekti “Nendrete Arapi” ka eksportuar mallra në shumën 407,834,310 Lekë, ndërkohë që subjekti deklaroi në librat e shitjes shumën 410,565,411 Lekë eksport. Nga rakordimi rezultoi se kjo diferencë i përket dy faturave të datës 31.10.2018, regjistruar në doganë në datën 01.11.2018 dhe konkretisht: fatura nr.484, datë 31.10.2018, rregjistruar në doganë me R23446, datë 01.11.2018 dhe fatura nr.485, datë 31.10.2018 me nr.rregjistrimi në doganë, R23448, datë 01.11.2018.

Subjekti “S.V”, me NIPT L.....

Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:

Subjekti është i regjistruar në organet tatimore më datë 12.03.2015, me aktivitet “Tregti me shumicë dhe pakicë i fruta - perimeve dhe import-eksport i tyre”, me adresë kryesore: Komuna Gradisht, Lushnje.

Referuar shkresës nr.4325/2 prot., datë 15.03.2019 të DPT, (nr. 3930 prot., datë 19.03.2019 të DRT. Fier), “Dërgohet shkresë për veprim”, i kërkohet DRT Fier kontroll për periudhën 05/2018-12/2018 për efekt të kërkesës së subjektit për rimbursim TVSH-je në vlerën 10,123,178 Lekë.

Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit L.C, bazuar në Njoftim Kontrollin nr. 3930/1 prot., datë 25.03.2019, si dhe Programit të Kontrollit nr. 3930/2 prot., datë 25.03.2019, të konfirmuar nga tatimpaguesi nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura më datë 25.03.2019. Kontrolli ka filluar në datë 25.03.2019, ku janë parashikuar për kontroll 40 orë (5 ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 29.03.2019, afat për të cilin është zbatuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 25.03.2019, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 08.04.2019, pra afërsisht dy javë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

Titulli gjetjes:	Nuk është zbatuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit.
Situata:	Subjekti “S.S” sh.p.k, me NIPT K... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti është i regjistruar në organet tatimore më datë 14.06.2005 dhe ushtron aktivitet “Tregtim të artikujve të ndryshëm ushqimore e industriale, me shumicë e pakicë. Prodhim, tregtim dhe ambalazhim të produkteve, ëmbëlsira, prodhime brumi të gjitha llojeve, biskota, karamele, çokollata, akullore e çdo asortiment tjetër i kësaj natyre. Import-eksport të lëndëve të para ushqimore, industriale, makineri e pajisje të automatizuara për prodhime brumi e ëmbëlsirash. Transport mallrash dhe furnizim të dyqaneve e lokaleve me to. Import-eksport të përgjithshëm konform ligjeve në fuqi për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar”, me adresë: Lagja “Xhevdet Nepravishta”, rruga: “Bulevardi Kongresi”, godina nr.123, Lushnje. Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit D.S, bazuar në njoftimet e kontrollit nr.17184, datë 30.10.2019, nr.17184/1, datë 13.02.2020 dhe programit të kontrollit nr.17184/2, datë 13.02.2020, për TVSH-në për periudhën 2014.10-2019.09, për Tatim Fitimin për periudhën 2014-2018, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2014.10-2019.09. Parashikuar për kontroll 160 orë (20 ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Njoftimi për kontroll tatimor është bërë në datë 13.02.2020 dhe referuar nenit 23 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, kontrolli duhej të fillonte në datë 23.02.2020, në fakt kontrolli ka filluar në datë 29.06.2020, 157 ditë kalendarike me vonesë. Sqarimi për vonesën është dhënë në sistemin C@TS nga inspektori. Inspektori D.S nga data 16.01.2020-10.03.2020 ka qenë duke ushtruar detyrën në një subjekt tjetër, ndërkohë që në datat 09.03.2020-24.03.2020 ka qenë duke kryer pushimin vjetor të paguar. Në datën 19.03.2020 në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave për veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, DRT Fier është njoftuar nga DPT, nëpërmjet postës elektronike për pezullim të procesit të kontrollit deri në normalizim të situatës. Rifillimi i punës është njoftuar nga DPT me shkresën nr.6419, datë 29.06.2020, datë në të cilën është njoftuar subjekti “S.S” Sh.p.k për ushtrim kontrolli. Në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në

datë 31.07.2020. Kontrolli ka përfunduar në datë 24.07.2020 dhe projekt raporti i kontrollit është dërguar brenda afatit të përcaktuar.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 29.06.2020, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 30.07.2020, pra afërsisht një muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: "...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës".

Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se raporti i kontrollit nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e programit dhe më konkretisht:

- Nuk është dokumentuar intervista me tatimpaguesin;
- Nuk është mbajtur procesverbal për inventarin e plotë të ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve në shërbim të aktivitetit dhe nuk janë pasqyruar në mënyrë të detajuar aktivitetet që zotëron shoqëria duke mos përcaktuar origjinën e krijimit të tyre;
- Nuk është verifikuar fuqia punëtore në raport me funksionet që ata kryejnë;
- Nuk është kryer inventarizim i faturave të shitjes, të blera në DRT Fier;
- Nuk është administruar nxjerrja e kuponit të kasës në momentin e kontrollit dhe nuk është kryer krahasimi me deklaratimet e kryera;
- Nuk është detajuar lista e klientëve dhe debitorëve në fillim dhe fund të periudhës;

Inventarizimi fizik i kryer nga inspektori në datë 29.06.2020 në ambientet e subjektit tatimpagues nuk ka të llogaritur vlerën e mallit. Nga llogaritjet e bëra nga grupi i auditimit rezulton se vlera e mallit të inventarizuar nga inspektori nuk është përfaqësuese (zë 1.2% të peshës specifike të gjendjes së mallit gjendje në datë 31.12.2018) dhe nuk i shërben analizës së gjendjes financiare të subjektit.

Nr.	Inventarizimi fizik kryer nga inspektori (në vlerë)	Vlera e mallrave referuar bilancit v.2018	Pesha specifike e inventarit fizik kryer nga inspektori
1	Inspektori -	47,225,988	-
2	KLSH 551,694	47,225,988	1.2%

Në lidhje me kontrollin e TVSH, nuk është dokumentuar kontrolli kronologjik i shitjeve (lidhja faturë-libër-FDP). Në analizën e kryer nga inspektori janë përlllogaritur për secilin vit shitjet dhe blerjet e përjashtuara nga TVSH, që përfaqësojnë artikullin "cigare". Llogaritjet nuk janë shoqëruar me analizë për llojet e cigareve të shitura, komisionet e aplikuar dhe furnitorët respektiv. Nga shqyrtimi i analizës së kryer nga inspektori në lidhje me çmimet e blerjes dhe të shitjes konstatohet se për të njëjtën markë cigareje në vite të ndryshme ka normë të ndryshme fitimi, çka tregon për ndryshim çmimi. Në kushtet e mungesës së informacionit në raport, nuk mund të shprehemi për respektim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

Në pasiv të bilancit zëri "Të pagueshme ndaj furnitorëve" paraqitet në rritje nga 5,780,752 Lekë në vitin 2014 në 15,516,474 Lekë në vitin 2018 e pashoqëruar me analizë sipas furnitorëve, kërkesë kjo e programit të kontrollit.

Në kapitullin e huamarrjeve në zërin "Debitorë dhe Kreditorë të tjerë" për periudhën 2014-2018 pasqyrohet një vlerë konstante 12,632,847 Lekë. Në raport nuk ka informacion dhe analizë se çfarë përfaqëson kjo shumë dhe si ka hyrë në shoqëri. Në pasiv të bilancit është paraqitur llogaria "Debitorë dhe Kreditorë të tjerë" e pashoqëruar me analizë e cila përfaqëson huatë (kredi të ndryshme), për të cilat nuk kemi informacion nëse janë transferuar nëpërmjet sistemit bankar. Nga ana e inspektorit të kontrollit dhe drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve nuk është verifikuar burimi i këtyre huave të deklaruara, me të cilën lidhet ngushtë tatim fitimi apo tatimi në burim, veprime këto, jo në përputhje dhe shkelje të kërkesave të nenit 5.1/2 të Udhëzimit nr.16, datë 16.02. 2009 të MF "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave" për "Raportimi i aktivitetit të dyshimtë" ku

	<p>shprehimisht citohet: “Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit” dhe “Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për aktivitetin e dyshimtë (sipas shtojcave në anekset II dhe III për formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi)”.</p> <p>Zëri “Debitorë dhe Kreditorë të tjerë” paraqitet si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Subjekti</th> <th>NIPTI</th> <th>Viti 2014</th> <th>Viti 2015</th> <th>Viti 2016</th> <th>Viti 2017</th> <th>Viti 2018</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>“S.S” Shpk</td> <td>K....</td> <td>12,632,847</td> <td>12,632,847</td> <td>12,632,847</td> <td>12,632,847</td> <td>12,632,847</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për subjektin rezulton se të paktën që nga viti 2015, nuk ka shpërndarë dividend, por të gjitha fitimet i ka kaluar “Krijimin e rezervës për investime në të ardhmen, gjë e cila nuk është analizuar nga ana e inspektorit.</p>	Subjekti	NIPTI	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	“S.S” Shpk	K....	12,632,847	12,632,847	12,632,847	12,632,847	12,632,847
Subjekti	NIPTI	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018									
“S.S” Shpk	K....	12,632,847	12,632,847	12,632,847	12,632,847	12,632,847									
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Udhëzimit nr.16, datë 16.02. 2009 dhe manuali i Kontrollit Tatimor.														
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, nuk ka efekte financiare.														
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.														
Rëndësia:	E Lartë.														
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.														

Titulli gjetjes:	Nuk është zbatuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit, diferencë midis FDP-PASH.
Situata:	<p>Subjekti “B.L”, me NIPT L....</p> <p>Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:</p> <p>Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 12.10.2012 dhe ushtron aktivitet “Ndërtim i godinave për banesa civile, ndërtesa industriale, bujqësore, tregtare, ndërtesa dhe struktura turistike, ndërtim të rrugëve dhe infrastruktura të çdo lloji, punime ndërtimi e rikonstruksioni. Prodhim asfalto-beton, prodhim inertesh, prodhim pllakash betoni, përpunim i lëndëve bituminoze”, me adresë: Hekal, rruga Levan-Tepelenë, Mallakastër.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit V.C, bazuar në njoftimet e kontrollit nr.6717/1, datë 17.05.2018, konfirmuar nga subjekti dhe programit të kontrollit nr.6717/2, datë 17.05.2018, për TVSH-në për periudhën 2016.11-2018.02, për Tatim Fitimin për periudhën 2016-2017, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2016.11-2018.02. Njoftimi për kontroll tatimor është bërë në datë 17.05.2018 dhe referuar nenit 23 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kontrolli duhej të fillonte në datë 27.05.2018. Kontrolli ka filluar në datë 19.05.2018, brenda afateve ligjore. Parashikuar për kontroll 197 orë (25 ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 18.06.2018.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i perkasin datës 19.05.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 16.12.2020, pra afërsisht 2.5 vite me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.</p> <p>Për këtë subjekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk është bërë një analizë e thelluar e veprimtarisë së subjektit dhe nuk është bërë ndarja e aktivitetëve (ndërtim/prodhim/përpunim). • Në raportin e kontrollit janë evidentuar vlerat e shitjeve dhe vlerat e blerjeve, por nuk ka analizë të tyre. • Nuk është mbajtur proçes verbal për inventarin e plotë të makinerive dhe pajisjeve në

	<p>shërbim të aktivitetit. Aktivitet afatgjatë nuk janë pasqyruar në raport të detajuar, duke mos dhënë informacion për origjinën e krijimit të tyre, koston historike dhe amortizimin e akumuluar, veçmas për secilin aktiv.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bilanci material nuk është shoqëruar me analizën e harxhimit të materialeve sipas kartës teknologjike të prodhimit përpara i përket pjesës së aktivitetit që shoqëria ushtron në fushën e prodhimit. • Nuk është dokumentuar kontrolli kronologjik i shitjeve, lidhja faturë-libër-FDP. • Nuk është bërë evidentimi i blerjeve sipas pjesëmarrjes në aktivitet, nëse mallrat janë për shitje, materiale dhe lëndë të para për prodhim apo investime dhe ndërtime. • Nuk ka analizë për klientët dhe furnitorët. <p>Për vitin 2017 është konstatuar diferencë midis të ardhurave nga shitja sipas deklarimeve FDP që paraqiten në shumën 518,186,839 Lekë dhe të ardhurave të pasqyruara në PASH në shumën 517,654,841 Lekë. Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektin “B.L”, për diferencën prej 531,998 Lekë, përllëgariten detyrimet si vijon:</p> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>Detyrim TF</td> <td>531,998 x 15% =</td> <td>79,800 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Gjobë TF (21.9% e detyrimit)</td> <td></td> <td>17.476 Lekë</td> </tr> <tr> <td>Detyrimi</td> <td></td> <td>97,276 Lekë</td> </tr> </table> <p>Sipas informacioneve të marra nga burime të tjera(media/portale) referuar linkut bashkëlidhur https://ëëë.monitor.al/tabela-skema-e-shitjeve-fiktive-34-milione-euro-si-u-mashtrua-me-tvsh-ne-dhe-tatim-fitimin/, rezulton se subjekti ka kryer blerje nga subjekte të cilat janë konstatuar dhe konfirmuar nga organet gjyqësore si subjekte fiktive. Blerjet e këtij subjekti janë kryesisht në periudhën Maj -Nëntor 2017. Nga ana e administratës nuk janë marrë masat përkatëse për zerimin e këtyre faturave.</p>	Detyrim TF	531,998 x 15% =	79,800 Lekë	Gjobë TF (21.9% e detyrimit)		17.476 Lekë	Detyrimi		97,276 Lekë
Detyrim TF	531,998 x 15% =	79,800 Lekë								
Gjobë TF (21.9% e detyrimit)		17.476 Lekë								
Detyrimi		97,276 Lekë								
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115 dhe manuali i Kontrollit Tatimor.									
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare në shumë n 97.276 Lekë .									
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115 dhe manuali i Kontrollit Tatimor.									
Rëndësia:	E Lartë.									
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF konform legjislacionit në fuqi, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.									

Titulli gjetjes:	Nuk është zbatuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimit e kontrollit.
Situata:	<p>Subjekti “SH”, me NIPT K.....</p> <p>Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se:</p> <p>Subjekti është regjistruar në organet tatimore më datë 01.07.2007 dhe ushtron aktivitet “Në fushën e ndërtimit të çdo lloji..., transport e tregtim karburantesh e mallrash të ndryshme ushqimore, industrial, bujqësor, blegtoral, ...bar, restaurant, menaxhim i integruar i mbetjeve, etj...”, me adresë: Fshati Belishovë, Fier.</p> <p>Tatimpaguesi është kontrolluar nga inspektori i kontrollit G.M, bazuar në Njoftimet e Kontrollit nr.127/1, datë 12.02.2018, konfirmuar nga subjekti në datë 23.02.2018 dhe Programit të Kontrollit nr.127/2, datë 12.02.2018, për TVSH-në për periudhën 2014.01-2017.10, për Tatim Fitimin për periudhën 2014-2016, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të tjera, për periudhën 2014.01-2017.10.</p> <p>Njoftimi për kontroll tatimor është bërë në datë 12.02.2018 dhe referuar nenit 23 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kontrolli duhej të fillonte në datë 23.02.2020. Kontrolli ka filluar në datë 23.02.2018, brenda afateve ligjore. Parashikuar për kontroll 160 orë (20 ditë) nga data e fillimit të kontrollit. Nisur nga sa më sipër afati i qëndrimit në subjekt i inspektorit të kontrollit është deri në datë 27.03.2018 (zbritur ditët e festave zyrtare) dhe në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 83, pika 1, afati për</p>

përgatitjen e raportit të kontrollit është brenda 7 ditëve kalendarike, pra deri në datë 03.04.2018. Projekt Raporti i Kontrollit është dërguar tek tatimpaguesi me shkresën përcjellëse nr.127/3, datë 23.04.2018, pra me 20 ditë vonesë.

Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 23.02.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 17.04.2018, pra afërsisht 2 muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: "...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (procesverbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës".

Nga shqyrtimi i raportit të kontrollit është konstatuar se raporti i kontrollit nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e programit dhe më konkretisht:

- Nuk është dokumentuar intervista me tatimpaguesin;
- Nuk është mbajtur procesverbal për inventarin e plotë të ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve në shërbim të aktivitetit;
- Nuk është verifikuar fuqia punëtore në raport me funksionet që ata kryejnë;
- Nuk është kryer inventarizim i faturave të shitjes, të blera në DRT Fier;
- Nuk është administruar nxjerrja e kuponit të kasës në momentin e kontrollit dhe nuk është kryer krahasimi me deklaratimet e kryera;
- Nuk është administruar lista e çmimeve të shitjes të aplikuara nga shoqëria dhe nuk është bërë analiza e shitjeve sipas natyrës së aktivitetit: tregti, shërbim;
- Bilanci nuk është shoqëruar me raportin teknik të inxhinierit dhe situacione punimesh të kryera;
- Nuk është bërë analiza e bilancit material përse i përket artikujve që gjatë procesit transformohen në mallra ose shërbime referuar normativave të lejuara ligjore;
- Nuk është dokumentuar kontrolli kronologjik i shitjeve, lidhja faturë-libër-FDP;
- Aktivitet Afatgjatë nuk janë pasqyruar në raport të detajuar, duke mos dhënë informacion për origjinën e krijimit të tyre, koston historike dhe amortizimin e akumuluar, veçmas për secilin aktiv.
- Nuk është bërë një analizë e thelluar e veprimtarisë së subjektit dhe nuk është bërë ndarja e aktiviteteve.
- Në pasqyrat dhe bilancet materiale të hartuara nga inspektori për të gjithë periudhën objekt kontrolli jepen cmimet e blerjes. Mungesa e informacionit lidhur me cmimet e shitjes e bën të pamundur llogaritjen e të ardhurave nga shitja.
- Për periudhën 2014-2017, inspektori ka pasqyruar të ardhurat, të cilat i specifikon në:
 - të ardhura nga kryerja e punimeve, por këto të ardhura nuk shoqërohen me raport teknik të inxhinierit mbi punimet e kryera/situacione punimesh bashkëlidhur faturën tatimore;
 - të ardhura nga shitja e produkteve të gatshme, e pa shoqëruar me analizë të kostos së produktit;
 - Të ardhura nga shitja e shërbimeve, e pa shoqëruar me analizë për cilin aktivitet është kryer shitja e shërbimeve;
 - Të ardhura nga shitja e mallrave (Diezel EN 590 + Benzinë pa plumb). Nuk jepet informacion për sasinë e shitura dhe cmimet e shitjes;
 - Të ardhurat nga qiratë; transporti dhe shitja e aktiveve, e pashoqëruar me analizë.

Referuar analizës së blerjeve kryer nga inspektori në raport me objektin e veprimtarisë së subjektit, rezulton se në vitin 2017 janë blerë në total 1.330.496 Lekë artikuj që nuk i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë, kondicioner 8 copë x 92,267 Lekë = 738,137 Lekë, kondicioner 16 copë x 37,022 Lekë = 592,359 Lekë.

Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar për subjektin lindin detyrime si vijon:

Detyrim TVSH	1.330.496 x 20% =	266,099 Lekë
Gjobë TVSH (0.06%/365)		58,276 Lekë
Detyrimi		324,375 Lekë
Detyrim TF	1.330.496 x 15% =	199,574 Lekë
Gjobë TF (0.06%/365)		43,707 Lekë
Detyrimi		243,281 Lekë +
		324.375 Lekë

	Tot. 567.750 Lekë
Në llogaritjet e kryera nga inspektori për sasinë e pllakave të zdrukthit të blera në vitin 2016, konstatohet gabim në përlllogaritje. Nga 2,108,700 Lekë që është shuma e mallit të blerë jo në përputhje me aktivitetin e shoqërisë, veprimet për llogaritjen e detyrimeve për TVSH dhe TF janë kryer mbi shumën 1,808,700. Për diferencën prej 300,000 Lekë, llogaritet:	
Detyrim TVSH	300,000 x 20% = 60,000 Lekë
Gjobë TVSH (0.06%/365)	13,140 Lekë
Detyrimi	73,140 Lekë
Detyrim TF	300,000 x 15% = 45,000 Lekë
Gjobë TF (0.06%/365)	9,855 Lekë
Detyrimi	54,855 Lekë + 73,140 Lekë
	Tot. 127,995 Lekë
Në vitin 2016 kemi: deklarime të subjektit për blerje nga importi, në shumën 65,572,758 Lekë dhe deklarata doganore në shumën 65,601,726 Lekë. Diferenca midis deklaratës doganore dhe deklarimit të subjektit në shumën 28,968 Lekë . Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, për subjektin lindin detyrimet si vijonë:	
Detyrim TVSH	28968 x 20%= 5,794 Lekë
Gjobë TVSH (0,06%/ditë)	1,269 Lekë
Detyrimi	7,063 Lekë
Detyrim TF	28968 x 15%= 4,345 Lekë
Gjobë TF (0,06%/ditë)	952 Lekë
Detyrimi	5,297 Lekë + 7,063 Lekë
	Tot. 12,360 Lekë
Në vitin 2017 për periudhën 01/2017-10/2017 kemi: deklarime të subjektit për blerje nga importi, në shumën 19,372,921 Lekë dhe deklarata doganore në shumën 20,690,387 Lekë. Diferenca midis deklaratës doganore dhe deklarimit të subjektit në shumën 1,317,466 Lekë . Në zbatim të nenit 115 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektin lindin detyrimet si vijonë:	
Detyrim TVSH	1,317,466 x 20% = 263,493 Lekë
Gjobë TVSH (0,06%/ditë)	57,704 Lekë
Detyrimi	321,197 Lekë
Detyrim TF	1,317,466 x 15% = 197,620 Lekë
Gjobë TF (0,06%/ditë)	43,278 Lekë
Detyrimi	240,898 Lekë+ 321,197 Lekë
	Tot. 562,095Lekë
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115 dhe manuali i Kontrollit Tatimor.
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmenduara sjellin efekte financiare në shumë n 1.270.200 Lekë .
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 115 dhe manuali i Kontrollit Tatimor, Kap.2.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF, që për subjektin të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor.

Titulli gjetjes:	Nuk është zbatuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke ndryshuar periudhën e kontrollit si dhe ndërhyrje në TB jashtë periudhës së kontrollit.
Situata:	Subjekti “H...”, me NIPT K..... Bazuar në analizën e këtij subjekti rezulton se: Subjekti “H” sh.p.k ka kaluar kontroll të thelluar operacional nga inspektori M.U. Ky subjekt është kontrolluar për periudhën 2013/04-2014/01 për TVSH dhe Sigurimet Shëndetësore dhe Shoqërore si dhe Tatim Fitimin për vitin 2013. Kontrolli është ushtruar në bazë të lajmërimit të kontrollit me nr.20990/1 datë 03.05.2018 si dhe programit të kontrollit me nr.20990/2 i po së njëjtës datë. Kontrolli

	<p>është përcaktuar që do të kryhet për 180 orë pune dhe të filloj më datën 17.05.2018. Sipas Formularit 4 të ardhur nga DPT ky subjekt është planifikuar për <i>Rikontroll</i> për muajin Shkurt 2018, por që ka filluar në Maj 2018, pra afërsisht tre muaj me vonesë.</p> <p>Në programin e kontrollit pavarësisht se subjekti është planifikuar si rikontroll janë ndryshuar periudhat e kontrollit me arsyetimin se jemi përball faktit se periudhat janë parashkruar.</p> <p>Rikontrolli ka dalë bazuar në shkresën nr.2592/16 datë 14.12.2017, nisur nga DRTF, me lëndë “Mbi vazhdimin e procedurës së kontrollit...”. Për këtë, nga verifikimet e kryera nga ana jonë, mbi korrespondencat e mbajtura me DPT rezulton se statusi i këtij kontrolli deri në datën e nisjes së kësaj shkrese është kontroll në proces, ku data për njoftim kontrolli është 03.03.2015 me nr.2592, për të cilin subjektit i është dërguar projekt raporti i kontrollit 2592/14 datë 16.09.2015, për të cilin subjekti ka paraqitur kundërshtime me shkresën nr.2592/15 datë 30.09.2015.</p> <p>Në datë 23.10.2015 është hedhur në sistemin tatimor C@TS raporti përfundimtar, i cili nuk është evaduar nga drejtori i kontrollit B.S. Me daljen e raportit të kontrollit përfundimtar, hedhur në sistem më datë 16.07.2018, konstatohet mbyllja e çështjes së mbetur pezull e vitit 2015 dhe vazhdimin me të njëjtin nr çështje të rastit të rikontrollit për këtë subjekt.</p> <p>Ky veprim ka ndodhur në mënyrë të paargumentuar dhe në shkelje të plotë të Manualit të Kontrollit Tatimor dhe të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar. Si rezultat I këtij veprimi, subjektit nuk i ka dal njoftim vlerësimi për kontrollin e vitit 2015, të mbetur pezull, duke shmangur kontabilizimin e detyrimeve të lindura nga kontrolli i vitit 2015, të cilat kanë vlerën 40.477.157 Lekë. Sa më sipër, këto veprime janë kompetencë e përgjegjësitet të kontrollit /drejtorit të kontrollit/drejtorit rajonal të cilët janë personat e autorizuar për të kryer këto veprime në sistemin Tatimor C@TS.</p> <p>Ndër të tjera konstatohet se me anë të memos me nr.20990/14 datë 12.10.2018, me lëndë “Kërkesë për sistemim deklarate”(konceptuar nga M.U, miratuar nga E.XH dhe A.K dhe aprovuar nga O.C), për detyrimin e tatimit në burim për periudhën tatimore 2012, e ngarkuar në sistem për periudhën tatimore 2014, kërkohet heqja e detyrimit të kontabilizuar për shumën 4.704.308 Lekë, me arsyetimin se i përket një periudhe të parashkruar, ndërkohë që periudha për të cilën bëhet fjalë, nuk është periudhë që i përkon programit të kontrollit për të cilën është i autorizuar inspektori(periudha e kontrollit është vetëm për vitin 2013 për TF).</p> <p>Në këtë raport nuk janë trajtuar në asnjë moment problematikat për të cilat është ndërprerë kontrolli i mëparshëm dhe arsyeja për të cilën ky subjekt ka dalë për rikontroll.</p> <p>Procesverbalet e mbajtura nga inspektori i perkasin datës 16.05.2018, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 16.07.2018, pra afërsisht 2 muaj me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proces-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.</p>
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor.
Ndikimi:	Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare 4.704.308 Lekë .
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	DRTF të kryejë rikontroll tatimor, pasi për subjektin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale.

Titulli gjetjes:	Nuk është zbatuar Plani Operacional Korrik-Dhjetor 2020, duke moskryer rivlerësimet e subjekteve.
Situata:	Nga auditimi mbi veprimtarinë e kryer nga ana e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (në Vend/operacional) Fier, në kuadër të planit operacional të Korrik-Dhjetor 2020, për zbatimin e pikës “ <i>për subjektet të cilat kanë transaksione me subjektet të cilat janë në hetim për skemë mashtrimi me TVSH-në</i> ” ka rezultuar: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT është përcjell subjekti B shpk si subjekt i cili ka patur transaksione me tatimpagues që kanë kryer transaksione në formë të një skeme mashtrimi me TVSH-në, dhe nga kjo drejtori është kërkuar të verifikohen transaksionet me këto subjekte. Gjithashtu dhe nga informacionet e marra nga burime të tjera si(media/portale), rezulton se subjekte të cilat menaxhohen nga

DRTF (*dhe jo vetëm*) kanë kryer blerje nga këto subjekte që janë evidentuar si subjekte “fiktive”. Blerjet i përkasin viteve 2015-2018. Sa më sipër nga ana jonë është kërkuar informacion nga DRTF dhe personat kompetent të kësaj drejtorie, pretendojnë se nuk kanë patur informacion me përjashtim të një rasti ardhur në rrugë elektronike (datë 07.07.2020), ku kërkohet nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT që të kryhet një vizitë fiskale në subjektin “B” sh.p.k me NIPT J..., pasi rezultoi se sipas Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, ka kryer transaksione me NIPT-et e evidentuara nga kjo Drejtori si skemë mashtrimi me TVSH-në ku kërkohet të verifikohen transaksionet me këto subjekte për të gjithë periudhat e lejura.

Ky email është dërguar nga drejtori i DKT në DPT Znj. I.A, të cilës nga ana e personit të kontaktit në atë periudhë Znj. E.E, i është kërkuar periudha e cila do të jetë objekt kontrolli, pasi nuk kanë patur informacion për cilën periudhë do të përfshihet kontrolli. Për këtë, nga ana e drejtoreshës së DKT Znj. I.A nuk ka patur asnjë reagim dhe nga DRTF është ndërtuar një program vizitë fiskale ku inspektorët për këtë vizitë fiskale kanë qënë Z. G.M dhe Z. J.H. Në programin e vizitës fiskale nuk është përcaktuar periudha që do të kontrollohet si dhe afati kryerjes së saj. Kontrolli ka përfshirë vetëm një periudhë 18 muaj pa arritur të vlerësojë transaksionet e dyshimta, objekt i informacionit të përcjellë duke mos përmbushur në këtë mënyrë objektivin e verifikimit. Programi i kontrollit është ndërtuar në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor dhe konkretisht Pika 2.1 paragrafi 3 ku citohet se: “Në rastin e kryerjes së vizitave fiskale, të cilat janë kontrolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të verifikuar saktësinë e deklaratave e të pagesave, si rregull vetëm për një periudhë të caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi...”, nga ana jonë është konstatuar se subjekti me këtë vizitë fiskale është kontrolluar për një periudhë 18 muaj, për më tepër në programin e vizitës fiskale nuk është përcaktuar në asnjë moment periudha që do të kontrollohet dhe afati kryerjes së kësaj vizite, kjo në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, pika 2.1, ku përcaktohen elementët që duhet të përmbajë një njoftim kontrolli tatimor. Gjithashtu procesverbalet e mbajtura nga inspektori i përkasin datës 18.08.2020, ndërkohë që në sistemin tatimor C@TS janë ngarkuar në datën 26.08.2020, pra afërsisht 8 ditë me vonesë, kjo në kundërshtim me manualin e Kontrollit Tatimor, konkretisht pika 2.2 ku citohet se: “...Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës”.

Veç subjekteve dhe transaksioneve më sipër evidentohen dhe të paktën **7 (shtatë)** subjekte nën juridiksionin e DRT-Fier të cilat kanë kryer blerje fiktive nga subjektet pjesë e skemave të mashtrimit me faturat tatimore **si më poshtë:**

Sa më sipër nga ana jonë u analizuan librat e subjektit dhe rezultoi se subjekti ka kryer blerje në subjektet fiktive sa më poshtë:

Nr	Subjekti shitës	Periudha transaksionit	Vlera/Lekë
1	L...	Nëntor 2017	4,539,600
2	L...	Nëntor 2017	5,901,540
3	L...	Nëntor 2017	4,672,200
4	L....	Nëntor 2017	5,634,720
5	L....	Maj 2017	7,300,000
6	L....	Maj 2017	18,002,220
7	L....	Maj 2017	7,152,000
8	L....	Maj 2017	7,200,000
9	L....	Qershor 2015	1,354,992
10	Total blerje		61,757,272
	Detyrim TVSH	61,757,272 x 20% =	12,351,454 Lekë
	Gjobë TVSH (100% e detyrimit)		12,351,454 Lekë
	Detyrimi		24,702,908 Lekë
	Detyrim TF	61,757,272 x 15% =	9,263,590 Lekë
	Gjobë TF (100% e detyrimit)		9,263,590 Lekë
	Detyrimi		18,527,181 Lekë +
			24,702,908 Lekë

	Tot. 43,230,089 Lekë
	Veç subjekteve dhe transaksioneve më sipër evidentohen dhe të paktën 7 (shtatë) subjekte nën juridiksionin e DRT-Fier të cilat kanë kryer blerje fiktive nga subjektet pjesë e skemave të mashtrimit me faturat tatimore si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Subjekti “S.T”sh.p.k, me NIPT L..... ○ Subjekti “Z” sh.p.k, me NIPT J..... ○ Subjekti “A.S”, me NIPT L..... ○ Subjekti “S.R”, me NIPT L..... ○ Subjekti “E.C”, me NIPT L..... ○ Subjekti “S” sh.p.k, me NIPT K..... ○ Subjekti “S” sh.p.k, me NIPT J.....
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor.
Ndikimi:	Nga ana e punonjësve të DRTF, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas Legjislacionit, ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare.
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe manuali i Kontrollit Tatimor.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	-Nga DRT-Fier të merren masat e menjëherëshme për kontrollin nga zyra/vend të subjekteve të evidentuar nga KLSH lidhur me skemat e mashtrimit me faturat tatimore dhe të kryhen rivlerësimet përaktëse. -Nga DRT-Fier të trajtohen me profesionalizëm dhe objektivitet informacionet e përcjella nga DPT, dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm procedural për verifikimin e tyre konform legjislacionit fiskal në fuqi, duke informuar dhe organin qendror mbi rezultatet. -Nga DPT, në të gjitha rastet e përcjelljes së problematikave drejt institucioneve të varësisë, të merren masat për monitorimin e zbatimit të tyre. Në rastet e mosveprimit ose veprimeve të mangëta nga këto njësi varësie për personat përgjegjës të ndërmerren masat konform legjislacionit në fuqi.

(Për sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi Nr.11, datë 08.4.2021)

Në lidhje me Projektraportin kanë ardhur observacionet me nr. 9253/101 datë 24.08.2021, nr. 9253/109 datë 01.09.2021, 9253/121 datë 07.09.2021, 9253/124 datë 07.09.2021 si dhe nr. 9253/99 datë 24.08.2021, të cilat pasi u shqyrtuan nga grupi i auditimit **nuk u morën në konsideratë**, me arsyetimin se janë të njëjtat argumente si ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit të mbajtur dhe nuk ka argumente apo dokumente shtesë. Në asnjë nga observacionet e paraqitura, nuk përmbajnë argumenta për të shmangur subjektin nga propozimi për rikontroll.

II.2.2.1/2 Mbi Përputhshmërinë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (kontrolli nga zyra).

Për auditimin e periudhës 2018-2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Organika e Sektorit të kontrollit nga Zyra dhe monitorimit
2. Plane mujore të punës
3. Ndarjet e Nipt-ve sipas inspektorëve
4. Deklaratat mujore në nivel subjekti të TVSH
5. Deklaratat vjetore në nivel subjekti të TVSH
6. Tepricat kreditore TVSH-TF-TTHF
7. Deklaratat e TF-TTHF
8. Rivlerësimet e kësteve të TF
9. Deklaratat e Tatimit në burim dhe pagesat e Tatimit mbi Dividentin
10. Kasat Fiskale
11. Gabimet e Kasave
12. Pasqyrat Financiare të subjekteve
13. Sistemi C@TS me akses të kufizuar (hapur në janar 2021)

Cdo informacion dhe dokumentacion shitesë i vlerësuar për kontroll nga grupi i auditimit dhe i vënë në dispozicion nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Manuali për Kontrollin nga Zyra, shërben për punën e përditëshme të inspektorëve të kontrollit nga zyra. Ai trajton aspektet që duhen patur parasysh e ndjekur prej tyre gjatë ushtrimit të kontrollit nga zyra tek tatimpaguesit lidhur me zbatimin e Legjilacionit ne fuqi. Manuali ofron mbështetjen e nevojshme teknike për arritjen e vlerësimeve më të mira të deklarimeve të tatimpaguesve në raport me faktet e konstatuara. Arsyet për ushtrimin e kontrollit tatimor nga zyra janë: verifikimi i përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve, kontrolli ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi.

Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra:

- Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjëndje të lartë e të vazhdueshme kreditore tvsh, tatimfitimi, mosdeklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin.
- Analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes duke përcaktuar detyra për sistemime e rivlerësime të ndryshme tatimore kur është e nevojshme.
- Në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 5 datë 30.01.2006 në zbatim të ligjit krijon në ulje apo në rritje, me kërkesë ose jo të tatimpaguesit plan të rishikuar të parapagimeve sipas modulit të krijimit të planeve të parapagimit të implementuar në sistem.
- Zbaton dhe hedh në sistem vendimet e apelimit tatimor dhe vendimet e formës së prerë të gjykatave në lidhje me detyrimet tatimore dhe penalitetet. Për detyrimin tatimor nëpërmjet rivlerësimit të deklaratave tatimore sipas vendimeve përkatëse (Moduli i kontrollit nga zyra) dhe për anulimin e penaliteteve me modulën e anulimit të gjobave.
- Ndjekin procedurat e përthithjes, ndarjes së tatimpaguesve, për transferimin e kredive të tatimeve të ndryshme nga një tatimpagues tek tjetri brënda një DRT-je apo në DRT-të të ndryshme.
- Kryen rimbursimin e tatimeve të ndryshme tatimore sipas këkesave të tatimpaguesve përveç TVSH-së.
- Ndjekin në çdo rast kryerjen e procesit të kompensimit të detyrimeve të papaguara para kryerjes së rimbursimeve qoftë nga DPT-ja për TVSH-në, apo nga DRT-të të tatimeve të tjera, sipas manualeve të përdorimit të implementuara në sistemin informatik.
- Analizojnë dhe pregatisin planet e ndryshuara të parapagimeve sipas kërkesave të tatimpaguesve në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi gjatë gjithë vitit ushtrimor.
- Ndjek arkëtimin e detyrimeve tatimore të vetëdeklaruara por të papaguara deri në kalimin e tyre ne borxh që duhet të mblidhet me forcë.
- Ndjek nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit tatimpaguesit të cilët nuk kanë deklaruar në afatin ligjor.

Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Sektori Kontrolli nga Zyra

Struktura ka funksionuar me Urdhërin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, me Urdhërin nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126

datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore Qëndrore” dhe me Urdhër nr.86, datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, të ndryshuar.

Struktura e miratuar me Urdhrin Nr. 33 date 12.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, është miratuar si në Tabelën nr. 1 bashkëlidhur në seksionin “Aneke” dhe plotësimi i strukturës ka përfunduar në datën 03.08.2020

- ✓ Delegimet e kryera me Urdhër të Drejtorit Rajonal (*rasti i Z.SH*) janë kryer pa qënë në kompetencë të tij.
- ✓ Struktura e plotësuar aktualisht paraqitet në Tabelën Nr.2 bashkëlidhur në seksionin “Aneke” të këtij Projektraporti.

Veprimtaria e Kontrollit nga zyra dhe monitorimit

Nga auditimi u konstatua se: Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit për periudhën e auditimit nuk disponon plane mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme. Nga dokumentacioni i kërkuar në DRT Fier mbi hartimin dhe raportimin e planeve mujore është vënë në dispozicion vetëm një shkresë me nr 15963 (pa prot) datë 10.10.2017 me lëndën “plan sektorial i punës” dhe 2 memo si në vijim:

- Memo nr.13934 prot datë 10.09.2019 “Plan veprimi për zbatim”, e pregatitur nga Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, drejtuar Sektorit Operacional dhe Sektorit të Kontrollit nga Zyra.
- Memo nr.9426 prot datë 05.06.2019 drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra “Plani i punës Qershor 2019”. Konstatohet se ky është plan format tip dhe jo me objektiva të matshme. Në këtë plan përmenden të gjitha detyrat funksionale dhe kërkesat për raportim e të gjithë treguesve të aktivitetit të subjekteve, të mbështetura edhe nga përcaktimet e Manualit të Kontrollit nga Zyra.

Ndarja e Nipte-ve sipas Inspektorëve

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion 6 memo në lidhje me ndarjen e subjekteve si në vijim:

- Memo nr.16451 prot datë 16.10.2017, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Memo nr.19337 prot datë 13.11.2018, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Memo nr.3676 prot datë 12.03.2019, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Memo nr.3676/1 prot datë 18.06.2019, drejtuar Inspektor L.R, E,M
- Memo nr.15084/1 prot datë 01.10.2019, drejtuar Inspektor A.K
- Memo nr.15083/1 prot datë 09.10.2019, drejtuar Inspektor O.D
- Memo nr.3461 prot datë 06.03.2020, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Memo nr.10004 prot datë 28.09.2020, drejtuar Inspektor E.F
- Memo nr.10962 prot datë 16.10.2020, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra

Konstatohet se:

- Memot janë të përgatitura nga përgjegjësja e Sektorit, aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit dhe miratuar nga Drejtori Rajonal.
- Në lidhje me organizimin e inspektorëve nga zyra nuk janë respektuar udhëzimet në Manual, pika 5 “Organizimi i Inspektorëve nga Zyra”, ku citohet:

“Në muajin Janar të çdo viti, Drejtori i Kontrollit Tatimor /Përgjegjesi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, merr listën e plotë të tatimpaguesve të rajonit, përfshirë Persona fizikë : tatimpaguesit e regjistruar për TFTH & TVSH , tatimpaguesit me Xhiro e parashikuar < 2.000.000, Persona juridikë : tatimpaguesit e regjistruar për TF &

TVSH, si dhe Individët. Bazuar në këtë listë, Drejtori i Kontrollit Tatimor /Përgjegjesi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra bën ndarjen e të gjithë tatimpaguesve sipas inspektorëve të kontrollit nga zyra”.

Për sa më sipër kjo ndarje nuk është bërë në periudhën e përcaktuar në Manual. Tepricat kreditore të TVSH-s, TF dhe TTHF

Nga auditimi i tepricave kreditore të TVSH-s, Tatimit mbi Fitimin dhe Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin nëperiudhat dhjetor 2017, 2018, 2019 dhe 2020 u konstatua si në vijim:

Kredia e tatimpaguesve për çdo lloj tatimi (nga deklaratat dhe nga mbi-pagesat)

Teprica Kreditore TVSH (Dhjetor 2017)

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	1,040,207,643	7,049,240	1,047,256,883
Total	1,040,207,643	7,049,240	1,047,256,883

Të ardhurat tatimore për vitin 2017 në nr. subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr Subjekte	Statusi	Të ardhura tatimore
2306	Aktivë	64,544,099
522	Pasivë	5,271,775
195	Kërkesë C' regjistrimi	1,708,381
92	Të c' regjistruar	216,751
3115	TOTAL	71,741,006

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C' reg Nr	Vlera	Të c' regj Nr	Vlera		
BM	1507	62,913,217	289	5,033,864	61	1,566,889	0	0	1857	69,513,970
BV me TVSH	795	1,628,632	233	237,911	134	141,492	0	0	1162	2,008,035
Të tjera	4	2,250	0	0	0	0	92	216,751	96	219,001
TOTAL	2306	64,544,099	522	5,271,775	195	1,708,381	92	216,751	3115	71,741,006

Teprica Kreditore TVSH (Dhjetor 2018)

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	1,433,268,030	7,826,833	1,441,094,863
Total	1,433,268,030	7,826,833	1,441,094,863

Të ardhurat tatimore për vitin 2018 në nr subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr Subjekte	Statusi	Të ardhura tatimore
3634	Aktivë	71,736,597
523	Pasivë	1,862,978
281	Kërkesë C' regjistrimi	987,272
129	Të c' regjistruar	162,380
4567	TOTAL	74,749,227

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C' reg Nr	Vlera	Të c' regj Nr	Vlera		
BM	1641	68,254,854	223	1,622,026	58	784,360	0	0	1922	70,661,239
BV me TVSH	1956	3,476,580	299	240,857	223	202,912	0	0	2478	3,920,348
BV pa TVSH	34	2,054	0	0	0	0	0	0	34	2,054
Të tjera	4	3,206	0	0	0	0	129	162,380	133	165,586
TOTAL	3635	71,736,694	522	1,862,883	281	987,272	129	162,380	4567	74,749,227

Teprica kreditore e TVSH (Dhjetor 2019)

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	2,203,914,384	8,256,786	2,212,171,170

Total	2,203,914,384	8,256,786	2,212,171,170
--------------	---------------	-----------	---------------

Të ardhurat tatimore për vitin 2019 në nr. subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr Subjekte	Statusi	Të ardhura tatimore
4026	Aktivë	77,341,449
317	Pasivë	644,806
184	Kërkesë C' regjistrimi	533,854
67	Të c' regjistruar	131,087
4594	TOTAL	78,651,196

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C' reg Nr	Vlera	Të c' regj Nr	Vlera		
BM	1727	72,662,219	121	516,149	38	377,690	0	0	1886	73,556,058
BV me TVSH	2275	4,666,824	196	128,657	146	156,164	0	0	2617	4,951,645
BV pa TVSH	19	1,579	0	0	0	0	0	0	19	1,579
Të tjera	5	10,827	0	0	0	0	67	131,087	72	141,914
TOTAL	4026	77,341,449	317	644,806	184	533,854	67	131,087	4594	78,651,196

Teprica kreditore e TVSH deri në 31.12.2020

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	3,205,716,546	11,147,906	3,216,864,452
Total	3,205,716,546	11,147,906	3,216,864,452

Nga databaza e tepricave kreditore të TVSH-s u përzgjedhën subjektet (76) me tepricën më të lartë kreditore në fund të periudhës tatimore dhjetor 2017-2020 si në vijim:

NR	NIPT	SEKTORI	31.12.2017	31.12.2018	31.12.2019	31.12.2020
1	J....	Prodhim	99,113,508	116,444,476	132,053,197	143,701,120
2	K.....	Tregti	57,091,648	68,676,569	80,962,338	89,729,919
3	L.....	Prodhim	29,017,261	29,017,261	29,017,261	29,017,261
4	K.....	Tregti	23,856,206	23,856,206	23,856,206	23,856,206
5	K....	Tregti	22,309,530	22,309,530	22,309,530	22,309,530
6	K....	Tregti	21,096,095	21,096,095	21,096,095	16,039,669
7	K.....	Tregti	19,310,454	19,310,454	19,310,454	18,727,265
8	L.....	Tregti	19,139,518	19,175,574	19,183,467	19,183,467
9	K.....	Tregti	17,559,204	19,058,391	24,044,495	24,044,495
10	K....	Tregti	15,153,558	21,683,099	27,147,965	30,288,095
11	L.....	Tregti	13,813,731	18,774,631	21,625,756	26,445,911
12	L.....	Tregti	13,612,174	13,612,174	13,612,174	13,612,174
13	K.....	Tregti	13,266,486	16,487,535	21,245,317	29,232,571
14	K.....	Tregti	12,904,025	14,467,104	16,271,582	16,821,707
15	K.....	Tregti	12,739,982	14,000,788	14,925,441	14,547,098
16	K....	Transport	11,206,341	11,206,341	11,206,341	11,206,341
17	K....	Tregti	11,128,899	18,686,701	25,643,248	26,435,004
18	K.....	Tregti	10,958,920	10,958,920	10,958,920	10,958,920
19	L.....	Prodhim	10,576,429	10,576,429	10,576,429	10,576,429
20	L....	Tregti	9,960,217	10,107,598	10,508,895	10,494,562
21	L.....	Tregti	9,449,760	15,561,742	17,369,142	17,321,543
22	K....	Tregti	8,899,082	8,899,082	8,899,082	8,899,082
23	K.....	Transport	8,608,013	8,608,013	8,812,787	9,037,690
24	K....	Prodhim	8,445,348	11,837,350	14,353,551	17,232,239
25	K....	Tregti	8,201,983	14,680,675	20,957,744	22,156,669
26	K.....	Tregti	8,181,969	9,017,544	9,757,996	8,620,605
27	L....	Tregti	7,886,259	7,886,259	7,886,259	7,886,259
28	J....	Shërbim	7,326,995	7,326,995	7,326,995	7,326,995
29	L.....	Tregti	7,319,213	7,319,213	7,319,213	7,319,213
30	J.....	Shërbim	7,305,895	9,422,964	12,967,854	20,747,560
31	K.....	Tregti	6,981,027	11,566,422	14,636,357	15,568,245
32	L.....	Tregti	6,815,823	7,687,519	7,780,365	7,756,365
33	L.....	Tregti	6,728,892	6,728,892	6,728,892	6,728,892
34	K....	Ndërtim	6,624,241	6,687,571	6,775,718	5,152,616
35	J.....	Prodhim	6,483,113	6,483,113	6,483,113	6,483,113
36	K.....	Tregti	6,015,046	6,015,046	6,015,046	6,015,046

37	K.....	Tregti	5,954,005	5,954,005	5,954,005	5,954,005
38	L.....	Tregti	5,721,545	5,803,175	5,803,175	5,803,175
39	J....	Prodhim	5,548,804	5,548,804	5,548,804	5,548,804
40	L.....	Tregti	5,528,048	7,815,438	8,886,102	9,066,401
41	L.....	Tregti	5,515,095	5,515,095	5,535,595	5,535,595
42	K.....	Tregti	5,344,953	9,398,207	12,449,041	12,598,888
43	K.....	Tregti	5,300,200	5,300,200	7,636,389	8,400,287
44	L....	Ndërtim	5,148,284	9,971,805	10,756,557	12,078,241
45	J....	Tregti	4,958,021	7,965,322	11,673,253	13,918,339
46	K.....	Tregti	4,946,777	4,946,777	4,946,777	4,946,777
47	L.....	Tregti	4,766,507	6,712,642	8,561,352	11,312,549
48	L....	Tregti	4,722,684	12,061,653	18,767,527	25,212,272
49	K.....	Ndërtim	4,717,273	4,717,273	4,717,273	4,717,273
50	K.....	Tregti	4,672,772	4,672,772	4,672,273	4,672,273
51	L.....	Tregti	845,311	29,396,612	96,528,123	89,930,915
52	K.....	Ndërtim	389,520	13,000,324	17,741,028	18,347,176
53	K.....	Tregti	-	11,125,919	11,125,919	40,016,003
54	L.....	Shërbim	-	7,564,860	7,564,860	22,233,669
55	L....	Tregti	-	6,760,429	15,031,348	16,880,093
56	L.....	Tregti	4,034,957	6,666,236	9,378,370	11,364,956
57	L.....	Tregti	2,776,548	6,628,502	9,793,604	12,324,900
58	L....	Prodhim	3,056,725	6,362,795	11,885,002	11,668,759
59	J....	Tregti	-	6,161,381	6,161,381	9,355,768
60	L....	Shërbim	-	-	37,126,777	52,414,333
61	L.....	Prodhim	-	-	32,743,547	-
62	L....	Tregti	-	-	17,452,798	49,536,724
63	L.....	Tregti	-	-	17,284,822	30,114,529
64	L....	Prodhim	150,715	940,319	13,563,848	16,667,528
65	L....	Ndërtim	-	5,861,966	10,665,622	22,925,973
66	K....	Tregti	2,168,870	5,085,716	10,651,223	11,628,926
67	K.....	Prodhim	31,331	3,926,818	10,342,184	10,313,564
68	J.....	Shërbim	1,428,694	4,599,489	10,338,789	17,606,188
69	L.....	Prodhim	-	-	9,325,131	9,144,733
70	L....	Shërbim	2,899,158	5,384,126	9,031,486	1,412,469
71	L....	Tregti	-	-	910,536	136,254,444
72	K.....	Prodhim	-	-	-	64,890,321
73	L.....	Tregti	98,432	98,432	8,662,045	9,827,456
74	L.....	Prodhim	359	359	19,678	32,929,152
75	L....	Tregti	31,859	31,859	31,859	4,359,510
76	J....	Prodhim	-	3,618,864	8,471,627	385,140
	TOTAL i subjekteve Të zgjedhur		655,844,292	864,832,450	1,217,364,955	1,593,777,984
	TOTALI i tepricës kreditore		1,047,256,883	1,441,094,863	2,212,171,170	3,216,864,452
	% e subjekteve të përzgjedhur mbi totalin		62,6%	60%	55%	50%

Për sa më sipër konstatohet se për periudhën/ecurinë 3 vjecare në auditim (01.01.2018-31.12.2020) kemi subjekte me tepricë kreditore të pandryshuara ose në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat risin rikun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këta subjekte mbajnë peshën dhe teprica kreditore e tyre është trefishuar nga viti 2018 në vitin 2020.

Rritja e tepricave kreditore ndikon në performancë dhe në lidhje me deklaratat tatimore të tatimpaguesit.

Duke qënë se ky nr i kufizuar subjektësh (në raport me totalin) e tatimpaguesve të DRT Fier ka 50% të tepricës kreditore të TVSH-s, duhet të jenë objekt monitorimi dhe verifikimi.

Për këta subjekte duhet të bëhet verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

Kredia e tatimpaguesve për çdo lloj tatimi (nga deklaratat dhe nga mbi-pagesat)

Teprica kreditore e Tatim Fitimit në 31.12.2017

Nga të dhënat e marra lidhur me ecurinë e tepricës kreditore të Tatim Fitimit dhe veprimet e ndërmarra nga administrata e DRT-Fier mbi monitorimin dhe verifikimin e saj konstatohet si me poshtë:

Sipas të dhënave të disponuara Teprica kreditore më datë 31.12.2017 për Tatim Fitimin paraqitet në shumën:

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi(Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	118,733,948	32,947,298	151,681,246
Total	118,733,948	32,947,298	151,681,246

Të ardhurat tatimore për vitin 2017 në nr subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr subjekte	Statusi	Të ardhurat tatimore
1340	Aktiv	61,569,635
303	Pasiv	4,965,355
62	Kërkesë për c'regjistrim	1,501,501
15	C'regjistruar	131,000
1720	TOTAL	68,167,491

Mijë lekë

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C'regj Nr	Vlera	Të c'regj Nr	Vlera		
BM	1336	61,563,226	303	4,965,355	61	1,501,501	0	0	1700	68,030,082
BV me TVSH	2	1,147	0	0	0	0	0	0	2	1,147
Të tjera	2	5,262	0	0	0	0	15	131,000	17	136,262
TOTAL	1340	61,569,635	303	4,965,355	62	1,501,501	15	131,000	1720	68,167,491

Teprica kreditore e Tatim Fitimit në 31.12.2018

Rajon	Kredi	Mbi -Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	123,352,799	63,500,427	186,853,226
Total	123,352,799	63,500,427	186,853,226

Të ardhurat tatimore për vitin 2018 në nr subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr subjekte	Statusi	Të ardhurat tatimore
1564	Aktiv	66,420,229
240	Pasiv	1,460,517
57	Kërkesë për c'regjistrim	758,528
11	C'regjistruar	25,524
1872	TOTAL	68,664,798

Mijë lekë

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C'regj Nr	Vlera	Të c'regj Nr	Vlera		
BM	1563	66,420,229	240	1,460,517	56	755,922	0	0	1859	68,636,668
BV me TVSH	0	0	0	0	1	2,606	0	0	1	2,606
Të tjera	1	0	0	0	0	0	11	25,524	12	25,524
TOTAL	1564	66,420,229	240	1,460,517	57	758,528	11	25,524	1872	68,664,798

Teprica kreditore e Tatim Fitimit në 31.12.2019

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	128,361,843	109,662,236	238,024,079
Total	128,361,843	109,662,236	238,024,079

Të ardhurat tatimore për vitin 2019 në nr subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr subjekte	Statusi	Të ardhurat tatimore
1675	Aktiv	71,305,965

123	Pasiv	474,352
35	Kërkesë për c'regjistrim	319,307
2	C'regjistruar	66,506
1835	TOTAL	72,166,130

Mijë lekë

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C' reg Nr	Vlera	Të c' regj Nr	Vlera		
BM	1671	71,298,519	123	474,352	34	319,306	0	0	1828	72,092,177
BV me TVSH	1	0	0	0	1	0	0	0	2	0
Të tjera	3	7,446	0	0	0	0	2	66,507	5	73,953
TOTAL	1675	71,305,965	123	474,352	35	319,306	2	66,507	1835	72,166,130

Teprica kreditore e Tatim Fitimit në 31.12.2020

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	136,210,034	114,743,104	248,408,620
Total	136,210,034	114,743,104	248,408,620

Nga databaza e tepricave kreditore të Tatim Fitimit u përzgjedhën subjektet (49) me tepricën më të lartë kreditore për vitet 2017-2020 si në vijim:

Nr	NIPT	2,017	2,018	2,019	2,020
1	L....	15,502,199	15,502,199	15,502,199	15,502,199
2	L....	5,169,805	5,169,805	5,169,805	4,122,235
3	K....	3,280,666	3,305,666	3,305,666	3,305,666
4	J....	3,269,817	3,269,817	3,269,817	3,269,817
5	L....	2,076,176	2,171,932	2,171,932	2,096,396
6	K....	2,071,380	2,071,380	2,071,380	2,071,380
7	K....	1,999,944	1,999,944	1,999,944	1,999,944
8	K....	1,966,770	1,966,770	1,966,770	1,966,770
9	J....	1,786,553	1,786,553	1,786,553	1,786,553
10	K....	1,600,495	1,600,495	1,600,495	1,600,495
11	K....	1,578,544	1,578,544	1,578,544	1,578,544
12	J....	1,482,730	1,482,730	1,482,730	1,482,370
13	L....	1,434,497	1,434,497	1,980,698	1,980,698
14	K....	1,346,019	1,346,019	1,346,019	1,346,019
15	K....	1,329,635	1,738,058	1,738,058	1,372,137
16	K....	1,328,964	1,328,964	1,328,964	1,328,964
17	J....	1,309,835	1,309,835	1,309,835	1,309,835
18	K....	1,163,544	1,163,544	1,163,544	1,163,544
19	K....	1,043,268	1,043,268	1,043,268	1,043,268
20	K....	1,029,382	1,029,382	1,029,382	1,029,382
21	K....	1,026,046	1,026,046	1,026,046	1,026,046
22	K....	1,021,678	1,021,678	1,021,678	1,021,678
23	J....	1,004,662	1,087,744	1,087,744	1,051,216
24	K....	920,078	920,078	920,078	920,078
25	J....	907,237	907,237	907,237	907,237
26	L....	877,607	2,056,872	2,056,872	2,056,872
27	K....	874,548	874,548	874,548	874,548
28	L....	858,667	858,667	858,667	908,667
29	J....	836,302	836,302	836,302	861,370
30	K....	827,722	827,722	827,722	823,802
31	K....	818,530	818,530	818,530	818,530
32	L....	810,273	1,051,382	1,111,403	1,057,043
33	J....	788,513	788,513	788,513	788,513
34	K....	771,589	771,589	771,589	771,589
35	K....	760,944	760,944	760,944	741,700
36	K....	713,846	713,846	713,846	713,846
37	K....	696,436	696,436	723,586	723,586
38	J....	605,901	897,964	1,780,057	2,568,111
39	J....	599,782	761,494	761,494	761,494
40	J....	532,050	968,477	968,477	490,297
41	L....	502,061	502,061	1,179,204	1,285,795
42	J....	500,290	700,290	970,453	809,405
43	K....	171,992	2,533,536	3,336,324	3,336,324
44	J....	154,809	572,758	1,175,275	1,175,275
45	J....	38,800	38,800	4,579,731	3,000,835

46	J.....	1,777	289,763	1,994,150	1,967,186
47	K.....	1,528	1,528	1,047,207	839,711
48	J.....	887	1,210,301	1,210,301	1,210,301
49	K.....	695	695	1,762,138	1,194,470
	TOTAL i subjekteve të zgjedhur	69,395,473	76,795,203	89,715,719	86,061,741
	TOTALI i tepricës kreditore	151,681,246	186,853,226	238,024,079	248,408,620
	% e subjekteve të përzgjedhur mbi totalin	45,7%	41%	37,7%	35%

Kredia e tatimpaguesve për çdo lloj tatimi (nga deklaratat dhe nga mbi-pagesat)

Teprica kreditore e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin në 31.12.2017

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	11,413,888	11,970,735	23,384,623
Total	11,413,888	11,970,735	23,384,623

Të ardhurat tatimore për vitin 2017 në nr subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr subjekte	Statusi	Të ardhurat tatimore
6236	Aktiv	9,347,235
1334	Pasiv	1,064,762
1085	Kërkesë për c'regjistrim	1,010,842
871	C'regjistruar	723,784
9526	TOTAL	12,146,623

Mijë lekë

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr Total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C'regj Nr	Vlera	Të c'regj Nr	Vlera		
BM	346	1,824,687	32	169,981	14	83,636	0	0	392	2,078,305
BV me TVSH	1964	4,409,890	302	436,613	241	388,087	0	0	2507	5,234,590
BV pa TVSH	3926	3,112,658	1000	458,168	830	539,119	0	0	5756	4,109,945
Të tjera	0	0	0	0	0	0	871	723,783	871	723,783
TOTAL	6236	9,347,235	1334	1,064,762	1085	1,010,842	871	723,783	9526	12,146,623

Teprica kreditore e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin në 31.12.2018

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	11,707,894	13,979,198	25,687,092
Total	11,707,894	13,979,198	25,687,092

Të ardhurat tatimore për vitin 2018 në nr. subjektsh dhe sipas qarkullimit paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr subjekte	Statusi	Të ardhurat tatimore
6793	Aktiv	9,608,918
1033	Pasiv	679,758
898	Kërkesë për c'regjistrim	644,023
593	C'regjistruar	432,328
9317	TOTAL	11,365,027

Mijë lekë

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit									Nr total	Të ardhura tatimore Total
	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C'regj Nr	Vlera	C'regj Nr	Vlera		
BM	323	1,743,064	16	95,015	11	35,400	0	0	350	1,873,479
BV me TVSH	2149	4,521,360	286	294,832	227	282,181	0	0	2662	5,098,373
BV pa TVSH	4321	3,344,493	731	289,912	660	326,442	0	0	5712	3,960,847
Të tjera	0	0	0	0	0	0	593	432,328	593	432,328
TOTAL	6793	9,608,917	1033	679,759	898	644,023	593	432,328	9317	11,365,027

Teprica kreditore e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin në 31.12.2019

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	12,371,001	16,342,976	28,713,977

Total	12,371,001	16,342,976	28,713,977
--------------	------------	------------	------------

Të ardhurat tatimore për vitin 2019 në nr subjektsh dhe sipas qarkullimit siuate paraqiten si në vijim:

Mijë lekë

Nr subjekte	Statusi	Të ardhurat tatimore
7228	Aktiv	9,583,580
652	Pasiv	306,476
623	Kërkesë për c'regjistrim	412,044
325	C'regjistruar	158,699
8828	TOTAL	10,460,799

Mijë lekë

Lloji i tatimpaguesit sipas qarkullimit	Aktiv Nr	Vlera	Pasiv Nr	Vlera	Kërkesë C'reg Nr	Vlera	Të c'regj Nr	Vlera	Nr total	Të ardhura tatimore Total
BV me TVSH	2351	4,907,140	186	128,485	0	0	150	170,518	2687	5,206,143
BV pa TVSH	4705	3,522,439	463	142,586	467	194,850	0	0	5635	3,859,874
Të tjera	1	0	0	0	0	0	325	158,699	326	158,699
TOTAL	7228	9,583,580	652	306,476	473	241,527	475	329,217	8828	10,460,799

Teprica kreditore e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin në 31.12.2020

Rajon	Kredi	Mbi-Pagesë	Total Kredi (Lekë)
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	12,718,987	16,538,841	30,532,065
Total	12,718,987	16,538,841	30,532,065

Nga databaza e tepricave kreditore të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin u përzgjedhën 50 subjektet me tepricën më të lartë kreditore për vitet 2017-2020 si në vijim:

NR	NIPT	2,017	2,018	2,019	2,020
1	L....	1,556,737	1,556,737	1,556,737	1,556,737
2	K....	401,150	401,150	401,150	401,150
3	L....	255,169	255,169	255,169	255,169
4	K....	239,674	239,674	239,674	239,674
5	K....	207,098	207,098	207,098	207,098
6	K....	203,070	203,070	203,070	203,070
7	K....	184,334	184,334	184,334	184,334
8	K....	182,090	182,090	182,090	182,090
9	K....	180,223	180,223	180,223	180,223
10	K....	169,248	169,248	169,248	169,248
11	K....	168,750	168,750	168,750	168,750
12	K....	165,659	165,659	165,659	165,659
13	L....	162,651	162,651	162,651	162,651
14	K....	154,498	154,498	154,498	154,498
15	K....	142,424	142,424	142,424	142,424
16	K....	137,779	137,779	137,779	137,779
17	K....	135,710	135,710	135,710	135,710
18	L....	133,205	133,205	133,205	133,205
19	L....	125,439	125,439	125,439	125,439
20	K....	116,000	116,000	123,882	123,882
21	K....	113,478	113,478	113,478	113,478
22	K....	113,478	113,478	113,478	113,478
23	K....	109,145	109,145	109,145	109,145
24	L....	105,731	105,731	105,731	105,731
25	K....	105,000	105,000	105,000	105,000
26	K....	103,663	103,663	103,663	103,663
27	K....	101,478	101,478	101,478	101,478
28	K....	101,198	101,198	101,198	101,198
29	K....	100,695	100,695	100,695	100,695
30	K....	99,195	99,195	99,195	99,195
31	L....	93,021	93,021	93,021	93,021
32	K....	90,783	90,783	90,989	90,989
33	K....	90,430	90,430	90,430	90,430
34	K....	89,152	89,152	89,152	89,152
35	K....	87,170	87,170	87,170	87,170
36	K....	86,444	86,444	86,444	86,444
37	K....	85,652	85,652	85,652	85,652
38	K....	84,469	84,469	84,469	84,469
39	K....	83,750	83,750	83,750	83,750

40	K....	79,435	79,435	79,435	79,435
41	K....	79,184	79,184	79,184	79,184
42	L....	78,176	78,176	78,176	78,176
43	K....	78,050	78,050	78,050	78,050
44	K....	70,924	70,924	70,924	70,924
45	K....	69,316	69,316	69,316	69,316
46	L....	68,692	68,692	68,692	68,692
47	K....	67,239	67,239	67,239	67,239
49	K....	47,283	47,283	64,334	64,334
50	L....	23,481	23,481	108,342	-
	TOTAL i subjekteve të zgjedhur	7,526,620	7,526,620	7,636,620	7,528,278
	TOTALI i tepricës kreditore	23,384,623	25,687,092	28,717,977	30,532,065
	% e subjekteve të përzgjedhur mbi totalin	32%	29,3%	27%	25%

Në rastet e tepricave kreditore të TF dhe TFTH, konstatojmë se nuk është bërë kërkesa për kontroll ose verifikime nga zyra mbi treguesit e kasës, FDP-bilancë, akt-konstatime të DHT etj.

Biznes i madh me Humbje Tatimore mbi një vit

Grupi i auditimit ka përzgjedhur subjektet Biznes i madh me humbje të konsiderueshme në vitet 2017-2019 si në vijim. Disa prej subjekteve janë dhe me humbje në 3 vite me radhë. Nga grupi i auditimit është bërë dhe një kryqëzim me të dhënat e marra nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara ku ka rezultuar se disa prej tyre janë dhe debitorë si në vijim:

NIPT	Subjekti	Statusi	Humbja 2019	Humbja 2018	Humbja 2017	Vlera Debitorë deri në 31.12.2109
L....	Y	Aktiv	61,800,408	14,745,289		0
L....	Y	Aktiv	47,618,102			187,206
K....	Q.A	Aktiv	44,794,367			290,064
K	A.O	Aktiv	42,472,277	15,746,331	27,726,091	0
L	A.A	Aktiv	40,696,540	41,288,489	33,871,877	0
J	E	Aktiv	37,077,719	769,867		0
J	V.B	Aktiv	35,116,484		5,682,443	91,712
K	S	Aktiv	13,057,651		6,067,438	1,762,670
L	F.P.K	Aktiv	9,709,673	301,860	983,026	0
K	A.F	Pasiv	9,521,576	9,738,675		386,797
K	B	Aktiv	9,372,700			0
J	B	Aktiv	8,737,096			0
K	E	Aktiv	8,721,455			1,458,003
J	T	Aktiv	8,184,271			7,637,769
J	E	Aktiv	8,081,527			125,980
L	K.A	Aktiv	7,918,591			0
J	A	Aktiv	7,898,008	19,717,446	507,376	242,305
L	L	Aktiv	7,753,127	18,034,372		0
L	F.K	Aktiv	7,232,007			0
L	E	Aktiv	6,453,157			0
L	K	Aktiv	6,304,224			30,000
K	H	Aktiv	5,836,445	1,454,306	1,222,606	0
L	L	Pasiv	5,747,538			0
L	S.P.D	Kërk. Çregj	5,573,858		197,870	180,000
K	T	Aktiv	4,732,698			856,460
L	L.M	Aktiv	4,643,882			2,179,153
L	XH.T	Aktiv	4,015,673	251,856		4,860
L	E	Aktiv	3,762,129			0
L	E	Aktiv	3,688,173	7,140,606	14,716,424	0
K	U.K	Aktiv	3,578,063			51,630
K	S. G.	Aktiv	3,503,149		3,125	98,948
K	V.A	Aktiv	3,354,308		54,170	383,592
K	P.S	Aktiv	3,304,370	2,682,626		580,000
K	P.SHPK	Aktiv	3,197,188	2,428,031	2,780,676	59,921
J	N...	Aktiv	3,188,652	2,565,582	901,605	10,000
K	T.C	Aktiv	3,118,364	1,497,547		0
K	A.Q	Aktiv	2,974,539			0
L	A.E	Aktiv	2,617,731			187,891

K	A.L	Aktiv	2,592,790			116,006
L	LXH	Pasiv	2,584,291			1,069,805
K	E.P	Pasiv	2,514,869			669,270
L	S.C	Aktiv	2,478,574			0
K	P	Aktiv	2,350,813		331,398	1,537,965
K	F.F	Aktiv	2,284,656	3,450,495	2,528,918	0
L	A.R	Aktiv	2,276,145	3,253,271	5,692,197	0
L	E	Aktiv	2,096,928	424,756		509,728
L	P.B	Aktiv	2,074,562	693,890		0
L	B	Aktiv	1,872,340			0
L	AL	Aktiv	1,823,042	4,665,283		300,821
K	R.O	Aktiv	1,820,892			1,711,816
K	S.B	Aktiv	1,784,832			0
K	F.K. A	Aktiv	1,776,638	13,837,489	14,645,927	5,567,213
L	N	Aktiv	1,774,608	5,505,278		33,043
L	ALB	Pasiv	1,758,586	2,561,556	2,685,668	0
J	P	Aktiv	1,753,358	2,044,678	731,844	0
L	B.F	Aktiv	1,733,687			892,623
K	K	Aktiv	1,677,777	160,645		0
L	MP	Aktiv	1,655,556			0
K	A	Aktiv	1,629,082	1,356,071		0
K	S	Aktiv	1,615,852	326,832		31,683,857
L	M	Aktiv	1,544,920			7,262
L	B.L	Aktiv	1,544,649	2,218,118		0
K	D.N	Aktiv	1,514,920		1,023,300	0
L	F.K	Aktiv	1,493,741	1,448,462		0
K	I.S.	Pasiv	1,490,677	11,218	432,960	0
K	P.A	Pasiv	1,431,762			0
K	A.L	Aktiv	1,415,862	384,588		0
K	F	Aktiv	1,260,285		1,521,123	4,562,714
K	G 7	Aktiv	1,252,353	1,154,700	1,150,320	0
L	S.E	Aktiv	1,194,855	833,412		0
K	R.K	Aktiv	1,169,131			22,942
L	SSA	Aktiv	1,158,320			433,154
K	N.A	Aktiv	1,128,502	298,616		322,369
L	G.F.A	Aktiv	1,106,463	185,203		0
K	T.L	Aktiv	1,065,023			0
J	AR	Aktiv	1,043,099			0
K	I.Q	Aktiv	957,807		2,877,845	0
J	F	Pasiv	932,376	5,736,787	1,986,497	0
L	B.CH	Aktiv	851,438	1,965,432		139,132
J	A V N	Aktiv	794,582	350,611	5,900,411	3,331,808
K	A	Aktiv	783,727	754,281	783,440	2,250
L	R	Pasiv	719,458		7,939,139	0
K	A.D.F	Aktiv	655,700	1,678,857	932,816	18,650
L	C...	Aktiv	628,096	314,044	6,658,416	0
L	O.A	Pasiv	599,793	2,522,421		0
K	V	Aktiv	570,165		810,340	0
L	D.S	Aktiv	565,215		688,220	21,862
L	II	Pasiv	475,809	6,970,737		2,106,502
L	A.A	Aktiv	474,022	3,032,499		0
LE	N.C	Aktiv	404,765	6,802,709		0
K	A	Pasiv	375,782	493,591	1,064,668	0
L	P.G	Aktiv	358,026		2,139,691	10,450
K	W.I	Aktiv	280,279		435,436	0
L	S	Pasiv	266,638		141,565	0
K	A.P	Aktiv	247,645	15,381,237		578,005
K	H.L	Aktiv	242,235		450,113	0
J	K.S	Aktiv	188,008	545,404	677,934	0
L	L	Pasiv	175,380		242,736	0
K	O	Pasiv	153,920	256,900	7,245,392	506,966
K	V.L	Pasiv	47,857		2,424,188	0
L	D.O	Aktiv	28,417		246,050	0
J	S	Aktiv	21,006	802,177	6,111,375	6,168,274
K	B.C	Aktiv	17,368	348,096	434,169	0
J	R	Aktiv	15,279		212,212	2,842,993
	TOTAL		571,932,953	231,133,227	175,861,035	81,972,441

Për sa më sipër konstatohet se:

Humbja tatimore e vitit 2017 është në vlerën 175,861,035 lekë, vlerë e cila i përket 45 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2018 është në vlerën 231,133,227 lekë, vlerë që i përket 51 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2019 është në vlerën 571,932,953 lekë dhe u përket 104 subjekteve të marr në shqyrtim.

Nga 104 subjektet që rezultojnë me humbje, 48 prej tyre janë dhe debitorë kundrejt DRT Fier në vlerën 81,972,441 lekë. Nga administrata tatimore Fier nuk janë marr masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to. Humbjet në vlera të konsiderueshme në afatgjatë të cilat nuk arrijnë të verifikohen krijojnë risk të lartë jo vetëm për shmangien e dividendëve për tu shpërndarë në të ardhmen por ngrejne pikëpyetje edhe mbi burimet e financimit të këtyre humbjeve.

Biznes i vogël me Tatim të Thjeshtuar me Humbje Tatimore > 500,000 leke

Nga Biznesi i vogël, janë konstatuar 113 Biznese me Humbje Tatimore mbi vlerën 500,000 lekë, në vitet 2017-2018-2019. Humbja tatimore e vitit 2017 është në vlerën 62,854,904 lekë, vlerë që u përket 71 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2018 është në vlerën 65,746,530 lekë, vlerë që u përket 68 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2019 është në vlerën 44,519,187 lekë, vlerë që u përket 38 subjekteve. Konstatohen subjekte me humbje edhe 3 vite me radhë.

NIPT	Emri i Subjektit	Lloji Biz	Statusi	Humbja 2019	Humbja 2018	Humbja 2017
K	V.C	BV PA TVSH	Kërkesë Çregj	3,299,390	0	0
L	P.G	BV ME TVSH	Aktiv	3,206,929	2,833,873	1,380,000
L	A.C	BV ME TVSH	Kërkesë Çregj	3,035,892	0	0
K	A.L	BV ME TVSH	Aktiv	2,871,896	0	0
L	G	BM	Aktiv	2,533,450	0	0
L	A.S	BV PA TVSH	Aktiv	2,293,171	0	0
K	A.E	BV ME TVSH	Aktiv	2,264,270	934,946	0
L	E.F	BV PA TVSH	Kërkesë Çregj	1,918,441	0	0
L	E.E	BV ME TVSH	Aktiv	1,759,653	0	0
L	T	BV ME TVSH	Aktiv	1,641,560	910,089	773,481
L	A.M	BV ME TVSH	Aktiv	1,574,073	1,582,936	110,144
K	SH.B	BV ME TVSH	Aktiv	1,534,792	0	2,042,949
L	D	BV ME TVSH	Aktiv	1,407,127	293,441	0
L	S	BV ME TVSH	Aktiv	1,286,163	862,720	176,550
L	A.S	BV ME TVSH	Aktiv	1,256,005	0	0
L	M	BV ME TVSH	Aktiv	1,233,179	1,677,031	0
L	A.B	BV ME TVSH	Aktiv	1,230,000	0	83,440
L	T.H	BV ME TVSH	Aktiv	1,209,743	0	0
L	A.I	BV ME TVSH	Kërkesë Çregj	1,151,092	0	292,975
K	E.G	BV ME TVSH	Aktiv	1,037,206	1,018,886	0
K	M.T	BV PA TVSH	Aktiv	0	2,772,264	0
L	I.R	BV PA TVSH	Aktiv	0	2,652,000	0
L	A.K	BV ME TVSH	Pasiv		2,571,535	0
L	T.M	BV ME TVSH	Pasiv		2,353,025	0
L	K.B	BV ME TVSH	Pasiv		2,200,740	1,111,682
L	S.B	BV ME TVSH	Aktiv	0	1,879,187	0
L	S.S	BM	Aktiv		1,871,164	1,118,643
K	I.C	BV ME TVSH	Aktiv	497,596	1,830,492	402,801
L	H.T	BV ME TVSH	Aktiv	373,440	1,795,331	842,436
K	I.Y	BM	Aktiv		1,558,229	0
L	P.G	BV PA TVSH	Aktiv	0	1,475,531	0
K	E	BM	Aktiv	419,490	1,427,751	1,129,549
L	A.H	BV PA TVSH	Aktiv	0	1,416,158	0
K	Q.M	BV ME TVSH	Aktiv	0	1,397,887	2,248,287
L	A.K	BM	Aktiv	224,932	1,395,643	0
L	J.R	BV PA TVSH	Aktiv	461,337	1,339,674	0
L	AF	BV ME TVSH	Aktiv	0	1,334,720	1,295,944
L	A.O	BV PA TVSH	Aktiv	434,947	1,095,217	0
L	M.H	BV ME TVSH	Aktiv	0	1,052,634	0
Koment: Një pjesë e subjekteve kanë bërë ndërhyrje në deklaratë për sistemim dhe ri-deklarim të të ardhurave pas konstatimeve të bëra nga grupi auditimit. Diferencat e tjera të konstatuara nga grupi i auditimit sipas trajtimit të mësipërm pas komenteve/shpjegimeve të dhëna nga Inspektorët gjykon se është e nevojshme 1 rivlerësim pasi edhe pas testimeve të komenteve ka mospërputhje me regjistrimet në pasqyra financiare, një pjesë e subjekteve edhe për kontroll më të thelluar nëse ka pamundësi vlerësimi nga zyra. Përmendim gjithashtu faktin se ka subjekte që janë fasoneri dhe diferencat midis dy deklaratave janë të arsyeshme pasi fasoneritë deklarojnë vetëm hakun e punës por nga ana e Inspektorët duhet bërë një vlerësim nëse këto diferenca përfaqësojnë realisht hakun e punës apo jo, pasi për shkak të diferencave të larta janë subjekt me risk. Gjithashtu në lidhje me subjektet e ndërtimit shprehemi se diferenca e konstatuar nga grupi i auditimit është testuar në pasqyrat financiare pas komenteve nga ana e Inspektorëve (si diferencë parapagimesh/arkëtimesh në avancë) diferencë e cila në disa raste nuk është regjistruar ose nuk paraqitet në të njëjtën vlerë. Për sa më sipër grupi i auditimit nuk ka siguri të arsyeshme në lidhje me diferencat dhe vetëkorrigjimet nga ana e subjektit, të kryera pas dërgimit të kërkesave me email, bërë në datën 17.11.2020.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- z. O.C në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier
- z. A.K në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit periudha 07.12.2017-28.03.2019
- z. B.S në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit periudha 10.04.2019-31.12.2020
- znj. E.E në cilësinë e përgjegjësës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit
- Inspektorët sipas ndarjes së Nipteve bashkëlidhur në cdo konstatim

Shënim: Për praktikatat e konstatuara me problematika lënë me përgjegjësi inspektorët D.S, XH.B, L.C, të cilët kanë observuar në fazën e projekt raportit dhe janë marr në konsideratë

nga grupi auditimit, nga përgjegjësja e Sektorit të Monitorimit dhe Vlerësimit nga Zyra, të ndryshojë përgjegjësia dhe të kalojë te inspektorët përkatës.

Për sa më sipër është lënë akt konstatimi Nr.7 datë 29.03.2021, ndaj të cilit janë bërë observacione.

Në observacionin me nr.9253/110 prot datë 01.09.2021 (prot në KLSH me nr 844/76 datë 03.09.2021) G.M shprehet si në vijim:

Pretendimi i subjektit : “...Detyrimet bëhen 0 kur subjekti pranon kontrollin në zbatim të Nenit 68, 3.4 të Udhëzimit Nr.24 datë 02.09.2008 të Ligjit “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”..Në kuptimin e drejtë të Ligjit, vlerësimi tatimor nga zyra në rastet e mospranimit të kontrollit tatimor është subjektiv dhe këto detyrime shumëzohen me 0 momentin kur subjekti rregullon situatën (pranon kontrollin). Referuar situatës financiare dhe statusit të tij në gjykimin tim subjekti nuk përbënte rast evazioni..Në mbështetje të Nenit 71 4.9 të Udhëzimit Nr.24 datë 02.09.2008 të Ligjit “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë citoj “Rikarakterizimi i transaksionit dhe përdorimi i metodave alternative të vlerësimit për përcaktimin e detyrimit tatimor, në rastet kur aplikohet neni 71/2 i ligjit, në thelb është vlerësim alternativ nga administrata tatimore. Qëllimi i këtij vlerësimi është të përcaktojë sa duhet të ishte detyrimi ligjor i pagueshëm nga tatimpaguesi, nëse nuk do të ishim në kushtet e moskryerjes së veprimeve apo transaksione të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, apo evidentohen elementë që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore. Nëse nuk ka prova dhe fakte që jemi para një rasti të evazionit tatimor por vërehen elementë të shmangies tatimore “ligjore”, administrata tatimore nuk mund të aplikojë penalitetet e nenit 16 të Ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Në mbështetje të këtij neni gjobat në vlerësimin tatimor nga zyra për pengim kontrolli nuk mund të jenë 100% të vlerës së detyrimit dhe ndaj subjektit nuk mund të vazhdohen procedurat e evazionit tatimor. Gjithashtu për pengim kontrolli subjekti u penalizua me gjobë 1,000,000 lekë. Vlerësimi tatimor nga zyra është subjektiv (detyrimet mund të jenë të cdo madhsie) dhe këto detyrime shumëzohen me 0 në momentin kur subjekti rregullon situatën (pranon kontrollin) dhe në ligj nuk përcaktohet afat. Vlerësimi tatimor nga zyra në rastin e pengimit të kontrollit nuk duhet të jetë vlerësim që rrit efektivisht borxhin tatimor. Duhet theksuar se ortakët edhe administratori i shoqërisë janë me origjinë kineze dhe program kontrolli doli më 11.02.2020 në fillimin e pandemisë COVID-19 dhe bllokimin e tyre.

Për analogji sjellim në vëmendje të grupit të auditimit faqen 173-174 në konstatimin e bërë për subjektin SH... ku konstatohen diferenca në importe deklarime të subjektit me importet e ardhura nga DPD...grupi i auditimit i vlerëson dhe i llogarit me gjobën 21.9% sipas nenit 115 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008. Qëndrim me 2 standarte.

Grupi i auditimit ka kryer verifikimin në sistemin ASYCUDA të doganës dhe ka konstatuar që importet janë të përjashtuara nga detyrimet doganore dhe për tu rikthyer në origjinë...kundërshtoj argumentin si në vijim: “nuk kemi të drejta hyrje në sistemin Asycuda për të saktësuar statusin e importeve...Grupi i auditimit konstaton se në datën 23.07.2020 është bërë vlerësimi i detyrimeve në sistemin C@ts dhe është hedhur detyrimi i TVSH 4,349,049 lekë në vend të 14,496,830 lekë, Ky korrigjim është kryer pas konstatimeve nga ana e grupit të auditimit....Është e drejtë që në plotësimin e deklaratës është plotësuar rubrika 15 në vend të rubrikës 16, por vlera në deklaratë është po aq sa në akt kontrollu por mqns rubrika 15 është me shkallë tvsh 6%, kjo ka dhënë efektin në TVSH. Ky është një gabim njerëzor, i konstatuar në dhjetor 2020 gjatë raporteve përmbledhëse të akt-kontrolleve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket aplikimit të penalitetit për tatimin mbi vlerën e shtuar duhej referuar nenit 123 “Shkeljet për moslëshimin e faturave shoqëruese pika ë

“Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-n dënohen me gjobë prej 75,000 lekë, por jo me pak se vlera e TVSH-s së munguar, pra në masën 100%.

Për sa i përket aplikimit për tatimin mbi fitimin pranohet arsyetimi juaj për aplikimin e penalitetit referuar Nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore , gjobë të barabartë me 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për cdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për 1 periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Kjo duke qënë se është rivlerësim nga zyra dhe mund të bie poshtë dhe anulohet sapo personi i tatueshëm të rregullojë situatën e tij, duke lejuar dhe krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin e kontrollit tatimor, kjo konform përcaktimeve ligjore. Në lidhje me qëndrimin me 2 standarte të grupit të auditimit, sipas observacionit tuaj sqarojmë se çështjet janë të ndryshme nga njëra tjetra, si rrjedhojë edhe vlerësimi nga ana jonë, argumentuar si më lartë. Gjithashtu sqarojmë se mbajmë në konsideratë elementët e tjerë si rrjedhojë e situatës së krijuar nga COVID-19 në lidhje me kontrollin dhe kufizimet e mundshme, por gjithashtu sqarojmë se deri në këtë moment nuk disponojmë informacion se nga ana e subjektit janë krijuar aktualisht kushtet për ushtrim kontrolli apo jo. Në momentin e plotësimit të këtij kriteri, ashtu si dhe ju përmendni dhe pohoni në observacion, këto detyrime mund të zerohen në vijim (ose jo), duke qënë vlerësim alternativ nga zyra.

Për sa më sipër grupi i auditimi merr pjesërisht në konsideratë observacionin tuaj dhe u bën reflektimet përkatëse në material.

Titulli gjetjes	Diferenca pozitive dhe negative të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në bilancë me të ardhurat e deklaruara me deklaratat e tvsh-së në situatën financiare për periudhën 2017-2019.
Situata:	<p>Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (kontrolli nga zyra), u konstatua se, DRT-Fier nuk ka përbushur detyrimin për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me deklarim të pasaktë të (TF) Tatimit mbi Fitimin dhe (TVSH) Tatimin mbi vlerën e shtuar, jo në përputhje me përcaktimet ligjore e proceduralë të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Konstatimi i diferencave negative të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në formularin vjetor të TF me totalin e shitjeve të vetëdeklaruara nëpërmjet deklaratave të TVSH –së, kjo sipas situatës financiare për periudhat 2017-2019. Përkatesisht 28 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2017 në shumën 714,252 mijë lekë krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëjtin vit, 27 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2018 në shumën 1,232,651 mijë lekë krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëjtin vit, 52 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2019 në shumën 1,371,739 mijë lekë.</p> <p>Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 995,593 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përlllogaritur nga aplikimi i TF në shkallën 15% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.</p> <p>b) Në deklaratat vjetore të TF për vitin 2017 u konstatuan 28 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura më shumë në këtë deklaratë krahasuar me shitjet e deklaruara në situatën financiare të këtij viti, në shumën 369,729 mijë lekë, për vitin 2018 u konstatuan 58 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën 825,557 mijë lekë krahasuar me shitjet e deklaruara sipas situatës financiare vjetore, për vitin 2019 u konstatuan 58</p>

	<p>subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën 657,057 mijë lekë krahasuar me shitjet e deklaruar sipas situatës financiare vjetore.</p> <p>Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 740,937 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përlogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.</p> <p>Theksojmë se nga DRT Fier pas konstatimit të sipërm, gjatë periudhës së auditimit në terren dhe në vijim po kryhen akt-vlerësime si dhe vetëkorrigjime deklarave të TVSH dhe TF nga subjektet.</p>
Kriteri :	Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 71, Rregullore e Funksionimit të DRT-së, miratuar nga MFE me urdhër nr.19, datë 22.02.2017.
Ndikimi/Efekti	Një situatë e vazhdueshme për periudhën në auditim duke mos u shoqëruar me përmirësime në këtë proces, dhe duke krijuar vlera të munguara në buxhetin e shtetit në shumën e <u>1,736,530 mijë lekë.</u>
Shkaku:	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga Drejtori i Kontrollit dhe përgjegjësat respektivë dhe mosnxjerrje përgjegjësish në vazhdimësi për punonjësit sipas detyrave funksionale.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DRT Fier/Sektori i Kontrollit nga Zyra, të marre masa sipas legjislacionit në fuqi për të verifikuar subjektet e mbetur me diferenca midis deklarave të TVSH dhe TF, referuar anekseve bashkangjitur Raportit Përfundimtar, duke nxjerr akt-vlerësimet përkatëse me qëllim arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Titulli gjetjes	Diferenca të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruar në kasë me të ardhurat e deklaruar në deklaratat e tvsh-së në situatën financiare për periudhën 2018-2019.
Situata:	<p>Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (<i>kontrolli nga zyra</i>), u konstatua se, DRT-Fier nuk ka përbushur detyrimin për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me diferenca në qarkullim sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruar në TTFH-s dhe TVSH-s, jo në përputhje me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Për bizneset e vogla pa TVSH u konstatuan 530 subjekte për vitin 2018 me qarkullim sipas kasës me vlerë 116,290 mijë lekë më tepër sesa të ardhurat e deklaruar në TTFH dhe 347 subjekte për vitin 2019 me vlerë 90,761 mijë më të lartë sesa të ardhurat e deklaruar në TTFH.</p> <p><i>Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen parregullësi/mospërputhje, në të ardhurat e deklaruar për vitin 2018-2019 për 877 subjekte në vlerën 207,051 mijë lekë, por pa u shoqëruar me efekt financiar.</i></p> <p>b) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaraten e TVSH-së ku u konstatuan: 40 subjekte për vitin 2018 me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 44,118,079 lekë.</p> <p><i>Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 14,706 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përlogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.</i></p> <p>Për vitin 2019, u konstatuan 175 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 48,649 mijë lekë.</p> <p><i>Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej</i></p>

	<p>16,216 mijë lekë të ardhura të munguara, <u>vlërë kjo e përlogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.</u></p> <p>c) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-s, ku u konstatuan për vitin 2018, 36 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 95,455 mijë lekë.</p> <p><i>Këto diferencë, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 31,818 mijë lekë të ardhura të munguara, <u>vlërë kjo e përlogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.</u></i></p> <p>Për vitin 2019 u konstatuan 28 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH në vlerën 114,741 mijë lekë.</p> <p><i>Këto diferencë, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 38,247 mijë lekë të ardhura të munguara, <u>vlërë kjo e përlogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.</u></i></p> <p><i>(Trajtuar në fq 170-206 të Raportit).</i></p> <p><i>Theksojmë se nga DRT Fier pas konstatimit të sipërm dhe në vijim me dërgimin e observacioneve ndaj Projektraportit, u morën masa për nxjerrjen e akt-vlerësimeve, u kryen vetëkorrigjimet e deklaratave të TVSH dhe TFTH, si dhe u krye raportimi/sistemimi i gabimeve të pajisjeve fiskale/kasave nga subjektet.</i></p>
Kriteri :	Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 71, Rregullore e Funkcionimit të DRT-së, miratuar nga MFE me urdhër nr.19, datë 22.02.2017.
Ndikimi/Efekti	Një situatë e vazhdueshme për periudhën në auditim duke mos u shoqëruar me përmirësime në këtë proces, dhe duke krijuar vlera të munguara në buxhetin e shtetit në shumën e 100,987 mijë lekë.
Shkaku:	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga Drejtori i Kontrollit dhe përgjegjësat respektivë dhe mosnxjerrje përgjegjësish në vazhdimësi për punonjësit sipas detyrave funksionale
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DRT Fier/Sektori i Kontrollit nga Zyra, të marre masa sipas legjislacionit në fuqi për të verifikuar subjektet e mbetur me diferencë midis deklaratave të TVSH, TFTH dhe kasave fiskale, referuar anekseve bashkangjitur Raportit Përfundimtar, duke nxjerr akt-vlerësimet përkatëse me qëllim arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Titulli gjetjes:	Metodë e gabuar vlerësim alternativ detyrimi
Situata:	<p>Nga auditimi i akt kontrolleve në sistemin c@ts, mbajtur në datë 22.07.2020 konstatohet se subjektit K.O me Nipt L.....4G i është vlerësuar për vitin 2018 detyrimi i TVSH në vlerën 14,497 mijë lekë dhe i është vendosur penalitet 3,175 mijë lekë ndërsa për Tatimin mbi Fitimin i është vlerësuar detyrimi 518 mijë lekë dhe penaliteti në vlerën 113 mijë lekë.</p> <p>Konstatohet se deklarata e TVSH-s e plotësuar në datën 23.07.2020 është vlerësuar në vlerën 4,349 mijë lekë, dhe jo në vlerën 14,497 mijë lekë, për shkak se është plotësuar rubrika 15 në vend të rubrikës 16, veprim ky që ka krijuar diferencë, konstatuar nga auditimi.</p> <p>Korigjimi i deklaratës së TVSH-s është bërë nga Inspektori në datën 31.12.2020, duke shtuar diferencën e munguar prej 10,148 mijë lekë.</p> <p>Për efekt vlerësimi tatimor duke qënë se “<i>aktivet e blera nuk u gjenden në vendin e deklaruar të ushtrimit me vlerë prej 69,032,527 lekë u vlerësuan si të shitura me 5% të vlerës së blerë të të ardhurave të vitit 2017-2018</i>”.</p> <p>Duke qënë se për vitin 2017-2018-2019 nga ana e subjektit nuk janë dorëzuar</p>

	<p>Pasqyra Financiare, u bë kryqëzimi i librave të Blerjes dhe sistemit ASYCUDA të Doganës ku u konstatua si në vijim: <i>SUBJEKTI ka kryer dy importe me DAV IM 5: R 9883 dhe R 9884, datë 15.09.2017, në kodin e procedurës *5500*, “IMPORT I PËRKOHSHËM PËR RLP ME PËRJASHTIM”, me vlerë doganore respektivisht 26,188,063 dhe 22,055,216. Artikujt e importuar sa më sipër klasifikohen në kodin tarifor *84051000* të NKM-s me emërtimin pjesë e pajisjeve për gjenerimin e azotit, të cilat janë të përjashtuara nga detyrimet doganore pasi janë mallra për tu rikthyer në origjinë. Kanë statusin e mallrave jo shqiptare, për sa më sipër nuk mund të regjistrohen në bilancë si aktive, pasi nuk kanë asnjë detyrim në legjislacionin tonë përveçse duhet të respektojnë afatet e qëndrimit sipas kritereve të vendosura në RLP.</i></p> <p>Për sa më sipër duke qënë se aktivet janë gjetur në vendin e tyre duhej bërë verifikimi me doganën dhe vec ngarkesës së TVSH në import që u bën dogana, nga ana tatimore ajo përbën shitje pa faturë tatimore dhe penalizohet në masën 100% të vlerës në shitje ndërsa penaliteti i TF me vlerën 21.9%.</p> <p>Si rrjedhojë: <u>Vlera e detyrimit të TVSH</u> 72,484,153 * 20 % = 14,496,830 lekë <u>Gjoha TVSH</u> 14,496,830 * 100 % = 14,496,830 lekë (pika ë neni 123, ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar) <u>Vlera e detyrimit të TF</u> 72,484,153 * 15 % = 10,872,623 lekë <u>Gjoha TF</u> 10,872,623 * 21,9 % = 2,381,104 lekë</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Detyrimi TVSH në akt kontrolli</th> <th>Detyrimi TVSH në C@TS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Inspektori</td> <td>14,496,830</td> <td>4,349,049</td> </tr> <tr> <td>Audituesi</td> <td>14,496,830</td> <td>14,496,830</td> </tr> <tr> <td>Diferenca</td> <td>0</td> <td>10,147,781</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Gjoha TVSH</th> <th>Detyrimi TF</th> <th>Gjoha TF</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Inspektori</td> <td>3,174,805</td> <td>517,743</td> <td>960,397</td> </tr> <tr> <td>Audituesi</td> <td>14,496,830</td> <td>10,872,623</td> <td>2,381,104</td> </tr> <tr> <td>Diferenca</td> <td>11,322,025</td> <td>10,354,880</td> <td>1,420,707</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për sa më sipër grupi i auditimit e vlerëson gjobën e TVSH-s me 100% dhe gjobën e TF me 21.9%.</p>		Detyrimi TVSH në akt kontrolli	Detyrimi TVSH në C@TS	Inspektori	14,496,830	4,349,049	Audituesi	14,496,830	14,496,830	Diferenca	0	10,147,781		Gjoha TVSH	Detyrimi TF	Gjoha TF	Inspektori	3,174,805	517,743	960,397	Audituesi	14,496,830	10,872,623	2,381,104	Diferenca	11,322,025	10,354,880	1,420,707
	Detyrimi TVSH në akt kontrolli	Detyrimi TVSH në C@TS																											
Inspektori	14,496,830	4,349,049																											
Audituesi	14,496,830	14,496,830																											
Diferenca	0	10,147,781																											
	Gjoha TVSH	Detyrimi TF	Gjoha TF																										
Inspektori	3,174,805	517,743	960,397																										
Audituesi	14,496,830	10,872,623	2,381,104																										
Diferenca	11,322,025	10,354,880	1,420,707																										
Kriteri:	Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar																												
Impakti:	Ulur në mënyrë të padrejtë detyrimet e subjektit																												
Shkaku:	Është përzgjedhur metodë e gabuar vlerësimi.																												
Rëndësia:	E lartë																												
Rekomandimi:	DRT Fier, Sektori i Kontrollit nga Zyra të marra masa të menjëhershme për vlerësimin dhe rregullimin e situatës të tatimpaguesit “K.O” shpk.																												

Titulli Gjetjes	Monitorim i dobët i treguesve me risk që ndikojnë në mirëfunksionimin e punës së Sektori të Kontrollit nga zyra dhe Monitorimit
Situata:	<p>Nga auditimi në DRT Fier u konstatua se nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës, më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për periudhën e auditimit nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme. -Në lidhje me ndarjen e NIPT-ve, organizimin dhe monitorimin e Inspektorëve

	<p>nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.</p> <p>-Për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2020 konstatohen subjekte me tepricë kreditore të pandryshuara ose në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim, të cilat risin rikun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Teprica kreditore e tyre është trefishuar nga viti 2018 në vitin 2020. Fakti që teprica kreditore nuk ndryshon apo ka pësuar rritje ndikon në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Duke qënë se ky numër i kufizuar subjektesh kundrejt totalit të tatimpaguesve të DRT Fier, zë rreth 50% të tepricës kreditore të TVSH-s, duhet të jenë objekt monitorimi dhe verifikimi. Për subjektet duhet të bëhet verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.</p> <p>-Nga kryqëzimi i të dhënave të marra nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara u konstatuan subjekte të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit të cilë rezultojnë edhe debitorë kundrejt DRT Fier. Humbja tatimore e vitit 2017 është në vlerën 175,861 mijë lekë, vlerë e cila i përket 45 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2018 është në vlerën 231,133 mijë lekë, vlerë që i përket 51 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2019 është në vlerën 571,933 mijë lekë dhe u përket 104 subjekteve të marr në shqyrtim. Nga 104 subjektet që rezultojnë me humbje, 48 prej tyre janë dhe debitorë kundrejt DRT Fier në vlerën 81,972 mijë lekë. Nga administrata tatimore Fier nuk janë marr masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to. Nga Biznesi i vogël, janë konstatuar 113 Biznese me Humbje Tatimore mbi vlerën 500 mijë lekë, në vitet 2017-2018-2019. Humbja tatimore e vitit 2017 është në vlerën 62,855 mijë lekë, vlerë që u përket 71 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2018 është në vlerën 65,747 mijë lekë, vlerë që u përket 68 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2019 është në vlerën 44,519 mijë lekë, vlerë që u përket 38 subjekteve. Konstatohen subjekte me humbje edhe 3 vite me radhë. Për sa më sipër konstatohet një monitorim i dobët për këto biznese, veçanërisht për kategorinë Biznes i madh, i cilësuar me risk të lartë. Nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Vlerësimit nuk dokumentohen shkresa për kalimin/propozimin e kontrolleve në Drejtorinë e Kontrollit.</p> <p><i>Për asnjë biznes të madh nuk konstatohet që nga ana e DRT Fier të jenë shpallur procedurat e falimentimit sipas përcaktimeve ligjore në Nenin 16, Ligji Nr.110/2016 datë 27.10.2016 "Për falimentimin".</i></p> <p>-Konstatohen 42 biznese për të cilët DRT Fier jo në përputhje me Vendimin nr. 652, datë 10.11.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", neni 2, pika 1, nuk u është ndryshuar përgjegjësia Tatimore për të kaluar me TVSH.</p> <p>-Konstatohen subjekte që kanë ndryshuar me vonesë përgjegjësinë tatimore për të kaluar në Biznes i Madh. Konstatohet gjithashtu një monitorim jo efektiv i deklaratave mujore të qarkullimit sipas TVSH-s, me qëllim ndryshimin e përgjegjësisë. Kjo evidentohet nga kryqëzimi i të dhënave të qarkullimit sipas deklaratave mujore të TVSH, me datat e ndërrimit të përgjegjësisë dhe gjithashtu me deklarin vjetor të të ardhurave në deklaratën e TTHF dhe TF.</p> <p>-Për një pjesë të konsiderueshme të subjekteve kërkesat për ulje të kësteve të tatim fitimit janë të paargumentuara dhe të mbështetura dhe miratimi i tyre nga ana e Inspektorëve është bërë pa një monitorim të plotë veçanërisht në nivelin e qarkullimit të shitjeve, ku është risku i rritjes së xhiros por i uljes së tatim fitimit.</p>
Kriteri :	Manuali i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi

Ndikimi/Efekti	Problemtika që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës, mosvlerësimin korrekt të veprimtarisë dhe shmangie nga detyrimet tatimore
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Spektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi të marr masa të menjëhershme për vlerësimin e problematikave të nxjerra gjatë auditimit me qëllim vlerësimin e treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës. Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të marr masa për hartimin e planeve mujore të punës dhe monitorimin rigoroz të tyre referuar kalendarit tatimor të deklarimit të tatimpaguesve.

Titulli Gjetjes	Problematika në lidhje me pagesën e Tatimit mbi dividendin
Situata:	Nga auditimi u konstatuan 10 subjekte që në kundërshtim me Ligjin Nr.94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, në nenin 38 “Dispozita Kalimtare”, pika 9 e cila citon se “Norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8% do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019 dhe në rast të mosrespektimit të këtij kushti dividenti do të tatohet në masën 15%, kanë përfituar nga pagesa prej 8% ndërkohë që pagesat e tatimit mbi dividendin për vitin 2018 i kanë kryer pas datës 20 gusht 2019, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit të ardhura të munguara në vlerën 5,709 mijë lekë.
Kriteri :	Ligjit Nr.94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, në nenin 38 “Dispozita Kalimtare”, shtohet pika 9
Ndikimi/Efekti	Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 5,709 mijë lekë.
Shkaku:	Moszbatim i përcaktimeve ligjore dhe mungesa e rivlerësimit nga ana e Inspektorëve
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	DRT Fier të marr masa për rivlerësimin e detyrimit të subjekteve sipas anekseve përkatëse në raportin e auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve në buxhetin e shtetit.

Titulli gjetjes:	Problematika në lidhje me Subjektet e përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar
-------------------------	--

Situata:	Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, u konstatua se, jo në përputhje me Udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 12.06.2015 <i>“Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e tvsh-së, si dhe procedurat e përjashtimit”</i> për subjektet e përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar, nuk është dorëzuar kopje e marrëveshjes dhe kontratës, por vetëm autorizimi nga AKBN. Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat/vlerat për përjashtim nga TVSH sipas subjekteve dhe viteve përkatëse të miratuara në autorizim dhe vlerave që rezultojnë në deklaratën e TVSH-s, kategoria <i>“shitje të përjashtuara nga TVSH”</i> , <i>“shitje pa TVSH”</i> dhe <i>“Eksporte”</i> , ku për subjektet sipas anekseve përkatëse në Raportin e auditimit janë vlerësuar detyrime në vlerën 12,848 mijë lekë dhe penalitet 100% në vlerën 12,848 mijë lekë.
Kriteri :	Udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 12.06.2015 <i>“Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e tvsh-së, si dhe procedurat e përjashtimit”</i>
Ndikimi/Efekti	Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 25,696 mijë lekë
Shkaku:	Moszbatim i dispozitave ligjore dhe mosmarrja e masave nga e Inspektorëve për rivlerësim të detyrimeve
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	DRT Fier të marre masa për rivlerësimin e detyrimit të subjekteve sipas anekseve përkatëse në raportin e auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve në buxhetin e shtetit.

Shënim: Në lidhje me konstatimet mbi kontrollin në vend dhe nga zyra, nga subjekti janë dërguar observacionet me shkresat: nr 9253/108 prot datë 01.09.2021, nr 9253/114 datë 03.09.2021, nr 9253/113 datë 02.09.2021, nr 9253/119 datë 03.09.2021, nr 9253/118 datë 03.09.2021, nr 9253/107 datë 01/09/2021, nr 9253/111 datë 01.09.2021, nr 9253/116 datë 03.09.2021 dhe 9213/21 datë 05.07.2021, nr 9253/126 datë 07.09.2021, për projektraportin. Gjithashtu nga takimi ballafaques me përfaqësuesit e DRT Fier, në ambjentet e KLSH datë 15.09.2021, subjekti ngriti pretendimet në lidhje me diferencat midis deklaratave që kanë krijuar të ardhura të munguara, për të cilat grupi i auditimit rekomandon nxerrjen e akt-vlerësimeve me qëllim arkëtimin e tyre. Duke qënë se nga momenti i konstatimit deri në përgatitjen e Raportit Përfundimtar DRT Fier ka marre masa duke nxjerr akt-vlerësime dhe gjithashtu nga ana e subjekteve ka patur vetëkorrigjime deklaratash apo janë konstatuar me diferenca fasoneri, diferenca të cilat janë vlera në material porositeti, nga subjekti u pretendua që rekomandimi të rishikohet duke u kërkuar sistemimi i pjesës tjetër sipas anekseve.

Grupi auditimit merr sqaron se çdo sistemim/rregullim etj. i bërë gjatë kësaj faze, duhet të jetë objekt monitorimi nga strukturat e DRT Fier dhe auditimeve të KLSH në të ardhmen. Në lidhje me pretendimet u pasqyruan në këtë raport përfundimtar auditimi.

II/2.1.2 Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Evidencat e borxhit për periudhën 01/01/2018 - 30/09/2020*

2. *Plane/analiza të Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara 2018-2019-2020*
3. *Manual i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë;*
4. *Rregullorja e funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale*
5. *Dosje të subjekteve debitorë*
6. *Databaza e akt-marrëveshjeve*

Cdo dokumentacion i cilësuar i nevojshëm për përpunimin e materialit.

Baza Ligjore

- ✓ Ligji nr.33/2017, datë 19.04.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/ shuarjes së detyrimeve tatimore”.
- ✓ Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 I ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 1234, datë 16.12.2009 “Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguroese dhe/ ose barrën hipotekore”;
- ✓ Urdhër nr. 19, datë 22.02.2017 i Ministrit të Financave: “Rregullore për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore”;
- ✓ Udhëzimi nr.14, datë 03.05.2017 “Për zbatimin e ligjit nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë , si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/ shuarjes së detyrimeve tatimore”;
- ✓ Manual i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Administrata Tatimore sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI , nenet 88-104, ka detyrimin ligjor nëpërmjet ushtrimit të kompetencës të mbledhë detyrimin tatimor të papaguara brenda afateve ligjore sipas burimeve të krijimit. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara.**Drejtoria/Spektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara** në DRT ka si objektiv kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore te papaguara, menaxhimin e borxhit me qëllim reduktimin e tij dhe moskrijimin e borxhit të ri.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT është e organizuar dhe funksionon në zbatim “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar me Urdhërin nr.19, datë 22.02.2017.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DRT ka si objektiv kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore te papaguara, menaxhimin e borxhit me qëllim reduktimin e tij dhe moskrijimin e borxhit të ri.

Detyrat kryesore të kësaj strukture janë:

- ✓ *Përbush detyrat dhe funksionet duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve;*
- ✓ *Mban në monitorim dhe ndjek borxhin duke synuar uljen e tij, veçanërisht të borxhit të ri, por edhe atë të vjetër në të njëjtën kohë; etj.*

Drejtoria/Spektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë Rajonale ka si objektiv kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe deklaratave të padorëzuara, dhe ka këto funksione:

- Funksioni i menaxhimit të Programit të Detyrimeve të Papaguara dhe Deklaratave të Padorëzuara(DePa) sipas sistemit informatik C@TS:

Ky funksion menaxhon procedurat që lidhen me përdorimin e “Programit të Detyrimeve të Papaguara dhe Deklaratave të Padorëzuara” dhe zbatimin e hapave të parashikuara për përpunimin e rasteve, përfshirë:

- ✓ Gjenerimin e rasteve të detyrimeve tatimore të papaguara.
- ✓ Gjenerimin e rasteve të deklarave të padorëzuara.
- ✓ Kalimin e rasteve të deklarave tatimore të padorëzuara dhe detyrimeve tatimore të papaguara tek inspektorët e mbledhjes nga zyra dhe inspektorët e mbledhjes në terren.
- ✓ Menaxhimin e sistemit të informacionit të DePa-s.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Struktura e DMDTP (ish DMF) ka funksionuar me Urdhërin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, me Urdhërin e ri nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126 datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore Qëndrore” dhe me Urdhër nr.86, datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, të ndryshuar, në lidhje me DMDTP-në, struktura paraqet ndryshimin vetëm në emërtesë: Nga Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtori e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhër.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore” përcakton rregullat dhe detyrat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet, ndërmjet njësisve të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetet në DPT dhe DRT. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ka të miratuar në strukturë 8 punonjës: 1 Drejtor Drejtorie, 1 përgjegjës sektori, 6 inspektorë të parë.

Si ka funksionuar Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore (ish DMF) krahasur me strukturën e miratuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier.

Struktura e miratuar me Nr.126 datë 02.08.2016 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”

Drejtoria e Mbledhjes me forcë 2018	Gjthsej 14 punonjës Të miratuar	Fakt 9
Drejtor Drejtorie	1	22.12.2016 - 18.4.2019 Delegim Z.SH 26.04.2019 – vazhdim Drejtor Drejtorie A.A
Zyra e Marrëveshjeve	2	-
Spektori i Menaxhimit dhe Analizës së detyrimeve të papaguara	1 përgjegjës Sektori 10 inspektor	8 punonjës në pozicionin Inspektor

Me Urdhërin nr.86 datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore” Drejtoria e Mbledhjes më forcë emërtohet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Struktura e miratuar me Urdhërin Nr. 33 date 12.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, është miratuar si në vijim, dhe plotësimi i strukturës ka përfunduar në datën 03.08.2020. Pra për periudhën 12.02.2020-03.08.2020 struktura ka patur 9 punonjës fakt nga 26 plan.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara 2020	Gjthsej 26 punonjës Të miratuar	Fakt 30.09.2020 24
Drejtor Drejtorie	1	1
Spektori i procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë	1 përgjegjës Sektori 10 Inspektor	1 përgjegjës Sektori 10 Inspektor
Spektori i Monitorimit, Analizës për masat shtrënguese	1 përgjegjës Sektori 6 Inspektor	- 6 Inspektor
Spektori i Zbatimit të masave shtrënguese në Terren	1 përgjegjës Sektori	-

	6 Inspektor	6 Inspektor
--	-------------	-------------

Nr.	Funksioni	Emri	Mbiemri	Data e fillimit te punes ne kete pozicion	Dorezimi	Delegim kompetencash
1	Drejtor Drejtorie	Z	Sh	22.12.2016	18.04.2019	Delegim kompetencash
	Inspektor i dyte	Z	Sh	26.12.2019	19.08.2020	Delegohet me urdher te Dr. Rajonal Insp.Kontrolli
2	Drejtor Drejtorie	A	A	26.04.2019	vazhdim	
3	Inspektor i dyte	F	Xh	21.11.2019	vazhdim	
4	Pergjegjes Sektori	E	K		20.09.2018	Delegim kompetencash
	Pergjegjes Sektori	E	K	20.09.2018	vazhdim	
5	Inspektor i dyte	E	Sh			
6	Inspektor i dyte	F	H	13.08.2018	15.02.2019	
7	Inspektor i dyte	F	K			
8	Inspektor i dyte	M	GJ		25.04.2017	
9	Inspektor i dyte	N	T		25.06.2019	
10	Inspektor i dyte	O	K	16.04.2019	vazhdim	
11	Inspektor i dyte	L	R		27.09.2017	
12	Inspektor i dyte	N	Ll	20.10.2017	Vazhdim	
13	Inspektor i pare	T	R		13.08.2018	
14	Inspektor i pare	F	D		03.09.2018	
15	Inspektor i dyte	V	Gj	14.03.2019	Vazhdim	
16	Inspektor i dyte	G	H	17.04.2019	28.08.2020	
17	Inspektor i dyte	E	S	26.04.2019	vazhdim	
18	Specialist	E	S		25.04.2019	

Struktura e plotësuar në 03.08.2020 rezulton si në vijim:

Nr.	Funksioni	Emri	Mbiemri	Kategoria e Pagës	Data e fillimit të punës në tatime
	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Jugor (Gjithsej punonjes)			26	
1	Drejtor Drejtorie	A	A	III-a.1	05.03.2014 dhe 27.12.2010-03.04.2013 Përgj. Sektori
	Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë			11	
1	Pergjegjes Sektori	E	K	III-b	16.01.2009
1	Inspektor i dytë	A	M	IV-a	11.08.2020
2	Inspektor i dytë	A	I	IV-a	01.09.2020
3	Inspektor i dytë	E	S	IV-a	14.08.2009
4	Inspektor i dytë	E	Sh	IV-a	15.05.2009
5	Inspektor i dytë	F	K	IV-a	22.04.2011
6	Inspektor i dytë	M	D	IV-a	27.08.2020
7	Inspektor i dytë	M	M	IV-a	27.08.2020
8	Inspektor i dytë	P	Z	IV-a	14.08.2020
9	Inspektor i dytë	R	K	IV-a	01.09.2020
10	Inspektor i dytë	K	Ll	IV-a	14.03.2019 (ekselent)
	Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese			7	
1	Pergjegjes Sektori			III-b	
1	Inspektor i dytë	A	K	IV-a	08.08.2020
2	Inspektor i dytë	A	D	IV-a	11.08.2020
3	Inspektor i dytë	F	M	IV-a	18.08.2020
4	Inspektor i dytë	N	Ll	IV-a	20.10.17- vazhdim
5	Inspektor i dytë	O	K	IV-a	16.04.2019- vazhdim
6	Inspektor i dytë	A	M	IV-a	17.09.2020
	Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese			7	
1	Pergjegjes Sektori			III-b	
1	Inspektor i dytë	E	M	IV-a	18.08.2020
2	Inspektor i dytë	E	Ç	IV-a	11.08.2020
3	Inspektor i dytë	L	Xh	IV-a	11.08.2020
4	Inspektor i dytë	Z	Sh	IV-a	21.01.2009
5	Inspektor i dytë	F	X	IV-a	21.11.2019 (ekselent)
6	Inspektor i dytë	V	Gj	IV-a	14.03.2019 (ekselent)

Konkluzion:

✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Fier gjatë vitit 2018 dhe deri në datën 18.04.2019 për shkak të vendit vakant të pozicionit Drejtor, ka funksionuar me delegim, në mungesë të plotësisimit të tyre sipas procedurave ligjore. Delegimi kompetencave është një instrument ligjor i cili parashikohet të përdoret për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për t'u përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndëruar në një mekanizëm të përhershëm. Për sa kohë Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, ndalon delegimin e detyrave të caktuara të një pozicioni pune nuk mundet këto pozicione të mbahen nga nëpunës të deleguar në periudha afatgjata apo një vjeçare, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni.

✓ Delegimet e kryera me Urdhër të Drejtorit Rajonal (rasti i Z.SH) janë kryer pa qënë në kompetencë të tij.

✓ Mungesa e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale, e Përgjegjesit të Sektorit (zëvendësimi me delegim) dhe disa inspektorëve gjatë periudhës së auditimit 2018-2020 ka bërë që të mos sigurohet mbikëqyrje e plotë e punës. Vendet e lira të punës tregojnë mangësi në procesin e realizimit të strukturës së miratuar. Mosplotësimi me staf i kësaj drejtorie shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës.

Niveli i Borxhit tatimor, niveli i arkëtimeve, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi.

Konsiderohet borxh tatimor:

-Detyrimi tatimor i vetëdeklaruar nga tatimpaguesit dhe i papaguar brenda afatit ligjor.

-Detyrimi tatimor i vlerësuar nga administrata tatimore në përfundim të një kontrolli tatimor, verifikimi apo çdo procedure tjetër ligjore, i papaguar brenda afatit ligjor.

Për periudhën objekt auditimi , periudha 01.08.2018-30.09.2020, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, situata e gjendjes në fillim, krijimi i detyrimit, arkëtimit dhe gjendjes në fund të detyrimit të paarkëtuar pasqyrohet si në vijim:

1.Të dhënat progresive 2018-2019-2020

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2018		SHTIME Janar - Dhjetor 2018		PAKËSIMË						GJENDJA 31.12.2018		PROCES GJYQ	
					Arkëtuar 2018		Sistemime		Falur Ligji 33/2017					
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
Fier	9,520	2,370,748	8,478	1,175,665	9,829	833,036	-	-	38	1,718	8,600	2,711,659	27	208,019

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2018 është 2,370,748 mijë lekë që i përkasin

9,520 subjekte. Referuar arkëtimeve gjithsejt të realizuara nga DRT Fier janë 833,036 mijë lekë në vitin 2018, që u përkasin 9,829 subjekteve. Nga Ligji Nr.33/2017 janë falur 1,718 mijë lekë, vlerë që i përket 38 subjekteve. Gjendja e detyrimeve të papaguara **në fund të vitit 2018 është 2,711,659 mijë lekë që i përkasin 8,600 subjekteve**. Pra borxhi në 31.12.2018, krahasuar me 01.01.2018 është rritur me 340,911 mijë lekë.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2019		SHTIME Janar - Dhjetor 2019		PAKËSIMË						GJENDJA 31.12.2019		PROCES GJYQ	
					Arkëtuar2019		Sistemime		Falur Ligji 33/2017					
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
Fier	8,600	2,711,659	8,793	1,235,810	6,848	749,309	331	210,472	-	-	10,214	2,987,688	27	208,019

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2019 është 2,711,659 mijë lekë që i përkasin 8,600 subjekteve. Referuar arkëtimeve gjithsejt të realizuara nga DRT Fier janë

749,309 mijë lekë në vitin 2019 që u përkasin 6,848 subjekteve. Detyrimi është pakësuar në vlerën 210,472 mijë lekë edhe nga sistemimet, vlerë që i përket 331 subjekteve. Gjendja e detyrimeve të papaguara **në fund të vitit 2019 është 2,987,688 mijë lekë, që i përkasin 10,214 subjekteve.** Pra borxhi në 31.12.2019, krahasuar me 01.01.2019 është rritur me 276,029 mijë lekë.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2019	
	Nr	Vlera
Fier	10,214	2,987,688

Me Ristrukturimin që ka kaluar Institucioni me Urdhërin e Kryeministrit nr.33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës Organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, me strukturën e re Drejtoria e Borxhit është emërtuar Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Jugor). Ky Rajon përfshin Fierin, Vlorën, Sarandën, Gjirokastrën, Beratin.

Për këtë arsye vlera e borxhit në vijim paraqitet jo për Drejtorinë Rajonale Fier, por për Rajonin Jugor.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2020		SHTIME Janar -Dhjetor 2020		PAKËSIMET						GJENDJA 31.12.2020		PROCES GJYQ	
					Arkëtuar 2020		Sistemime		Falur					
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	VI	Nr	Vlera	Nr	Vlera
Rajon Jugor	29,010	8,398,207	24,085	2,160,009	22,173	1,995,747	244	104,322	-	-	30,678	8,458,147	61	398,431

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2020 për Rajonin Jugor është 8,398,207 mijë lekë që i përkasin 29,010 subjekteve. Nga këto 2,987,688 mijë lekë është detyrim i papaguar i Drejtorisë Rajonale Fier dhe u përket 10,214 subjekteve. Referuar arkëtimeve gjithsej të realizuara nga DRT Fier deri në 31.12.2020 janë në shumën prej 1,995,747 mijë lekë që u përkasin 22,173 subjekteve. Detyrimi është pakësuar edhe në vlerën 104,322 mijë lekë, vlerë që i përket 244 subjekteve në formën e sistemimeve.

Gjendja e detyrimeve të papaguara **në fund të vitit 2020 është 8,458,147 mijë lekë, që i përkasin 30,678 subjekteve.**

Trendi për detyrimet, për vitin 2018-2019 paraqitet me një rritje të ndjeshme: në masën 10,18.% në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018.

Trendi për arkëtimet, për vitin 2018-2019 paraqitet me një ulje të ndjeshme: në masën 10 % në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018.

Duke analizuar të dhënat nisur nga zbatimi i ligjit rezulton se detyrimet e papaguara tatimore të raportuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore nga viti 2018-2019-2020, është përfshirë dhe vlera e cila faktikisht nuk është kthyer në detyrim dhe që i përket çështjeve që janë në proces gjyqësor e konkretisht:

- vlera e proceseve gjyqësore 208,019 mijë lekë dhe i përket 27 subjekteve, viti 2018
Për këtë subjekt është bërë akt marrëveshje me këste me shkresën Nr.5176/2 Prot datë 29.03.2018 për detyrimin global në vlerë 250,000 dhe tatim fitimin në vlerë 13,753,013 lekë, pra në total për detyrimin 14,003,013 lekë. Në kundërshtim me dispozitat ligjore kjo marrëveshje është lidhur pas pagimit të subjektit të vlerës 87,123 lekë me mandatë pagesën e datës 23.03.2018 lekë, duke mosrespektuar detyrimin për lidhje marrëveshje pas pagimit të 20% të detyrimit. Vlera e papaguar prej 2,713,479 lekë. Konstatohet gjithashtu se ky subjekt nuk është raportuar në databazën e regjistrimit të akt-marrëveshjeve.

9.SUBJEKTI AD... NIPT L....

Për këtë subjekt masat e marra për periudhën objekt auditimi janë:

Shkresa nr.16468 prot datë 16.10.2017 lënda njoftim tatimpaguesit në lidhje me detyrimin.

Shkresa nr.12487 prot datë 11.08.2017 lënda urdhër bllokim i llogarive bankare, drejtuar 16 Bankave.

Shkresa nr.6357 prot datë 18.04.2018 lënda urdhër bllokim i llogarive bankare, drejtuar 16 Bankave.

Shkresa Nr.2167 prot datë 07.02.2019 prot datë 07.02.2019 drejtuar 14 Bankave me lëndën urdhër bllokim i llogarive bankare.

10.SUBJEKTI S... NIPT L....

Për këtë subjekt masat e marra për periudhën objekt auditimi janë:

Shkresa nr.12494 prot datë 11.08.2017 me lëndën urdhër bllokim i llogarive bankare, drejtuar 16 bankave.

Shkresa nr.15407 prot datë 14.09.2018 me lëndën kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shkresa nr.15407 prot datë 14.09.2018 lënda njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore drejtuar Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme.

Shkresa nr.15407 prot datë 14.09.2018 lënda urdhër bllokim i llogarive bankare dhe kërkim informacioni, drejtuar 15 Bankave.

Shkresa nr.15407 prot datë 14.09.2018 lënda njoftim për vendosjen e barrës siguruese, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

11.SUBJEKTI KFL NIPT L....

Për këtë subjekt masat e marra për periudhën objekt auditimi janë:

Shkresa nr.17477 prot datë 30.10.2017 me lëndën njoftim dhe kërkesë për të paguar drejtuar tatimpaguesit.

Shkresa nr.7213 prot datë 07.05.2019 njoftim dhe kërkesë për të paguar.

Shkresa nr.2167 prot datë 07.02.2019 lënda urdhër bllokim i llogarive bankare, drejtuar 14 Bankave.

12.SUBJEKTI D... NIPTI L....

Masat e fundit të marra për këtë subjekt janë me shkresën nr.15252 prot datë 12.09.2018 me lëndën urdhër bllokim i llogarive bankare dhe kërkim informacioni drejtuar 15 bankave.

Shkresa është e pavulosur.

Për sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur konstatohet se nga 13 llojet e masave shtrënguese nga ana e DRT Fier, masat e zbatuara për subjektet debitorë janë si në vijim:

Nr	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Zbatuar	Pazbatuar
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	Zbatuar	
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	Zbatuar	
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	Zbatuar	
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	Zbatuar	
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	Zbatuar	
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	Zbatuar	
8	Urdhër sekuestrimi		Pazbatuar
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë		Pazbatuar
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta, nenit 98		Pazbatuar
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administr.		Pazbatuar
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë		Pazbatuar
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB		Pazbatuar
14	Konfiskimi		Pazbatuar
	Totali		

✓ Nga sa më sipër konkludohet se, mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarrja për arkëtimin e borxhit të tatimpaguesve më të mëdhenjë të DRT-s Fier, të marra në shqyrtim, si dhe moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese ka shkaktuar që stoku i borxhit të vijojë me rritje.

✓ Nga ana e DRT nuk janë përmbushur detyrimet institucionale lidhur me zbatimin e masave shtrënguese me efekte negative në dëm të buxhetit të shtetit.

✓ Mangësitë në staf dhe delegimet të cilat e cenojnë procesin, mungesat e ndarjes së detyrave, planet e punës, mosndjekja e hapave në kohë, janë faktorë me risk që kanë ndikuar në rritjen e borxhit.

✓ Për zbatimin e masave shtrënguese dhe vendosjen e barrëve siguroese i janë drejtuar DRSHTRR/DPSHTRR dhe Banka të Nivelit të Dytë. Drejtoria e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara-DRT Fier, nuk ka kërkuar informacion në të gjitha zyrat që regjistrojnë pasuri të luajtshme sipas përcaktimeve të Nenit 91, pika 91.2.5 dhe pika 91.2.8 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo ka shkaktuar që pasuri të tjera të luajtshme të tatimpaguesve debitorë të mos jenë identifikuar dhe rrjedhimisht vijuar në fazat e tjera të mbledhjes me forcë.

✓ Menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara ka patur mangësi të theksuara. Rritja e lartë e këtij treguesi si në numër subjektësh dhe në vlerë ka ardhur si pasojë e efektivitetit të ulët të masave organizative dhe shtrënguese, duke rritur së tepërmi detyrimet me vjetërsi mbi 2 vjet dhe pamundësinë e arkëtueshmërisë së tyre, duke ndikuar kështu edhe në mosvjeljen e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

✓ Bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore ka qenë i pjesshëm si pasojë e mangësive në dispozitat ligjore përkatëse dhe pengesave të nxjerra prej tyre, duke ndikuar kështu pak në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat.

✓ Konstatohen boshllëqe në politikat ekzistuese për shuarjen e borxhit të pambledhshëm

✓ Konstatohet mosrespektimi imarrvëshjeve të lidhura ndërmjet administrates tatimore dhe subjekteve me detyrime tatimore.

Subjekte që rezultojnë debitorë në TF

Nisur nga deklarata e TF 2018 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në moslikuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

SUBJEKTI	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
93 aktivë	11,807,491	242,668	1,246,855	13,297,014

9 kërkesë për c' regjistrim	-	-	130,000	130,000
98 pasivë	5,420,820	15,641	2,025,277	7,461,738
TOTAL 200	17,228,311	258,309	3,402,132	20,888,752

Për sa më sipër konstatohen 200 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2018 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 20,888,752 lekë, vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2019. Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i subjekteve për DRT Fier.

Nisur nga deklarata e TF 2019 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në moslikuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

SUBJEKTI	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
198 aktivë	50,361,469	1,427,842	5,612,473	57,401,784
6 kërkesë për c' regjistrim	36,522	431	69,983	106,936
59 pasivë	981,666	0	1,199,504	2,181,170
TOTAL 263	51,379,657	1,428,273	6,881,960	59,689,890

Për sa më sipër konstatohen 263 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 57,508,720 lekë, vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2020. Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i pambledhur nga DRT Fier.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:

- Ligji nr.33/2017, datë 19.04.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore , detyrimeve të pagueshme në doganë , si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/ shuarjes së detyrimeve tatimore ”.
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.
- Urdhër nr. 19, datë 22.02.2017 i Ministrit të Financave: “Rregullore për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore”;
- Udhëzimi nr.14, datë 03.05.2017 “Për zbatimin e ligjit nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë , si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/ shuarjes së detyrimeve tatimore”;
- Manual i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë.

Konkluzion: Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. O.C në cilësinë e Drejtorit Rajonal të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për periudhën 01.01.2018-31.12.2020.
 - 2) Znj. Z.SH në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për periudhën 01.01.2018 - 18.04.2019.
 - 3) Znj. A.A në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguar për periudhën 26.04.2019-31.12.2020.
 - 4) Inspektorët sipas konsatimeve të larpërmendura
- Për sa më sipër është lënë akt konstatimi Nr.6 datë 29.03.2021.*

Titulli i gjetjes:	Lidhja e Akt-Marrëveshjeve në mënyrë të përsëritur për tatimpagues të cilët nuk kanë respektuar Akt-Marrëveshjet e mëparshme si dhe vonesa të konsiderueshme midis datës së anulimit të marrëveshjes dhe kohës kur është paguar kësti i fundit.
Situata:	Nga auditimi i kërkesave të bëra nga subjektet për lidhje të akt-marrëveshjeve, rezulton se subjektet nuk paraqesin argumente mbi aftësinë paguese në të

	<p>ardhmen, veprime të cilat bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 77 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Nga testimet e kryera mbi databazat e akt-marrëveshjeve të lidhura dhe atyre të anuluar për periudhën objekt auditimi janë evidentuar:</p> <p>-39 raste kur nga ana e DRT Fier janë lidhur akt-marrëveshje me tatimpaguesin debitor pa respektuar pagesën paraprake prej 20% të vlerës së detyrimit.</p> <p>-9 raste, ku tatimpaguesit pas pagesës së menjëhershme së para kushtit (20% të vlerës së detyrimit për të cilën lidhet marrëveshja), rezultojnë me 0 këste të paguara pas lidhjes së A-M, duke mos zbatuar kështu kushtet e akt-marrëveshjeve për pagesë me këste dhe duke mos arkëtuar vlerën e detyrimeve për të cilën ato janë lidhur.</p> <p>-Vonesa të konsiderueshme midis datës së anulimit të marrëveshjes dhe kohës kur është paguar kësti i fundit. Anullimi i Akt-marrëveshjeve pas një kohe të konsiderueshme nga pagesa e fundit bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 78 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe me pikën 5.1 dhe 5.2 të Marrëveshjeve të lidhura midis tatimpaguesve dhe DRT-së.</p>
Kriteri:	Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Manual i mbledhjes me forcë.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandim:	<p>Drejtoria Rajonale Tatimore përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve të analizojnë aftësinë paguese të tatimpaguesit me qëllim arritjen e objektivave të lidhjes së A-M, për likuidimin e plotë të detyrimeve.</p> <p>Drejtoria Rajonale Tatimore për subjektet që kanë lidhur Akt-Marrëveshje të monitorojë nivelin e detyrimeve të tatimpaguesve si dhe pagesat e kryera për çdo këst me qëllim përmbushjen e kushteve të marrëveshjeve dhe uljen e riskut të anulimit të tyre.</p> <p>Drejtoria Rajonale Tatimore të marr masa të menjëhershme për anulimin e akt-marrëveshjeve që rezultojnë me shkelje.</p>

Titulli i gjetjes	Mos mbulimi i borxhit tatimor me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
Situata:	Nga analizimi i të dhënave të Borxhit rezulton se nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rezulton se nuk është marrë asnjë masë “Njoftim transferimi detyrimi palës së tretë”, “Njoftim për transferimin e detyrimit. ortakut, aksionarit, administratorit”.
Kriteri:	Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Manual i mbledhjes me forcë.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mos mbulimit të borxhit tatimor me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, rritet risku i mos arkëtimit të detyrimeve të papaguara.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandim:	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara të marrë masat e nevojshme për të siguruar mbulimin e debitorëve, me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi me qëllim uljen e riskut të mos arkëtimit të

detyrimeve tatimore të papaguara.

Titulli i gjetjes:	E ardhur e munguar në buxhetin e shtetit vlerën 80,579 mijë lekë
Situata:	Nga auditimi për vitet 2018, 2019 dhe analizimi i të dhënave të sektorit të informatikës mbi mospërputhjet në deklarim të situatës financiare me të ardhurat në pasqyrat financiare u konstatua se: 200 tatimpagues të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2018, nuk kanë kryer pagesën e këtij Fitimi që ka vlerën 20,889 mijë lekë , 263 tatimpagues të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019 nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi që kap vlerën 59,690 mijë lekë , duke shkaktuar të ardhur të munguar buxhetin e shtetit në total në vlerën 80,579 mijë lekë. Ky detyrim duhet të ishte arkëtuar për TF 2018 brenda datës 31.03.2019 dhe për TF 2019 brenda datës 31.03.2020.
Kriteri:	Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 71, 74 “Pagesa e rimbursimit të Tatim fitimit”, 76 Kamatëvonesa “Kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afat, tatimpaguesi është i detyruar që, për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës së tatimit, të paguajë kamatëvonesë për këtë shumë, në masën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni”, Neni 114 Mospagimi në afat, ligji 8438 datë 28.12.1998 për tatimin mbi të ardhurat Neni 30 “Parapagimet
Efekti:	Mos realizimin e të ardhurave nga Tatim Fitimi në vlerën 80,579 mijë lekë
Shkaku:	Mos kryerja e pagesës së tatim fitimit nga subjektet tatimore në kohë sipas përcaktimeve ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DRT Fier të marrë masa të menjëhershme dhe të ndjekë cdo rrugë ligjore për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi.

II.2.2.1/4 Përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

Për auditimin e periudhës 2018-2020, u shqyrtua dokumentacioni:

-Rregullore e brendshke dhe manuali

-Ndarja e detyrave të punonjësve

-Klasifikimi i subjekteve (aktiv/pasiv/ të regjistruar/të c’regjistruar/ të pezulluar etj) për periudhën objekt auditimi

-Vërtetimet që janë lëshuar për subjektet në lidhje me detyrimet

Cdo dokumentacion e cilësuar e nevojshme për përpunimin e materialit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT është e organizuar dhe funksionon në zbatim “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar me Urdhërin nr.19, datë 22.02.2017. Drejtorja e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Fier në zbatim të detyrave funksionale për vitet 2018-2020 është fokusuar kryesisht në përpunimin e kërkesave për vërtetime, dhënien e asistencës, dhënien e fjalëkalimeve, dërgimin e njoftimeve subjekteve të ndryshme, edukimin dhe informimin e subjekteve me bazën ligjore.

Sipas të dhënave të ofruara nga DSHT, në zbatim të neneve 5, 6, 7, dhe 8 të rregullores së brendshme për funksionimin e Zbatimit të Rregullores për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për Tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit të tatimpaguesve në DRT, Sektori i Shërbimit dhe Asistencës ka qënë i fokusuar kryesisht në:

Informimin e shpejtë dhe të saktë të tatimpaguesve, administrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike brenda një afati kohor të arsyeshem.

Shërbimi dhe asistenca në këtë drejtori është dhënë kryesisht nëpërmjet email-it zyrtar, në adresën e dsht_fier@tatime.gov.al, nëpërmjet telefonit, si dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me tatimpaguesit në ambientet e Drejtorisë Shërbimit, janë bërë nëpërmjet sqarimeve verbale apo shpërndarjes së broshurave informuese mbi mënyrën e deklarimit, përpilimit të librave të shitblerjes etj., si dhe janë dhënë sqarime të nevojshme në lidhje me paqartësitë e tatimpaguesve rreth situatave të tyre financiare në sistemin tatimor.

Detyrat kryesore të kësaj strukture janë:

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT sipas Manualit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues ka si objektiva/parime/detyra kryesore:

- Parimin për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit
- Vetëvlerësimin dhe vetdeklarimin e detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit
- Nxitjen e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore
- Hartimi i strategjive dhe marrja e masave për pakësimin e risqeve që vijnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor.
- Ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur.
- Nxitja e veprimtarive elektronike, sidomos të deklarimit dhe të pagesës elektronike të detyrimit tatimor.

Strukura

Struktura e DSHT ka funksionuar me Urdhërin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, me Urdhërin e ri nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126 datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore Qëndrore”, me Urdhër nr.86, datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, të ndryshuar si dhe me Urdhërin Nr. 33 date 12.02.2019. Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhër.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave përcakton rregullat dhe detyrat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet, ndërmjet njësive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetet në DPT dhe DRT. Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT ka të miratuar në strukturë aktualisht 11 punonjës: 1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjigjës sektori, 8 specialistë.

Si ka funksionuar Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve krahasur me strukturën e miratuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier.

Viti 2018

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve (01.01.2018)	Gjthsej punonjës 15 Të miratuar	Fakt 13
Drejtor Drejtorie	1	Pa drejtor periudha 22.11.2017-16.03.2018
Spektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve	11	10
Spektori i Regjistrimit	3	3

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve (31.12.2018)	Gjthsej punonjës 15 Të miratuar	Fakt 13
Drejtor Drejtorie	1	1
Spektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve	11	9
Spektori i Regjistrimit	3	3

Viti 2019

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (01.01.2019)	Gjthsej punonjës 15 Të miratuar	Fakt 13
Drejtor Drejtorie	1	1
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve	11	9
Sektori i Regjistrimit	3	3

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (31.12.2019)	Gjthsej punonjës 15 Të miratuar	Fakt 13
Drejtor Drejtorie	1	1
Sektori i As. dhe Shërb.Tatimpaguesve	11	9
Sektori i Regjistrimit	3	3

Viti 2020

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (01.01.2020)	Gjthsej punonjës 15 Të miratuar	Fakt 13
Drejtor Drejtorie	1	1
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve	11	9
Sektori i Regjistrimit	3	3

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (17.09.2020)	Gjthsej punonjës 11 Të miratuar	Fakt11
Drejtor Drejtorie	1	1
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve	7	7
Sektori i Regjistrimit	3	3

Në mënyrë të përmbledhur lëvizjet e punonjësve të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues paraqiten në Tabelën nr.1 bashkëlidhur në seksionin “Aneksë”:

Konkluzion:

-Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues ka funksionuar pa drejtor gjatë periudhës 22.11.2017-16.03.2018

-Në një rast kemi delegimin punonjësit Specialist në Zyrën e Asistencës.dhe Shërbimit Tatimpagues në DRT Sarandë, pa afat të përcaktuar. *Delegimi është një instrument ligjor i cili parashikohet të përdoret për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për t’u përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndëruar në një mekanizëm të përhershëm.* Për sa kohë Ligji nr.10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, ndalon delegimin e detyrave të caktuara të një pozicioni pune nuk mundet këto pozicione të mbahen nga nëpunës të deleguar në periudha afatgjata apo një vjeçare, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni.

-Vendet e lira të punës tregojnë mangësi në procesin e realizimit të strukturës së miratuar. Mosplotësimi me staf i kësaj drejtorie shoqërohet me risk në mirëfunksionimin e punës.

Ndarja e detyrave:

Inspektorët kanë ndarjen e detyrave specifike ku përfshihen:

- 1- Regjistrimi i subjekteve
- 2- Ndryshimi i përgjegjesive tatimore.
- 3- Ndryshimi i përgjithshëm
- 4- Ndjekja e procedurave tëÇ’regjistrimit
- 5- Ndjekja e regjistrave të subjekteve dhe përgatitja e raporteve të ndryshëm

Janë realizuar planet operationale vjetore 2018-2020 të Drejtorisë me shkresat:

- ✓ Nr prot 595/1 datë 15.01.2018
- ✓ Nr.2037 prot datë 05.02.2019
- ✓ Nr.528 prot datë 15.01.2020

Sipas këtyre planeve janë përcaktuar: objektivat, forma e realizimit, afatet kohore dhe personat e ngarkuar me përgjegjësi. Planet janë të firmosura nga përgjegjësi i Sektorit, Drejtor i Drejtorisë dhe të miratuara nga Drejtori Rajonal.

Analizat vjetore

Kjo Drejtori ka zhvilluar analizat vjetore për vitet 2018-2020. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës u konstatua si në vijim:

Analiza vjetore e vitit 2018 është bërë me shkresën nr.21846 prot datë 31.12.2018

Analiza vjetore e vitit 2019 është bërë me shkresën nr.527 prot datë 15.01.2020

Analiza vjetore e vitit 2020 është bërë me shkresën nr.216 prot datë 08.01.2021.

Nga analizimi i veprimtarisë së kësaj Drejtorie për vitet 2018-2020 u konstatua si në vijim:

Viti 2018

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2018	Regjistrime të reja 2018	Pezullime 2018	Aplikim për c' regjistrim 2018	Situata e Aktiveve më datë 31.12.2018
BM	1,583	63	199	28	1,697
BV +TVSH	1,236	279	260	118	2,401
BV	7,148	803	885	732	5,694
Ente+OJF	125	9	2	3	134
Fermer	9,911	1,441	0	190	11,162
Total	20,003	2,595	1,346	1,071	21,088

Për sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2018 ka patur në total 2595 regjistrime të reja subjektsh nga të cilët: 63 MB, 279 BV me TVSH, 803 bv, 9 Ente+OJF dhe 1,441 prej tyre Fermer.

Janë konstatuar 1346 pezullime nga të cilat: 199 i përkasin subjekteve BM, 260 BV+TVSH, 885 BV, 2 Ente+OJF dhe 1441 Fermer.

Kanë aplikuar për c' regjistrim 1071 subjekte nga të cilët 28 BM, 118 BV+TVSH, 732 BV, 3 Ente+OJF dhe 190 Fermer.

Në fund të 2018 numri i subjekteve aktivë rezulton 21,088 nga 20,003 që rezultonin në 01.01.2018, pra një rritje me 1085 subjekte.

Viti 2019

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë më Datë 01.01.2019	Regjistrime të reja 2019	Pezullime 2019	Aplikim për c' regjistrim 2019	Situata e Aktiveve më datë 31.12.2019
BM	1,697	42	87	17	1,741
BV +TVSH	2,401	243	122	54	2,536
BV	5,694	671	442	708	5,334
Ente	134	8	3	6	136
Fermer	11,162	1,636	0	177	12,621
Total	21,088	2,600	654	962	22,368

Për sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2019 ka patur në total 2600 regjistrime të reja subjektsh nga të cilët: 42 MB, 243 BV me TVSH, 671 BV, 8 Ente+OJF dhe 1,636 prej tyre Fermer.

Janë konstatuar 654 pezullime nga të cilat: 87 i përkasin subjekteve BM, 122 BV+TVSH, 442 BV, dhe 3 Ente+OJF.

Kanë aplikuar për c'regjistrim 962 subjekte nga të cilët 17 BM, 54 BV+TVSH, 708 BV, 6 Ente+OJF dhe 177 Fermer.

Në fund të 2019 numri i subjekteve aktivë rezulton 22,368 nga 21,088 që rezultonin në 01.01.2019, pra një rritje me 1280 subjekte.

Viti 2020

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2020	Regjistrime te reja 2020	Pezullime 2020	Aplikim për c'regjistrim 2020	Situata e Aktiveve më datë 31.12.2020
BM	1,741	25	82	23	1,774
BV +TVSH	2,536	262	142	104	2,581
BV	5,334	611	350	426	5,235
Ente	136	6	6	7	177
Fermer	12,621	1175	-	103	13,693
Total	22,368	2,079	580	663	23,460

Për sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2020 ka patur në total 2079 regjistrime të reja subjektsh nga të cilët: 25 MB, 262 BV me TVSH, 611 BV, 6 Ente+OJF dhe 1175 prej tyre Fermer.

Janë konstatuar 580 pezullime nga të cilat: 82 i përkasin subjekteve BM, 142 BV+TVSH, 350 BV, dhe 6 Ente+OJF.

Kanë aplikuar për c'regjistrim 663 subjekte nga të cilët 23 BM, 104 BV+TVSH, 426 BV, 7 Ente+OJF dhe 103 Fermer.

Në fund të 2019 numri i subjekteve aktivë rezulton 23,460 nga 22,368 që rezultonin në 01.01.2019, pra një rritje me 1092 subjekte.

Në lidhje me ndryshimet e e përgjegjësive të TVSH dhe Tatim Fitimit sipas subjekteve të dhënat paraqiten si në vijim:

Viti 2018

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2018	Ndryshime	Ndryshimi
BM	1,583		
BV +TVSH	1,236	192	Tatim Fitimi
BV	7,148	604	TVSH
Ente	125		
Fermer	9,911		
Total	20,003	796	

Gjatë vitit 2018 rezultojnë 796 ndryshime përgjegjësish nga të cilët 192 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 604 prej tyre me TVSH.

Viti 2019

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2019	Ndryshime	Ndryshimi
BM	1,697		
BV +TVSH	2,401	74	Tatim Fitimi
BV	5,694	204	TVSH
Ente	134		
Fermer	11,162		
Total	21,088	278	

Gjatë vitit 2019 rezultojnë 278 ndryshime përgjegjësish nga të cilët 74 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 204 prej tyre me TVSH.

Viti 2020

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktive me Date 01.01.2020	Ndryshime	Ndryshimi
BM	1,741		

BV +TVSH	2,536	129	Tatim Fitimi
BV	5,334	153	TVSH
Ente	136		
Fermer	12,621		
Total	22,368	282	

Gjatë vitit 2020 rezultojnë 282 ndryshime përgjegjësish nga të cilët 129 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 153 prej tyre me TVSH.

Në lidhje me c'regjistrimet e subjekteve situata paraqitet si në vijim:

Viti 2018

Aplikim për c'regjistrim	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2018	Aplikim për c'regjistrim	C'regjistruar
BM	1,583	28	12
BV +TVSH	1,236	118	44
BV	7,148	732	371
Ente	125	3	0
Fermer	9,911	190	183
Total	20,003	1071	610

Në lidhje me c'regjistrimet e subjekteve, gjatë vitit 2018 kanë aplikuar për c'regjistrim 1071 subjekte dhe janë c'regjistruar 610 prej tyre. Numri më të lartë të aplikimeve për c'regjistrim e zënë BV me 732 aplikime.

Viti 2019

Aplikim për c'regjistrim	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2019	Aplikim për c'regjistrim	C'regjistruar
BM	1,697	17	6
BV +TVSH	2,401	54	55
BV	5,694	708	344
Ente	134	6	7
Fermer	11,162	177	149
Total	21,088	962	561

Në lidhje me c'regjistrimet e subjekteve, gjatë vitit 2019 kanë aplikuar për c'regjistrim 962 subjekte dhe janë c'regjistruar 561 prej tyre. Numri më të lartë të aplikimeve për c'regjistrim e zënë BV me 708 aplikime.

Viti 2020

Aplikim për c'regjistrim	Subj. Aktivë me Datë 01.01.2020	Aplikim për c'regjistrim	C'regjistruar
BM	1,741	23	7
BV +TVSH	2,536	104	53
BV	5,334	426	199
Ente	136	7	4
Fermer	12,621	103	125
Total	22,368	663	388

Në lidhje me c'regjistrimet e subjekteve, gjatë vitit 2020 kanë aplikuar për c'regjistrim 663 subjekte dhe janë c'regjistruar 388 prej tyre. Numri më të lartë të aplikimeve për c'regjistrim e zënë BV me 426 aplikime.

Konstatohet se janë c'regjistruar 22 fermer më shumë sesa kanë aplikuar. Kjo si rezultat që janë kërkesa të mbartura nga vitet e kaluara.

Nga auditimi u konstatua heqje përgjegjësie nga TVSH dhe TF si në vijim:

Nga TVSH

NIPT	Subjekti	Data e Regjistrimit	Data e Çregjistrimit	Data e Ri-regjistrimit	Dite diference
K	G.H	05/13/2010	1/11/2017	03/05/18	418
L	E.SH	03/01/2012	1/12/2017	03/05/18	417
K	E.A	02/14/2011	4/12/2017	03/05/18	327
L	A.R	02/03/2014	4/12/2017	03/05/18	327

L	A.D	05/27/2014	5/12/2017	03/05/18	297
L	J.SH	11/14/2017	7/12/2017	03/05/18	236
L	L.K	10/12/2017	12/10/2017	08/30/18	263
L	F.D	10/12/2017	12/10/2017	01/10/20	761
K	A.SH	02/14/2011	12/12/2017	03/05/18	83
L	K.D	09/10/2012	12/12/2017	03/05/18	83
L	D.D	10/15/2014	12/12/2017	03/05/18	83
L	O.C	04/01/2018	12/6/2018	01/11/19	36
L	L.S	02/15/2017	27/02/2017	04/01/18	398
L	V.H	10/14/2013	21/11/2017	03/05/18	104
K	A.B	02/14/2011	22/11/2017	03/05/18	103
L	A.DH	11/20/2013	23/11/2017	03/05/18	102
L	D.P	01/06/2015	23/11/2017	03/05/18	102
L	A.D	01/25/2016	23/11/2017	03/05/18	102
K	E.T	02/16/2011	24/11/2017	03/05/18	101
K	T.A	02/16/2011	24/11/2017	03/05/18	101
L	A.T	02/01/2013	24/11/2017	03/05/18	101
L	N.B	03/06/2014	24/11/2017	03/05/18	101
L	G.Z	08/31/2015	24/11/2017	03/05/18	101
L	SH.J	09/11/2015	24/11/2017	03/05/18	101
K	B.SH	02/14/2011	29/11/2017	03/05/18	96
K	Z.H	02/14/2011	29/11/2017	03/05/18	96
K	K.J	02/18/2011	29/11/2017	03/05/18	96
K	XH.M	02/16/2011	29/11/2017	03/05/18	96
L	V.M	02/16/2011	29/11/2017	03/05/18	96
L	E.N	10/12/2011	29/11/2017	03/05/18	96
L	E.SH	01/03/2012	29/11/2017	03/05/18	96
L	D.P	01/12/2012	29/11/2017	03/05/18	96
L	E.S	02/21/2012	29/11/2017	03/05/18	96
L	A.B	10/03/2012	29/11/2017	03/05/18	96
L	A.G	11/25/2013	29/11/2017	03/05/18	96
L	S.M	01/22/2014	29/11/2017	03/05/18	96
L	B.T	01/29/2014	29/11/2017	03/05/18	96
L	A.K	03/05/2014	29/11/2017	03/05/18	96
L	R.B	10/16/2014	29/11/2017	03/05/18	96
L	N.D	01/07/2015	29/11/2017	03/05/18	96
L	G.H	02/04/2015	29/11/2017	03/05/18	96
L	E.Z	1/7/2015	29/11/2017	03/05/18	96
L	A.R	9/1/2015	29/11/2017	03/05/18	96
L	K.H	11/4/2015	29/11/2017	03/05/18	96
L	K.C	1/26/2016	29/11/2017	03/05/18	96
K	I.D	2/16/2011	30/11/2017	03/05/18	95
L	A.A	2/10/2012	30/11/2017	03/05/18	95
L	K.K	7/11/2013	30/11/2017	03/05/18	95
L	M.XH	10/14/2016	30/11/2017	03/05/18	95
L	S.R	10/12/2017	30/11/2017	03/05/18	95
L	K.XH	1/11/2016	13/12/2017	03/05/18	82
L	I.M	1/29/2016	13/12/2017	03/05/18	82
L	A.V	4/15/2013	14/12/2017	03/05/18	81
L	E.V	10/25/2018	18/02/2019	01/13/20	329

Nga TF:

NIPT	Subjekti	Data e Regjistrimit të Taksës	Data e Çregjistrimit të Taksës	Data e Ri-regjistrimit	Dite diference
L	J.Q	1/5/2017	24/05/2017		
L	T.P	9/29/2017	29/09/2017		
L	FON...	5/26/2017	31/05/2018	06/12/20	743
K	A.K	5/21/2019	24/06/2019		
K	N.S	1/28/2020	27/05/2020		

Konstatohet se për veprimet e mësipërme Drejtoria e Shërbimit tatimpagues ka bashkëlidhur praktikat me dokumentacionin e nevojshëm si: kërkesë, shkresa përcjelljese nga Drejtoria e Kontrollit, Sektorit të Vlerësimit dhe Monitorimit nga Zyra. Arsyet e konstatuara në lidhje me c' regjistrimin nga TF lidhen me regjistrim të gabuar me TF (tatimpagues ambulantë dhe JOF) arsye të argumentuara në praktikat e audituara.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me veprimtarinë e kësaj Drejtorie paraqiten si në vijim:

LLOJI I VËRTETIMIT 2018	Total		
	Kërkesa të paraqitura	Kërkesa të Refuzuara	Kërkesa të Plotësuara
Vërtetim për pagesën e detyrimeve Tatimore. (FORM. 4)	542	0	542
Vërtetim xhiroje për 3 vitet e fundit për tender.(FORM.6)	69	0	69
Vërtetim për xhiron e 3 viteve të fundit. (FORM. 3)	11	0	11
Vërtetim për kontributete sigurimet. (FORM.E-SIG 02/A)	54	0	54
Vërtetim për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender. E-sig 01-A	14	0	14
Vërtetim për disponimine mjeteve të transportit. (FORM.8)	47	0	47
Vërtetim për lejim ose zbllokim importesh (FORM. 1,2,3).	0	0	0
Vërtetimpër marrjen e lejes së shfrytëzimit në ndërtim (FORM.2)	0	0	0
Vërtetim për efekt regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në ZRPP(FORM.4)	0	0	0
Vërtetim për regjistrim investim në ndërtim (FORM.1)	0	0	0
Vërtetim për kontribut individual të punonjës. (FORM. E-sig 03/A)	74	0	74
Vërtetim që u janë lëshuar individëve	1645	0	1645
Vërtetim për formularin e dyfishtë	130	0	130
Vërtetim për status	57	0	57
Vërtetim për përgjegjësi tatimore	93	0	93
TOTALI	2736	0	2736

Gjatë vitit 2018 në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 2736 kërkesa, të cilat janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet që u janë lëshuar individëve. Numri total i tyre përbëhet nga 1645 kërkesa. Vazhdon me vërtetimet për vërtetim për pagesën e detyrimeve tatimore me 542 të tilla. Pjesa tjetër e kërkesave përbëhet nga vërtetime për formularin e dyfishtë, kontributet dhe sigurimet, xhiron në 3 vitet e fundit për tender, disponimin e mjeteve të transportit, kontributet e sigurimet, disponimin e mjeteve të transportit dhe për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender etj.

LLOJI I VËRTETIMIT 2019	Total		
	Kërkesa të paraqitura	Kërkesa të Refuzuara	Kërkesa të Plotësuara
Vërtetim për pagesën e detyrimeve Tatimore. (FORM. 4)	480	0	480
Vërtetim xhiroje për 3 vitet e fundit për tender.(FORM.6)	43	0	43
Vërtetim për xhiron e 3 viteve të fundit. (FORM. 3)	0	0	0
Vërtetim për kontributete sigurimet. (FORM.E-SIG 02/A)	0	0	0
Vërtetim për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender. E-sig 01-A	54	0	54
Vërtetim për disponimine mjeteve të transportit. (FORM.8)	0	0	0
Vërtetim për lejim ose zbllokim importesh (FORM. 1,2,3).	0	0	0
Vërtetim për marrjen e lejes së shfrytëzimit në ndërtim (FORM.2)	0	0	0
Vërtetim për efekt regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në ZRPP (FORM.4)	0	0	0
Vërtetim për regjistrim investim në ndërtim (FORM.1)	0	0	0
Vërtetimpër kontribut individual të punonjës. (FORM. E-sig 03/A)	145	0	145
Vërtetim që u janë lëshuar individëve	1665	0	1665
Vërtetim për formularin e dyfishtë	111	0	111
Vërtetim për status	36	0	36
Vërtetim për përgjegjësi tatimore	39	0	39
TOTALI	2573	0	2573

Gjatë vitit 2019, në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 2573 kërkesa, të cilat janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet që u janë lëshuar individëve. Numri total i tyre përbëhet nga 1665 kërkesa. Vazhdon me vërtetimet për vërtetim për pagesën e detyrimeve tatimore me 480 të tilla. Pjesa tjetër e kërkesave përbëhet nga vërtetime për formularin e dyfishtë, kontributet dhe sigurimet, xhiron në 3 vitet e fundit për tender, disponimin e mjeteve të transportit, kontributet e sigurimet, disponimin e mjeteve të transportit dhe për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender etj.

LLOJI I VËRTETIMIT 2020	Total		
	Kërkesa të paraqitura	Kërkesa të Refuzuara	Kërkesa të Plotësuara

Vërtetim për pagesën e detyrimeve Tatimore. (FORM. 4)	165	0	165
Vërtetim xhiroje për 3 vitet e fundit për tender.(FORM.6)	5	0	5
Vërtetim për xhiron e 3 viteve të fundit. (FORM. 3)	6	0	6
Vërtetimpër kontributete sigurimet. (FORM.E-SIG 02/A)	3	0	3
Vërtetimpër nummrin e të siguruarve në shoqëri për tender. E-sig 01-A	10	0	10
Vërtetimpër disponimin e mjeteve të transportit. (FORM.8)	0	0	0
Vërtetim për lejim ose zbllokim importesh (FORM. 1,2,3).	0	0	0
Vërtetimpër marrjen e lejes së shfrytëzimit në ndërtim (FORM.2)	0	0	0
Vërtetimpër efekt regjistrimin e pasurisë së paluajtshme nëZRPP(FORM.4)	0	0	0
Vërtetim për regjistrim investim në ndërtim (FORM.1)	0	0	0
Vërtetim për kontribut individual të punonjës. (FORM. E-sig 03/A)	55	0	55
Vërtetim që u janë lëshuar individëve	47	0	47
Vërtetimpër formularin e dyfishtë	39	0	39
Vërtetim për status	19	0	19
Vërtetim për përgjegjësi tatimore	12	0	12
TOTALI	361	0	361

Gjatë vitit 2020 në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 361 kërkesa, të cilat janë plotësuar dhe trajtuar në masën 100%. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet për pagesën e detyrimeve tatimore me 165 të tilla. Pjesa tjetër e kërkesave përbëhet nga vërtetime për formularin e dyfishtë, kontributet dhe sigurimet, xhiron në 3 vitet e fundit për tender, disponimin e mjeteve të transportit, kontributet e sigurimet, disponimin e mjeteve të transportit dhe për numrin e të siguruarve në shoqëri për tender etj.

LLOJI I KOMUNIKIMIT 2018	Numri i rasteve
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre kryera on line në Sistemin C@TS.	5,746
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në tvsh.	1,442
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me tvsh	1,207
Seminare të hapura	19
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve nëlidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë.	626
Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve përdeklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre.	2,647
Vizita për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiscal	782
TOTALI	12,469

LLOJI I KOMUNIKIMIT 2019	Numri i rasteve
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre kryera on line në Sistemin C@TS.	5,674
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në tvsh.	74
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me tvsh	176
Seminare të hapura	17
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve nëlidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë.	3,211
Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve përdeklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre.	0
Vizitave për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiscal	732
TOTALI	9,884

LLOJI I KOMUNIKIMIT 2020	Numri i rasteve
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre të kryera on line në Sistemin C@TS.	8,516
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në tvsh.	0
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me tvsh	20
Seminare të hapura	48
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve në lidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë.	100
Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve përdeklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre.	0
Vizitave për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiscal	517
TOTALI	9,201


Për sa më sipër konstatohet se për periudhën objekt auditimi numrin më të lartë në veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues e zënë asistimet kundrejt Tatimpaguesve nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve të kryera online në Sistemin C@TS.

Fjalëkalime për C@TS	Nr
Viti 2018	791
Viti 2019	825
Viti 2020	816

Vërtetime Individësh	Drejtoria e Shërbimit nga Tatimpaguesve (Nr)	Portali E-Albania (Nr)
Viti 2018	1645	2654
Viti 2019	1665	2361
Viti 2020	47	5185

Për sa më sipër konstatohet se numri i vërtetimeve të dhëna nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues ka pësuar një ulje të konsiderueshme në vitin 2020. Megjithatë ende vijohet të lëshohen vërtetime me vulë të njomë edhe përpos faktit që Portali E-Albania është konceptuar dhe ofron mundësinë e marrjes së këtij shërbimi.

Paraqitur në mënyrë grafike si në vijim:



Një problematikë tjetër e konstatuar nga auditimi është fakti se për periudhën objekt auditimi 2018-2020, është dhënë një numër i konsiderueshëm vërtetimesh nga Drejtoria e Kontrollit nëpërmjet Protokollit, pavarësisht se në strukturë ekziston Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues e cila e mbulon këtë funksion.

Në lidhje me shkresat total të përcjella nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues për periudhën objekt auditimi nga auditimi konstatohet se:

Shkresa përcjellëse	Nr Total
Viti 2018	8,418
Viti 2019	3,990
Viti 2020	5,078

Këto shkresa përcjellëse janë kryesisht me Institucionet: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, MIE, QKB, Shërbimi Kombëtar i Punësimit etj.

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT e tjera në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier dhe anasjelltas konstatohet se:

Nr	Subjekte	DRT 2018	DRT 2019	DRT 2020
1	Transferime nga DRT e tjera	47	35	28
2	Transferime në DRT e tjera	42	43	31

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT e tjera në DRT Fier për vitin 2018 rezultojnë 47 të tilla, për vitin 2019 rezultojnë 35 dhe për vitin 2020 rezultojnë 28 subjekte.

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT Fier në DRT e tjera për vitin 2018 rezultojnë 42 të tilla, për vitin 2019 rezultojnë 43 dhe për vitin 2020 rezultojnë 31 subjekte.

Subjekti	DRT 2018	DRT 2019	DRT 2020
Kalimi në pasiv me çështje	1	0	4
Riaktivizimi	383	28	27
Ndryshime të kategorisë së sigurimeve	742	438	419
Ndryshim kodit NACE	0	0	0

Totali	1,126	466	450
---------------	-------	-----	-----

Subjekti	DRT 2018	DRT 2019	DRT 2020
Emërtimi, Administratori, adresa, nr. tel	11	18	14

Në lidhje me auditimin e vërtetimeve për detyrime të dhëna nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues për periudhën 2018-2020, nuk u konstatuan problematika. Dhënia e vërtetimeve u konstatua se kishte bashkëlidhur të dhënat në lidhje me detyrimet reale të subjekteve.

Nga auditimi i vërtetimeve dhe i praktikave të tërhequra nga Zyra e Protokollit u konstatua si në vijim:

Subjekti T.E me Nipt L.... në vijim të kërkesës me email për vërtetim për detyrim, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues është lëshuar vërtetimi me nr. 511 prot datë 06.03.2019 me përmbajtjen si në vijim: “...rezulton se për periudhën deri në 06.03.2019, nuk ka detyrim për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, taksa kombëtare, tatim i mbajtur në burim, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, ka gjoba në tatim mbi vlerën e shtuar 9,425,951 lekë dhe këste të tatim fitimit 4,276,941 lekë.”

Në vijim me shkresën nr.3490 prot datë 08.03.2019 shoqëria T.E ka protokolluar kërkesë për vërtetim në lidhje me detyrimet tatimore në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, për detyrimet sipas llojit të tatimit

- Kontribute për sigurime shoqërore
- Tatim i mbajtur në burim
- Tatim mbi fitimin
- Taksa kombëtare
- Tatim mbi të ardhurat nga punësimi

Me shkresën Nr.3490/1 prot datë 08.03.2019 “Lënda kthim përgjigje” tatimpaguesit i është kthyer përgjigje në lidhje me detyrimet sipas llojit të tatimeve:

- Kontribute për sigurime shoqërore 0
- Tatim i mbajtur në burim 0
- Tatim mbi fitimin 0
- Taksa kombëtare 0
- Tatim mbi të ardhurat nga punësimi 0

Shkresa është lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit, firmosur dhe vulosur nga ish Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier z. O.C.

Për sa më sipër konstatohet një mospërputhje me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues në paraqitjen e detyrimit për këstet e tatimit mbi fitimin në vlerën 4,276,941 lekë, detyrim i cili paraqitet 0 në shkresën e Drejtorisë së Kontrollit. Nga grupi i auditimit u konstatua se ky detyrim e kishte afatin e pagesës deri në datën 30 mars, por në vërtetim nuk është përmendur kjo vlerë, pavarësisht se subjekti ka patur afat për likuidimin.

Për këtë rast ngarkohet me përgjegjësi z. O.C dhe z. A.K

Për veprimtarinë e Shërbimit Tatimpagues nuk janë konstatuar problematika.

Për sa më sipër është lënë akt konstatimi Nr.8 datë 29.03.2021.

Në observacionin me nr.9253/100 prot datë 24.08.2021 (prot në KLSH me nr 844/66 datë 25.08.2021) dhe në observacionin me nr.9253/127 prot datë 07.09.2021 (prot në KLSH me nr 844/92 datë 09.09.2021) z.O.C në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe z. A.K në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit, shprehen:

Pretendimet e subjektit: “...Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues cilëson se subjekti Tosk Energy ka kështu e Tatim Fitimit në vlerën 4,276,941 lekë ndërsa shkresa kthim përgjigje e lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit është shprehur se subjekti nuk ka detyrime tatimore për të njëjtin subjekt pasi ky i fundit ka afat deri në datën 30 mars për të paguar kështu e TF. Për sa më sipër nuk quhet detyrim tatimor. Pas kësaj quhet detyrim dhe merr penalitet për mospagesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit konstaton se me shkresën nr.511 prot datë 06.03.2019, ku sipas kësaj shkrese subjekti ka kërkuar të njihet me detyrimet tatimore të cilat janë: gjoha në TVSH 9,425,951 Lekë dhe kështu të TF 4,276,941 lekë.

Pas kësaj subjekti ka kërkuar me anë të shkresës nr.3490.prot datë 08.03.2019 që të pajiset me një vertetim për detyrimet tatimore gjë të cilën e ka trajtuar Drejtoria e Kontrollit dhe jo Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesit e cila e ka detyrë funksionale, për më tepër në përgjigje të kësaj shkrese subjektit nuk i është vënë në dijeni se ka detyrimet e mësipërme. Megjithatë grupi auditimit merr në konsideratë faktin që subjekti ka patur afat pagese deri në datën 30 mars për të paguar kështu e TF.

Observacioni merret pjesërisht në konsideratë nisur nga fakti që kjo shkresë duhej pregatitur nga Shërbimi Tatimpagues dhe jo nga Drejtoria e Kontrollit.

II.2.2.1/4 Mbi Përputhshërinë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Jugut.

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor është e organizuar dhe funksionon në zbatim “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar me Urdhërin nr.19, datë 22.02.2017.

Drejtoria e Hetimit Tatimor në Rajonin Jugor, e ka patur qëndrën në Fier, dhe ka ushtruar funksionet e saj në territoret në juridiksion të Drejtorive Rajonale Tatimore Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë dhe Sarandë. Varësinë hierarkike e ka patur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Struktura e *Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Jugor* ka funksionuar me Urdhërin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, me Urdhërin e ri nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126 datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore Qëndrore” dhe me Urdhër nr.86, datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, të ndryshuar.

Struktura e miratuar me Urdhërin Nr. 33 datë 12.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, është miratuar si në vijim, dhe plotësimi i strukturës ka përfunduar në Gusht 2020.

Sipas strukturës së re, Drejtoria e Hetimit Tatimor funksionon vetëm në DPT, ndërsa në rajone(Shkodër, Tiranë dhe Fier) është krijuar Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, e cila përbëhet nga:

- Sektori i Koordinimit.
- Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit në Terren (ish Sektori i Zbatimit).

Nga auditimi u konstatua se struktura plan/fakt në periudhën objekt auditimi, paraqitet si në vijim:

Viti 2018

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor (01.01.2018)	Gjithsej Plan –Miratuar 56	Fakt 54
<i>Drejtor Drejtorie</i>	1	1
<i>Sektori i Analizes</i>	4	4
<i>Sektori i Hetimit Tatimor</i>	16	14 (pa plotësuar 2 inspektorë hetimi)
<i>Sektori i Zbatimit</i>	35	35

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor (01.01.2018)	Gjithsej Plan –Miratuar 56	Fakt 50
<i>Drejtor Drejtorie</i>	1	1
<i>Spektori i Analizës</i>	4	3 (pa plotësuar 1 inspektorë)
<i>Spektori i Hetimit Tatimor</i>	16	16
<i>Spektori i Zbatimit</i>	35	30 (pa plotësuar 5 inspektorë)

Viti 2019

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor (01.01.2019)	Gjithsej Plan –Miratuar 56	Fakt 47
<i>Drejtor Drejtorie</i>	1	1
<i>Spektori i Analizës</i>	4	3 (pa plotësuar 1 inspektor hetimi)
<i>Spektori i Hetimit Tatimor</i>	16	15 (pa plotësuar 1 inspektor hetimi)
<i>Spektori i Zbatimit</i>	35	28 (pa plotësuar 7 inspektor hetimi)

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor (31.12.2019)	Gjithsej Plan –Miratuar 55	Fakt 53
<i>Drejtor Drejtorie</i>	1	1
<i>Spektori i Hetimit Tatimor</i>	17	17
<i>Spektori i Monitorimit Territorial</i>	37	35
<i>-Përgjegjës</i>		
<i>-Zyra e Koordinimit</i>	1	1
<i>-Zyra e Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative</i>	4	4
	32	30 (pa plotësuar 2 inspektorë)

Viti 2020

Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor (01.02.2020)	Gjithsej Plan –Miratuar 55	Fakt 52
<i>Drejtor Drejtorie</i>	1	1
<i>Spektori i Hetimit Tatimor</i>	17	17
<i>Spektori i Monitorimit Territorial</i>	37	34
<i>-Përgjegjës</i>		
<i>-Zyra e Koordinimit</i>	1	1
<i>-Zyra e Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative</i>	4	4
	32	29 (pa plotësuar 3 inspektorë)

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (17.09.2020)	Gjithsej Plan –Miratuar 23	Fakt 23
<i>Drejtor Drejtorie</i>	1	1
<i>Spektori e Koordinimit</i>	3	3
<i>Spektori i Verifikimit dhe Monitorimit në Terren</i>	19	19

Konkluzion:

- ✓ Konstatohet se struktura ka qënë e plotësuar, në pozicionin drejtor drejtorie dhe përgjegjës sektori.
- ✓ Evidentohen disa vende vakante në pozicionin inspektor gjatë periudhës së auditimit. Vendet e lira të punës tregojnë mangësi në procesin e realizimit të strukturës së miratuar. Gjithashtu, nga auditimi rezulton se Spektori i Zbatimit dhe Spektori i Hetimit nuk disponon planet mujore dhe vjetore të punës për vitin 2018, kjo në kundërshtim me Nenin 160 dhe 165 të Rregullores së AQT dhe pikës 3.1 të Manualit të Hetimit Tatimor.

Në zbatim të programit të auditimit nr.844/1 datë 25.09.2020, i ndryshuar është kërkuar elektronikisht, me datë 15.02.2021, drejtuar titullarit të institucionit Znj. E.E, dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e Sektorit të Hetimit konkretisht praktikat e hetuara dhe arshivuara nga kjo drejtori, për periudhën 2018-2020. Nga ana jonë, për mos vënien e dokumentacionit në dispozicion, i është drejtuar shkresë me nr.844/6 dhe datë 25.02.2021 nga Kryetari i

Kontrollit të Lartë të Shtetit, Znj. E.E, Drejtor i DRTF dhe Znj. D.I, Drejtor i Përgjithshëm, ku është kërkuar se për përmbushjen e objektivave të auditimit brenda afateve të parashikuara në programin përkatës, kërkohet angazhim i menjëhershëm për pajisjen e grupit të auditimit me informacion/dokumentacion brenda datës 01.03.2021.

Për sa më sipër, grupit të auditimit pranë DRTF nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i lartëpërmendur.

Kërkesat e grupit të auditimit bazohen në Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, konkretisht në:

-Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” pika “dh”: *Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: “dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake; dhe pika e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t’u kërkojë subjekteve të audituara që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij;*

- Nenin 26 “Aksesi në dokumentet zyrtare”

1. *Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.*

2. *Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t’i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.*

Mosvënia në dispozicion e informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit, bëhet pengesë serioze për realizimin e programit të auditimit dhe bën të pamundur dhënien e opinionit për përputhshmërinë në lidhje me këto fusha, objektiv kryesor i auditimit të KLSH-së.

Për sa sipër është mbjtur Aktkonstatim Nr. 5, datë datë 09.03.2021”Mbi kërkesën për tërheqjen e dokumentacionit të Sektorit të Hetimit Tatimor, me Znj. E.E, Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe Znj. D.I, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme.

Nga auditimi i procesverbaleve të gjobave, mbajtur nga inspektorët e DHTRJ, konstatohet:

Titulli gjetjes:	Dhënie masave administrative jo në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi gjatë verifikimeve në terren.
Situata:	Në dy raste me të dhënat në tabelën nr.1 më poshtë inspektorët e Sektorit të Zbatimit, kanë mbajtur PVGJ në subjekt bazuar në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe konkretisht, Nenin 122, pika 1, gërma a(i) ku citohet se: <i>“Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, i cili detyrohet të përdorë pajisjen fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, dënohet në rast se: a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit: i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë; Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që plotësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të qarkullimit”,</i> ndërkohë që nga verifikimet tona subjektet posedonin një të tillë, kjo bazuar në grupet e kontrollit të mëparshëm në po të njëjtën adresë. Sa më sipër, inspektorët duhej të mbanin PVGJ bazuar në: Nenin 122, pika 1, gërma g të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, ku citohet se subjekti: <i>“nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, me</i>

	<p><i>gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) Lekë</i>". Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: G.B, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ dhe A.M, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ.</p>																							
	<p>Tabela nr.1</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Subjekti NIPT</th> <th>PVGJ Datë</th> <th>Baza ligjore e aplikuar</th> <th>Baza ligjore nga konstatimi KLSH</th> <th>Inspektorët</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>L.....</td> <td>17.08.2018</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma a(i)</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma g</td> <td>G. B A. M</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>K.....</td> <td>11.04.2018</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma a(i)</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma g</td> <td>G. B A. M</td> </tr> </tbody> </table>						Nr	Subjekti NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore nga konstatimi KLSH	Inspektorët	1	L.....	17.08.2018	Neni 122, pika 1, gërma a(i)	Neni 122, pika 1, gërma g	G. B A. M	2	K.....	11.04.2018	Neni 122, pika 1, gërma a(i)	Neni 122, pika 1, gërma g	G. B A. M
Nr	Subjekti NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore nga konstatimi KLSH	Inspektorët																			
1	L.....	17.08.2018	Neni 122, pika 1, gërma a(i)	Neni 122, pika 1, gërma g	G. B A. M																			
2	K.....	11.04.2018	Neni 122, pika 1, gërma a(i)	Neni 122, pika 1, gërma g	G. B A. M																			
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 122, pika 1, gërma g.																							
Ndikimi:	Inspektorët kanë penalizuar subjektin për mos instalim të kasës fiskale, ndërkohë që nga konstatimi jonë rezulton se subjektet posedonin një të tillë dhe duhet të penalizoheshin për mosmbajtjen e saj në gjendje pune.																							
Shkaku:	Mos verifikim nga ana e inspektorëve në sistemin C@TS dhe Nexus, nëse subjekti kishte të regjistruar pajisje fiskale.																							
Rëndësia:	E ulët.																							
Rekomandimi:	Nga ana e DVT Rajoni Jugor, të merren masa që para hartimit të aktkonstatimeve të kryhen të gjitha verifikimet përkatëse në sistemin tatimor C@TS.																							

Titulli gjetjes:	Mbajtje të masave administrative jo në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi gjatë verifikimeve në terren.																																				
Situata:	<p>Në pesë raste me të dhënat në tabelen nr.2 më poshtë, inspektorët kanë konstatuar se subjekti nuk disponon faturë shoqërimi për mallrat që mbanë në ruajtje dhe për këtë kanë mbajtur PVGJ bazuar në Nenin 124, pika 1 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, ku citohet se: <i>“Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”</i>, ndërkohë që duhej të bazoheshin në Nenin 121, pika 1, gërma a, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar ku citohet se: <i>“Tatimpaguesit të tatimit të thjeshtuar të fitimit, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së. Për qëllim të konstatimit të mos dokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë, sipas Nenit 53, të këtij ligji, me qëllim dokumentimin e mallit dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të Nenit 124, të këtij ligji”</i>.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi A.K ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, J,GJ, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, F.RR ish inspektore hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, I.A, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, B.M, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, GJ.K, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, B.K, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, K.I, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ.</p>																																				
	<p>Tabela nr.2</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Subjekti me NIPT</th> <th>PVGJ Datë</th> <th>Baza ligjore e aplikuar</th> <th>Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH</th> <th>Inspektorët</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>L....</td> <td>21.09.2018</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma a</td> <td>A. K J. Gj</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>L....</td> <td>31.03.2020</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma a</td> <td>F.Rr I.A</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>K....</td> <td>31.03.2020</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma a</td> <td>F.Rr I.A</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>L....</td> <td>21.08.2019</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma a</td> <td>B.M Gj.K</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>L....</td> <td>31.01.2019</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma a</td> <td>B.K K.I</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH	Inspektorët	1	L....	21.09.2018	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	A. K J. Gj	2	L....	31.03.2020	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	F.Rr I.A	3	K....	31.03.2020	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	F.Rr I.A	4	L....	21.08.2019	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	B.M Gj.K	5	L....	31.01.2019	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	B.K K.I
Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH	Inspektorët																																
1	L....	21.09.2018	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	A. K J. Gj																																
2	L....	31.03.2020	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	F.Rr I.A																																
3	K....	31.03.2020	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	F.Rr I.A																																
4	L....	21.08.2019	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	B.M Gj.K																																
5	L....	31.01.2019	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma a	B.K K.I																																
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 121, pika 1, gërma a.																																				
Ndikimi:	Bazuar në konstatimin e inspektorëve këto subjekte duhej të kalonin si subjekte me TVSH, nuk është aplikuar Legjislacioni përkatës.																																				
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 121, pika 1, gërma a.																																				
Rëndësia:	E ulët.																																				
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRT përkatëse që subjektet e evidentuara nga ana jonë(dhe jo vetëm), tu ndryshohet																																				

përgjegjësia tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Titulli gjetjes:	Dhënie të masave administrative jo në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi gjatë verifikimeve në terren.																														
Situata:	<p>Në katër raste me të dhënat në tabelën nr.3, më poshtë, inspektorët kanë konstatuar se subjekti nuk disponon faturë shoqërimi për mallrat që mban në ruajtje dhe për këtë kanë mbajtur PVGJ bazuar në Nenin 124 të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, ku citohet se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”, ndërkohë që duhej të bazoheshin në Nenin 121, pika 1, gërma b, të ligjit 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, ku citohet se: “Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore, sipas Nenit 53, të këtij ligji. Për qëllim të konstatimit të mos dokumentimit të mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të pa dokumentuar dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të Nenit 124, të këtij ligji” dhe Nenin 124, pika 2, gërma b, të këtij ligji, pasi subjektet kanë patur shkelje të përsëritur të Nenit 121, pika 1, gërma a. Në Nenin 124, pika 2, gërma a dhe gërma b citohet se: a) “Tatimpaguesi, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, në momentin kur konstatohet shkelja e përsëritur, sipas këtij Neni, regjistrohet për TVSH-në. b) Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në dhe tatimin e thjeshtuar të fitimit, në momentin kur konstatohet shkelja e përsëritur, sipas këtij Neni, regjistrohet për tatimin mbi fitimin”.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi A.K ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, J,GJ, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, F.RR, ish inspektore hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, I.A, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, B.M, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, GJ.K, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, B.K, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, K.LL, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ.</p> <p>Tabela nr.3</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Subjekti me NIPT</th> <th>PVGJ Datë</th> <th>Baza ligjore e aplikuar</th> <th>Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH</th> <th>Inspektorët</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>K...</td> <td>22.09.2018</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma b</td> <td>A. K J. Gj</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>L...</td> <td>01.04.2020</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma b</td> <td>F.Rr I.A</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>L...</td> <td>21.08.2018</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma b</td> <td>B.M Gj.K</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>L...</td> <td>31.01.2019</td> <td>Neni 124, pika 1</td> <td>Neni 121, pika 1, gërma b</td> <td>B.K K.II</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH	Inspektorët	1	K...	22.09.2018	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	A. K J. Gj	2	L...	01.04.2020	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	F.Rr I.A	3	L...	21.08.2018	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	B.M Gj.K	4	L...	31.01.2019	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	B.K K.II
Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH	Inspektorët																										
1	K...	22.09.2018	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	A. K J. Gj																										
2	L...	01.04.2020	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	F.Rr I.A																										
3	L...	21.08.2018	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	B.M Gj.K																										
4	L...	31.01.2019	Neni 124, pika 1	Neni 121, pika 1, gërma b	B.K K.II																										
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 124, pika 2, gërma a dhe b.																														
Ndikimi:	Bazuar në konstatimin e inspektorëve këto subjekte duhej të kalonin në subjekte me TF, nuk është aplikuar Legjislacioni përkatës.																														
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 124, pika 2, gërma a dhe b.																														
Rëndësia:	E ulët.																														
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRT përkatëse që subjektet e evidentuara nga ana jonë (dhe jo vetëm), ti ndryshohet përgjegjësia tatimore, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.																														

Titulli gjetjes:	Dhënie të masave administrative jo në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi gjatë verifikimeve në terren.
Situata:	<p>Në një rast, tabela nr.4, më poshtë, inspektorët kanë konstatuar se subjekti mban në ruajtje mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, duke e penalizuar atë bazuar në Nenin 118 të ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar ku citohet se: “Tatimpaguesi, që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 Lekë, për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si biznes i vogël” dhe nuk kanë aplikuar kundërvajtjen administrative bazuar në Nenin 121, pika 1, gërma a, të ligjit 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, ku citohet se: “Tatimpaguesit të tatimit të thjeshtuar të fitimit, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së. Për qëllim të konstatimit të mos dokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë, sipas Nenit 53, të këtij ligji, me qëllim dokumentimin e mallit dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të Nenit 124, të këtij ligji”. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi K.K ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ dhe R.C,</p>

	ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ.					
	Tabela nr.4					
	Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH(+118)	Inspektorët
	1	L...	26.02.2018	Neni 118	Neni 121, pika 1, gërma a	K.K R.Ç
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 121, pika 1, gërma a.					
Ndikimi:	Bazuar në konstatimin e inspektorëve subjekti duhej të kalonte si subjekt me TVSH, nuk është aplikuar Legjislacioni përkatës.					
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 121, pika 1, gërma a.					
Rëndësia:	E ulët.					
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRT përkatëse që për subjektin e evidentuar nga ana jonë, ti ndryshohet përgjegjësia tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi.					

Titulli i gjetjes :	Dhënie masave administrative jo në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi gjatë verifikimeve në terren.					
Situata:	Në një rast tabela nr.5, më poshtë, inspektorët kanë mbajtur PVGJ për subjektin sipas Ligjit Nr.9920, Neni 122, pika 1, germa, për mos instalim të kasës fiskale, ndërkohë që subjekti, bazuar në akt-konstatimin e grupit të kontrollit, kishte paraqitur kontratën e porosisë (pagesën për kasën fiskale) me një nga shoqëritë e autorizuara të kasave fiskale. Kjo bie në kundërshtim me <i>VKM nr. 781, datë 14.11.2007 pika 15.1 ku citohet se: "Tatimpaguesi aplikon për pajisje apo sistem fiskal pranë shoqërive të autorizuara. Shoqëritë e autorizuara janë të detyruara të pajisin tatimpaguesin me sistem apo pajisje fiskale brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës"</i> . Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi V.V, ish përgjegjës zyre, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ, R.B, ish inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ dhe B.M, në cilësinë e inspektor hetimi, në Sektorin e Zbatimit, në DHTRJ.					
	Tabela nr.5					
	Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Baza ligjore që duhet aplikuar sipas KLSH	Inspektorët
	1	L...	21.07.2018	Neni 122, pika 1, gërma a(i)	Nuk duhej të ishte penalizuar	V.V R.B B. M
Kriteri:	VKM nr.781, datë 14.11.2007 pika 15.1.					
Ndikimi:	Bazuar në konstatimin e inspektorëve subjekti nuk duhej të ishte penalizuar për mos instalim të kasës fiskale, nuk është aplikuar Legjislacioni përkatës.					
Shkaku:	Mos zbatimi i VKM nr.781, datë 14.11.2007 pika 15.1.					
Rëndësia:	E ulët.					
Rekomandimi:	Nga ana e DVT Rajoni Jugor, të merren masa që para hartimit të aktkonstatimeve të kryhen të gjitha verifikimet përkatëse në sistemin tatimor C@TS.					

Titulli i gjetjes:	Mos kontabilizim gjobe nga inspektorët e DRTF.					
Situata:	Në një rast tabela nr.6, më poshtë, është mbajtur PVGJ nga inspektorët por penaliteti nuk është kontabilizuar në sistemin tatimor C@TS në kundërshtim me Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 69. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi D.S, në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF dhe A.H, në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF.					
	Tabela nr.6					
	Nr	Subjekti me NIPT	PVGJ Datë	Baza ligjore e aplikuar	Në sistemin tatimor C@TS.	Inspektorët
	1	L...	09.02.2019	Neni 124, pika 1, gërma a	E pa kontabilizuar	D.S A. H
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 69.					
Ndikimi:	Bazuar në konstatimin e inspektorëve kanë penalizuar subjektin sipas shkeljeve përkatëse, por penaliteti nuk është kontabilizuar në sistemin tatimor C@TS.					
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 69.					
Rëndësia:	E mesme.					
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRT Fier që për moskontabilizim të gjobës dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimit me vonesë, të nxirren përgjesitë për inspektorët.					

Titulli i gjetjes :	Mos kryerja e vlerësimit alternativ për subjektet me TVSH, nga inspektorët e kontrollit nga zyra.																																										
Situata:	<p>Në gjashtë raste (tabela nr.7), është mbajtur PVGJ nga ana e inspektorëve të Hetimit Tatimor, në kundërshtim me Nenin 122, pika 1, gërma b(i)/(ii), të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, ku citohet se: “...penalizohej me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë dhe përveç masës së gjobës për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 dhe 72 të këtij ligji”. Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS rezultoi se këto subjekte (të regjistruar me TVSH), përveç masës së gjobës prej 50.000 Lekë, nuk u janë kryer vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 dhe 72 në ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar ku citohet se: “Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: ...ë) tatimpaguesi nuk përdor rregullisht pajisjen fiskale”.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi O.A, në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF, SH.N, në cilësinë e inspektor kontrolli, në DRTF. Dhe E.E, në cilësinë e përgjegjëses së kontrollit nga zyra, në DRTF.</p> <p>Tabela nr.7</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Subjekti me NIPT</th> <th>Data PVGJ</th> <th>Kundravajtja sipas inspektorit në terren</th> <th>Rrethi</th> <th>Inspektorët nga zyra</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>L...</td> <td>02.08.2018</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma b(i)</td> <td>Sarandë</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>L....</td> <td>23.08.2018</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma b(i)</td> <td>Fier</td> <td>O. A</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>L....</td> <td>07.04.2020</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma b(i)</td> <td>Vlorë</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>K...</td> <td>01.08.2019</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma b(i)</td> <td>Vlorë</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>L...</td> <td>06.11.2019</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma b(i)</td> <td>Fier</td> <td>Sh. N</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>L...</td> <td>08.11.2019</td> <td>Neni 122, pika 1, gërma b(i)</td> <td>Fier</td> <td>Sh. N</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Subjekti me NIPT	Data PVGJ	Kundravajtja sipas inspektorit në terren	Rrethi	Inspektorët nga zyra	1	L...	02.08.2018	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Sarandë	-	2	L....	23.08.2018	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Fier	O. A	3	L....	07.04.2020	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Vlorë	-	4	K...	01.08.2019	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Vlorë	-	5	L...	06.11.2019	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Fier	Sh. N	6	L...	08.11.2019	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Fier	Sh. N
Nr	Subjekti me NIPT	Data PVGJ	Kundravajtja sipas inspektorit në terren	Rrethi	Inspektorët nga zyra																																						
1	L...	02.08.2018	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Sarandë	-																																						
2	L....	23.08.2018	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Fier	O. A																																						
3	L....	07.04.2020	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Vlorë	-																																						
4	K...	01.08.2019	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Vlorë	-																																						
5	L...	06.11.2019	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Fier	Sh. N																																						
6	L...	08.11.2019	Neni 122, pika 1, gërma b(i)	Fier	Sh. N																																						
Kriteri:	Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 71 dhe 72.																																										
Ndikimi:	Nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra, nuk janë kryer akt-vlerësime.																																										
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Nenin 71 dhe 72.																																										
Rëndësia:	E ulët.																																										
Rekomandimi:	Të merren masa nga DRTF që subjektet e evidentuara nga ana jonë(dhe jo vetëm), për të cilët është mbajtur PVGJ nga inspektorët e verifikimit në terren bazuar në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 122, pika 1, të bëhet vlerësimi përkatës tatimor bazuar në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 71-72.																																										

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare të DRT Fier për vitin 2019, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve, në llogarinë 210, zëri “*Toka, troje, terrene*” rezultojnë me vlerë 0 lekë, nga 21,728,526 lekë që duhej të ishte pasqyruar, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e VKM nr.89, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë*”, (*Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016*) dhe kërkesave të kapitullit 2, Klasa 2 “*Aktivitet Afatgjatë*” (*Përbërja dhe trajtimi kontabël*) të Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”. (*Më hollësisht trajtuar në fq.14-32 të Raportit*).

1.1Rekomandimi: DRT Fier/Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DRT Fier, të marrë masa për të saktësuar vlerën e “*Aktiveve Afatgjatë*”, “*Toka, Troje, Terrene*” si dhe për të kontabilizuar e paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të AAM.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare të DRT Fier, për vitin 2019, transferimi i aktiveve (llog. 214), nuk është shoqëruar me shkresën e Njesisë (DPT) për transferim, si dhe nuk ka autorizim për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e pikës 55 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Regjistrimet në kontabilitet për llog.214 janë kryer mbështetur vetëm mbi dokumentacion vërtetues (*fletë hyrje dhe fletë dalje*), i pa shoqëruar me dokumentacion autorizues nga DPT, që të autorizojë kryerjen e një veprimit ekonomik e që në çdo rast duhet t’i bashkëlidhet dokumentit vërtetues, kërkesë kjo e pikës 35 të UMF nr.30, datë 27.12.2011. (*Më hollësisht trajtuar në fq.14-32 të Raportit*).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier/Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të merren masa, që në çdo rast, transferimi dhe regjistrimi në kontabilitet i aktiveve të kryhet mbështetur në dokumentacion autorizues dhe vërtetues të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së përpilimit të pasqyrave financiare të DRT Fier për vitin 2019, vlera kontabël e llogarisë 215 “Mjete transporti” rezulton në shumën 10,786,081 lekë, nga 10,898,739 lekë që duhej të ishte në fakt, pra më e ulët për 112,658 lekë, si rrjedhojë e llogaritjes gabim të amortizimit për automjetin Toyota Rav 4 AA 826PK, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e kapitullit 2. Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël) të UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (*Më hollësisht trajtuar trajtuar në fq 14-32 të Raportit*).

3.1Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DRT Fier, të marrë masat për të kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve, në përputhje me normat e përcaktuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të aktiveve dhe paraqitjen e tyre me vlerë reale në pasqyrat financiare.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2019, shuma prej 9,611,993 lekë është keq klasifikuar në llog.7200 “Grand korrent”, pasi shuma nuk përfaqëson grand por të ardhura jo tatimore. Për rrjedhojë, duhej të klasifikohet në grupin e llog.71 “Të ardhura jo tatimore”. Ky veprim nuk është në përputhje me përcaktimet e kapitullit 4.2, të UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (*Më hollësisht trajtuar trajtuar në fq 14-32 të Raportit*).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat për të sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2021 vlerën e të ardhurave jo tatimore, klasifikuar gabimisht në pasqyrat financiare të vitit 2019 në llog. 7200 “Grand korent”.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas ligjit vjetor të buxhetit dhe shpërndarjes së miratuar nga DPT, për vitin 2018, të ardhurat tatimore janë programuar në masën 3,212,000 mijë lekë dhe rishikuar me rritje në 5,896,001 mijë lekë bazuar në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.20537/1 datë 08.10.2018. Pavarësisht rishikimit, të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën

5,072,498 mijë lekë ose me mosrealizim prej -14% ose -823,503 mijë lekë më pak se plani. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën të ardhurat u realizuan 2,869,420 mijë lekë, rezultatet janë në rritje të konsiderueshme me +2,203,078 mijë lekë ose +76%.

Për vitin 2019, të ardhurat tatimore janë programuar në masën 4,345,000 mijë lekë dhe rishikuar me ngritje në 4,592,000 mijë lekë sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.9355/1 datë 03.06.2019. Pavarësisht rishikimit, të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën 4,461,945 mijë lekë ose **me mosrealizim prej -2.8% ose 130,055 mijë lekë më pak se plani**. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën të ardhurat u realizuan **5,072,498** mijë lekë, rezultatet janë në rënie me **-610,553 mijë lekë ose -12%**.

Për vitin 2020, të ardhurat tatimore janë programuar në masën **3,100,001 mijë lekë** por të ardhurat tatimore rezultojnë të jenë arkëtuar në masën **2,717,782 mijë lekë** ose **me mosrealizim prej -14.06% ose -382,219 mijë lekë** më pak se plani. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën të ardhurat u realizuan **4,461,945 mijë lekë**, rezultatet janë në rënie me **-1,744,163 mijë lekë** ose **-39.09%**. (Më hollësisht trajtuar trajtuar në fq. 14-32 të Raportit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, të analizojë faktorët që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave tatimore, sipas zërave dhe burimeve të disponueshme në territorin që ajo administron dhe t'i paraqes ato në mënyrë të dokumentuar në DPT, për marrje në konsideratë nga ana e saj.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të institucionit konstatohet se, Drejtori Rajonal i Tatimeve, Fier, ka nxjerrë Urdhrin nr.19093/1 prot., datë 19.11.2018, për “Ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të Institucionit, për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, dhe Urdhrin nr. 92 prot., datë 07.01.2020, për “Ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të institucionit, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019”, të përbërë nga 7 anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të inventarizimit, konstatohet se:

- Në Urdhër nuk është përcaktuar afat në lidhje me përfundimin e procesit të Inventarizimit.
- Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, për të fiksuar numrin e fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit.
- Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal të plotë ku të pasqyrojë dhe krahasojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit.
- Procesverbali i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve për vitin 2019, nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët.

Veprimet dhe mosveprimet e komisioneve të inventarizimit bien në kundërshtim me pikën 83 dhe 85 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në fq. 57-64 të Raportit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier të marrë masa që procesi i inventarizimit të bëhet sipas përcaktime ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzime e dieta u konstatua se pagesat e kryera kundrejt punonjësve nuk janë sipas kuadrit ligjor në fuqi pasi jo vetëm janë paguar me vonesa të konsiderueshme (edhe deri në 1 vit me vonesë për shkak të mungesës së fondeve) por edhe iu është paguar më pak se vlera që u takon sipas urdhrin të punës dhe faturës tatimore që vërtetojnë kohën e qëndrimit në shërbim. Këto veprime janë jo në përputhje me VKM nr. 130 datë 07.03.2018 “Për një ndryshim në Vendimin nr.997 datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, të ndryshuar pika 1, ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, Neni 7 “Afati për autoritetet publikë” dhe Nenin 463 të Kodit Civil. *(Më hollësisht trajtuar në fq. 64-73 të Raportit).*

7.1 Rekomandimi: Drejtorja e Funksioneve Mbështetëse në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, të marrë masa për kryerjen e pagesave për shpenzime udhëtimi dhe dieta, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura ose nisjen e proceseve gjyqësore nga ana e punonjësve me objekt përfitimin e tyre.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatuan problematikat në vijim:

-Nga DRT Fier nuk janë hartuar Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1, të Ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar, Manualit të MFK, kapitulli III, pika 3.5 “*Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm*”.

- Nga DRT Fier nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrin të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrin të Financave. *(Më hollësisht trajtuar në fq. 14-32 të Raportit).*

8.1 Rekomandim: Titullari i institucionit, të marrë masa për zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve njohjen dhe implementimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, duke synuar rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 11 procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk është vepruar në përputhje me VKM “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nr.914, datë 19.12.2014, i ndryshuar konkretisht me:

-neni 59, pika 1 dhe pika 2 shkronjat: “a”; “b” dhe “c”, pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është bërë investigim i tregut/nuk është bërë argumentimi dhe dokumentimi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës;

-neni 56, pasi në disa praktika prokurimi nga pjesëmarrësit në procedurë nuk janë nënshkruar deklaratat për konfliktin e interesit;

-neni 40, pika 5, pasi është përzgjedhur ofertues i renditur pas fituesit, veprime të cilat nuk janë dokumentuar nga komisioni përmes procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim;

-neni 68, pasi nga komisioni, në përfundim të afateve të ankimit nuk është përgatitur raporti përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave që e dërgon për miratim te titullari i AK,

-neni 40, pika 5, pasi nga anëtarët e komisionit nuk janë ftuar të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. *(Më hollësisht trajtuar në fq. 79-92 të Raportit).*

9.1 Rekomandimi: DRT Fier në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi në kualifikimin e ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i blerjeve me vlerë të vogël, të vlerësojë përgjegjësitë e tij në çdo rast sipas legjislacionit për prokurimin publik.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, u konstatua se, është vepruar jo në përputhje me Udhëzimin Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë nr. 17, datë 12.06.2015 *“Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e TVSh-së, si dhe procedurat e përjashtimit”* për subjektet e përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar, nuk është dorëzuar kopje e marrëveshjes dhe kontratës, por vetëm autorizimi nga AKBN. Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat/ vlerat për përjashtim nga TVSh sipas subjekteve dhe viteve përkatëse të miratuara në autorizim dhe vlerave që rezultojnë në deklaratën e TVSH-s, kategoria “shitje të përjashtuara nga TVSh”, “shitje pa TVSh” dhe “Eksporte”, ku për subjektet sipas anekseve përkatëse në Raportin e auditimit janë vlerësuar detyrime në vlerën 12,848 mijë lekë dhe penalitet 100% në vlerën 12,848 mijë lekë. *((Më hollësisht trajtuar Trajtuar në fq 170-206 të Raportit).*

10.1 Rekomandimi: DRT Fier, në të gjitha rastet e subjekteve të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve dhe kanë zbatuar regjimin e përjashtimit nga TVSh pa dorëzuar marrëveshjet dhe kontratat përkatëse sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë nr. 17, datë 12.06.2015 të marrë masat për trajtimin e shitjeve të tyre si shitje të tatueshme dhe arkëtimin e TVSh-së në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në DRT Fier u konstatua se nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës, më konkretisht:

-Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për periudhën e auditimit, nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme.

-Në lidhje me ndarjen e NIPT-ve, organizimin dhe monitorimin e inspektorëve nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

-Për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-31.12.2020, konstatohen subjekte me tepricë kreditore të pandryshuara ose në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim, të cilat rrisin riskun e evazionit nëpërmjet mos deklarimit të shitjeve. Teprica kreditore e tyre është trefishuar nga viti 2018 në vitin 2020. Fakti që teprica kreditore nuk ndryshon apo ka pësuar rritje ndikon në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Duke qenë se ky numër i kufizuar subjektesh kundrejt totalit të tatimpaguesve të DRT Fier, zë rreth 50% të tepricës kreditore të TVSH-së, duhet të ishin objekt monitorimi dhe verifikimi. Për subjektet duhet të ishte bërë verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

-Nga kryqëzimi i të dhënave të marra nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të pa paguara u konstatuan subjekte të mëdhenj me humbje tatimore mbi 1 vit të cilët rezultojnë edhe

debitorë kundrejt DRT Fier. Humbja tatimore e vitit 2017 është në vlerën 175,861 mijë lekë, vlerë e cila i përket 45 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2018 është në vlerën 231,133 mijë lekë, vlerë që i përket 51 subjekteve. Humbja tatimore e vitit 2019 është në vlerën 571,933 mijë lekë dhe u përket 104 subjekteve të marrë në shqyrtim. Nga 104 subjektet që rezultojnë me humbje, 48 prej tyre janë edhe debitorë kundrejt DRT Fier, në vlerën 81,972 mijë lekë. Nga administrata tatimore Fier nuk janë marrë masa mbi verifikimin apo të jenë mbajtur korrespondenca shkresore me to. Nga biznesi i vogël, janë konstatuar 113 biznese me humbje tatimore mbi vlerën 500 mijë lekë, në vitet 2017-2018-2019. Humbja tatimore e vitit 2017 është në vlerën 62,855 mijë lekë, vlerë që u përket 71 subjekteve, e vitit 2018 është në vlerën 65,747 mijë lekë, vlerë që u përket 68 subjekteve, e vitit 2019 është në vlerën 44,519 mijë lekë, vlerë që u përket 38 subjekteve. Konstatohen subjekte me humbje edhe 3 vite me radhë. Për sa më sipër konstatohet një monitorim i dobët për këto biznese, veçanërisht për kategorinë Biznes i madh, i cilësuar me risk të lartë. Nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Vlerësimit nuk dokumentohen shkresa për kalimin/propozimin e kontrolleve në Drejtorinë e Kontrollit.

Për asnjë biznes të madh nuk konstatohet që nga ana e DRT Fier të jenë shpallur procedurat e falimentimit sipas përcaktimeve ligjore në nenin 16, ligjit nr.110/2016, datë 27.10.2016 "Për falimentimin".

-Nga auditimi rezultuan 42 biznese për të cilët DRT Fier nuk u ka ndryshuar përgjegjësinë tatimore për të kaluar me TVSH, veprim jo në përputhje me Vendimin nr. 652, datë 10.11.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", neni 2, pika 1..

- Nga auditimi rezultuan subjekte që kanë ndryshuar me vonesë përgjegjësinë tatimore për të kaluar në Biznes i Madh. Konstatohet gjithashtu një monitorim jo efektiv i deklaratave mujore të qarkullimit sipas TVSh-së, me qëllim ndryshimin e përgjegjësisë. Kjo evidentohet nga kryqëzimi i të dhënave të qarkullimit sipas deklaratave mujore të TVSH, me datat e ndërrimit të përgjegjësisë dhe gjithashtu me deklarinimin vjetor të të ardhurave në deklaratën e TTHF dhe TF.

-Për një pjesë të konsiderueshme të subjekteve kërkesat për ulje të kësteve të tatim fitimit janë të pa argumentuara dhe të pa mbështetura dhe miratimi i tyre nga ana e inspektorëve është bërë pa një monitorim të plotë veçanërisht në nivelin e qarkullimit të shitjeve, ku është risku i rritjes së xhiros por jo i uljes së tatim fitimit. ((*Më hollësisht trajtuar në fq 170-206 të Raportit*).

11.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të marrë masa për vlerësimin e problematikave të nxjerra gjatë auditimit me qëllim vlerësimin e riskut sipas llojit të tatimit apo veprimtarisë së subjekteve.

Menjëherë

11.2 Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të marrë masa për hartimin e planeve mujore të punës dhe monitorimin rigoroz të tyre referuar kalendarit tatimor të deklarinimit të tatimpaguesve.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara konkretisht i kërkesave të bëra nga subjektet për lidhje të akt-marrëveshjeve, rezulton se subjektet nuk paraqesin argumente mbi aftësinë paguese në të ardhmen, veprime të cilat janë jo në përputhje me kërkesat e pikës 2, neni 77, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Nga testimet e kryera mbi data bazat e akt-marrëveshjeve të lidhura dhe atyre të anuluar për periudhën objekt auditimi janë evidentuar:

-39 raste kur nga ana e DRT Fier janë lidhur akt-marrëveshje me tatimpaguesin debitor pa respektuar pagesën paraprake prej 20% të vlerës së detyrimit;

-9 raste, ku tatimpaguesit pas pagesës së menjëhershme së para kushtit (20% të vlerës së detyrimit për të cilën lidhet marrëveshja), rezultojnë me 0 këste të paguara pas lidhjes së Akt-marrëveshjeve, duke mos zbatuar kështu kushtet e akt-marrëveshjeve për pagesë me këste dhe duke mos arkëtuar vlerën e detyrimeve për të cilën ato janë lidhur;

-Vonesa të konsiderueshme midis datës së anulimit të marrëveshjes dhe kohës kur është paguar kësti i fundit. Anulimi i akt-marrëveshjeve pas një kohe të konsiderueshme nga pagesa e fundit janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 78 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe me pikën 5.1 dhe 5.2 të Akt- marrëveshjeve të lidhura midis tatimpaguesve dhe DRT-së. *(Më hollësisht trajtuar në fq 170-206 të Raportit).*

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore, përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve të analizojnë aftësinë paguese të tatimpaguesit me qëllim arritjen e objektivave të lidhjes së saj për likuidimin e plotë të detyrimeve.

Në vijimësi

12.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore për subjektet që kanë lidhur akt-marrëveshje të monitorojë nivelin e detyrimeve të tatimpaguesve si dhe pagesat e kryera për çdo këst me qëllim përmbushjen e kushteve të marrëveshjeve dhe uljen e riskut të anulimit të tyre.

Në vijimësi

12.3 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore të marr masa të menjëhershme për anulimin e akt-marrëveshjeve që rezultojnë me shkelje.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DRT-Fier rezultoi se, nga ana e kësaj Drejtorie nuk janë ezauruar të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rezulton se nuk është marrë asnjë masë “Njoftim transferimi detyrimi palës së tretë”, “Njoftim për transferimin e detyrimit, ortakut, aksionarit, administratorit”. *(Më hollësisht trajtuar në fq 96-266 të Raportit).*

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara të marrë masa sipas përcaktimeve të legjislacionit fiskal, ezaurimin e masave shtrënguese me qëllim arkëtim e detyrimeve tatimore të papaguara.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit (*kontrolli në vend/operacional*) u konstatua se, në 26 praktika kontrolli të kryera nga DRT Fier, në subjekte tatimpagues janë evidentuar mangësi dhe parregullsi, si më poshtë:

-Në hartimin e Njoftimit për kontroll/Programit, nuk përcaktohet data e fillimit/mbarimit të kontrollit veprim jo në përputhje me Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 1.1, pika 2, germa "f" dhe Manualin për kontrollin tatimor (Manuali) Kapitulli II, pika 2.1.2 dhe germa "i".

-Mungesë dokumentacioni shoqërues të Raportit si pjesë përbërëse të tij, si p.sh. Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit apo intervista me tatimpaguesin, jo në përputhje me Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 81, pika 3, dhe UMF nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar dhe Manualin Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

-Vonesa në hedhjen e dokumenteve në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2, pika 2.8/b, Kapitulli VII, pika 7.1.

-Vonesa në përgatitjen e projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar si në disa kontrolle për rimbursim, në tejkalim të afatit 5 ditor, veprime jo në përputhje me UMF nr.24, datë 02.09.2008, pika 75.1, pika 2.5.2 dhe Manualin Kapitulli II, pika 2.1.2, apo në tejkalim të afatit 7 ditor, në kontrollet e planifikuara, veprime jo në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 i ndryshuar neni 83-84/1 dhe Manualin, Kapitulli II, pika 2.3 dhe 2.5.

-Në disa raste nuk është zbatuar programi dhe nuk është arritur qëllimi i kontrollit duke u mbuluar me analizë dhe evidencë të mjaftueshme në të gjitha drejtimet e kontrollit.

-Në disa raste, të dhënat mbi afatet për kryerje kontrolli të parashikuar në Programin e Kontrollit me ato të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk kanë përputhje. *(Më hollësisht trajtuar në fq 101-170 të Raportit).*

14.1 Rekomandimi: Nga DRT Fier, të merren masa që në hartimin e Njoftimit Kontrollit Tatimor/Programit të përcaktohet periudha e fillimit/mbarimit të kontrollit.

14.2 Rekomandimi: Nga DRT Fier të merren masa që miratimi i raporteve të kontrollit nga personat përgjegjës, të bëhet pasi të kenë përmbushur detyrimet ligjore mbi formën e paraqitjes dhe dokumentacionit bashkangjitur raportit.

14.3 Rekomandimi: Nga DRT Fier, të merren masa, që dorëzimi i raporteve të kontrollit tatimor në Zyrën e Arkiv-Protokollit të bëhet me të gjithë dokumentacionin shoqërues,

Në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit Tatimor, Rajoni Jugor, në lidhje me kontrollet e ushtruara nga kjo njësi referuar procesverbaleve të gjobave (PVGJ) të mbajtura nga inspektorët rezultojnë disa parregullsi sa vijon:

-Në dy raste inspektorët e Sektorit të Zbatimit, kanë mbajtur PVGJ në subjekt bazuar në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe konkretisht, nenin 122, pika 1, germa a(i), ndërkohë që duhej të aplikohet neni 122, pika 1, germa g.

-Në gjashtë raste, inspektorët kanë konstatuar se subjekti nuk disponon faturë shoqërimi për mallrat që mban në ruajtje dhe për këtë kanë mbajtur PVGJ bazuar në nenin 124, pika 1, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, ndërkohë që duhej të aplikohet neni 121, pika 1, germa a.

-Në katër raste, inspektorët kanë konstatuar se subjekti nuk disponon faturë shoqërimi për mallrat që mban në ruajtje dhe për këtë kanë mbajtur PVGJ, bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, ndërkohë që duhej të aplikohet neni 121, pika 1, germa b dhe Neni 124, pika 2, germa b, të këtij ligji, pasi subjektet kanë patur shkelje të përsëritur të nenit 121, pika 1, germa a.

-Në një rast, inspektorët kanë mbajtur PVGJ për subjektin sipas ligjit nr.9920, neni 122, pika 1, germa a, për mos instalim të kasës fiskale, ndërkohë që subjekti, bazuar në akt-konstatimin e grupit të kontrollit, kishte paraqitur pranë grupit të kontrollit kontratën e porosisë (pagesën

për kasën fiskale) me një nga shoqëritë e autorizuara të kasave fiskale, veprim në kundërshtim me VKM nr. 781, datë 14.11.2007 pika 15.1.

-Në një rast është mbajtur PVGJ nga inspektorët por penalteti nuk është kontabilizuar në sistemin tatimor C@TS në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 69.

-Në gjashtë raste, janë mbajtur PVGJ në kundërshtim me nenin 122, pika 1, germa b(i)/(ii), të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, nga inspektorët e kontrollit në terren, ku kanë konstatuar dhe penalizuar subjektet në kundërshtim me nenin 122, pika 1, germa b(i)/(ii), të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, ndërkohë që nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra, nuk janë kryer akt-vlerësime, ose edhe nëse janë kryer, nuk janë kontabilizuar. (Më hollësisht trajtuar në fq 239-247 të Raportit).

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Verifikimit në Terren Rajoni Jugor, të merren masa që para hartimit të akt konstatimeve, të kryhen të gjitha verifikimet përkatëse në sistemin tatimor C@TS.

15.2 Rekomandimi Nga DRT Fier, të merren masa që subjektet e evidentuara nga auditimi dhe jo vetëm, t`u ndryshohet përgjegjësia tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

15.3 Rekomandimi: Nga DRT Fier të merren masa që subjektet e evidentuara nga auditimi dhe jo vetëm, për të cilët është mbajtur PVGJ nga inspektorët e verifikimit në terren të bëhet vlerësimi përkatës tatimor si dhe tu ndryshohet përgjegjësia tatimore nëse janë penalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e kryer nga ana e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (në vend/operacional) Fier, në kuadër të planit operacional të periudhës korrik -dhjetor 2020, për zbatimin e pikës “për subjektet të cilat kanë transaksione me subjektet të cilat janë në hetim për skemë mashtrimi me TVSH-në” ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT është përcjell me shpresë informacioni mbi subjektin “B...” ShPK si subjekt i cili ka patur transaksione me tatimpagues që kanë kryer transaksione në formë të një skeme mashtrimi me TVSh-në, dhe nga kjo Drejtori është kërkuar të verifikohen transaksionet me këto subjekte. Nga ana e DRT-Fier është iniciuar një vizitë fiskale mbi këtë çështje, e cila nuk ka arritur të përmbushë objektivin e verifikimit. Në programin e vizitës fiskale nuk është përcaktuar periudha që do të kontrollohet si dhe afati kryerjes së saj. Kontrolli ka përfshirë vetëm një periudhë 18 mujore, pa arritur të vlerësojë transaksionet e dyshimta, objekt i informacionit të përcjellë.

Nga verifikimet mbi të dhënat e DRT-Fier rezultoi se, subjekt “B...” ShPK ka kryer blerje në **9 (nëntë)** tatimpagues “fiktiv” duke përfituar fatura blerje për të cilat DRT Fier, duhet të kishte kryer saktësimin dhe më pas vlerësimin e situatës financiare. Rezultatet e verifikimit nuk janë përcjellë në DPT, por as nga ky i fundit nuk evidentohen hapa të ndërmarra në kuadër të monitorimit mbi veprimet e kryera nga ana e DRT-Fier, çka tregon për një bashkëveprim dhe monitorim jo efektiv midis hallkave institucionale.

Veç subjekteve dhe transaksioneve më sipër evidentohen dhe të paktën **7 (shtatë)** subjekte nën juridiksionin e DRT-Fier të cilat kanë kryer blerje fiktive nga subjektet pjesë e skemave të mashtrimit me faturat tatimore **si më poshtë:**

Subjekti “S.T” sh.p.k, me NIPT L....

Subjekti “Z” sh.p.k, me NIPT J....

Subjekti “A.S”, me NIPT L....

Subjekti “S.R”, me NIPT L....

Subjekti “E.C”, me NIPT L....

Subjekti “Sh” sh.p.k, me NIPT K....

Subjekti “S” sh.p.k, me NIPT J....

(Më hollësisht trajtuar në fq 101-170 të Raportit).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e DRT Fier të merren masa të menjëhershme për kontrollin nga zyra/vend të subjekteve të evidentuar nga grupi i auditimit të KLSH, lidhur me skemat e mashtrimit me faturat tatimore dhe të kryhen rivlerësimet përkatëse.

Menjëherë

16.2 Rekomandimi: Nga ana e DRT Fier të trajtohen informacionet e përcjella nga DPT mbi subjektet e lidhur me skemat e mashtrimit me TVSh dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm procedural për verifikimin e tyre, duke informuar dhe organin qendror mbi rezultatet.

Menjëherë

16.3 Rekomandimi: Nga ana e DPT, në të gjitha rastet e përcjelljes së problematikave drejt institucioneve të varësisë, të merren masat për monitorimin e zbatimit të tyre. Në rastet e mosveprimit ose veprimeve të mangëta nga këto njësi varësie për personat përgjegjës të ndërmerren masat përkatëse.

Menjëherë dhe në

vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi lëshimin e vërtetimeve nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues për detyrimet tatimore të tatimpaguesve, u konstatua:

Për subjektin T.E me Nipt L.... referuar kërkesës me e-mail është lëshuar vërtetimi me nr. 511 prot., datë 06.03.2019, sipas të cilit “... për periudhën deri në 06.03.2019, nuk ka detyrim për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, taksa kombëtare, tatim i mbajtur në burim, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, ka gjoba në tatim mbi vlerën e shtuar 9,425,951 lekë dhe këste të tatim fitimit 4,276,941 lekë”.

Në vijim kjo shoqëri ka depozituar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, shkresën nr.3490 prot., datë 08.03.2019, sipas të cilës kërkohet lëshimi i vërtetimit në lidhje me detyrimet tatimore në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, sipas llojit të tatimit (*kontribute për sigurime shoqërore, tatim i mbajtur në burim, tatim mbi fitimin, taksa kombëtare, tatim mbi të ardhurat nga punësimi*). Me shkresën nr.3490/1 prot., datë 08.03.2019, lëshuar nga Drejtoria e Kontrollit dhe nënshkruar nga titullari i DRT Fier, është kthyer përgjigje në lidhje me detyrimet në vlerën 0. Shkresat e cituara më sipër kanë mospërputhje në paraqitjen e detyrimit për këstet e tatimit mbi fitimin në vlerën 4,276 mijë lekë, i cili në shkresën e Drejtorisë së Kontrollit paraqitet 0 lekë. Paga e detyrimit në fjalë ka afatin deri në datën 30 mars, por në vërtetim nuk është përmendur kjo vlerë. (*Më hollësisht trajtuar në fq 206-230 të Raportit*).

17.1 Rekomandimi: DRT Fier, Drejtoria e Kontrollit, të marrë masa që të gjitha kërkesat në lidhje me detyrimet e subjekteve t'i përcjellë në Drejtorinë e Shërbimit Tatimpagues për trajtim ku të citohen jo vetëm detyrimet por dhe afati i fundit ligjor për likuidimin e tyre.

Në vijimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT

1.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (*kontrolli nga zyra*), u konstatua se, DRT Fier nuk ka përmbushur detyrimin për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me deklaram të pasaktë të Tatimit mbi Fitimin (TF) dhe Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), veprim jo në përputhje me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a) Konstatimi i diferencave negative të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në formularin vjetor të TF me totalin e shitjeve të vetë deklaruara nëpërmjet deklaratave të TVSh –së, kjo sipas situatës financiare për periudhat 2017-2019. Përkatësisht 28 tatimpagues Biznes i Madh (BM) kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2017 në shumën 714,252 mijë lekë, krahasuar me

qarkullimin total të situatës financiare për të njëjtin vit, 27 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2018 në shumën 1,232,651 mijë lekë krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëjtin vit, 52 tatimpagues BM kanë deklaruar më pak të ardhura në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2019 në shumën 1,371,739 mijë lekë.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 995,593 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përlllogaritur nga aplikimi i TF në shkallën 15% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.

b) Në deklaratat vjetore të TF:

- për vitin 2017 u konstatuan 28 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura më shumë në këtë deklaratë krahasuar me shitjet e deklaruara në situatën financiare të këtij viti, në shumën 369,729 mijë lekë;

- për vitin 2018 u konstatuan 58 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën 825,557 mijë lekë krahasuar me shitjet e deklaruara sipas situatës financiare vjetore;

- për vitin 2019 u konstatuan 58 subjekte të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën 657,057 mijë lekë krahasuar me shitjet e deklaruara sipas situatës financiare vjetore.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 740,937 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përlllogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.

Nga DRT Fier pas konstatimit të sipërm, gjatë periudhës së auditimit në terren dhe në vijim po kryhen akt-vlerësime si dhe vetëkorrigjime deklaratave të TVSH dhe TF nga subjektet. (Më hollësisht trajtuar në fq 170-206 të Raportit).

1.1 Rekomandimi: DRT Fier/Spektori i Kontrollit nga Zyra, të marrë masa për të verifikuar subjektet e mbetur me diferenca midis deklaratave të TVSh dhe TF, referuar anekseve bashkangjitur Raportit Përfundimtar, duke nxjerr akt-vlerësimet përkatëse me qëllim arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (*kontrolli nga zyra*), u konstatua se, DRT-Fier nuk ka përmbushur detyrimin për vlerësimin nëpërmjet kontrollit tatimor për tatimpaguesit me diferenca në qarkullim sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në TTFH-s dhe TVSH-s, jo në përputhje me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a) Për bizneset e vogla pa TVSh u konstatuan 530 subjekte për vitin 2018 me qarkullim sipas kasës me vlerë 116,290 mijë lekë më tepër sesa të ardhurat e deklaruara në TTHF dhe 347 subjekte për vitin 2019 me vlerë 90,761 mijë më të lartë sesa të ardhurat e deklaruara në TTHF.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen parregullsi/mospërputhje, në të ardhurat e deklaruara për vitin 2018-2019 për 877 subjekte në vlerën 207,051 mijë lekë, por pa u shoqëruar me efekt financiar.

b) Për bizneset e vogla me TVSh, u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSh-së ku u konstatuan: 40 subjekte për vitin 2018 me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSh-s në vlerën 44,118,079 lekë.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 14,706 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përllogaritur nga aplikimi i TVSh në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.

Për vitin 2019, u konstatuan 175 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 48,649 mijë lekë.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 16,216 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përllogaritur nga aplikimi i TVSh në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.

c) Për Biznes i Madh u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-s, ku u konstatuan për vitin 2018, 36 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH-s në vlerën 95,455 mijë lekë.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 31,818 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përllogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.

Për vitin 2019 u konstatuan 28 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TVSH në vlerën 114,741 mijë lekë.

Këto diferenca, me të dhënat e vëna në dispozicion nga DRT Fier, në datën 17.11.2020 dhe të përpunuara nga grupi i auditimit vlerësohen në vlerën prej 38,247 mijë lekë të ardhura të munguara, vlerë kjo e përllogaritur nga aplikimi i TVSH në shkallën 20% dhe aplikimi i penalitetit në shkallën 100%.

Theksojmë se nga DRT Fier pas konstatimit të sipërm dhe në vijim me dërgimin e observacioneve ndaj Projektraportit, u morën masa për nxjerrjen e akt-vlerësimeve, u kryen vetëkorrigjimet e deklaratave të TVSH dhe TPTH, si dhe u krye raportimi/sistemimi i gabimeve të pajisjeve fiskale/kasave nga subjektet. ((Më hollësisht trajtuar në fq 170-206 të Raportit).

2.1 Rekomandimi: DRT Fier/Spektori i Kontrollit nga Zyra, të marrë masa për të verifikuar subjektet e mbetur me diferenca midis deklaratave të TVSh, TPTH dhe kasave fiskale, referuar anekseve bashkangjitur Raportit Përfundimtar, duke nxjerr akt-vlerësimet përkatëse me qëllim arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i akt kontrolleve në sistemin c@ts, mbajtur në datë 22.07.2020 konstatohet se subjektit K.O me Nipt L..., i është vlerësuar për vitin 2018 detyrimi i TVSh në vlerën 14,497 mijë lekë dhe i është vendosur penalitet 3,175 mijë lekë ndërsa për tatimin mbi fitimin i është vlerësuar detyrimi 518 mijë lekë dhe penaliteti në vlerën 113 mijë lekë.

Konstatohet se deklarata e TVSh-së e plotësuar në datën 23.07.2020 është vlerësuar në vlerën 4,349 mijë lekë, dhe jo në vlerën 14,497 mijë lekë, për shkak se është plotësuar rubrika 15 në vend të rubrikës 16, veprim ky që ka krijuar difference, konstatuar nga auditimi.

Korrigjimi i deklaratës së TVSh-s është bërë nga inspektori në datën 31.12.2020, duke shtuar diferencën e munguar prej 10,148 mijë lekë.

Për efekt vlerësimi tatimor duke qënë se “aktivet e blera nuk u gjenden në vendin e deklaruar të ushtrimit me vlerë prej 69,032,527 lekë u vlerësuan si të shitura me 5% të vlerës së blerë të të ardhurave të vitit 2017-2018”.

Duke qënë se për vitin 2017-2018-2019 nga ana e subjektit nuk janë dorëzuar Pasqyra Financiare, u bë kryqëzimi i librave të blerjes dhe sistemit ASYCUDA të doganës ku u konstatua si në vijim:

Subjekti ka kryer dy importe me DAV IM 5: R 9883 dhe R 9884, datë 15.09.2017, në kodin e procedurës *5500*, “Import i përkohshëm për RLP me përjashtim”, me vlerë doganore respektivisht 26,188,063 dhe 22,055,216. Artikujt e importuar sa më sipër klasifikohen në kodin tarifor *84051000* të NKM-s me emërtimin pjesë e pajisjeve për gjenerimin e azotit, të cilat janë të përjashtuara nga detyrimet doganore pasi janë mallra për tu rikthyer në origjinë. Kanë statusin e mallrave jo shqiptare, për sa më sipër nuk mund të regjistrohen në bilancë si aktive, pasi nuk kanë asnjë detyrim në legjislacionin tonë përveçse duhet të respektojnë afatet e qëndrimit sipas kriterëve të vendosura në RLP.

Për sa më sipër duke qënë se aktivet janë gjetur në vendin e tyre duhej bërë verifikimi me doganën dhe veç ngarkesës së TVSh në import që u bën dogana, nga ana tatimore ajo përbën shitje pa faturë tatimore dhe penalizohet në masën 100% të vlerës në shitje ndërsa penalteti i TF me vlerën 21.9%. *(Më hollësisht trajtuar në fq 96-266 të RAPORTIT).*

3.1 Rekomandimi: DRT Fier, Sektori i Kontrollit nga Zyra të marr masa për vlerësimin dhe rregullimin e situatës së tatimpaguesit “K.O” SHPK.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale Fier, është vepruar jo në përputhje me Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjetikës nr. 17, datë 12.06.2015 *“Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e TVSh-së, si dhe procedurat e përjashtimit”* për subjektet e përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar, nuk është dorëzuar kopje e marrëveshjes dhe kontratës, por vetëm autorizimi nga AKBN. Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat/ vlerat për përjashtim nga TVSh sipas subjekteve dhe viteve përkatëse të miratuara në autorizim dhe vlerave që rezultojnë në deklaratën e TVSh-së, kategoria “shitje të përjashtuara nga TVSh”, “shitje pa TVSh” dhe “Eksporte”, ku për subjektet sipas anekseve përkatëse në Raportin e auditimit janë vlerësuar detyrime në vlerën 12,848 mijë lekë dhe penaltet 100% në vlerën 12,848 mijë lekë. *(Më hollësisht trajtuar në fq 170-206 të Raportit).*

4.1 Rekomandimi: DRT Fier të marrë masa për rivlerësimin e detyrimit të subjekteve sipas anekseve përkatëse në raportin e auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve në buxhetin e shtetit të vlerës 12,848 mijë lekë dhe penalteteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i të dhënave të Sektorit të Informatikës mbi mospërputhjet në deklarin të situatës financiare me të ardhurat, në pasqyrat financiare, u konstatua se: 200 tatimpagues të cilët kanë kryer deklarinimin e TF 2018, nuk kanë kryer pagesën e Tatim Fitimit në vlerën **20,889 mijë lekë**, 263 tatimpagues të cilët kanë kryer deklarinimin e TF 2019 por nuk kanë kryer pagesën e tatim fitimit në vlerën **59,690 mijë lekë**, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total në vlerën **80,579 mijë lekë**. Detyrim i cili duhet të ishte arkëtuar për TF 2018 brenda datës 31.03.2019 dhe për TF 2019 brenda datës 31.03.2020. *(Më hollësisht trajtuar në fq 31-57 të Raportit).*

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Fier të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit në vlerën **80,579 mijë lekë**, nga

subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën, duke ndjekur procedurat administrative dhe gjyqësore.

Menjëherë

6.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatuan 10 subjekte që kanë përfituar nga pagesa prej 8%, ndërkohë që pagesat e tatimit mbi dividendin për vitin 2018 i kanë kryer pas datës 20 gusht 2019, jo në përputhje me ligjin nr.94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, në nenin 38 “Dispozita Kalimtare”, pika 9, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit të ardhura të munguara në vlerën **5,709 mijë lekë.** (*Më hollësisht në fq 31-57 të Raportit*).

6.1 Rekomandimi: DRT Fier të marrë masa për rivlerësimin e detyrimit të subjekteve në vlerën **5,709 mijë lekë**, sipas anekseve përkatëse në raportin e auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit (*kontrolli në vend/operacional*) për periudhën objekt auditimi, konstatohet se në kontrollet e ushtruara në subjektet tatimpagues dhe raportet e kontrollit të hartuara nga inspektorët: nuk kanë zbatuar pikat e programit të kontrollit dhe legjislacionin tatimor, pasi nuk kanë kryer rakordimin e blerjeve në formularin e deklarimit të pagesës(FDP) me ato të deklaruara në pasqyrat financiare, nuk shoqërohen me raport teknik të inxhinierit mbi punimet e kryera/situacione punimesh, nuk është bërë analiza e bilancit material përsa i përket artikujve që gjatë procesit transformohen në mallra ose shërbime referuar normativave të lejuara ligjore, nuk është dokumentuar kontrolli kronologjik i shitjeve, lidhja Faturë-Libër-FDP, nuk është bërë një analizë e thelluar e veprimtarisë së subjektit dhe nuk është bërë ndarja e aktiviteteve, etj, Veprime të cilat kanë shkaktuar **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 105,255 mijë lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 115, neni 124, ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” i ndryshuar, neni 44, neni 77, dhe Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si edhe udhëzimet e dala në zbatim të tyre, Udhëzimi nr. 19, datë 3.11.2014, konkretisht të specifikuara sipas subjekteve:

- Subjekti “G.K”, me NIPT L... me vlerën 53,555,148 Lekë.
- Subjekti “A”, me NIPT L... me vlerën 406,740 Lekë.
- Subjekti “A”, me NIPT L... me vlerën 1,314,575 Lekë.
- Subjekti “A.D”, me NIPT L... me vlerën 166,006 Lekë.
- Subjekti “K.J”, me NIPT K.... me vlerën 18,871 Lekë.
- Subjekti “F.A”, me NIPT L.... me vlerën 492,986 Lekë.
- Subjekti “B.L”, me NIPT L.... me vlerën 97,276 Lekë.
- Subjekti “SH”, me NIPT K.... me vlerën 1,270,200 Lekë.
- Subjekti “H”, me NIPT K.... me vlerën 4,704,308 Lekë.
- Subjekti “B” sh.p.k me NIPT J.... me vlerën 43,230,089 Lekë.

(*Më hollësisht trajtuar në fq 146-170 të Raportit*).

7.1Rekomandimi: DRT Fier, për tatimpaguesit e cituar më sipër, për të cilët nga auditimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit tatimor, të llogaritura të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën **105,255 mijë Lekë**, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor dhe të marrë masa për kryerjen e një vlerësimi tatimor.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raport kontrolleve të plota dhe tematike, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, të cilat janë përzgjedhur për auditim u konstatua se: inspektorët e kontrollit nuk kanë zbatuar pikat e programit dhe të manualit të kontrollit dhe legjislacionin tatimor pasi nuk kanë kryer rakordimin e blerjeve në FDP me ato të deklaruara në pasqyrat financiare, nuk janë kryer analizat e shitjeve apo rritjes së çmimit, nuk kanë verifikuar diferencën tatime / dogana, konstatohen diferenca në inventar, nuk kanë analizuar saktë edhe në ato raste kur është kryer bilanci material, nuk janë kryer analizat e shpenzimeve për zërat kryesore të zhvillimit të aktivitetit referuar kartës teknologjike, nuk pasqyrojnë në raport kontrolli situacionet e punimeve. Veprimet e sipërme kanë shkaktuar **të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 24,419,117 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 117, neni 124, ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar ne RSH” i ndryshuar, neni 51, neni 52, neni 53, neni 54, neni 71, neni 72, dhe udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar ne RSH”, ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si edhe udhëzimet e dala në zbatim të tyre, Udhëzimi nr. 19, datë 3.11.2014, analitikisht paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr	Subjekti	Nipti	Diferenca
1	S.F	L...	5,681,105
2	F.B	L....	3,320,188
3	R...	K...	7,367,535
4	A.K	K...	872,369
5	B.S	K...	700,513
6	F.K	L...	3,829,376
7	S	K...	700,096
8	D.F	L...	1,947,934
9	S.F	L....	5,681,105
	Totali		24,419,117

(Më hollësisht trajtuar në fq 121-146 të Raportit).

8.1Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, për 9 tatimpaguesit e cituar më sipër, për të cilët nga auditimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit tatimor, në vlerën **24,419 mijë lekë**, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor dhe të marrë masa për kryerjen e një vlerësimi tatimor.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e kryer nga ana e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (në vend/operacional) Fier, në kuadër të planit operacional të periudhës korrik-dhjetor 2020, për zbatimin e pikës “për subjektet të cilat kanë transaksione me subjektet të cilat janë në hetim për skemë mashtrimi me TVSH-në” ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, është përcjell me shkresë informacioni mbi subjektin “B...” SHPK, si subjekt i cili ka patur transaksione me tatimpagues që kanë kryer transaksione në formë të një skeme mashtrimi me TVSh-në, dhe nga kjo drejtori është kërkuar të verifikohen transaksionet me këto subjekte. Nga ana e DRT-Fier është inicuar një vizitë fiskale mbi këtë çështje e cila nuk ka arritur të përmbushi objektivin e verifikimit. Në programin e vizitës fiskale nuk është përcaktuar periudha që do të kontrollohet si dhe afati kryerjes së saj. Kontrolli ka përfshirë vetëm një periudhë 18 mujore, pa arritur të vlerësojë transaksionet e dyshimta, objekt i informacionit të përcjell. Nga verifikimet mbi të dhënat e DRT-Fier rezultoi se, subjekt “B...” SHPK ka kryer blerje në 9 tatimpagues “fiktiv” duke përfituar fatura blerje për të cilat DRT-Fier duhet të kishte kryer saktësimin dhe më pas

vlerësimin e situatës financiare e cila krijon një efekt financiar të munguar që llogaritet në vlerën rreth **43,230 mijë lekë**. Rezultatet e verifikimit nuk rezultojnë të jenë përcjellë nga DRT-Fier drejt organit qendror por as nga ky i fundit nuk evidentohen hapa të ndërmarra në kuadër të monitorimit mbi veprimet e kryera nga ana e DRT-Fier cka tregon për një bashkëveprim dhe monitorim jo efektiv midis hallkave institucionale. *(Më hollësisht trajtuar në fq 165-170 të Raportit).*

Rekomandimi: Nga ana e DRT-Fier të merren masa për rivlerësimin e situatës financiare të subjektit B... me qëllim arkëtimin e detyrimeve përkatëse në vlerën **43,230 mijë lekë**.

Menjëherë

10.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit për subjektin tatimpagues “B...”, “E...” dhe “R...” konstatohet:

-mos verifikim i burimit të huasë nga subjekti/ortaku, (“B...”) pasi Raporti nuk shprehet mbi rritjen prej **39,039 mijë lekë** që ka pësuar në pasqyrat financiare/pasivi për vitin 2018, llogaria “Detyrimet afatshkurtra” në zërin “hua të tjera”, ku rezulton vlera prej 74,689 mijë lekë ndërkohë që në vitin paraardhës 2017, ky zë rezulton në vlerën 35,650 mijë lekë. Rritja e vlerës argumentohet “*si pasojë e shtimit të inventarit*”. Gjithashtu dhe nga verifikimi në sistemin C@TS, rezulton që fitimi për këtë subjekt për periudhën nga 2015-2018 është në total në vlerën 10,735 mijë lekë, dhe nuk rezulton që ortaku i subjektit të jetë aksioner në ndonjë subjekt tjetër, kjo dhe nga verifikimi i deklaratave individuale.

-mos raportim RAD (*Raportim i aktivitetit të dyshimtë*) në organet kompetente jo në përputhje me ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe me UMF nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 2, pika 3 dhe neni 5.

-mos verifikim i rritjes së huasë në vlerën **32,765 mijë lekë** (“E...”) në pasqyrat financiare të vitit 2016, e për pasojë asnjë analizë mbi tatim fitimin apo tatimin në burim, ku nga subjekti është deklaruar në llogarinë “detyrimet afatshkurtra” zërin “të tjera të pagueshme” vlera prej 97,000 mijë lekë krahasuar me vitin paraardhës 2015, që ishte 64,243 mijë lekë, por analizohet vetëm si “*hua të tjera në shumën 97,000,000 lekë që përfaqësojnë detyrime ndaj të tjerëve*”,

-mos dhënie informacioni në Raport, nëse huatë janë transferuar përmes sistemit bankar apo deklaratave të ligjshme mbi huamarrjen,

-mos raportim RAD (*Raportim i aktivitetit të dyshimtë*) në organet kompetente jo në përputhje me ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 i ndryshuar, neni 18.1 dhe UMF nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

-mos verifikim i rritjes së huasë në vlerën **97,895 mijë lekë**, në bilancin e shoqërisë (R...) në lidhje me **huatë e mëdha** (Zëri “Detyrime të tjera”), që janë në vlerë më të lartë se edhe vetë kreditë bankare formale të marra në institucionet e kredisë (kredi afatshkurtër dhe kredi afatgjatë), (viti 2017 vlera e huasë është 255,114 mijë lekë, viti 2018 vlera e huasë është 353,009 mijë lekë),

-nuk ka informacion nëse vlerat e huasë janë të kaluara jashtë apo nëpërmjet sistemit bankar si dhe nuk është dhënë informacion mbi kushtet që është marrë ky borxh.

-nuk është verifikuar burimi i këtyre huave të deklaruara, me të cilën lidhet ngushtë tatim fitimi apo tatimi në burim. *(Më hollësisht trajtuar në fq 112-133 të Raportit).*

10.1 Rekomandimi: Nga DPT Fier të merren masa, për dërgimin e informacionit RAD, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pas konstatimit të bërë nga KLSH, mbi burimin e

fitimit për vlerën **39,039 mijë lekë**, që përfaqëson rritjen llogarisë së ortakut të subjektit tatimpagues “**B...**” ShPK.

10.2 Rekomandimi: Nga DRT Fier, të merren masa, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pas konstatimit të bërë nga KLSH, mbi burimin e fitimit për vlerën **32,765 mijë lekë**, që përfaqëson rritjen që ka pësuar huaja krahasuar me vitin 2015, për subjektin tatimpagues “**E...**” ShPK.

10.3 Rekomandimi: Nga DRT Fier të merren masa, për dërgimin e informacionit RAD në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pas konstatimit të bërë nga KLSH, mbi burimin e fitimit për vlerën **97,895 mijë lekë**, që përfaqëson rritjen që ka pësuar huaja krahasuar me vitin 2017 për subjektin tatimpagues “**R....**” ShPK.

Menjëherë

D.MASA DISIPLINORE

I. Bazuar në Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” i ndryshuar neni 15, germa “ c”, i rekomandojmë Titullarit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, pasi të ketë analizuar përgjegjësitë e personave përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara në praktikën e kontrollit operacional të trajtuara gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, faqe 100-164, mbështetur në ligjin nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 57, 58 dhe 59, marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga shërbimi civil**” për punonjësit më poshtë në cilësinë e inspektorit në Drejtorinë e Kontrollit:

1. M.U
2. J.H
3. E.F
4. G.M
5. A.K
6. A.H
7. D.S
8. A.Q
9. G.LL
10. A.G
11. A.K
12. S.Z
13. A.H

II. Për punonjësit e tjerë të atakuar në këtë Raport, të analizohen dhe vlerësohen nga Titullari i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pasi të zbatohen procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmerren veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

I. Për ish punonjësit e mëposhtëm në cilësinë e inspektorit të kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit, nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “vërejtje” përkatësisht:

1. G.B
2. A.M
3. A.K
4. J.GJ
5. F.Rr
6. GJ.K
7. K.LL
8. K.K
9. R.C
10. R.B
11. V.V
12. V.V

II. Për z. O.C, në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal Fier, të përcillet kopje e Raportit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vlerësimin e përgjegjësive në lidhje me procedurën e ndjekur për delegimet e punonjësve (Z.SH) të kryera në kundërshtim me legjislacionin e nëpunësit civil pasi adresimi institucional i tij është në këtë drejtori. DPT, është përgjegjës për menaxhimin e strukturës së administratës tatimore për plotësimin në kohë të vendeve të lira me qëllim shmangien e anomalive në delegimin e punonjësve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT